



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 14, 19, 28 QERSHOR DHE 12, 23, 26 KORRIK 2018

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 14, 19, 28. JUNA I 12, 23. I 26. JULA 2018. GODINE

QERSHOR/KORRIK - JUN/JUL  
2018

## **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Interpelancë me ministren e Integritimit Evropian, znj. Dhurata Hoxha, në lidhje me zbatimin e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) për kuartalin e katërt (K4) 2017 dhe kuartalin e parë (K1) 2018,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aktet juridike,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin në Vlerën e Shtuar,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,
9. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017,
10. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017,
11. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin 2017,
12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017,
13. Propozimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyeseve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës,
14. Propozimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më 29 mars 2018,
15. Debat parlamentar në lidhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021.

## Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Interpelacija sa ministarkom za evropsku integraciju, Dhurata Hoxha, o sprovođenju Nacionalnog programa u vezi Sporazuma o stabilizaciji-pridruživanju za četvrti kvartal (K4) 2017 i prvi kvartal (K1) 2018,
4. Prvo razmatranje N/zakona o pravnim aktima,
5. Prvo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 05/L-028 o porezu na lične dohotke,
6. Prvo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 05/L-029 o porezu na dohotke korporacija,
7. Prvo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 05/L-037 o porez na dodatnu vrednost,
8. Drugo razmatranje N/zakona o rudnicima i mineralima,
9. Razmatranje godišnjeg finansijskog izveštaja o budžetu Republike Kosova za 2017,
10. Razmatranje godišnjeg izveštaja Agencije za menadžiranje memorijalnih kompleksa za 2017 godinu,
11. Razmatranje godišnjeg izveštaja Kosovskog saveta za kulturno nasleđe za 2017,
12. Razmatranje godišnjeg izveštaja Državne agencije za zaštitu ličnih podataka za 2017 godinu,
13. Predlog za formiranje Anketne parlamentarne komisije u vezi imenovanje visokih civilnih službenika u državnoj administraciji Republike Kosova,
14. Predlog za formiranje Anketne komisije u vezi rasvetljavanja slučaja proterivanja šest turskih državljana , 29. marta 2018 godine,
15. Parlamentarna debata u vezi Srednjoročnog okvira troškova za period 2019- 2021.

## **Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.**

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Tani hyjmë në seancën e re, po e fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

### **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

E dini që koha është 30 minuta dhe dua t'ju them që asnjë minutë më shumë s'ka për të zgjatur diskutimi.

Në radhë është paraqitur zoti Haxhi Avdyli.

HAXHI AVDYLI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Derisa kjo Qeveri po fal miliona për borxhlinj të ndryshëm në veri e jug, derisa falen edhe 53 milionë për Bechtel-Enka, e ndahen qindra-mijëra euro për pushime në deti e koncerte, sot dola para jush për të ngritur zërin e shtresës më të harrur dhe më të dëmtuar në vendin tonë, për pacientët.

Sot, kur i vetmi debat është se sa u shumëfishuan pagat për qeveritarët, askush nuk po pyet se sa po shumëfishohen çdo ditë shpenzimet për barna nga qytetarët tanë. Sot në spitale tona po mungojnë barnat më bazike, e të mos flasim për barnat më specifike. Familjet kosovare në heshtje po shpenzojnë kursimet familjare për shërim dhe duke u lënë në mëshirë të tregtarëve të barnave. Përkundër rritjes së buxhetit, furnizimi me barna aspak nuk është përmirësuar. Nëse shikojmë gjendjen pa zbukurime, kushtet në spitalet tona janë më të këqijat në rajon, pritjet për ekzaminime radiologjike dhe për operacione janë shumë të gjata, sot i vetmi qytetar i Evropës pa sigurime shëndetësore mbetet qytetari i Kosovës dhe si është duke shkuar dinamika e reformave në shëndetësi, ai do të mbetet edhe një kohë të gjatë pa sigurime shëndetësore.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Reforma në shëndetësi ka ngecur, sistemi i informimit shëndetësor si pararendëse e sigurimeve shëndetësore po kthehet në pikën zero. Ligji për shëndetësi, si ligji bazik i planifikuar në agjendën legjislative për plotësim dhe ndryshim, akoma nuk ka ardhur as në komision dhe është larg për t'u plotësuar dhe ndryshuar. Ligji për sigurimet shëndetësore po ashtu ka ngecur dhe shpresa për një reformë të re në sektorin e shëndetësisë po zbehet çdo ditë e më shumë. E vetmja që mund të ndodhë është reforma, duke filluar mbledhja e premieeve nga qytetarët, por pa siguruar shërbime cilësore për ta. Reforma nuk është vetëm prerja e shiritave, e projekteve dhe investimeve të qeverive të kaluara, por as ndërtimi i spitaleve megalomane të mëdha, derisa shfrytëzueshmëria e shtretërve të spitaleve ekzistuese është ende e ulët.

Me milionat në beton dhe armaturë do të mund të siguronim furnizim 100% me barna e material shpenzues, do të bënim pajisje më moderne, do të përmirësonim inventarin për pacientë dhe personel dhe do ta hiqim listën e pritjes. Me milionat të investuara në beton do të përmirësonim edhe indikatorët shëndetësorë me investimin në promovim e edukim shëndetësor, por edhe investimin në mjekësinë familjare.

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Regjia, në emër të grupit e ka!

HAXHI AVDYLI: Prandaj, të nderuar deputetë, po shihet se reforma për sistemin shëndetësor ka ngecur, por sot këtu jam para jush për të bërë një apel për kryeministrin e Kosovës, për ministrin e Financave, për ministrin e Shëndetësisë që të ulen dhe të gjejnë një fond emergjent që do të shkonte në përmirësimin e furnizimit të barnave. Kjo nuk do të ishte shpëtimi i sistemit shëndetësor, por vetëm do të ishte një infuzion që do ta shpëtonte këtë sistem nga kolaps. Prandaj, ky investim do të ishte dhe një ndihmë e madhe për taksapaguesit kosovarë, të cilët tani për tani janë në nevojë dhe po kanë shpenzime enorme nga xhepat e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Veselaj-Gutaj, në emër të grupit parlamentar e ka fjalën.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Çështja për të cilën unë sot do të diskutoj ka të bëjë me shqetësimet e qytetarëve të Prishtinës.

Partia Demokratike në vazhdimësi ka përcjellë mënyrën e qeverisjes në Prishtinë. Duke qenë se Prishtina na përfaqëson të gjithëve si kryeqytet, dëshiroj të them se jemi të shqetësuar me zhvillimet e fundit në Komunën e Prishtinës. Publikimi i përgjimeve të zyrtarëve të lartë të Lëvizjes Vetëvendosje në krye me Albin Kurtin, të cilët janë përfshirë në një aferë pazaresh në pronën komunale, tregon më së miri se si ka vepruar kjo parti dhe qeverisja e kaluar komunale me Prishtinën. Në fakt, e gjitha tregon dhe faktin atë që PDK-ja e ka thënë vitin e kaluar në disa raste dhe atë e ka prezantuar edhe me fakte.

Çfarë po del tash është pothuajse e njëjta, por me fakte plotësuese dhe më inkriminuese. Protagonistët e këtij përgjimi, Nexhat Kryeziu drejtor i ndërmarrjes banesore në Prishtinë, ish-kandidat për deputet dhe ish-kandidat për kryetar komune të Malishevës nga Lëvizja Vetëvendosje dhe i dyti Liridon Latifi kryesues i bordit të kësaj ndërmarrjeje dhe aktivist i dhunshëm i Lëvizjes Vetëvendosje. Anulimi i konkursit për dhënien me qira për lokalet afër Katedrales në Prishtinë, për shkak se dy militantë të Lëvizjes vetëvendosje nuk kanë përfituar në

këtë konkurs e tregon qartë, se jo vetëm në ndërmarrjet publike banesore, por edhe në të gjitha institucionet e komunës së Prishtinës është manipuluar kështu, duke rehatuar militantë partiakë dhe duke dhënë tenderë bizneseve mbështetëse të Lëvizjes Vetëvendosje.

Siç e dimë të gjithë, vetëm në mandatin e parë mbi 400 aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje janë rehatuar nëpër pozita të ndryshme në konkurse të ndryshme komunale, të cilat janë shpallur nga Komuna e Prishtinës.

Protagonisti Liridon Latifi në audio-incizimin thotë se konkursi duhet të rrëzohet dhe t'u rriten pikët këtyre dy aplikuesve që përmenden si financues dhe mbështetës të Lëvizjes Vetëvendosje. Keqpërdorimi i zyrtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje me pushtetin eliminoi 190 biznese që kishin aplikuar për marrjen me qira të lokaleve të Komunës së Prishtinës në Lagjen Pejton. Ky veprim i zyrtarëve të lartë të Lëvizjes Vetëvendosje, sigurisht me urdhrin e Albin Kurtit tregon se ky subjekt politik ka tentuar të rrënojë çdo gjë në këtë vend për të ardhur në pushtet e përmes pushtetit të keqpërdorë edhe më shumë. Si pasojë e këtyre veprimeve qytetarët e Prishtinës, si në mandatin e kaluar edhe në këtë mandat, po vuajnë nga padrejtësitë që po u bëhen ndërtuesve dhe bizneseve, ndërsa qytetarët e rëndomtë po marrin shërbime jashtëzakonisht të dobëta nga Komuna e Prishtinës.

Kërkojmë nga organet e rendit dhe të drejtësisë të zhvillojnë hetime dhe keqpërdoruesit e pozitave zyrtare, që janë brenda institucioneve të Komunës së Prishtinës dhe këta të vihen para drejtësisë.

PDK-ja në Prishtinë nuk do të përkrahë sjelljen hakmarrëse që po bën Lëvizja Vetëvendosje kundër PSD-së dhe Shpend Ahmetit, siç nuk do të përkrahë as neglizhencën dhe ikjen nga përgjegjësia që po e bën kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti. Gjithashtu, nga asamblistët tanë në Komunën e Prishtinës kemi mësuar se kryetari i Prishtinës, pra i kryeqytetit, po injoron në tërësi Kuvendin Komunal dhe po ikë nga përgjegjësia që e ka me shumë probleme. Kërkojmë që Shpend Ahmeti të përgjigjet për situatën e krijuar në Komunën e Prishtinës si dhe të silltet me përgjegjësi vendimmarrëse për 100 probleme të qytetarëve të Prishtinës. I sigurojmë të gjithë qytetarët e Prishtinës, se Partia Demokratike nuk do të jetë parti bllokuese në Kuvendin Komunal të Prishtinës, përkundrazi aty ku kërkohet ndihmë nga ne si Parti Demokratike do të ndihmojmë dhe do të mbrojmë të gjitha interesat e qytetarëve të Prishtinës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Në emër të Lëvizjes kush e ka? Zonja Haxhiu e ka fjalën.

**ALBULENA HAXHIU:** Para tri ditësh, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese Arta Rama Hajrizi, Bekim Sejdiu, Snezhana Botusharova, Altai Surroi, Ivan Çukallovic dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, na njoftuan se kishin vendosur që vendimin skandaloz dhe të paligjshëm të Qeverisë Haradinaj për rritjen e pagave për vete ta shpallin kushtetues.

Nuk shkuan as 24 orë Qeveria Haradinaj para gjithçka tjetër u ngut për ta jetësuar atë vendim skandaloz. Ky veprim dëshmon se Qeveria Haradinaj është Qeveri e zhatjes, është Qeveri e abuzimit të parasë publike edhe me këto rritje në shpërputhje me gjendjen socio-ekonomike, por edhe me faljen e milionave Kompanisë Behtel&Enka, por edhe me numrin e zëvendësministrave, këshilltarëve e tani edhe të koordinatorëve.

Në muajin shkurt të këtij viti kjo Qeveri e pakicës shërbyesve civilë ua rriti pagën vetëm 4%, pra nga 400 në 416 euro. Ndërsa, kategorive të ndihmave sociale në 20% dhe në anën tjetër, kundërshtoi propozimin e Këshillit Ekonomik Social për ngritjen e pagës minimale nga 170 në 250 euro. Shtrohet pyetja, se a është ndihmë sociale 90 euro në muaj? Pra, dikush që nuk ka as pronë e as të ardhura në familje i merr 90 euro në muaj, ndërsa kryeministri 3000 euro në muaj. Si mund të ju shërbejë këtyre personave ky kryeministër nëse të hyrat vjetore të një familjeje me ndihmë sociale janë 1080 euro, ato të kryeministrit sipas deklaramentit të fundit të pasurisë, janë mbi 100 000 euro, pra njëqindfish më shumë se një familje që jeton në ndihmë sociale.

Teksa shërbyesve civilë ua rritën pagën 4%, kategorive sociale 20%, vetes ia rritën 100%. Shtrohet pyetja, pse nuk e rritën 100% ndihmën sociale, apo pensionet, apo pagat e shërbyesve civilë? Çfarë kuptimi ka që mësuesi a profesori, që na i përgatisin fëmijët e të rinjtë, të paguhet sa 1/3-ta e pagës së një këshilltari nëpër kabinete kryeministrash apo një zjarrfikës që e ka pagën 300 euro, që përditë i rrezikohet jeta, e ka pagën katër ose pesëfish më të vogël se këshilltari i Haradinajt. Paga mesatare sot në Kosovë është pak më shumë se 400 euro. I bie që kryeministri e ka pagën shtatëfish më shumë se një punëtor me pagë mesatare 400 euro.

Dje në konferencë për medie kemi bërë një krahasim ndërmjet pagave të kryeministrave në vendet në Ballkan dhe ka një shpërputhje të madhe. Për shembull, kryeministri i Maqedonisë e ka pagën 1300 euro, ajo e Serbisë e ka 1000 euro, Shqipëria 1700 euro, Mali i Zi 1130 euro, ndërsa Kosova 3000 euro, ndonëse shumë prej këtyre vendeve e kanë shumë më të madhe pagën mesatare, se sa që e ka Kosova. Arsyetimi i sërishëm i Haradinajt se me paga të larta nuk korruptohet është banal. Kur dikush ka vendosur të korruptohet nuk e shpëtojmë duke ia rritur pagën, qoftë edhe 3000 euro, sepse ryshfeti ndaj të cilit është i ekspozuar është me miliona euro, ndaj mbi një mesatare që nevojitet për jetë të dinjitetshme si zyrtar publik, çdo shifër tjetër nuk garanton ndershmëri. Nuk ka asnjë vend që ndershmërinë e zyrtarit publik e blen me pagë të lartë.

Ata që kanë pasion për të bërë para, nuk e kanë vendin në sektorin publik e sidomos jo në politikë, sepse ky pasion për paratë nuk është i përputhshëm me detyrën zyrtare edhe sikur Kosova të ishte vend i pasur.

Të dashur qytetarë,  
Të nderuar deputetë,

Me këtë Qeveri duket se e keqja po normalizohet. Secila ditë mbulohet me nga një skandal tjetër, përfshirë këtu edhe skandalin me largimin me forcë të një zonje nga foltorja në përvjetorin e 140 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Kjo Qeveri e pakicës për t'u ndalur duhet të rrëzohet me votë këtu në Kuvend. Andaj, në emër të Grupit Parlamentar më duhet me e theksua faktin që neve na duhet një bashkim opozitar, por po ashtu edhe qytetar për t'i ndalë dëmet e kësaj Qeverie. Këtë Qeveri duhet ta ndalim, andaj na duhet një përbashkim edhe i opozitës edhe i qytetarëve të Republikës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! PSD-ja, zoti Salih Salihu është i paraqitur.

**SALIH SALIHU:** Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

I nderuar kryesues,

Sot dua të flas për Policinë e Kosovës e cila përkujdeset për ruajtjen e rendit dhe qetësisë në Kosovë, duke siguruar kështu zhvillimin normal të jetës në këtë periudhë të vështirë të tranzicionit të pasluftës në Kosovës.

Duhet theksuar, se përveç popullatës së gjerë e cila po i vuan pasojat e keqkeqverisjeve të njëpasnjëshme të pasluftës është edhe Policia e Kosovës e cila po ballafaqohet me sfida të rënda për të kryer detyrat e veta, konform obligimeve ligjore që kanë. Sot Policia e Kosovës është e vetmja polici në Botë, që nuk kanë sigurim shëndetësor dhe sigurim jetësor. Në krye të detyrës shumë herë policët e Kosovës kanë qenë të rrezikuar apo janë lënduar dhe mungesa e sigurimit shëndetësor dhe jetësor kanë vështirësuar trajtimin e tyre mjekësor apo të shërbimit për familjarët e policëve që kanë humbur jetën.

Që nga themelimi i Policisë së Kosovës deri më tani 17 pjesëtarë të saj kanë humbur jetën në vendin e tyre të punës, kurse numri i policëve të lënduar në krye të detyrës konsiderohet të jetë shumë i lartë. Së fundmi, kemi rastin e humbjes së jetës së dy policëve të Kosovës gjatë kryerjes së detyrës zyrtare në rrugën magjistrale Hani i Elezit - Kaçanik. Përveç kësaj, Policia e Kosovës nuk ka as kushte të mjaftueshme infrastrukturore dhe logjistike për ta kryer shërbimin e vet ashtu siç duhet. Shumica e stacioneve policore nuk kanë vetura të mjaftueshme për të patrulluar në terren, madje veturat e tyre janë ndër më të pasigurtat në aspektin teknik, sidomos në mekanizmin e frenave dhe gomave të shpenzuara.

Të shpeshta janë rastet, kur veturat e Policisë së Kosovës qarkullojnë në rrugë me një dritë, sepse tjetra nuk punon, duke rrezikuar kështu edhe veten edhe qytetarët e Republikës së Kosovës.

Përveç tjerash, stacionet policore do të duhej të kenë furnizim të mjaftueshëm me material shërbyes e logjistik, si: printerë, kompjuterë, e aparat fotografik. Është e papranueshme që



punonjësi policor në mungesë të tonerit të detyrohet të shkojë të shtypë një vendim në gjykatë apo te ndonjë shërbyes tjetër privat. Shumica e objekteve të stacioneve policore në Kosovë duket se janë shkatërruar dhe më aty nuk kushte elementare për zhvillimin normal të punës.

Unë po e sjell vetëm shembullin e Stacionit Policor të Vitisë, objekti i të cilit është mbi 50 vjet i vjetër dhe thuaja se që nga ndërtimi nuk është bërë asnjë investim përbrenda. Besoj se e njëjta gjë është edhe në stacionet policore tjera në Kosovë. Mungesa e inventarit, dhomat me plato nga betoni, të dëmtuara e të vrimëzuara nga minjtë, mungesa e nyjave sanitare, tregojnë se aty mungojnë kushtet elementare për punë, madje duke rrezikuar edhe shëndetin e punonjësve policorë.

Prandaj, duke pasur parasysh rolin e Policisë së Kosovës në angazhimin e tyre në shërbim të vendit, si dhe natyrën e punës që kanë, kërkoj nga Qeveria që të ndërmarrin hapa të shpejtë në rregullimin e sigurimit shëndetësor dhe jetësor të policëve të Kosovës, të krijojnë kushte normale për punë dhe të ofrojë kushte normale për punë dhe të ofrojë mjete të mjaftueshme logjistike për shërbimin policor, të ofrojë transport për policët që shërbejnë jashtë komunës së vet, sepse është e papranueshme që një punonjës policor të presë në rrugë tre-katër stacione duke stopuar derisa të mbërrijë ai në shtëpinë e tij.

Gjithashtu, kërkoj nga ministri i Punëve të Brendshme, që të bëjë një vizitë në Stacionin Policor të Vitisë për ta parë së afërmi se në çfarë kushtesh punojnë Policia e Kosovës aty dhe ngjashëm mendoj punojnë edhe kolegët e tyre nëpër stacione tjera policore.

Të nderuar kolegë deputetë,

Punonjësit e Policisë së Kosovës, përveç që janë zyrtarë të shtetit, ata janë para së gjithash qytetarë të Republikës së Kosovës, ata janë prindër, ata kanë familje, prandaj shteti, Qeveria, sikurse që kërkojnë përgjegjësi nga ta, njëkohësisht kanë obligim ndaj tyre për t'ua siguruar kushtet e nevojshme për punë, që ta përmbushin misionin e tyre ashtu siç duhet. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Rasim Selmanaj e ka fjalën. A je në emër të grupit apo individual?

**RASIM SELMANAJ:** Faleminderit! Në emër timin personal.

**KRYESUESI:** Mirë! Tre minuta!

**RASIM SELMANAJ:** Të nderuar kolegë deputetë,

Unë sot dëshiroj të ngre një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme, pra çështjen e Pushimores së Fëmijëve në Deçan. Një kompleks jashtëzakonisht i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e ekonomik të komunës së Deçanit.

Aty dikur kanë pushuar fëmijët e krejt Kosovës, të ish-Jugosllavisë, por edhe më gjerë. Është një kompleks jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse ofron mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, qoftë ato të karakterit lokal por edhe atij shtetëror. Interesi edhe më i madh publik për komunën e Deçanit është se nga kjo qendër do të realizoheshin edhe të hyra në aspektin financiar, si dhe do të krijohen mundësi për punësimin e një numri të madh të të papunëve.

Ky kompleks gjeografikisht gjendet afër tri ngastrave tjera, për të cilat komuna në vitin 2015 ka marrë vendim që pushimoren ta shpallë zonë me interes publik përfshi këtu edhe zonën kadastrale “Hulaj” me numër 71, 72 dhe 74. Prandaj, kërkesa ime e thjeshtë është që Pushimorja e Fëmijëve në Deçan të mos nxirret në privatizim dhe Qeveria me vendim të veçantë t’ia kthejë në menaxhim Komunës së Deçanit.

Dëshiroj të them se në kohën kur kam qenë kryetar i Komunës së Deçanit, më datë 16. 8. 2016 këtë kërkesë ia kam drejtuar AKP-së me arsyeshmërinë me kërkesën që realisht është bërë në atë kohë. Po ashtu, komuna e ka ripërsëritur të njëjtën kërkesë.

E ripërsëris, kërkoj që Qeveria me vendim të veçantë t’ia kthejë në menaxhim Komunës së Deçanit. Prania e KFOR-it afër Manastirit mendoj se duhet të shikohet që ky objekt të ruhet nga Policia e Kosovës, sepse prania e Policisë së Kosovës dhe fëmijët e krejt Kosovës aty dhe po ashtu, edhe të rajonit dhe të Evropës, do të ishte një siguri më e madhe për Manastirin e Deçanit dhe të njëjtën kohë një mundësi më e madhe për zhvillimin ekonomik dhe të turizmit të Komunës së Deçanit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Unë dola në foltore për të dhënë disa nga mendimet, kuptohet në emër të Nismës Socialdemokrate, pak edhe i inspiruar nga shoku Reçica, por gjithsesi edhe nga ambienti dhe atmosfera që është krijuar në institucione, duke filluar nga Kuvendi.

Kur thash nga shoku Reçica, më garantoi që edhe një vit s’ka zgjedhje kështu që unë kam një ide publike për të gjitha institucionet, duke përfshirë Kuvendin në radhë të parë, por gjithsesi edhe Qeverinë. Ne për të mos vazhduar këtë ambient të rëndë në Kuvendin e Kosovës, mendoj se duhet përfunduar Rregullorja e punës, sepse ka vite që sorollatet nëpër duart e komisioneve dhe të deputetëve, kurse defektet dhe hapësirat në Rregullore të punës bëjnë që Kuvendi të ketë edhe atmosfera jo të këndshme, deri edhe në përplasje të panatyrshme.

Gjithsesi, mendoj se një varg çështjesh duhet të rregullohen ku Qeveria duhet ta ketë fjalën e vet, por meqë Qeveria i ka gërhërët nëpër duart sot, besoj se do të na dëgjojë. Kosova ka nevojë të

ketë Ligj për Qeverinë. Nuk e kam fjalën veç për këtë Qeveri, kushdo edhe nesër në të ardhmen. Se, në rast se ne nuk kemi ligj për Qeverinë, kam përshtypjen se në mandatin e ardhshëm kemi me i pas 30 apo 40 ministra. Përfundimisht mendoj se ne duhet t'i kthehemi realitetit dhe funksionimit normal të Republikës. Nga zhvillimet që po i përjetojmë, edhe se deputetë, edhe si qytetarë, mendoj se duhet të ndërhyhet në Ligjin e protokollit të shtetit. Nuk është fjala veç për ngjarjen në Prizren ku ka dështuar protokollit i shtetit, por protokollit i shtetit ka dështuar edhe në dhjetëvjetorin e kujtimit dhe përkujtimit të Pavarësisë së vendit. Ka dështuar edhe në shumë momente të tjera, ku kemi pasur të bëjmë me vizita të ndryshme të burrështetasve, veçanërisht nga Perëndimi. Prandaj, unë mendoj se Ligji për protokollin e shtetit duhet të jetë në mesin prioriteteve.

Ajo që gjithsesi na bën jetën të rëndë është papërgjegjësia e agjencive të pavarura dhe mendoj se kjo çështje duhet të rregullohet me ligj, për shkak se ne kemi mbi 40 agjenci të pavarura, që nënkupton 40 mini-qeveri në shtetin e Kosovës. Kurrfarë logjike, kushdo qoftë që është kryeministër, ose edhe pretendon të jetë kryeministër, nuk mund të qeverisë me këtë vend nëse i ka 40 mini-qeveri që nuk i japin llogari askujt. Cili prej pretendentëve për të qeverisur vendin mund të premtojë diçka qytetarëve, kur paraprakisht e di se është veç për fushatë elektorale. Arsyeja tashmë është publike. Kemi agjenci që në rast se në një moment Qeveria ndërhyt, automatikisht zgjohet kureshtja dhe reagimi i opinionit, se po ndërhyhet në agjenci të pavarur. Nuk mund të ketë zhvillim ky vend, në rast se Agjencia për Privatizim është shtet brenda shtetit. Kush mund të parashohë, cili kryeministër, zhvillimin e vendit në një sektor të caktuar në këtë rast tashmë po dihet bujqësia si prioritet i prioriteteve, kur Agjencia e privatizimit i qet pikërisht ato prona, ose ato hapësira në shitje dhe i shet për një expresso.

Mendoj se tashmë u fol edhe në këtë seancë dhe ka kohë që flitet, Ligji për pagat në sektorin publik. Nuk mund të ketë në sektorin publik 400 paga të ndryshme, në variante të ndryshme. Mendoj se në rast se ne nuk marrim masa në këtë drejtim si institucione, duke u nisur prej Kuvendit, po veçanërisht Qeveria, ne do të vazhdojmë t'i japim material me të drejtë opinionit për t'i kritikuar zyrtarët publikë, që jo rrallë po ndihemi edhe në siklet, për shkak se nuk kemi përgjegjësi.

Reforma zgjedhore mendoj se është çështje që ka mbetur në sirtar, por duhet të hiqet nga pluhuri që i ka rënë, për shkak se thjesht shumë probleme të funksionimit të shtetit po rrjedhin nga mungesa e reformës së duhur zgjedhore, e cila po prodhon pastaj institucione jostabile...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Pacolli, e ke në emër të grupit pesë minuta.

**ISLAM PACOLLI:** Përshëndetje kryesues!

Kabinet qeveritar,  
Kolegë të nderuar,  
Medie,

Sot dua të sqaroj një rast që është përfolur në medie, që gjoja se unë e kam rrahur një polic. Nuk është absolutisht e vërtetë, kjo është inskenim. E vërteta është se unë kam dashur të hyj në objektin qeveritar dhe me verifikimin e ID-kartelës si deputet dhe me leje e të gjitha, ka vendosur që unë të kthehem prapa. Inskenimet tjera janë totalisht të pavërteta. Sigurisht, se koha do ta tregojë veten, por u bëj thirrje edhe një herë medieve, që mos të propagojnë një gjë që është e pavërtetë, se gjoja unë jam arrestuar. Absolutisht nuk është e vërtetë dhe nuk qëndron.

Sigurisht që koha do ta tregojë dhe ligjet do të funksionojnë. Por, kisha bërë thirrje të gjithë ata që punojnë në institucionet e Republikës së Kosovës duhet t'i përfillin ligjet e Republikës së Kosovës. Nuk mund të ketë me një fobi anti-ligjore të Republikës së Kosovës pastaj edhe të jenë brenda Qeverisë së Republikës së Kosovës. Prandaj, është mirë që këto të sqarohen. Ata njerëz që janë nëpër institucionet e Republikës së Kosovës duhet ta respektojnë Ligjin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bunjaku e ka fjalën. Nuk është. Atëherë, zonja Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë sot e mora fjalën si anëtare e Bordit të Grupit të Grave Deputete të Parlamentit të Republikës së Kosovës.

Ne jemi takuar dje si Bord në mungesë të kuoromit dhe jemi munduar të marrim një qëndrim për reagimin e fundit, të parafundit do të thosha, se tashmë i fundit u bë prapë pagat e kësaj Qeverie. Por, për të reaguar për skandalin i cili ndodhi në Prizren më datën 10, pra më rastin e shënimit të ditës së Lidhjes së Prizrenit, 140 vjetorit.

Fatkeqësisht, dua t'ia bëj me dije opinionit që Bordi i Grave Deputete nuk ka mundur të marrë vendim për të reaguar, me përjashtim të LDK-së dhe Vetëvendosjes, sepse gratë nuk duan të reagojnë, gratë e subjekteve që janë në koalicion, kundër skandaleve, qoftë të kryetarit të Kuvendit, qoftë të kryeministrit dhe kjo është e papranueshme.

Natyrisht që me relevantë të veçantë është skandali dhe dështimi i protokollit, koleg i nderuar. Nuk i ka ligji fajet. I kanë ata që janë sot në Qeveri, që atë ditë na kanë dëshmuar se ata nuk dinë as çka është protokollit, vetë kryetari i Kuvendit dhe kryeministri, që na treguan që njëri qohet jashtë protokollit, kryetari i Kuvendit i ndez mikrofonin zonjës në foltore, e cila kishte marrë fjalën jashtë protokollit dhe kryeministri çohet dhe e tërheq zvarrë për ta hequr nga foltorja. Domethënë, ky është respektimi i protokollit, ose dëshmia se çfarë liderësh institucionale ka Republika e Kosovës.

Me këtë rast, unë them se vërtet është bërë mjaft. Këta duhet ta shohin vetë, duhet të ikën, se është bërë mjaft. Njëkohësisht, dua të ftoj koleget e mia deputete, që mos të jemi të njëanshme, kur preken ministret, ose zyrtaret e larta, që ne të ngrihemi e të reagojmë, por ne duhet të jemi bashkë dhe të reagojmë për të gjitha zonjat kur vërtet duhet të reagojmë. Ju faleminderit për vëmendje.

**KRYESUESI:** Faleminderit! I fundit është Nait Hasani.

**NAIT HASANI:** Faleminderit, nënkryetar!

Krejt të thonë kryesues, unë po të them nënkryetar, sipas Rregullores së Kuvendit.

Unë kam një reagim nga shkolla “Motrat Qiriazit” në Prizren për seancën e datës 4. 6. 2018 dhe datës 5.6.2018, ku në Kuvendin e Kosovës është përdorur fjala “fashizëm” për shkollën.

Unë e kam reagimin e kësaj shkolle, kam me nënshkrime të kolektivit, kështu që Emilija Rexhepi dhe përfaqësuesit boshnjakë është dashur të mos shkojnë me fjalë të rrugëve, po të merren me argumentet, të merren me zëvendësministrin e Arsimit që ka qenë atje po ashtu nga komunitetet dhe e dinë gjendjen si është, po jo të na bëjnë një propagandë politike, të na sjellin ndjenjat e kohës së Milosheviqit, ku për gjëra të tilla i akuzonin shqiptarët.

Prandaj, unë kërkoj edhe një herë që zonja Emilija Rexhepi të kërkojë falje në Kuvend për shprehjen e tillë, nëse ajo do të jetë një qytetare e ndershme, e ndërgjegjshme e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Atëherë konsideroj se pika e parë e renditë të ditës ka përfunduar, s’ka replika për këtë pikë të rendit të ditës.

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Në bazë të nenit 45, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta.

Kemi 46 pyetje, po fillojmë prej fillimit.

Po e shihni që e kemi në sallë vetëm një ministër, shpresoj që disa që janë lajmëruar që do të vijnë, mund të vijnë gjatë kësaj kohe.

E kemi pyetjen e parë, deputeti Haxhi Avdyli, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Zoti Avdyli, e keni fjalën, në qoftë se doni mund ta shtyni, në qoftë se doni mund ta lexoni.

HAXHI AVDYLI: Pyetja ime për kryeministrin Haradinaj për emërimin e koordinatorëve do të bëhet në momentin që ai të jetë këtu.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Arbërie Nagavci, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi, Arbëria nuk qenka këtu.

Deputeti Enver Hoti, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi, Enveri nuk është këtu.

Deputeti Adem Mikullovc, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj, nuk është as Ademi.

Deputeti Driton Çausi, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj, zoti Driton, doni ta bëni pyetjen apo e lëni për seancë tjetër?

DRITON ÇAUSHI: Përderisa kryeministri mungon, do të pres një rast tjetër për ta bërë pyetjen.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Valentina Bunjaku, pyetje për ministrin Kujtim Gashi, Valentina nuk është këtu.

Deputeti Nezir Çoçaj, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi, zoti Çoçaj, e keni fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Ministri ishte këtu, nëse është në bufe dhe nëse hyn brenda, unë e bëj pyetje, nëse jo e pres ministrin dhe do ta pres derisa të përfundojë kjo legjislaturë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj, pyetje për ministrin Bejtush Gashi, Armendi nuk është këtu.

Zoti Avdullah Hoti, pyetje për ministrin Valdrin Lluka.

AVDULLAH HOTI: S’di kujt ia ke bërë pyetjen, ministri nuk është këtu, kështu që mbetet për seancën tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Faton Topalli, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Zoti Topalli, e keni fjalën.

FATON TOPALLI: Nuk e di ndoshta e kisha pritur edhe më tutje, po zoti Pal Lekaj si duket është lodhur prej Ramazanit, e nuk është këtu.

Në vitin 2017 përmes aeroportit të Prishtinës “Adem Jashari” kanë fluturuar rreth 1,9 milion pasagjer. Ky është një numër i madh dhe ka tendencë që numri i pasagjerëve të dyfishohet.

Megjithatë, Aeroporti i Prishtinës, në raport me aeroportet e tjera në rajon vazhdon të mbetet aeroporti më i shtrenjtë.

Qytetarët e Republikës së Kosovës në përgjithësi i paguajnë çmimet më të larta në rajon për kamatat bankare, çmimet më të larta për polica kufitare dhe çmimet më të larta për biletat me aeroplan.

Shpesh fluturimet nga Cyrih, Vjena, Shtutgardi apo ndonjë vend tjetër evropian për në Prishtinë janë më të shtrenjta se udhëtimet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Qytetari i Kosovës u është eksponuar çmimeve pa asnjë mbrojtje nga institucionet e Kosovës, kjo nuk është çështje që ka filluar me këtë Qeveri, por është çështje e vullnetit politik dhe mund të përfundojë me këtë Qeveri.

Jam i vetishëm që tregu është i lirë, ashtu siç jam i vetëdijshëm që ka edhe Qeveri që me punën e saj mund të ndikojnë në uljen e çmimeve të biletave nëpërmjet intervenimeve të ndryshme.

Ajo që pres nga Qeveria, e cila është e përkushtuar, është të krijojë kushte për t'i favorizuar qytetarët.

Kështu, për shembull, udhëtimet për në Kosovë me aeroplan zgjasin për 20 minuta më shumë për shkak që nuk ka korridor fluturimesh me Malin e Zi dhe Shqipërinë dhe natyrisht që kjo ndikon edhe në biletat e aeroplanëve.

Do të doja të dija se çfarë ka bërë Qeveria e Kosovës apo çfarë mendon të bëjë që të ndikojë në uljen e çmimeve të biletave të pasagjerëve, sepse ato, siç thashë, janë bileta më të shtrenjta në rajon? Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Shqipe Pantina, pyetje për kryeministrin Haradinaj. Shqipja nuk qenka këtu.

Zonja Deliu, pyetje për zëvendëskryeministrin Behxhet Pacolli. Nuk është zonja Deliu këtu.

Zonja Deliu, pyetje për ministrin Rikalo. Nuk është zonja Deliu këtu.

Zoti Lutfi Zharku, pyetje për ministrin Pal Lekaj.

**LUTFI ZHARKU:** Faleminderit, nënkryetar!

Ministra të nderuar,

Po e bëj pyetjen për shkak se ministri Lekaj edhe në seancën e kaluar nuk ka qenë. Ministri Lekaj siç është raportuar në lajmet e mbrëmjes të 13 majit 2018 në KTV ka deklaruar se në rastin e pezullimit të projekteve në Komunën e Lipjanit, se projektet që i kam nisur unë, kanë qenë vetëm në letër dhe pa kode buxhetore.

Unë e ftoj ministrin Lekaj publikisht, prej 174 projekteve të reja që i kam nisur gjatë kohës sa e kam udhëheq ministrinë, le ta gjejë vetëm një projekt që nuk ka kod buxhetor. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti Zharku! Zoti Rugova, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Nuk është zoti Rugova këtu.

Deputetja Hykmete Bajrami, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Hykmetja nuk është këtu.

Zonja Hykmete Bajrami, prapë pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Nuk është deputetja këtu.

Zonja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Zonja deputete, e dëshironi fjalën? Zonja Baftiu e ka fjalën.

**BESA BAFTIU:** Faleminderit, nënkryetar!

Para se të parashtrij pyetjen, meqenëse edhe në seancën e kaluar ministri lëshoi seancën, nuk kam pasur mundësi.

Më lejoni të sqarohem para opinionit dhe para juve rreth asaj që e tha kolegja ime Besa Gaxheri, rreth mospjesëmarrjes së grupit tonë, gjegjësisht Partisë Social Demokrate në Grupin e Grave Deputete.

Unë jam anëtare e këtij Bordi, mirëpo unë e kam paralajmëruar Bordin se kam mbledhje të Komisionit në atë kohë si dhe kam pasur grup punues rreth një projektligji. Prandaj, kjo ka qenë arsyeja e mospjesëmarrjes time në mbledhjen e Grupit të Grave Deputete.

Ndërsa sa i përket pyetjes, ka të bëjë me ndërtimin e spitalit të pediatriisë në hapësirën e Qendrës Klinike Universitare, gjegjësisht mes Spitalit të Pediatriisë apo Gjinekologjisë, spital i cili ka filluar të ndërtohet në vitin 2016, faktikisht në bazë të planit është dashur të përfundojë në fund të këtij viti. Sa e dimë, nuk ka filluar vetëm është bërë përrurimi në vitin 2016 dhe asgjë nuk është bërë rreth këtij ndërtimi të këtij spitali.

Pyetja ime është për ministrin: çka ka ndërmarrë në këtë drejtim që ky spital të ndërtohet, meqenëse Ministria e Shëndetësisë ka pasur vetëm të bëjë rregullimin apo hapësirën ta rregullojë dhe t'ia mundësojë, meqë ky spital është donacion prej Emirateve të Bashkuara Arabe me vlerë prej 22 milionë eurosh. Faleminderit!



KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë ia mundësojmë zotit Çoçaj pyetjen për ministrin Shyqiri Bytyqi, zoti Çoçaj e keni fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja që ka të bëjë sot me pyetjen është sepse në media si dhe në raportimi i Komisionit për Arsim ministri ka deklaruar se do të mbeten vetëm dy universitete, njëri në rrafshin e Dukagjinit dhe tjetri do të jetë ai i Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Shqetësimet e studentëve, stafit akademik dhe qytetarëve janë të mëdha, pasi që është edhe koha kur do të fillojnë regjistrimet nëpër universitete.

Duke u ndërlidhur me këto deklarata, kemi edhe një proces për zgjedhje të rektorit në Universitetin e Prizrenit, ku anëtarët e Këshillit Drejtuesit kanë bërë shkelje edhe të Ligjit të arsimit të lartë, edhe statusit të Universitetit të Prizrenit dhe të Rregullores së Këshillit Drejtues.

Andaj, pyetja ime ka të bëjë: sa universitete do të mbeten dhe a do të ketë regjistrim të studentëve në vitin e ri akademik?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti Çoçaj,

Faleminderit për pyetjen!

Sa për një korrigjim të vogël, në deklaratat tona që i kemi pasur kemi bërë shpalosjen e programit qeverisës të kryeministrit Haradinaj dhe është i përfshirë edhe fizibiliteti i universiteteve publike të Kosovës dhe kjo ka qenë zotimi ynë për të realizuar një gjë të tillë.

Nuk kemi deklaruar asnjëherë që do të mbeten vetëm dy universitete, qoftë në atë që e quani ju rrafshi i Dukagjinit apo Universiteti i Prishtinës. Kemi thënë që ne do të formojmë një grup punues, me ekspertë të brendshëm dhe të jashtëm, për ta bërë fizibilitetin e universiteteve publike dhe mbi raportin e profesionistëve do të vendoset se si do të qasemi në universitetet publike, me qëllimin e vetëm që cilësi në universitete publike të jetë në një standard më të lartë, do të jetë e përafërsisht e njëjtë siç është Universiteti i Prishtinës.

Ka qenë opsion që mund të mbeten dy universitete, duke kaluar në pjesë të tjera që të jenë kampuse të dy këtyre universiteteve, por tani jemi shumë më konkret, e kemi raportin e

përfunduar dhe shumë shpejt ky raport do të diskutohet në Qeverinë e Kosovës, ku janë propozuar dy propozime, njëri ka të bëjë me profilizimin e të gjitha universiteteve publike dhe i dytë që ndoshta profilizimet të shndërrohen vetëm në dy universitete publike.

I tërë kjo punë që është bërë nga ekspertët profesionalë, përfshirë edhe ERAS-in në rastin e Austrisë, kanë dhënë një kontribut të madh që universitetet publike të kenë një standard ndryshe, sepse tanimë besoj se të gjithë e kemi informatën se kur janë hapur universitetet publike, nuk është bërë një analizë, s'ka pasur fizibilitet për çfarë lloj profilizimi kanë nevojë këto regjione, por vetëm janë hapur si të gjitha universitetet e tjera publike. Kjo ka qenë arsyeja kryesore dhe konsideroj që është bërë një punë e mirë dhe të shohim pastaj me vendimet që do të marrë Qeveria e Kosovës.

**KRYESUESI:** Pyetje shtesë ka zoti Çoçaj.

**NEZIR ÇOÇAJ:** Sinqerisht unë nuk mora përgjigje konkrete, po ky raport ka filluar, unë s' kam thënë në rrafshin e Dukagjinit, po ka thënë kryetari i Komisionit dhe këshilltari juaj kryesor për Arsim të Lartë në raportim të komisionit tonë.

Sa i përket asaj unë mund t' ju rikujtoj, Ekonomia online.com më 21 janar 2018 e thotë atë që do të mbesin dy universitet, është deklarata juaj, Bota pres info 28 janar, Radio Kosova e Lirë.com më 3 janar, kam edhe një video të incizuar, kur ju keni thënë se do të mbesin dy universitete publike, mund ta lëshoj edhe një mikrofon këtu, nëse doni, besoj që zërin ta njihni zërin tuaj.

Sa përket asaj që thatë është bërë studim fizibiliteti apo jo, besoj se këto janë vendime të Qeverisë së kaluar dhe mendoj që këto universitete kanë luajtur rolin dhe rëndësinë e vet.

Besoj se e keni parë Universiteti i Prizrenit në kohën e fundit 10 500 vende është ranguar më lart në 2017-ën në krahasim me vitin paraprak...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Zoti ministër, e keni fjalën.

**MINISTRI SHYQIRI BYTYQI:** I nderuar deputet,  
Edhe një herë ne kemi deklaruar për formën e qasjes tonë, por jo vendimmarrjen. Nëse ne thirremi si vendimmarrje, atëherë do të ishte e zbatuar kjo gjë. Ne kemi propozuar fizibilitetin dhe kemi thënë që ideja mund të jetë: a) një profilizim të universiteteve ose të mbeten dy universitete publike me kampuse të tjera në të gjitha regjionet që janë të hapura.

Këtë e kemi cekur sa herë kemi deklaruar që përfundimi i kësaj do të jetë mbi bazën e raportit që do ta bëjë komisioni profesional, përfshirë tani edhe ekspertët e huaj. Dhe tani kjo do të zgjidhet nga ajo që është thënë në raportin që ne do ta prezantojmë dhe do ta bëjmë shumë shpejt publik.

Thjesht, nuk dua të aludoj çka është bërë në të kaluarën, por që kemi pasur problematikë në universitetet publike, tashmë nuk ka diskutim, edhe sot vazhdojnë shumica e universiteteve publike të punojnë jashtë standardeve që kërkon Ligji i arsimit të lartë, dhe kjo ka qenë arsyeja pikërisht pse ne kemi qenë të detyruar që të bëjmë një fizibilitet dhe të gjejmë zgjidhje shumë më të mirë që vërtet universitetet publike të kenë standardin minimum të Universitetit të Prishtinës. Shumica e universiteteve publike sot nuk e kanë standardin e Universitetit të Prishtinës, besoj që kjo është e njohur tashmë për gjithë opinionin. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Nagavci, më duket e pati një pyetje më herët, meqenëse jeni të dytë këtu. Po, keni një pyetje për ministrin Bytyqi.

**ARBËRIE NAGAVCI:** Faleminderit, kryesues!

Unë këtë pyetje e kisha bërë më 3 maj 2018, meqenëse ministri s'ka qenë dy herë, kam adresuar pyetjen me shkrim më 21 maj 2018, andaj po pres të marr përgjigjen me shkrim. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Po vazhdojmë me pyetjet. Zoti Zemaj, pyetje për ministrin Albena Reshitaj. Zoti Zemaj nuk është këtu.

Zoti Haxhi Avdyli, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Zoti deputet, e dëshironi fjalën, a doni ta shtyni për herën tjetër? Ministri nuk është këtu.

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Zonja deputete nuk është këtu.

Zonja Time Kadrijaj, prapë pyetje për ministrin Uran Ismajli. Nuk është këtu.

Deputeti Imet Rrahmani, pyetje për ministrin Uran Ismajli. E dëshironi zoti Rrahmani fjalën?

**IMET RRAHMANI:** Jo, e presim praninë e ministrit.

**KRYESUESI:** E presim, Faleminderit! Zoti Rrahmani, pyetje për ministrin Bejtush Gashi.

**IMET RRAHMANI:** Po, i nderuar kryesues, do ta bëj pyetjen, sepse është hera e dytë, e kam bërë herën e parë për mungesë të ministrit ish-ministrit tash, nuk kemi mundur ta bëjmë dhe po e bëjmë tash rishtas.

Ne këto ditë patëm një debat parlamentar lidhur me respektimin e të drejtave të punëtorëve, u konstatua nga shumë diskutues se ligjet i kemi të mira, por ato nuk po respektohen.

Njëra nga shkeljet ishte diskriminimi i punëtorëve me detyrim pune shtesë, pa kompensim adekuat material.

Sipas përfaqësuesve të Sindikatës së Policisë, ky lloj diskriminimi po bëhet edhe në Policinë e Kosovës. Policët detyrohen të punojnë edhe gjatë festave dhe gjatë ditëve të vikendit, kur të tjerët pushojnë dhe nuk kompensohen materialisht.

Pyetja për ministrin Gashi është: si kompensohen pjesëtarët e Policisë për punën shtesë dhe për punën e ditëve të festës? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Lekaj. Zonja Haxhiu, e keni fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Pyetja ime ka të bëjë lidhur me rrugën Smolicë-Nivokaz, është ndarë një pjesë e buxhetit, por ministri nuk është këtu, pyetja bartet për seancën tjetër.

KRYESUESI: Zonja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Po prapë është mirë të marr përgjigjen prej ministrit, njëkohësisht pyetja ime e drejtuar ministrit ka të bëjë me rezonancën magnetike dhe numrin e pacientëve prej 2500 që presin në radhë, sado që bëhet një punë shumë e mirë prej ekipit aty, por prapë pyetjen do ta bëj kur është ministri këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Daut Haradinaj, pyetje për ministrin Gashi. Dauti nuk është këtu.

Zoti Haradinaj, pyetje për ministrin Bytyqi. Deputeti nuk është këtu.

Deputeti Avdullah Hoti, pyetje për ministrin Pal Lekaj, zoti Hoti, kur të vijë ministri atëherë.

Zoti Bilall Sherifi, pyetje për ministrin Bejtush Gashi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Unë do ta lexoj pyetjen, sepse për mua ka rëndësi përgjigjja t'i jepet publikut, qoftë edhe me shkrim dhe jo detyrimisht mua këtu në seancë.

Unë do të ngre çështjen e sigurimeve edhe një herë, po në një qasje tjetër.

Pyetja për ministrin ka të bëjë me faktin se duke pasur parasysh që në Kosovë vitet e fundit kanë ndodhur shumë aksidente në komunikacion, dëshiroj të di sa aksidente kanë ndodhur gjatë viteve 2015, 2016 dhe 2017 në Republikën e Kosovës? Sa nga këto aksidente kanë përfunduar me lëndime të rënda dhe sa lehtë, po ashtu sa njerëz kanë humbur jetën në këto aksidente gjatë këtyre tre vjetëve.

Pra, esenca e krejt kësaj ka të bëjë me faktin se unë dua të di sa për qind të veturave, të cilat kanë qenë të përfshira në aksidente të kësaj periudhe, kanë qenë të peregjistruara ose me afat të skaduar të regjistrimit.

Ideja e pyetjes ka të bëjë me faktin se po spekulohet shumë se rreth 20% e veturave të cilat dalin në komunikacion ose janë të peregjistruara ose u ka kaluar afati i regjistrimit. Nëse është ashtu, dua të shoh përqindjen e këtyre veturave, sa janë të përfshira në aksidente? Nëse përfshirja nuk na del 20% siç propagandohet, atëherë do të dalë që do të jetë shumë më e vogël dhe jam i sigurt që do të jetë shumë më e vogël, sepse nuk ka asnjë logjikë që 20% të jenë në komunikacion, ndërsa 2-3% të jenë të përfshira në aksidente.

Këtë pyetje e kam shumë të rëndësishme, sepse nga përgjigjja e kësaj pyetje do të varet shumë a kemi të bëjmë me faktin se vërtet kaq shumë vetura janë në komunikacion të peregjistruara, apo kemi të bëjmë me grupe të interesit, të cilat për arsye të tjera nuk lejojnë heqjen apo futjen e Kosovës në Kartonin e gjelbër dhe rrjedhimisht, edhe heqjen e taksës për bashkatdhetarët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Pal Lekaj.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Pavarësisht mospërgjegjësisë së ministrave për të ardhur, mosgatishmërisë së tyre për të ardhur e të përgjigjen në pyetjet parlamentare, unë i inkurajoj kolegët e mi deputetë se të vazhdojnë me pyetje parlamentare, sepse kemi obligim që problemet e qytetarëve t'i adresojmë këtu në Kuvend.

Pyetjen parlamentare që ia kam adresuar ministrit të Infrastrukturës, zotit Pal Lekaj, e kam adresua më 7 qershor, por nuk po e ceku rastësisht këtë, se po dua ta arsyetoj edhe fjalën time që e thashë më herët, që i inkurajoi deputetët, sepse ministrat të pakën, edhe që nuk vinë të na përgjigjen në seanca, kanë filluar të reflektojnë dhe t'i zgjidhin problemet.

Pyetja ime ka pasur të bëjë me kycjen e Doganajt te Kaçaniku në autostradën Prishtinë-Shkup, që do të inaugurohet së shpejti, e qytetarëve të Vitisë do t'u duhet t'i bëjnë nga Gërlica deri në

Doganaj të Kaçanikut për t'u kyçur në autostradë dhe 5,8 kilometra do të duhet t'i bëjnë kur të kthehen nga kryeqyteti.

11,6 kilometra më larg qytetarët vitias do ta kenë kryeqytetin si pasojë e mungesës së kyçje në Gërllicë, e kjo do të ketë kosto financiare dhe shpenzime të kohës duke i izoluar bizneset e Vitisë dhe duke e favorizuar importin e mallrave përreth 50 mijë banorë rezidentë të Vitisë me më shumë se 9 mijë automjete po diskriminohen.

Pyetja për ministrin ishte: I nderuar ministër, shoqëria civile dhe qytetarët në Viti kanë paralajmëruar organizim të protestave për ta realizuar të drejtën e tyre, prandaj si do të veproni ju për të realizuar të drejtën e qytetarëve vitias?

Unë e falënderoj ministrin që e ka ndërmarrë menjëherë një hap dhe dje është takua me qytetarët vitias dhe me përfaqësuesit e Komunës atje dhe qytetarëve u ka ofruar zgjidhje që deri më 1 shtator ky problem do të zgjidhet.

Prandaj, ndihem goxha mirë që e kam bërë këtë pyetje parlamentare dhe pavarësisht të mungesës së ministrave këtu, ne do të vazhdojmë me pyetje parlamentare. Është mirë që Kryesia të mendojë që në të ardhmen ndoshta të ketë seanca të veçanta, në të cilat deputetët ...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Muliu, pyetje për ministrin Reçica.

**GANIMETE MUSLIU:** Duke mendua ndoshta është edhe paragjykim po duke besua që kjo pyetje do të përsëritet shpesh edhe në fund s' do të kem shansin me e lexua edhe pse në mungesë të ministrit Reçica unë po e bëjë pyetjen parlamentare shpresoj shumë që zoti Reçica t'i adresohet qytetarëve në të ardhmen por edhe mua të më adresohet me shkrim si deputete.

Çështja është kjo: Diskriminimi i punëtorëve në sektorin privat vazhdon edhe më tutje në të gjitha aspektet.

Ditët e fundit, kur shumë të rinj dhe të reja e shohin si mundësi për në një vizë pune gjatë përgatitjes së dokumenteve për aplikimin ata kanë vërejtur se pavarësisht që punojnë me vjet të tëra në sektorin privat, punëdhënësit e tyre i kanë ikur pagesës së Trustit Pensional, duke paguar vetëm për nga dy muaj në vit dhe kjo është një shkelje e të drejtave të punëtorëve dhe e shkeljeve të Ligjit të punës, si dhe Ligjit të Trustit Pensional.

Pyetja konkrete është, i nderuar ministër, a jeni në dijeni për këtë çështje dhe çka jeni duke ndërmarrë që kjo dukuri të mënjanohet dhe shkelësit të dalin para ligjit dhe para drejtësisë në këtë vend.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Evgjëni Thaçi-Drăgusha, pyetje për ministrin Bajram Hasani.

EVGJËNI THAÇI-DRĂGUSHA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Zoti ministër, më vjen mirë që po ju shoh këtu, pyetja ime konsiston në shqetësimin e theksuar të qytetarëve lidhur me kontrollin e kualitetit të lodrave për fëmijë që shiten në tregun kosovar dhe që importohen kryesisht nga Kina, lodra të cilat për shkak të përmbajtjes së lartë të fitalateve që i shtohen substancës plastike për ta zbutur jo vetëm që nuk i plotësojnë standardet elementare, por sipas ekspertëve, mund të dëmtojnë rëndë shëndetin e fëmijëve duke interferuar në hormone.

Për fat të keq, këto lodra, me të cilat fëmijët tanë janë në kontakt çdo ditë, nuk testohen asnjëherë në aspektin kimik dhe fizik, dhe si të tilla do të thotë eksportohen dhe shiten në tregun tonë.

I nderuar ministër Hasani, ju lutem, na tregoni se çfarë po bëni ju dhe ministria që ju drejtoni lidhur me këtë çështje? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hasani, e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM HASANI: Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete,

Faleminderit për pyetjen, për shkak se është një temë mjaft serioze dhe ne e kemi marrë shumë me seriozitet këtë çështje, sepse sipas informatave që kemi, futen lodra të tilla.

Inspektorati i MTI-së më 5. 3. 2018 ka kërkuar nga Dogana e Kosovës që të ndalojë të jitha importet që merren me importimin e lodrave që hyjnë në tregun e brendshëm, qëllimi i ndalimit është që të bëjë verifikimin dhe sigurinë se lodrat që futen në tregun e brendshëm, fokusi ynë ka qenë që lodrat për fëmijët nën moshën 36 muaj, kryesisht me prejardhje nga tregu aziatik apo, siç e thatë, shumica prej tregut të Kinës. Më 1. 5. 2018, Inspektorati i Tregut i ka marrë mostrat e nevojshme të lodrave për testimin e mëtutjeshëm në laboratorë. Ne kemi kërkuar tashmë për shkak se këto laboratorë fatkeqësisht nuk kemi në vendet fqinje, domethënë duhet t'i dërgojmë këto mostra diku në shtetet evropiane. Ne kemi kontaktuar me disa laboratorë të akredituar që janë në vendet evropiane, po presim përgjigjen e tyre dhe shumë shpejtë do t'i dërgojmë këto mostra, sepse ato mostra të cilat janë marrë, them diku 15 mostra janë marrë në Doganë. Këto mostra janë ndaluar, do të thotë, ai produkt është ndaluar apo është marrë nën kontrollin e Inspektoratit, ruhen nëpër depo, do të thotë nuk mund të shiten.

Në rast se dalin po themi mbi 51% të atyre mostrave se kanë shenja kancerogjene, janë të rrezikshme, do të thotë përveç shenjave kancerogjene, e them edhe për shkak të sigurisë, sepse lodra të tilla për fëmijët mund të jenë të rrezikshme, nuk e kanë atë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Regjia, vazhdoja fjalën edhe dy minuta!

MINISTRI BAJRAM HASANI: Unë ju siguroj se nëse dalin mbi 50% këto mostra që kanë elemente të tilla, ne do të japim urdhëresë që të ndalohen të gjitha, në rast se ka veç disa prej tyre, atëherë ato ndalohen vetëm produktet që rezultojnë me atë rezultat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, po zonja Dragusha!

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit, i nderuar ministër!

Më vjen mirë që e keni marrë me kaq përkushtim dhe seriozitet këtë çështje. Unë dua vetëm të shtoj diçka sa i përket çështjes së mungesës së laboratorëve në Kosovë dhe në rajon. Unë kam parë që nga AVUK-u është thënë se kjo nuk është e vërtetë, për shkak se ata bëjnë teste dhe analiza të ndryshme të materialeve që gjenden për shembull edhe në mbështjellësit e ushqimeve të ndryshme, bëjnë analiza për të njëjtën substancë, pra fitalate. Dhe, do të mund t'i bënin analizat edhe të këtyre lodrave. Prandaj, unë nuk e di nëse keni kontaktuar me AVUK-un më parë para se t'i dërgoni mostrat në shtetet e tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri e ka fjalën.

MINISTRI BAJRAM HASANI: E nderuar deputete,

Sipas informatave që kam, Inspektorati i Tregut që i ka dhënë, ne nuk kemi laboratorë të akredituar as në Kosovë, as në Shqipëri e Maqedoni, në të gjitha vendet e rajonit. Duhet të shkojnë në vendet evropiane. Sa i përket AVUK-ut, ndoshta AVUK-u është mirë të merret me atë pjesën që po kërkojmë çdo ditë, të cilët i kemi ato produktet ushqimore, që kemi ngritur shqetësim edhe ne si Ministri e Tregtisë, Industrisë edhe ju deputetë, sa i përket vajit të palmës kam kërkuar që disa herë nga AVUK-u, domethënë ata ta kryejnë punën e vet, t'i marrin ato produktet ushqimore, të cilët ne po dyshojmë se sot në Kosovë përdoret një sasi hyrje e importit të vajit të palmës tregon që është një sasi e madhe e importuar dhe shqetësimi jonë është që ai vaj i palmës mund të jetë për shëndetin e njeriut kancerogjen, ndoshta AVUK-u është mirë ta bëjë punën e vetë, por kjo sipas informatave të Inspektoratit nuk kemi laboratorë të akredituara për lodra të tilla që po flasim.



KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Driton Çausi, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Nuk është Dritoni këtu. Deputetja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Pal Lekaj, Besa, a dëshironi ta bëni pyetjen?

BESA BAFTIU: Meqenëse ministri nuk është këtu, po e lë për seancën e ardhshme kur ai të jetë këtu.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Bejtush Gashi. Zonja Haxhiu, e keni fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Çështja ka të bëjë me ndalimin e qytetarëve në pikat kufitare për shkak të mosshlyerjes së gjobave në komunikacion dhe arsyeja pse e kam parashtruar këtë është për shkak të ankesave të shumë qytetarëve dhe pyetja për ministrin e Punëve të Brendshme, ndonëse nuk është këtu, po e parashtroj. Domethënë, këto ditë kemi dëgjuar shumë ankesa nga qytetarët që po ndalohen në pikat kufitare me orë të tëra për shkak të mospagesës së gjobave të shqiptuara në komunikacion, madje ndalohen me orë të tëra edhe për 20-25 euro. Kur flas me orë të tëra, 5, 6, madje në 7 orë, ndoshta dhe tërë ditën dhe, natyrisht që gjobat duhet të paguhen, askush nuk është kundër, por që kjo formë që po bëhet në pikat kufitare është komplet e papranueshme dhe është maltretim për qytetarët, por po ashtu është edhe e paligjshme dhe kundërkushtetuese, sepse është në kundërshtim me të drejtat e njeriut, për shkak se as nuk njoftohen paraprakisht nga institucionet, as nuk ka ndonjë vendim apo urdhër gjyqate. Thjesht, ndalen në pikat kufitare për shkak të gjobave.

Andaj, pyetja për ministrin e Punëve të Brendshme është: mbi çfarë baze ligjore ndalohen qytetarët në pikat kufitare për shkak të mospagesës së gjobave të shqiptuara në komunikacionin rrugor? Pres që në seancën e ardhshme ministri të jetë i pranishëm dhe të na njoftojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E kam për korrektësi, zoti ministër i Punëve të Brendshme ka njoftuar që nuk mund të vijë në seancë për shkaqe shëndetësore. Zonja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Zonja Haxhiu, e keni fjalën!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Edhe kjo pyetje ka dalë pas disa takimeve që i kemi pasur me disa qytetarë. Ka dy vjet që shumë qytetarë po presin t'i nënshtrohen provimit për shofer instruktor. Ministria e Infrastrukturës nuk ka dhënë sqarime se pse nuk ka vepruar në këtë drejtim dhe pse nuk po organizohet mbajtja e këtij provimi, pra për dy vjet radhazi përgjigjja që u jepet qytetarëve, të cilët janë të interesuar që t'i nënshtrohen këtij provimi është pas një muaji. Pra, në vazhdimësi thuhet pas një muaji.

Andaj, pyetja për ministrin Pal Lekaj është se kur do të bëni përgatitjet për mbajtjen e provimit për shofer instruktor? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Sali Zyba, pyetje për ministrin Hasani.

SALI ZYBA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje ministra dhe të gjithë të pranishëm,

Pyetjen e njëjtë, zoti ministër, sa për informatën tuaj ia kam bërë ministrit Bedri Hamza, por i njëjti më ka rekomanduar t’jua bëj juve. Meqenëse ju në një prononcim për televizionin publik, apo më mirë nga “Koha Ditore” keni citur se është përgjegjësi edhe e Qeverisë dhe e ministrive të tjera. Andaj, unë kam menduar që atëherë është më adekuate, meqenëse ka të bëjë për pagesat e inspektorëve në veri, të njëjtën pyetje po e parashtroj tash.

Çështja është: pagesa e inspektorëve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në veri të Mitrovicës. Sipas një deklarimi për media, zoti Hasani, ke konfirmuar se 30 inspektorë të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë marrin paga pa punuar fare. Andaj, pyetja ime është deri kur Qeveria e Kosovës, konkretisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të lejojë dëmtimin e buxhetit të Kosovës, duke dhënë paga pa punuar që nuk dalin fare në vendin e tyre të punës?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BAJRAM HASANI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar deputet,

Ashtu siç jeni i informuar në zbatim të Marrëveshjes së Brukselit për shuarjen e të ashtuquajturës “Mbrotje civile në Mitrovicë të Veriut”, të arritur më 26 mars 2015, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, si dhe duke u mbështetur me vendimin e Qeverisë nr. 06/39 i datës 22.07.2015, për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka punësuar 25 zyrtarë, ku 11 prej tyre janë inspektorë, të cilët pas një procedure të thjeshtësuar të konkursit, të njëjtit kanë nënshkruar aktemërimet dhe të cilët që nga muaji janar 2016 marrin pagë të rregullt mujore në vlerë prej 360 euro nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Sa për informatë, nuk është vetëm Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, nëse s’gaboju mbi 300 zyrtarë janë në të gjitha ministrinë që janë shpërndarë në mënyrë paralele. Unë këtë çështje e kam parë prej ditës kur e kam marrë mandatin, po është çështje që ndoshta na takon të marrim një vendim së bashku. Unë nuk jam për të vazhduar, nëse e kam mbështetjen tuaj, natyrisht sot ua kisha shkëputur kontratën, se askush nuk mundet pa çfarëdo baze të marrë pagë pa punuar. Është e vërtetë që aksidenti që ka ndodhur, do të thotë kur kanë dashur të dalin në punë, ka pasur një problem në pjesën veriore dhe ata e kanë ndërprerë. Ndoshta është detyrë jona që t’i afrojmë edhe një herë, po ky është një vendim që duhet të merret, t’i afrojmë edhe një herë mundësi nëse dalin në punë, mund të vazhdojnë punën, se ka qenë marrëveshje që të jenë në pjesën veriore,

edhe inspektorët që unë mendoj që ka qenë e mirë sikur të kishin dalë në punë e ta fusim në sistem pjesën veriore.

Ne kemi sot shumë pika...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Një minutë, përgatituni!

MINISTRI BAJRAM HASANI: Ne kemi çështjen edhe të pikave të karburantit, do të thotë që sot në pjesën veriore operojnë pa licencë. Jemi duke u munduar që të gjejmë zgjidhje, për ta marrë një licencë të pikës karburantit duhet që të jetë pronësia e definuar. Ka qenë ky problemi, ne jemi duke u munduar që ta gjejmë një mënyrë, ta bëjmë një thjeshtësim të procedurës, t'i futim në sistem, t'i licencojmë pikat e karburantit që janë në pjesën veriore. Ndoshta këta inspektorë kishin mundur ta kryejnë shumë punën mirë, por në rast se nuk dalin në punë fare, është çështje politike, nuk është çështje veç e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, por është çështje e të gjitha ministrive, janë të shpërndarë diku mbi 300 zyrtarë të njëjtës kategori. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Zyba e ka fjalën!

SALI ZYBA: Faleminderit, ministër!

Por, meqenëse pyetja ime ishte për 30 zyrtarë, nuk ma hoqët dyshimin as shqetësimin, por ma ngrite edhe më shumë si shqetësim, sepse po bëhet fjalë për 300 zyrtarë. Do të thotë, në shpërndarje, në dikastere të ndryshme të Qeverisë, kjo është edhe më shqetësim, do të gjejmë forma tjera të kuptojmë më shumë, të paktën kemi të dhëna për ta kush janë minimumi, ndërsa nuk po tërhiqem prej pyetjes, sepse nuk përshkruat për vendimin tuaj për këta persona a do të vazhdojnë, a jo?

Meqenëse bëre pyetjen dhe kërkove mbështetjen tonë, jo vetëm timen personale, por edhe të subjektit tim, e marr edhe këtë qëndrim që do të kem mbështetje për të krijuar dhe për të ndërtuar institucione të qëndrueshme, jo për paga dhe pagesa, duke pasur për bazë qoftë edhe pagën që e përmende ti, sepse koj pagë nuk është e vogël, secila nëse përkthehet në raste të tjera është shumë e madhe. Ju kisha lutur edhe një herë a do të merrni vendim ju për ndërprerje të marrëdhënies së punës nëse nuk dalin në vendin e punës. E the se është çështje politike, kjo qeverisje është edhe për vendime politike, nuk është vetëm për menaxhim ose, edhe më keq, vetëm si vëzhgim. Të lutem, a do të merrni vendim ju për ndërprerje të marrëdhënies së punës, sepse është përgjegjësi konkrete juaja. Këtë të paktën e ka thënë ministri Hamza në këtë foltore.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër a dëshironi të përgjigjeni? Faleminderit! Zoti Zyba, pyetje edhe për ministrin Mahir Jaghillar. Zoti Zyba, a dëshironi ta bëni pyetjen, ministri s'është këtu.

SALI ZYBA: Faleminderit, kryesues!

Jo pse një kolege më parë nga subjekti i kryeministrit Haradinaj tha nuk është Kuvendi për të bërë politikë, po në rrugë, por me gjasë ministri i Administratës qenka në rrugë, andaj e shfrytëzoi rastin herën tjetër të parashtrij pyetjen.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi, pyetje për ministrin Skender Reçica. Zoti Kurteshi e keni fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Çështja ka të bëjë me pensionet invalidore dhe të pleqërisë të qytetarëve nga Republika e Kosovës të fituara në Zvicër.

Unë po e bëj pyetjen, e ministri ndoshta përgjigjet ndonjëherë, sidoqoftë! Pas neglizhimit total nga Qeveria e kaluar, Qeveria e atëhershme kur është bërë kërkesa e Republikës së Kosovës dhe kërkesave të vazhdueshme të qeverisë zvicerane për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare për sigurimet sociale të trashëguara nga ish-Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë dhe mosndërmarrjes së hapave, më 1 prill Qeveria zvicerane ka vendosur ndërprerjen e dërgimit të pensioneve për qytetarët e Kosovës, të pensionuar, të ashtuquajtura "eksport pensione". Më 16 nëntor 2016 falë angazhimit të sindikatës më të madhe "Unia" Zvicër, sidomos të bashkëpunëtorëve shqiptarë të asaj organizate, Qeveria zvicerane ka vendosur të fillojë bisedimet në lidhje me këtë çështje. Më 21 mars 2018 Qeveria zvicerane ka autorizuar Presidentin e Konfederatës që të nënshkruajë marrëveshjen bilaterale me Republikën e Kosovës. Javën e kaluar është nënshkruar kjo marrëveshje, pyetja ime ka të bëjë: zoti ministër, a mund ta njoftoni Kuvendin dhe qytetarët, sidomos bashkatdhetarët tanë, cila është gjendja aktualisht? Kur pritet të finalizohet marrëveshja ndërshtetërore për pensionet midis qeverive të Republikës së Kosovës dhe Zvicrës, kur pritet që kjo marrëveshje të silllet në Kuvend për miratim dhe përfundimisht kur pritet të hyjë në fuqi kjo marrëveshje dhe pensionistët kosovarë t'i marrin pensionet ashtu qysh iu takojnë?

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri s'qenka këtu. Prapë zoti Kurteshi keni pyetje për ministrin Pal Lekaj. Në qoftë se dëshironi, e bëni pyetjen.

SAMI KURTESHI: Po, unë po e bëj, sepse edhe ashtu po mungojnë ministrat, është çështje rastësie kur do të jenë ata këtu, ministri e ka për obligim në mbledhjet e ardhshme të përgjigjet. Çështja është hapja e vendkalimit kufitar ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë në aksin rrugor Gjilan-Kumanovë, në pikën kufitare Stanaj-Bellanoc.

Pas problemeve që i patëm para një-dy muaji, me ndërprerjen e rrugës Kaçanik-Hani i Elezit, domethënë Prishtinë - Shkup, ne e pamë cilat janë problemet që u shtohen të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, por edhe udhëtarëve në atë rrugë, edhe shpenzimet, edhe mundimet, edhe krejt. Mes Gjilanit dhe Kumanovës ekziston një rrugë solide nga ana e Maqedonisë shumë solide, edhe nga ana e Kosovës, ndoshta me riparime të vogla mund të rregullohet. Ajo rrugë është më e shkurtër se 40 km dhe mund të përdoret dhe duhet të përdoret si vendkalim kufitar midis Maqedonisë dhe Kosovës. Pjesa kosovare i ka nxjerrë piramidat e betonit, i ka vënë aty dhe ajo nuk lejohet të kalohet zyrtarisht tani. Kjo do ta lehtësonte shumë qarkullimin e mallrave dhe do t'i lidhte rreth 200-300 mijë banorë.

Pyetja ime është: a planifikon Qeveria e Kosovës hapjen e këtij vendkalimi me Republikën e Maqedonisë? Nëse jo, cilat janë problemet dhe pengesat objektive apo subjektive? Nëse po, kur planifikohet një veprim i tillë përfundimisht, nëse po kur mund të shpresojnë banorët e zonës se mund ta kalojnë këtë vendkalim kufitar në mënyrë zyrtare? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Valon Ramadani, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Zoti Ramadani, a dëshironi ta bëni pyetjen?

VALON RAMADANI: Kam dy pyetje për ministrin: njëra ka të bëjë me gjendjen e rëndë të rrugës të fshatrave Tërrn dhe Bablak, dhe pyetja e dytë është për të njëjtin problem, vetëm fshati është tjetër, kërkoj që pyetjet të barten për seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe pse kryeministri nuk është këtu, unë po e lexoj pyetjen dhe po e ngre si shqetësim, i cili nuk është vetëm imi, por është edhe i shumicës së kryetarëve të komunave. Pasi më datë 10.05.2018 Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal u ka dërguar kryetarëve të komunave të Kosovës një njoftim lidhur me kërkesën për pezullimin e shqyrtimit të kërkesave për kthimin e pronave, të cilat menaxhohen nga AKP në pronësi të komunave.

“Marrë parasysh që MAPL është në fazën finale të miratimit të ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale, në bashkëpunim të plotë me Zyrën e Kryeministrit, ju njoftojmë se procesi i shqyrtimit të kërkesave për kthimin e pronave të ndërmarrjeve shoqërore, të cilat menaxhohen nga AKP në pronësi të komunave do të pezullohet deri në miratimin e ligjit të ri për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale, i cili projektligj përcakton realizimin e këtij procesi”.

Ky është njoftimi, të cilin e ka dërguar MAPL-ja dhe e cila është thirrur që ka bërë një koordinim me këtë, mirëpo Ligji nr. 04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së

paluajtshme komunale është në fuqi dhe me këtë vendim sekretarja e përgjithshme e MAPL-së zonja Rozafa Ukimeraj ka abroguar këtë ligj dhe mendoj që është një shkelje ligjore, sepse edhe premtimi i kryeministrit, por edhe i të gjithë liderëve politikë ka qenë që të mos shiten pronat e komunave nga AKP-ja, të pezullohet si proces dhe kjo pastaj të ndihmonte dhe të krijonte lehtësi për investitorët.

Me këtë vendim, vetëm pse është ligji në shqyrtim nga MAPL, ligji i ri, do të thotë u pamundësohet një numri të madh të investitorëve që të...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! E keni edhe një pyetje për ministrin Uran Ismajli.

BEKIM HAXHIU: Po, është pyetja për projektin e modernizimit të shërbimit të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare. Një projekt i njohur edhe për Kuvendin e Republikës së Kosovës, sepse ka tre vjet që debatohet e diskutohet për këtë projekt këtu.

Dy vjet më parë është votuar ky projekt edhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, por realizimi i këtij projekti ka hasur në vështirësi, ndërsa ministri Uran Ismajli, më 02.2018 ka deklaruar se ky projekt do të përfundojë brenda tre muajsh dhe tani kanë kaluar më shumë se katër muaj dhe aparatura e kontraktuar, për të cilën ne kemi filluar të paguajmë kredi, nuk po vjen në Kosovë, përkundër përpjekjeve të menaxhmentit në Qendrën Klinike Universitare që ky shërbim të funksionalizohet, nuk po bëhet. Është thënë për shkak të mungesës së hapësirës ose përshtatjes së hapësirës, e dimë fare mirë se në projekt dhe në planifikime ka qenë e paraparë, edhe deklarimet e ish-ministrit kanë qenë që mjetet të cilat janë rritur për 500 mijë euro që janë planifikuar të rriteshin atëherë, ka pasur të bëjnë me investimet në hapësirë dhe mendoj që është një çështje, e cila po e dëmton pikë së pari shëndetin e pacientëve, sepse nuk po kanë mundësi të marrin shërbimin e duhur.

Listat e pritjes janë mbi 6 muaj, prandaj mendoj që do të duhej një përgjegjësi më e madhe në realizimin e këtij projekti dhe për ato neglizhenca, të cilat kanë qenë deri më tani, sigurisht që edhe duhet përgjegjësi edhe llogaridhënie. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kemi kohë të mjaftueshme për t'u rikthyer prapë edhe nja tri pyetjeve që janë. Meqenëse, kanë ardhur edhe ministrat këtu, së pari ia jap fjalën zotit Mikullovcit, ka një pyetje për zotin Haradinaj, por s'ishte në sallë parëz. Zoti Mikullovcit.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë nuk kam pyetje për ministrin, por kam pyetje për deputetët dhe në përgjithësi.

Po marr pak kohë. Kur e kemi dhënë betimin, jemi betuar që do të votojmë: për, kundër, ose abstenim. Dhe, është e paligjshme, po e thyejmë vetë Rregulloren e punës që nuk po marrim pjesë në votime. S'di si na doli kjo filozofi tash pasi që u votua. Kur s'pajtoheni, votoni kundër, ose abstenoni, por jeni të obliguar të votoni. Këtë desha të them.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Mikullovc! Dakord jam, por... Zoti Hoti, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Çështja ka të bëjë me disa mësimdhënës që tani nga drejtoritë komunale të arsimit janë konstatuar se përcillen me shkaqe shëndetësore bukur të rrënuara dhe me sëmundje kronike dhe si rezultat i mos mundësisë së mbarëvajtjes në procesin mësimor, ose shkuarjes në procesin mësimor të rregullt, pësojnë shumë nxënësit, sidomos në shkollat fillore dhe të mesme, por veçmas në shkollat fillore. Prandaj, pyetja është, i nderuar zoti ministër Bytyqi, çfarë masash keni marrë apo keni planifikuar t'i merrni për të ardhmen lidhur me këtë gjendje të rënduar shëndetësore të disa mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme. Pres përgjigje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Avdullah Hoti, pyetje për ministrin Valdrin Lluka. Ah, po përgjigje, më fal.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Deputet Hoti, faleminderit për pyetjen!

Po, ky është një shqetësim i madh. Realisht është ngritur edhe në Parlamentin e Kosovës nga deputetja Balaj, që një shqetësim ka ardhur nga të gjitha komunat dhe të gjitha shkollat për mësuesit që kanë probleme shëndetësore me sëmundje të ndryshme, në veçanti me sëmundjet malinje. Ne menjëherë kemi pasur takime me drejtorët e DKA-ve nëpër komuna dhe kemi kërkuar që të na i sjellin informacionet për gjithë numrin e mësimdhënësve, që kanë kësi lloj problemesh. Tanimë ne e kemi këtë raport, numri është mbi 100 mësimdhënës që vuajnë nga këto sëmundje dhe vërtet nuk janë në gjendje që t'i mbajnë orët e mësimi siç duhet dhe siç parashihet me standarde.

Veprimi ynë është, tani jemi duke diskutuar bashkë me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, gjegjësisht me ministrin Reçica, që me Udhëzimin Administrativ që zoti Reçica është duke e përgatitur për qëndrueshmërinë e të të punësuarve në vendin e punës ne do të bëjmë një zgjidhje që këta mësimdhënës më mos të shkojnë në shkollë në orë të mësimi, kur nuk janë në gjendje ta mbajnë orën e mësimi, sepse kjo është maltretim edhe për vetë nxënësit tanë.

Pra, zgjidhja do të jetë në këtë vit, në rast se do të arrijmë që ministri Reçica ta rregullojë me Udhëzim Administrativ ne do ta bëjmë. Përndryshe, nëse jo, ne do të marrim masa tjera që ta bëjmë një zgjidhje që mësimdhënësit mos të jenë të lënë anash, sepse këta mund të pushohen nga puna, mirëpo nuk mund t'i lëmë pa përkujdesje sociale. Ne duhet ta gjejmë një zgjidhje dhe besoj se këtë vit zgjidhja do të jetë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti ministër! Pyetje shitesë, zoti Hoti? Tani radha është e zotit Hoti, pyetje për ministrin Lluka. Avdullah Hoti.

**AVDULLAH HOTI:** Kryesues, është para tre, ose katër muajve është bërë kjo pyetje, po duheni me i sjellë ministrat në seancë, është e vërtetë, por jo në kuptimin e kësaj një ore të pyetjeve parlamentare. Pyetja atëherë ka qenë për marrëveshjen në mes të Telekomit dhe Z-Mobile pas vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit ku PTK i obligohet Z-Mobile 32 milionë euro, arrihet një marrëveshje për të tejkalar këtë shumë në këmbim të 100 000 numrave që 3G dhe 4G, që Telekomit duhet t'ia japë Z-Mobile.

Pyetja për ministrin ka qenë, se a është në dijeni për këtë marrëveshje? Cili është qëndrimi i tij, pasi që flet si në cilësinë e aksionarit në emër të Qeverisë së Kosovës karshi ndërmarrjeve publike, përfshirë edhe Telekomin e Kosovës? Unë pres që ministri së paku me shkrim të përgjigjet në këtë çështje. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! A dëshironi të përgjigjeni? Ministri Lluka e ka fjalën.

**MINISTRI VALDRIN LLUKA:** Faleminderit!

I nderuari kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Më lejoni të filloj këtë përgjigje për zotin Hoti, duke i parashtruar, duke bërë disa sqarime dhe duke parashtruar disa pyetje.

Zoti Hoti, gjatë mandatit të Qeverisë së kaluar ju keni qenë ministër i Ministrisë së Financave. Rrjedhimisht, anëtar i Komisionit për Ndërmarrje Publike, komision i cili sipas Ligjit në fuqi për ndërmarrjet publike ushtron të drejtën e aksionarit, mbi të gjitha ndërmarrjet publike, duke përfshirë edhe Telekomin e Kosovës. Pra, ky komision ka kompetencë ekskluzive për të paraqitur vërejtje, propozuar dhe vendosur për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ndërmarrjet publike.

Zoti Hoti, më lejoni t'ua përkujtoj se nënshkrimin e marrëveshjes së datës 24 maj 2017, ndërmjettë Kompanisë Z-Mobile dhe Telekomit të Kosovës i ka paraprirë vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit i datës 9 dhjetor 2016, andaj më lejoni të pyes si në vijim:



- Sa ishe anëtar i Komisionit të Ndërmarrjeve Publike a është ngritur të paktën një herë çështja e kontratës së Z-Mobile dhe Telekomit të Kosovës, duke pasur parasysh se këtij vendimi i kanë paraprirë disa vendime të ARKEP-it, si dhe shkresave të Telekomit të Kosovës drejtuar Qeverisë mbi pamundësinë e këtyre për të përmbushur kërkesën e Z-Mobile?

- Sa ishe anëtar i Komisionit për Ndërmarrje Publike a keni parashtruar një herë të vetme për diskutim mungesën e Bordit të drejtorëve të Telekomit të Kosovës, që ka munguar për mbi një vit?

- Në cilësinë tuaj si ish-anëtar i Komisionit për Ndërmarrje Publike a jeni interesuar një herë të vetme për ankesat e Z-Mobile dhe paralajmërimet e tyre për të dërguar Telekomit në Arbitrazh?

- Gjatë kohës së arbitrazhit, në periudhën prill 2015, kur për herë të parë është paraqitur kërkesa për arbitrim, deri në momentin përfundimtar në dhjetor të vitit 2016, a e keni ftuar një herë të vetme Telekomit, menaxhmentin, për të diskutuar mbi dëmet që mund t'i shkaktojnë ndërmarrjes, në rast se vendimi është në dëm të Telekomit të Kosovës?

Zoti Hoti, a më tregoni çfarë keni ndërmarrë ju si ish-anëtar i Komisionit për...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Pyetjet i ka bërë ai. Po, mirë po nuk ke shumë kohë. Unë e shkeli Rregulloren. Në rregull, jepe sqarimin, të lutem, nëse mundesh. Po, sqarimin.

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Sa i përket përgjigjes prej anës sonë, me marrjen e detyrës sot e kemi funksionalizuar Bordin e Telekomit, pra që nga muaji mars menjëherë Bordi është kërkuar nga Bordi që ta bëjë një vlerësim të kontratës për ta shikuar impaktin në dëm, që do të jetë. Sa i përket cila është forma më e mirë, a të vazhdohet me kontratën apo të ndërpritet kontrata dhe të paguhet dëmi që duhet të paguhet dhe në bazë të atij vlerësimi do të marrë edhe vendim Bordi pra për masat që duhet marrë.

Pra, është tash në periudhën e vlerësimit dhe kemi kohë gjashtë muaj nga themelimi i Bordit, që do të thotë janë në pyetje edhe disa muaj. Mirëpo, ne besojmë se deri në fund të muajit qershor do të dalim me një qëndrim sa i përket kësaj marrëveshjeje.

Pra, do të bazohet vendimi tërësisht në ekspertizën e ekspertëve në këtë fushë, të cilët Telekomit do t'i ngarkojë në vlerësim të kësaj kontrate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti, keni koment a pyetje, se s...?

AVDULLAH HOTI: Kryesues, po!

Unë mendoj që ka gabuar ministri krejt qëllimin e pyetjeve parlamentare. Ai nuk mund të më drejtohet mua me pyetje. Ai është kryesues i Komisionit për Ndërmarrje Publike dhe ai duhet ta japë qëndrimin e tij tash si ministër për Zhvillim Ekonomik, si kryesues i këtij komisioni, se çfarë qëndrimi ka karshi kësaj marrëveshje dhe si planifikon të merret me këtë. Mos të na dalë në foltore me pyetje, sepse ndryshojnë rolet shumë shpejt dhe mandej jep përgjegjësi për këto, por në një situatë normale, ju garantoj se ai nuk do të ishte fare aty.

Unë mund t'ia bëj plot pyetje për plot çështje, ministrit, me i tregua edhe si po merret me çështjen që e ka lënë të hapur tash e sa vite në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe si po përgjigjet çdo ditë në gjyqe për çështje të hapur që ka atje. Kjo është çështja që duhet ai të përgjigjet. Nëse dëshiron të hyjë pyetje-përgjigje kështu personale, nuk e di ku përfundon, po s'ia qet mirë atij.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e dëshironi fjalën? Në rregull është. Atëherë, sipas marrëveshjes paraprake dhe sipas kërkesës së kryeministrit kemi kaluar në pikën tjetër të radhës dhe kjo çështje është shteruar.

Tani, kemi edhe 13 pika të rendit të ditës. Nëse dëshironi e vazhdojmë, nëse dëshironi shkojmë në pauzë e kthehemi apo si e keni mendjen, se unë kam disa kërkesa herë pas here këtu për t'u shtyrë. Dikush kërkon ta shtyjme për të martën, dikush ashtu... Ministrja kërkon që të vazhdojë seanca dhe të vazhdohet debati me interpelancën. Mirë do të ishte që kryetarët e grupeve parlamentare të deklarohen pak a shumë, a doni të shkojmë në pauzë, apo doni ta shtyjme për të martën? Faleminderit!

Zoti Hoti, e keni fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Tash, për arsye krejt objektive plot deputetë veç e kanë lëshuar sallën dhe plot të tjerë, ndoshta edhe mund të mos vijnë pas pauzës. Prandaj, në konsultim edhe me disa prej grupeve parlamentare, jo me të gjitha se s'kisha mundësi të konsultohem, unë propozoj që seancën ta vazhdojmë të martën, në orën 10:00.

KRYESUESI: Zoti Reçica, urdhëro!

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Dakordohem plotësisht me zotin Hoti, që nuk ka kushte për ta vazhduar seancën. S'kemi deputetë dhe nuk besoj se do të kthehen. Dhe mendoj që ta vazhdojmë të martën në orën dhjetë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, urdhëro!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Po ashtu, edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje konsideron se seanca duhet të vazhdohet të martën në ora dhjetë.

KRYESUESI: PSD-ja, kush e ka? Zoti Driton Çausi, urdhëro!

DRITON ÇAUSHI: Konsideroj se do të duhej të paktën që kryesuesit e grupeve parlamentare të bënin fillimisht përpjekje që t'i thërrasin kolegët e tyre. Më e lehta është që ta ndërpresim seancën në gjysmë, siç ndodh shpesh, dhe nëse konstatojmë se është e pamundur atëherë, por jo në këtë mënyrë. Unë nuk besoj se ka arsytim të mjaftueshëm për ta ndërprerë.

KRYESUESI: Zoti Isufi, urdhëro!

AHMET ISUFI: Për shkaqe objektive në këtë pikë pajtohem me opozitën.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sasha Milosavljeviq, urdhëro!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

I Poslanička Grupa Srpska lista se slaže sa predloženim predlogom da se sednica nastavi u utorak. A ja bih ovu priliku iskoristio da u svoje lično ime i u ime Srpske liste čestitam sutrašnji predstojeći praznik Bajram svim vernicima muslimanske veroispovesti. Želim sve najbolje Vama i vašim familijama! Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi, urdhëro!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë propozoj që seanca të vazhdojë të hënën, sepse asgjë s'kemi të bëjmë, kemi mjaft pushim, e premtë, e shtunë, e diel, e të hënën të fillojmë me seancë. Pse jo? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shinik, urdhëro!

MÜFERRA ŞİNİK: Faleminderit, nënkryetar!

6+ Paralementer Grubu aynı şekilde Pazartesi günü başlamasını öneriyor ve aynı zamanda fırsattan faydalanarak tüm müslüman aleminin Ramazan Bayramını kutlar, aileleriyle birlikte sağlıklı, huzurlu ve mutlu günler temmeni ederim. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, me vullnetin tuaj, seanca vazhdon të martën në orën 10:00. Faleminderit!

\* \* \*

*E martë, më 19 qershor 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 14 qershor 2018*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës si në vijim.

Për fillim, zoti Ahmet Isufi e ka kërkuar fjalën.

AHMET ISUFI: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra,

Mendoj që ndaj mendimin e të gjithë deputetëve të Parlamentit të Kosovës për të mbajtur një minutë heshtje për patriotin, për luftëtarin dhe babanë e katër gjeneralëve, zotin Hilmi Haradinaj, i cili u varros me nderime shtetërore dje.

KRYESUESI: Faleminderit!

*(Një minutë heshtje)*

Nderim, Lavdi!

Në sallë nuk kemi kuorum të mjaftueshëm për të vazhduar me tri çështje të mbetura që janë kryesisht për votim.

Por, po fillojmë me pikën e tretë të rendit të ditës që ka ngelur, kur të bëhet kuorumi i mjaftueshëm për votim, do t'u rikthehem pikave që nuk janë votuar në seancën e kaluar.

### **3. Interpelancë me ministren e Integrimit Evropian, zonjën Dhurata Hoxha, në lidhje me zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për kuartalin e katërt (K4) 2017 dhe kuartalin e parë (K1) 2018**

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka parashtruar kërkesën për të ftuar në interpelancë ministren e Integrimit Evropian, zonjën Dhurata Hoxha, në lidhje me zbatimin e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për kuartalin e katërt 2017 dhe kuartalin e parë 2018.

Siç e dini, koha për diskutime është e rregulluar me Rregulloren e Kuvendit, neni 44, prapë po ju njoftoj që unë do ta zbatoj Rregulloren që ka të bëjë me çështjen e interpelancave, qoftë minutazhin, qoftë radhitjen e diskutuesve.

E ftoj deputetin e Lidhjes Demokratike, zoti Hoti, si propozues i interpelancës, ta marrë fjalën. Zoti Hoti e keni fjalën, urdhëroni!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Ministre Hoxha,

Në bazë të nenit 65.9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 44, paragrafi 1, të Rregullores të Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka thirrur në interpelancë parlamentare zonjën Dhurata Hoxha, ministre e Integritimit Evropian, e cila është përgjegjëse për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e realizimit të Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Zonja Hoxha është thirrur për të dhënë sqarime lidhur me zbatimin e këtij plani për tremujorin e fundit të vitit 2017 dhe tremujorin e parë të këtij viti.

Për informim të deputetëve dhe qytetarëve, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është marrëdhënia e parë kontraktuale e Kosovës me BE-në. Kjo marrëveshje përcakton rrugën që Kosova duhet të kalojë deri në anëtarësimin e plotë në BE. Prandaj zbatimi i kësaj marrëveshjeje është çështje jetike për të ardhmen e vendit tonë.

Të nderuar deputetë,

Analiza jonë lidhur me masat e parapara në Planin Kombëtar për zbatimin e MSA-së tregon mungesë të progresit. Duhet ditur se këto masa janë të detyrueshme për secilin institucion shtetëror të Kosovës. Por, zbatimi i MSA-së, ashtu si shumë çështje të tjera që lidhen me mirëqenien e qytetarëve, kanë rënë në hijen e interesave të tjera këtij koalicioni dhe nën hijen e skandaleve të përditshme.

Mungesa e progresin në realizimin e MSA-së u pa qartazi ditë më parë. Në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, zonja Apostolova ua bëri të qartë ministrave se reforma evropiane ka ngecur dhe se duhet shumë angazhim për të realizuar detyrat e parapara për këtë vit.

Ndërkaq, znj. Hoxha, në një ngjarje publike kishte pranuar mungesën e koordinimit në mes të dikastere qeveritare lidhur me zbatimin e Planit Kombëtar për MSA-në.

Të nderuar deputetë,

Në prill të këtij viti znj. Hoxha i ka dorëzuar në Komisionit për Integritim Evropian “Raportin mbi zbatimin e Programit Kombëtar për MSA-në për vitin 2017”. Për pjesën e dytë të vitit 2017 ky raport tregon se ka vonesa serioze në realizimin e rreth 60% të masave që lidhen me kriteret politike. Këtu hyjnë në veçanti vonesat në aprovimin e pakos së ligjeve kornizë për administratën

publike dhe kjo është më se e kuptueshme, kur në baza ditore emërohen zëvendësministra e koordinatorë nacionalë, kur ka rritje të pagave pa asnjë bazë ligjore dhe mbulesë buxhetore dhe ndarje të mjeteve nga rezerva pa asnjë arsytim dhe jashtë çdo procedure.

Njëjtë është e me masat që lidhen me kriteret ekonomike: 53 masa të parapara në këtë fushë nuk janë zbatuar. Ngecjet këtu janë në veçanti tek realizimi dhe rishikimi i Strategjisë për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare, si dhe ofrimin e dëshmive për rezultate konkrete në fushën e luftimit të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Besoj se kjo ngecje është e kuptueshme, po si është realizuar ky plan nga disa nga ministritë kyçe?

Në bazë të dhënave që prezantuar edhe në raportin ne kemi nxjerrë statistikën për secilin dikaster qeveritar dhe gjendja nuk është e mirë. P.sh. për Ministrinë e Drejtësisë 78 për qind të masave janë të përcaktuara, për Ministrinë e Infrastrukturës 73 për qind të masave janë të përcaktuara, për Ministrinë e Bujqësisë 67 për qind të masave nuk janë realizuar, për MPB-në 65 për qind, për MTI-në 65 për qind, për Ministrinë e Ambientit 55 për qind, për MASHT 45 për qind, etj.

Por, të nderuar deputetë,

Ta lëmë vitin 2017, pasi këta arsyetohen se kanë qenë në fillim të mandatit.

Raporti i Ministrisë së Integritimit Evropian për tre muajin e parë të këtij viti nuk tregon se ka pasur përparim.

- 46% të masave të parapara për tremujorin e parë, janar-mars 2018 nuk janë zbatuar.

- Në fakt, raporti i Ministrisë së Integritimit Evropian tregon se shkalla e zbatimit të Programit Kombëtar për këtë tremujor është vetëm 8% e të gjitha masave të parapara për vitin 2018.

Me këtë ritëm viti do të mbyllet me 32% realizim të Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së.

Si mund të kërkojmë integritet më të shpejtë evropian me këtë seriozitet që po tregojmë?

Si kriteret politike, ashtu edhe ato ekonomike, janë prapa në realizim.

- Në tremujorin e parë janë zbatuar vetëm 7% të masave të parapara të kriteret politike.

- Ngecjet janë në disa çështje të rëndësishme, si:

- ligji për konfliktet administrative,

- koncepti dokumenti për personat e zhdukur,

- strategjia kombëtare e sigurisë, etj.

Te masat ekonomike raporti thekson se ka vonesa serioze në zbatimin e 70% të masave. Vonesa ka në miratimin e ligjeve për përafrim të legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së, siç është Ligji për infrastrukturë dhe informata hapësinore, aktet ligjore për parametrat e cilësisë së shërbimeve, Rregullorja për hetimin e aksidenteve, Ligji për pyjet e Kosovës, Ligji për Këshillin Ekonomik-Social, Ligji i ri i konkurrencës dhe ligje e rregullore të tjera.

Më lejoni t'ju kujtoj të gjithë deputetëve se në maj të vitit 2016 është përgatitur dokumenti i quajtur "Agjenda e reformave evropiane". Ky dokument parasheh reformat prioritare që duhet të zbatohet Qeveria. Por, bazuar në raportin e fundit të BE-së për Kosovën, ka ngecje serioze në realizimin e reformave të parapara në këtë dokument.

Të nderuar deputetë,

Në këtë Kuvend funksionon Komisioni Parlamentar për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, apo delegacioni i Kuvendit të Kosovës për MSA, i cili udhëhiqet nga pozita. Jam i sigurt se shumica nga ju as që keni dëgjuar për këtë komision, sepse asnjëherë nuk është takuar. Ky komision asnjëherë nuk i ka ftuar në raportim ministrat përkatës për të mbikëqyrë punën e tyre në zbatimin e Agjendës së Reformave Evropiane.

Pra e shihni se nuk ka seriozitet të punës dhe përkushtim për integrim evropian.

Plotësimi i kriterëve për integrim evropian nuk sigurohet duke shpenzuar në delegacione me nga 30 veta nëpër kryeqendrat evropiane.

Andaj, të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh ngecjet serioze në zbatimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, në përputhje me nenin 44, paragrafi 4, pika (d), të Rregullores së Kuvendit, propozoj mocionin si në vijim:

1. Në afat prej dy jave Qeveria të sjellë në Kuvend Programin Kombëtar (të rishikuar) për zbatimin e MSA-së për vitin 2018, i cili plan merr parasysh vonesat e deritashme.
2. Komisioni Parlamentar për MSA dhe Komisioni për Integrim Evropian të shqyrtojnë në afat prej dy javësh këtë program me zyrtarët përkatës të Qeverisë dhe t'i paraqesin Kuvendit raport me shkrim, duke identifikuar masat prioritare dhe institucionet përgjegjëse.
3. Pas çdo tremujori, Komisioni Parlamentar për MSA t'i paraqesë Kuvendit raport me shkrim lidhur me realizimin e Programit Kombëtar për MSA-në.

4. Të gjitha komisionet parlamentare të obligohen të përcjellin punën e dikastereve qeveritare dhe institucioneve të tjera, të cilat ato i mbulojnë lidhur me detyrat e tyre të parapara në Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe ju ftoj që, pas debatit që mund të kemi, këto rekomandime t'i plotësojmë dhe t'i aprovojmë në fund të këtij debati. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Ftoj ministren e Integritit Evropian, zonjën Dhurata Hoxha, që të paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Republikës lidhur me çështjet e ngritura në interpelancë, zonja Hoxha e keni fjalën.

MINISTRJA DHURATA HOXHA: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Procesi i integritit evropian është karakterizuar me një dinamikë progresive viteve të fundit. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, MSA, ka hyrë në fuqi, duke krijuar nga një anë obligimet kontraktuale ndërmjet Kosovës dhe BE-së dhe, nga ana tjetër duke përfaqësuar themelet e anëtarësimit tonë në BE.

Jemi në prag të liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës dhe Kosova tani më është pjesë e programeve të BE-së në nivelin e barabartë me të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor.

BE-ja dhe Kosova kanë dakorduar asistencë zhvillimore për të përkrahur sundimin e ligjit, zhvillimin ekonomik dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve në vlerë prej 645 milionë euro për periudhën 2014-2020.

Siç e dini, MSA ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016 dhe është marrëveshja ndërkombëtare më e rëndësishmja dhe më gjithëpërfshirësja që ka lidhur ndonjëherë Kosova dhe ka vendosur kornizën e marrëdhënieve tona me shtetet anëtare të BE-në dhe institucionet e saj, si dhe mekanizmat dhe afatet zyrtare për reformat që në mënyrë progresive do ta përfaqësojnë Kosovën me standardet e BE-së, do të krijojnë stabilitet politik e institucione demokratike dhe do ta bëjnë ekonominë e saj të integruar në BE dhe të aftë për të përballuar forcat e tregut dhe presionin e konkurrencës brenda tregut të brendshëm të BE-së.

MSA mbulon të gjitha sferat e qeverisjes, në kuadër të 144 neneve, të ndarë në dhjetë tituj, si dhe në shtatë shtojca, pesë protokolle dhe një deklaratë të përbashkët.

Të nderuar deputetë,

Qeveria ka bërë hapa shumë të rëndësishëm në konsolidimin e planifikimit dhe zbatimit të politikave nacionale për zbatimin e MSA-së.



Në këtë drejtim, gjatë tetorit dhe nëntorit Ministria e Integritimit Evropian ka udhëhequr rishikimin e Programit Kombëtar për zbatimin e MSA-së, i cili mbulon periudhën 2018-2022 dhe i cili është finalizuar, miratuar dhe ka filluar së zbatuari në fillim të vitit 2018.

Për këtë vit ky program ka paraparë zbatimin e 531 masave afatshkurta, prej të cilave 144, ose rreth 27% e tyre, janë masa legislative, ndërsa pjesa tjetër prej 387 masave, ose rreth 73% e tyre, janë masa zbatuese.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2018 është arritur një shkallë e përgjithshme e zbatimit të programit prej 53.58%, pasi që 21 nga 39 masat e planifikuara për këtë tremujor janë zbatuar, ndërsa pjesa e mbetur prej 18 masave, ose 46.15%, akoma nuk kanë arritur të zbatohen.

Përveç këtyre, 23 masa janë zbatuar para afateve të planifikuara. Kjo i bie se deri në fund të tremujorit të parë janë zbatuar gjithsej 44 masa, të cilat përbëjnë 8.29% të të gjitha masave në bazë vjetore të planifikuara. Përmirësim ky i dukshëm krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017, pra nëse krahasojmë tremujorin e parë të vitit 2018 kemi një implementim prej 53,85%, ndërsa tremujori i parë i vitit 2017 kemi një implementim apo zbatim prej 45.79%, pra nuk mund të themi se ka ngecje në zbatimin e MSA-së, sepse po e shohim që trendi është pozitiv apo rritja e zbatimit është në ngritje e sipër.

Më tej, sa i përket gjendjes deri në fund të marsit drejt zbatimit të reformave legislative, të gjeturat tregojnë se kemi arritur një shkallë zbatimi prej 13.89%, pasi që janë zbatuar 20 nga 144 masat afatshkurtra legislative të planifikuara për tërë vitin. Ndërsa 124 prej tyre, akoma nuk kanë arritur të zbatohen.

Në kuadër të monitorimit të PKZMSA-së, Ministria e Integritimit Evropian gjatë këtij tremujori ka organizuar takime të rregullta të komisioneve ekzekutive për integrim evropian dhe të Komitetit punues për integrim evropian, e pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve përgjegjëse për të siguruar zbatimin e plotë dhe në kohë të masave të parapara në kuadër të programit.

Sa i përket vitit 2017 në tërësi është arritur një nivel i zbatimit të programit prej 62,05% pasi janë zbatuar plotësisht 600 nga 967 masa të planifikuara. Edhe këtu krahasuar me vitin 2016 kemi një rritje të zbatimit të MSA-së.

Derisa në vitin 2016 zbatimi i MSA-së ka qenë 55,46%, në vitin 2017 zbatimi në tërësi i MSA-së është 62,05%.

Sa i përket shkallës së zbatimit të masave legislative gjatë vitit 2017, të gjeturat tregojnë si në vijim: 38,47% e tyre, apo 100 masa, janë zbatuar, 61,53% apo 160 masa nuk kanë arritur të zbatohen.

Dhe bazuar në të gjeturat e statusit të ecurisë, shkalla e zbatimit të masave legislative gjatë vitit 2017 është 38,47%, pasi që 100 nga 260 masa të planifikuara janë zbatuar.

Gjatë vitit 2017, nën udhëheqjen e Ministrisë së Integrimit Evropian dhe në bashkëpunim të ngushtë me BE-në Qeveria gjithashtu ka bërë hapa shumë të rëndësishëm në konsolidimin e planifikimit dhe zbatimit të politikave nacionale për zbatimin e MSA-së.

Konkretisht fokusi ka qenë në planifikimin dhe zbatimin e dy dokumenteve nacionale për zbatimin e MSA-së, agjenda për reforma evropiane, apo procesi ERA dhe Programi Kombëtar për zbatimin e MSA-së.

Plani i veprimit për ERA parasheh zbatimin deri në fund të këtij viti të rreth 130 reformave strategjike të rëndësishme më të lartë politike për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së. Në vijim të përmbushjes së këtyre prioriteteve, më 10 nëntor 2017 Qeveria miratoi dokumentin Prioritetet kyçe të agjendës evropiane për vitin 2018, i cili parasheh zbatimin të programit ERA.

Zbatimi i prioriteteve të ERA-s është përshpejtuar me marrjen e detyrës së Qeverisë së re dhe sa i përket qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, kemi përgatitur dhe së shpejti do ta miratojmë pakon e ligjeve kornizë, të cilat do të krijojnë administratë publike efektive, meritokratike dhe në shërbim të qytetarëve.

Po ashtu është përgatitur edhe plani i veprimit për racionalizimin e agjencive të pavarura.

Për të forcuar sundimin e ligjit kemi miratuar Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe me miratimin e këtij projektligji, kemi siguruar kornizën moderne ligjore, e cila përkufizon më qartë kategorinë e zyrtarëve publikë, veprimet kundërligjore të zyrtarëve publikë, veprimet që nuk do të lejohen nga zyrtarët publikë pas përfundimit të mandatit të tyre, transparencë edhe më të madhe të raportimit në rastet e konfliktit potencial të interesit si dhe vendosja e procedurave të qarta në rast të pranisë së konfliktit të interesit.

Gjithashtu është miratuar Projektligji për Prokurorinë e Shtetit. Me miratimin e Projektligjit për Prokurorinë e Shtetit do të sigurohet hapësira ligjore e nevojshme për ngritjen e numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale dhe kjo do të kontribuojë drejtpërdrejt në intensifikimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Kodi Penal është miratuar nga Qeveria dhe pritet miratimi në Kuvend.

Projekt-kodi i Procedurës Penale është në hartim e sipër.

Miratimi i këtyre dy akteve do të sigurojë pezullimin dhe largimin e zyrtarëve të lartë publikë me rastin e ngritjes së aktakuzës apo dënimit të formës së prerë.

Me miratimin e Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim është avancuar korniza ligjore në përputhje me standardet evropiane.

Ligji ofron kontribut në zhvillim ekonomik të vendit, pasi që krijon mjedis edhe më të mirë për zhvillimin e ndërmarrjeve duke ndihmuar në kredidhënien e bizneseve dhe duke vendosur standarde kredibile sa u përket pasqyrave financiare të ndërmarrjeve.

Sa u përket reformave për zhvillimin ekonomik, rezultatet e arritura i tregon vetë fakti se Banka Botërore në raportin e saj të të bëri biznes ka ranguar Kosovën në mesin e dhjetë vendeve më reformatore në botë, pasi kemi avancuar në rangim për 20 pozita, nga vendi 60 në atë të 40.

Në këtë drejtim me sukses u miratuan këto akte: Projektligji për kontrollin e brendshëm të financave publike. Me miratimin e këtij Projektligji për kontrollin e brendshëm të financave do të krijohet baza ligjore për forcimin e llogaridhënies menaxheriale si faktor që ndikon pozitivisht në shpenzimin efikas të parasë publike.

Po ashtu u miratuan edhe projektligje si vijon: Projektligji për metrologjinë, Projektligji për mbrojtjen radioaktive si sigurinë nukleare, Projektligji për azilin, Projektligji për të huajt dhe Projektligji për kërkesa teknike, për produkte dhe vlerësimin e konformitetit, të gjitha këto prioritetet të specifikuar në procesin e ERA-së.

Të nderuar deputetë,

Sa i përket PKZMSA, Ministria e Integrimit rregullisht harton raporte tremujore për zbatimin e saj dhe të njëjtat i raporton në Qeveri, duke kërkuar vëmendjen e të gjitha institucioneve në përshpejtimin e reformave për zbatimin e masave të specifikuar në këtë plan veprimi.

Qëllimi i këtyre raporteve është vlerësimi dhe përmirësimi i zbatimit të programit, duke shërbyer si bazë për përgjegjësinë në kuadër të institucioneve deri në nivelin më të lartë politik si dhe për siguruar transparencë ndaj aktorëve të tjerë dhe më gjerë publik për zbatimin e MSA-së. Këto gjetje diskutohen në mbledhje të Qeverisë dhe shërbejnë edhe për punën e strukturave të Stabilizim-Asociimit.

Në aspektin e përmbajtjes, raportet japin një pasqyrë sasiore të zbatimit të masave gjatë periudhës raportuese në nivel të programit në tërësi, të secilit bllok dhe të secilit kapitull, ato gjithashtu japin një vlerësim cilësor të gjendjes në çdo kapitull, duke përmbledhur sfidat kryesore në zbatim dhe ato të mundshme gjatë pjesës së mbetur të vitit.

Vlen të theksohet se në vitin 2018 zbatimi i PKZMSA-së është i një rëndësie shumë të veçantë, për shkak se në kuadër të mbështetjes direkte buxhetore për reformën e administratës publike jemi zotuar se do të arrijmë shkallën e zbatimit minimum prej 60% në 2018-ën, dhe arritja e këtij indikator është jashtëzakonisht i rëndësishëm për të evituar mbulimin potencial të fondeve të BE-së.

Platforma online, të cilën e kemi lansuar, do të rritë efikasitetin e institucioneve në zbatimin e MSA-së dhe do të ofrojë informacion të sigurt, të saktë dhe të shpejtë për vendimmarrje politike.

Të nderur deputetë,

Konsideroj se PKZMSA është një mundësi e mirë që të gjitha institucionet të shohin prioritetet dhe të kuptojnë se ku duhet të fokusohet puna e tyre gjatë këtij viti.

Me theks të veçantë duhet të fokusohemi në fuqizimin e zbatimit të ligjeve, implementimin e reformës së administratës publike, avancimin e politikave të punësimit dhe arsimit, vazhdimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Puna e institucioneve në këto fusha duhet të jetë konkrete dhe të përfshijë të gjitha hallkat e zinxhirit institucional. Siç e dini tashmë disa herë kam insistuar në krijimin e një konsensusi nacional për reformat dhe proceset që janë pjesë e rrugës sonë drejt integritit, e sidomos masave që janë pjesë e PKZMSA-së.

Asnjë projektligj, reformë apo proces tjetër nuk guxon të ngecë për shkak të mospajtimeve politike e partiake. Është koha e fundit që të gjithë ta kuptojnë rolin e tyre në zbatimin e MSA-së, pavarësisht funksionit që mbajnë.

Le të punojmë të gjithë së bashku për të përmbushur sa më shpejt obligimet tona që dalin nga MSA-ja dhe të ecim para.

Zbatimi i MSA-së nuk është agjendë partiake, por agjendë shtetërore, nuk është diçka për të cilën duhet të angazhohet vetëm Qeveria, por duhet të angazhohen të gjitha institucionet dhe sigurisht, duhet edhe përkrahja e opozitës, sidomos kur kemi të bëjmë me masat legislative.

Si ministre e Integritit Evropian mbetem në dispozicion që të ndaj me ju të gjitha raportet që kemi dhe të punojmë së bashku për të adresuar sfidat në këtë proces aq të rëndësishëm për vendin. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Pas debatit që do të bëhet, ministrja Hoxha e ka fjalën dhe propozuesi i interpelancës pastaj i ka pesë minuta, por për çështje replike unë s'mund t'ia marr fjalën, nuk mund t'ia mohoj fjalën ministres, në qoftë se ka nevojë për replikë.

Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, zoti Ilir Deda, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së. Zoti Deda, e keni fjalën.

ILIR DEDA: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar,

Ministre,

Kolegë deputetë,

Faktikisht kur të shikojmë vlerësimin e zbatimit të kontratës të Kosovës me Bashkimin Evropian për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, e shohim edhe gjendjen e vendit tonë, edhe aftësinë e vendit tonë që të përmbushë kontratën, të cilën e ka marrë.

Në qoftë se do të notohej Kosova, nëse do të jepej notë për aftësinë e saj për zbatim të MSA-së, Kosova do të ngelte dhe nuk do ta kalonte asnjë provim, e me raportin, sidomos raporti i tremujorit të vitit 2018, tremujori i parë, njëjtë tregon që Kosova nuk po përgatitet as për vjeshtë që të kalojë në provimin e vjeshtës, edhe ky është realiteti apo duhet të jetë një pasqyrë e thyer për çdo njërin nga ne në këtë Kuvend, për këtë Qeveri, e cila diskuton apo kërkon që Kosova të ecë sa më shpejt drejt integritit të Bashkimit Evropian, ndërsa në fund, kur t'i shohim rezultatet në zbatim të kontratës, ajo del zero.

Dua t'i përmend pikat kyçe të MSA-së, zbatimi i MSA-së e forcon demokracinë në Kosovë, i forcon institucionet e bën më të pavarura, e forcon sundimin e ligjit dhe e forcon ekonominë, prodhimtarinë e Kosovës dhe e bën atë të gatshme për integrim në tregun e përbashkët në Bashkimin Evropian. Dhe, pasqyra e përgjithshme në fakt kur ta lexojmë Raportin e zbatimit për tremujorin e parë, del që Kosova e ka përmbush vetëm 8,29% të asaj çka i ka planifikuar vetë, sepse programi për zbatim të MSA-së, është dokument i Qeverisë, të cilin e planifikojmë ne vetë dhe ky del një mbivlerësim i kapaciteteve të vendit tonë çka mund të zbatohet apo jo. Masa legjislative, përqindja e zbatimit është 13,89%. Në kriteret politike, të cilat janë kyçe për zhvillim të demokracisë në këtë vend, kemi zbatim prej 5,88%, ndërsa në ekonomi, e cila është faktikisht pjesa më e madhe e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim kemi zbatim vetëm prej 21,43%.

E kur ta shohim përafrimin e legjislacionit të Kosovës me 'acquis communautaire', aty zbatimi është 8%, dhe nëse e lexojmë më thellë demokracinë dhe sundimin e ligjit, kur flasim për Parlamentin dhe sistemin zgjedhor të Kosovës, masat e plotësuara janë 0%. Reforma e Administratës Publike, masa e zbatimit 5,56%, çështjet për Avokatin e Popullit 0%, bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare të Kosovës 0%, kriteret ekonomike e tjera 33%, kapaciteti për përballje me konkurrencën në BE 0%, standardet evropiane - lëvizja e lirë e mallrave 12,5%, ndërsa lëvizja e lirë e punonjësve 0%. Epo më falni, atëherë për çka flasim ne këtu? Nëse e kemi 0 deri në rastin më të mirë 30% të zbatueshmërisë të programit, të cilin e kemi aprovuar vetë, të cilin e kemi përpiluar vetë, në bazë të një pune jashtëzakonisht të madhe, e cila është bërë me vite që Kosova ta ketë Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim, tash edhe këtu po e

shohim me mospraninë e Kabinetit qeveritar sesa ata e marrin seriozisht, shumica e tyre, sepse kryeministri natyrisht që nuk presim të jetë këtu, por anëtarët e tjerë a e marrin ata seriozisht këtë kontratë të Kosovës me BE-në? Jo! A e dini pse? Sepse, më me rëndësi është që kjo Qeveri t'i ketë rreth 80 zëvendësministra, 53 milionë euro - një vjedhje industriale e parave të buxhetit publik të ndodhë në Kosovë, e ta shohim si do të reflektojë në tremujorin e dytë të raportit vjedhja e 53 milionë eurove, mosfunksionimi i mirëfilltë i Kuvendit, mungesa e koordinimit të brendshëm qeveritar, dhe në fund a do të ketë kush të marrë përgjegjësinë për moszbatim. Moszbatimi i MSA-së nuk mund të jetë vetëm një diskutim yni këtu, por institucionet, të cilat po ngelin, a do të marrin përgjegjësi dhe cila është ajo përgjegjësi? A do të ketë shkarkim të ministrave, zëvendësministrave, apo do të vazhdojmë me avazin e vjetër që kur të përfundojë kjo seancë të gjithë do të thonë sesa shumë kjo Qeveri është e përkushtuar për Reformën e Agjendës Evropiane, për përafrimin e legjislacionit me BE-në, që Kosova me të vërtetë dëshiron të jetë në Bashkimin Evropian dhe 28 vende kur e shohin a e ka përnjëmend Kosova këtë punë, e shohin ngeljen e vazhdueshme të kësaj Qeverie, e për fat të keq nuk është moskalimi i provimit vetëm prej Qeverisë, por peshën e kësaj paaftësie e bart i gjithë shteti... Kaq!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Elmi Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Përshëndetje, i nderur zoti nënkryetar Haliti!

Ministri Hoxhaj,

Kabinet qeveritar,

Ministri qenka këtu,

Kolegë të nderuar deputetë,

Qytetarë të respektuar të këtij vendi,

Njëra nga çështjet që diskutohet më së tepërmi dhe që bën përshtypje, dhe ka kërkesa më së shumti, sigurisht është procesi i integritimit.

Dhe, si i tillë, ky proces është shumë kompleks dhe kërkon reforma në shumë sektorë. Për këtë, kapacitetet institucionale janë ndër faktorët kyçë. Ne si Grup Parlamentar i PDK-së kemi identifikuar një numër të fushave me prioritet të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Qëllimi parësor është zbatimi sa më efikas i MSA-së, në veçanti i agjendës së integritimit në përgjithësi, në mënyrë që të jemi të gatshëm për fazat e ardhshme drejt rrugës evropiane, ose drejt integritimit evropian. Ne si deputetë vlerësojmë se Qeveria, në bashkëpunim me Zyrën e BE-së në Kosovë, ka bërë hapa shumë të rëndësishëm në konsolidimin e planifikimit dhe zbatimit të politikave nacionale për zbatimin e MSA-së. Konkretisht, duke mbajtur në fokus planifikimin dhe zbatimin e dy dokumenteve kyçe e nacionale për zbatimin e MSA-së, Agjendës për Reforma Evropiane - shkurt ERA, dhe programit kombëtar për zbatimin e MSA-së.

Që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, në prill 2016, u miratua edhe programi i parë kombëtar për zbatimin e saj. Në ndërkohë, korniza e planifikimit të politikave dhe ajo ndërveprimit institucional ndërmjet dy palëve, Kosovës dhe BE-së, ka avancuar dhe është bërë më dinamike, me fokus në zbatimin e reformave që i kërkon MSA-ja. Në këtë kontest të zhvillimeve më të reja, në të cilat gjendet vendi ynë, kërkohet një dinamikë e re, funksionale, përmbajtjesore e reformave. Në radhë të parë, përkushtim dhe unitet politik shumë më i madh në këtë fushë, kjo veçmas duke e pasur parasysh faktin se zbatimi i MSA-së zhvillohet në kuadër të dy kornizave të lartpërmendura. Me fjalë të tjera, këto korniza bazë janë themelet, ndërsa ERA shërben si dokument më i fokusuar, që d.m.th. MSA-ja është korniza bazë, themel, kurse ERA shërben si dokument më i fokusuar që paraqet prioritetet afatmesme dhe masat afatshkurta për diskutime të vazhdueshme ndërmjet palëve tona.

Ndërkohë që zbatimi i këtij procesi ka vazhduar, ne e përgëzojmë dhe mbështesim iniciativën e fundit për lobim në vendet anëtare të BE-së nga disa kolegë deputetë të udhëhequr nga kryetari i Kuvendit, zoti Veseli. Duke mos u harruar me këtë rast kontributin e vazhdueshëm të ministres së Integritimit Evropian, përfaqësuesit e Zyrës së BE-së dhe Komisioni Parlamentar për Integritim Evropian dhe të gjithë deputetët veç e veç që në secilin takim dhe kudo që e kanë prezantuar Kosovën kanë mbajtur një qëndrim të përcaktuar qartë sa i përket agjendës evropiane. Në këtë mënyrë, ne si grup parlamentar, i përkrahim arritjet e konsiderueshme në këtë projekt madhor për Kosovën. Pa diskutim që i kemi vërejtjet tona dhe nuk jemi të kënaqur me dinamikën dhe angazhimin çfarë është e përcaktuar, por megjithatë bëjmë thirrje që objektivat qendrore të programit t'i vihen masa e veprime që do të sjellin reforma konkrete. Zbatimi i këtyre politikave patjetër që do ta hapte një kapitull të ri për Kosovën, duke mundësuar kështu integritimin më të mirë të politikëbërjes dhe nevojat e brendshme të zhvillimit në atë të integritimit evropian. Pra, sinkronizimit më të mirë të rrjedhjes së reformave përgjatë të gjitha niveleve, duke përfshirë këtu edhe nivelin ligjvënës, të cilit ne i përkasim si deputetë dhe kemi obligime krejt specifike sa i përket kësaj çështjeje.

Sa i përket përmbajtjes vërehet se programi i rishikuar e paraqet një kornizë gjithëpërfshirëse të reformave konkrete afatshkurtra dhe objektivave afatmesme dhe prioritetet. Flasim për periudhën 2018-2022 për zbatimin e MSA-së. Nëpërmjet përafrimit të legjislacionit kombëtar me atë të BE-së, me të gjitha masat dhe tri prioritetet kryesore: kriteret politike, kriteret ekonomike dhe standardet evropiane.

Ne jemi dëshmitarë që janë marrë një varg veprimesh sa i përket zbatueshmërisë së këtyre tri prioritetëve dhe normalisht që kërkesa e deputetëve, por edhe e qytetarëve, është që ato të përshpejtohen, të thellohen dhe të zgjerohen.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të theksoj që secili organ ose segment, niveli i Administratës Shtetërore, duhet të jetë përgjegjës për zbatimin e programit dhe monitorimin e zbatimit të tij në kuadër të fushëveprimit dhe kompetencave të tij. Si mekanizëm qendror qeverisës, në vend për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga MSA-ja, përgjegjësia për monitorimin dhe zbatimin e tij bie mbi Qeverinë e Kosovës, si dhe mbi të gjitha institucionet e tjera të përfshira në përgatitjen e programit. Ne si Kuvend dhe në veçanti si Grup Parlamentar i PDK-së, në bashkëpunim me partnerët e koalicionit dhe me të gjithë deputetët që janë në këtë legjislaturë, do të jemi një nga shtyllat kyçe institucionale për zbatimin e këtij programi, në veçanti miratimin e legjislacionit, duke i dhënë mbështetje të plotë Komisionit për Integrim Evropian edhe Ministrisë së Integritimeve Evropiane, në aspektin e shtyrjes përpara të agjendës legjislative, duke i përmbushur detyrat e marra nga Kuvendi.

Të nderuar deputetë,

Të gjithë e dimë se që nga fillimi i procesit drejt MSA-së, në tetor 2011, e deri më sot, si shtet kemi bërë punë të jashtëzakonshme në përmbushjen e kritereve që na dërgojnë drejt anëtarësimit në familjen evropiane. Andaj, në këto javë dhe këta muaj që na kanë mbetur kërkohet një konsensus gjithëpërfshirës prej të gjithë aktorëve politikë, prej shoqërisë civile dhe të gjithë të interesuarve që janë të dëshmuar sa i përket agjendës evropiane dhe në atë mënyrë i japim Qeverisë së Republikës së Kosovës gjithë mbështetjen e duhur në realizimin e këtyre qëllimeve në të mirë të qytetarëve të këtij vendi dhe të shtetit tonë.

Ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës kemi ndikuar dhe do të vazhdojmë të ndikojmë në strukturat e stabilizim-asociimit në kuadër të Komitetit Parlamentar për Stabilizim-Asociim si forum i përbashkët i deputetëve të Parlamentit Evropian dhe atyre të Kuvendit të Republikës së Kosovës për të shkëmbyer mendime rreth zbatimit të MSA-së, për të marrë detyra dhe obligime dhe për t'i mbushur të gjitha ato në plotëni. Më lejoni të përsëris se Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah me vendosmëri çdo iniciativë dhe veprim konkret për ta afirmuar dhe afruar Kosovën drejt Bashkimit Evropian.

Andaj, shpresojmë në këtë drejtim ky vit do të jetë vit i bashkëpunimit të fuqishëm ndër-institucional për të mirën e të gjithë qytetarëve të vendit tonë. Besoj që agjenda evropiane është një nga çështjet që na bashkon të gjithëve dhe në këtë aspekt ne duhet të dëshmojmë që jemi unikë dhe jemi të përcaktuar që t'i realizojmë të gjitha ato çka janë interes i qytetarëve dhe interes i këtij shteti. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Pacolli, në emër të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes.

**FITORE PACOLLI-DALIPI:** Të nderuar qytetarë të Republikës!

Të nderuar deputetë,



Është e vërtetë që MSA-ja e paraqet pra Marrëveshjen e parë kontraktuale ndërmjet Kosovës dhe BE-së, e cila e definon qartë rrugën që duhet Kosova ta ndjekë nëse si shtet synojmë të integrohemi në Bashkimin Evropian, mirëpo është po ashtu e vërtetë se MSA-ja e paraqet shumë qartë jo seriozitetin e kësaj qeverie për të ecur tutje me reformat.

Pra, përkundër zotimeve që, siç e shihni, janë vendosur në letër, këto zotime nuk kanë arritur të realizohen dhe se nuk po e themi vetëm ne tani në Kuvendin e Kosovës se kjo qeveri ka shënuar ngecje, pra po ngec sa i përket reformimit dhe të marrjes së masave që duhet të bëhen për të përmbushur MSA-në, po e thonë edhe raportet ndërkombëtare, siç ishte Raporti i vendit. Raporti i vendit e ceku fort mirë se kjo Qeveri ka shënuar ngecje dhe është tepër e ngadalshme në realizimin e reformave. Të njëjtën gjë po e thonë edhe raportet e organizatave vendore, se Qeveria ka ngecur. Pra, nëse analizohet në detaje se sa kemi arritur pra si shtet të ecim tutje drejt realizimit të reformave, kuptohet fare lehtë dhe mirë se fokusi vazhdon të mbetet te masat sipërfaqësore. Pra, tek masat e lehta dhe për këtë Qeveria flet se ka realizuar disa masa. Asnjëherë nuk është synuar përmbushja e detyrimeve, të cilat kërkojnë reforma të thella, pra reforma substanciale. MSA-ja pikërisht kërkon reforma të thella juridike, politike, ekonomike e institucionale, por kjo Qeveri dhe asnjë qeveri tjetër e përbërë nga zyrtarë të korruptuar dhe me aktakuza të ngrehura nuk mund të bëjnë reforma të nevojshme për ta vendosur këtë vend në binarët e duhur.

Për shembull, nëse i marrim rezultatet dhe i shohim për vitin 2018, shihet se janë planifikuar 531 masa. Mirëpo, deri më tani janë realizuar vetëm 8% e tyre dhe ministrja këtu sapo tha se ky është sukses dhe se ka përmirësim të dukshëm, mirëpo nga 39 masa të planifikuara për këtë tremujor janë realizuar vetëm 21, pra ka mbetur mbrapa me 18 masa, prandaj ky nuk mund të quhet përmirësim, kjo është ngecje, sepse 18 masa nuk janë realizuar të cilat janë paraparë të realizohen për këtë tremujor. Përmirësim do të quhej nëse masat, të cilat kërkojnë reforma të thella, të cilat dështuan të realizohen në tremujorin e fundit të vitit 2017, të realizoheshin në këtë tremujor të vitit 2018, por as këtë nuk e kemi parë. Reformat e thella si reforma në Administratën Publike, ne vetëm e kemi parë një partizimin të thellë të kësaj administrate. Pra, nuk ka ndodhur departizimi. Partitë politike në pushtet i kanë punësuar njerëzit e tyre në të gjitha bordet e ndërmarrjeve publike. Pra, këtu nuk kemi reformë dhe nuk mund të bëhet reformë e thellë përderisa kjo Qeveri vazhdon në këtë mënyrë. Pra, ky nuk është përmirësim, tremujori i parë i vitit 2018 na tregon se Qeveria jo vetëm se ka ngecur, por ka mbetur tepër mbrapa, pasi nuk ka arritur t'i realizojë masat e planifikuara të vitit 2017.

Një pasqyrë të qartë të asaj se çfarë pune ka bërë Qeveria, përveç tremujorit të parë të vitit 2018, shihet fare mirë në tremujorin e fundit të vitit 2017. Nga 967 masa të planifikuara, gjatë vitit 2017 janë realizuar vetëm 600 masa, e nuk kanë arritur të realizohen 367 masa. Pra, ky është dështim dhe për këtë Qeveria dhe Ministria e Integritetit Evropian, dhe ministritë përgjegjëse, duhet të japin përgjegjësi.

Për shembull, nëse ndalemi tek Administrata Publike, pra mbetja mbrapa me reformat në Administratën Publike është theksuar edhe në Raportin për vendin. Nga gjithsej 25 masa afatshkurtra për vitin 2017, janë zbatuar vetëm pesë sosh. Pra, 20 masa nuk janë zbatuar fare. Prandaj, këtë nuk mund ta quajmë sukses. Te kriteret ekonomike, pra nga 19 masa, janë realizuar vetëm 9, ndërsa 10 masa nuk janë realizuar fare. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut, pra kemi treg funksional, Raporti për vendin thotë se jemi mbrapa dhe se Kosova nuk ka treg funksional dhe kjo shihet edhe nga reformat dhe serioziteti i Qeverisë për t'i bërë reformat elementare për ta krijuar një treg funksional.

Pra, nga 13 masat afatshkurtra janë zbatuar vetëm 61,54%, 38% e tyre nuk janë zbatuar fare, përfshirë edhe rishikimin e strategjisë për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare, dhe kjo mbetet mjaft shqetësuese, sepse edhe në Raportin për vendin thuhet fare qartë se kjo Qeveri ka mbetur mbrapa sa i përket luftimit të ekonomisë joformale dhe sa i përket pastrimit të parave, kjo Qeveri nuk ka as qëllim dhe as synim që të merret me të. Pra, nëse kalojmë te kapaciteti i shtetit tonë për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcave brenda tregut, të tregut brenda Unionit Evropian, gjithsej nga gjashtë masa, pra vetëm gjashtë masa kanë qenë, kjo Qeveri ka arritur ta realizojë vetëm një masë, pra 5 masa të tjera nuk janë zbatuar fare.

Te standardet evropiane, nga 887 masa, 326 masa nuk janë zbatuar fare, përfshirë këtu miratimin e pesë projektligjeve në fushën e lëvizjes së lirisë së mallrave, rekrutimin e inspektorëve të punës, miratimin e strategjisë për zhvillimin e sektorit privat dhe shumë të tjera. Nëse flasim për lëvizjen e lirë të mallrave thuhet se ka vonesa serioze dhe se masat e planifikuara nuk janë përfunduar sipas afatit të paraparë. Nga 23 masa afatshkurtra, janë zbatuar vetëm 8, ndërsa 15 masa nuk janë zbatuar fare.

Te mjedisi, 52 masa afatshkurtra, 23 masa nuk janë realizuar fare. Pra, atëherë pyetja për ministren është se nëse vazhdojmë me këtë ritëm, sa mendoni se do ta përmbushim MSA-në, sepse ky ritëm na tregon se do të mbetemi edhe në vitin 2018 si shtet shumë mbrapa në reformat evropiane, apo ndoshta është më mirë që kjo Qeveri, kjo ministre dhe kryeministri të deklarohen se nuk janë të gatshëm t'i kryejnë detyrat të cilat i kanë marrë përsipër. Ne e dimë se reformat juridike, politike, ekonomike e institucionale, pra po flasim për reforma të thella, nuk mund të bëhen nga Qeveria, e cila ka edhe njerëz me aktakuzë të ngrehur dhe të involvuar në korrupsion. Këto reforma të thella mund të bëhen vetëm nga njerëz, nga Qeveria, e cila udhëhiqet nga njerëz me duar të pastra. Pra, këtë mund ta themi shumë hapur se vetëm Lëvizja Vetëvendosje mund të bëjë reforma të thella juridike, politike, ekonomike e institucionale, ashtu siç kërkohet nga Bashkimi Evropian.

Prandaj, edhe sot është për të të ardhur keq, sepse po flasim për një program që konsiderohet edhe nga Qeveria shumë i rëndësishëm, mirëpo ministrat përgjegjës nuk gjenden këtu. Këtu e

kemi ministren e Integritimeve Evropiane, por nuk kemi ministra tjerë, nuk e kemi ministrin për Zhvillim Ekonomik, ministrin për Arsime, për Shëndetësi, pra të gjithë duhet t'i marrin përsipër dëshimet e tyre dhe duhet të japin përgjegjësi para qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pantina, në emër të Grupit Parlamentar të PSD-së.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se të flas për Marrëveshjen e MSA-së, unë dua të ngre edhe një shqetësim tjetër që ka të bëjë me mënyrën se si operojnë bankat tek ne në Kosovë, e natyrisht edhe ajo lidhet me procesin e integritimeve. Vetëm dje është pranuar edhe nga vetë guvernatori se këto banka i kanë plaçkitur qytetarët rregullisht, por së fundi tashmë ajo po vërtetohet edhe nga vetë banka, kështu që dikush duhet të japë llogari për këtë plaçkitje të vazhdueshme.

Sa i përket zbatimit të Marrëveshjes së MSA-së, përvoja e deritashme e të gjitha qeverive tona na ka treguar se qeveritarët tanë nuk hezitojnë shumë për të nënshkruar marrëveshje apo dokumente, apo edhe për t'i miratuar ato, e sidomos kur ato vijnë nga mekanizma ndërkombëtarë, përfshirë këtu edhe Bashkimin Evropian, por problemi gjithmonë mbetet kur vjen koha për zbatimin e tyre. Kur lexohen marrëveshjet e tilla, përfshirë këtë edhe kontratën me MSA-në, krijohet përshtypja se ato nuk janë hartuar nga zyrtarët tanë. Natyrisht se MSA-ja është një dokument që po ashtu kërkon që të hartohet bashkë me BE-në, por pjesëmarrja e zyrtarëve tanë në negociim dhe në hartim është tejet e ulët, ndikimi i tyre në fakt është tejet i ulët, ndryshe mendoj se po ta merrnin fillimisht seriozisht vetë hartimin e këtij dokumenti, edhe zbatimi i tij pastaj do të bëhej më i lehtë, sepse do t'i kishin parasysh, e para kapacitetet tona që kemi, sidomos ato njerëzore për zbatimin e tyre, por e dyta do ta kishin ndërmend edhe sesa ekziston vullnet real sidomos për kryerjen e këtyre reformave. E këtu, gjithmonë ne kemi problem, dhe në këtë rast problemi kryesor për ngecjet në zbatimin e MSA-së natyrisht kanë të bëjnë me vullnetin dhe angazhimin e njerëzve, sepse unë besoj që në Kosovë ka kapacitete njerëzore, ka njerëz profesionistë që mund t'i udhëheqin dhe t'i çojnë përpara reformat e nevojshme.

Dhe këtu, natyrisht se është për t'u kritikuar thellë mungesa e ministrave, të cilët janë drejtpërdrejt përgjegjës për zbatimin e MSA-së. Më së paku përgjegjësi në kuadër të Qeverisë për zbatimin e MSA-së ka Ministria për Integritime Evropiane, sepse roli i kësaj ministrie është thjesht koordinimi, kurse zbatimi i këtyre masave varet drejtpërdrejt nga ministrinë përkatëse dhe ndoshta një numër i vogël edhe nga komunat, por kryesisht ministrinë. Tek agjenda për reformë evropiane kur janë nxjerrë prioritetet, e të cilat me të drejtë janë nxjerrë si prioritete, theksohet të jenë ato që kanë të bëjnë me zbatimin e MSA-së, qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit, konkurrueshmëria dhe klima e investimeve, punësimi dhe arsimit. Tek qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit këtu as nuk është ministri për Administratë Publike, e cili e ka përgjegjësinë e një

numri të madh të reformave që duhet të bëhen në administratë, po ashtu që dalin si obligime nga MSA-ja dhe nuk është as ministri i Drejtësisë, i cili e ka të njëjtën përgjegjësi. Për më tepër, nuk është ministri i Tregtisë dhe Industrisë, ku pjesa më e madhe e MSA-së ka të bëjë me këtë dikaster, pra me reformat që duhet të bëhen në këto sektorë. Dhe tash, edhe pyetjet që ne mund t'i kemi në këtë drejtim, se sa janë zbatuar këto masa, ministrat nuk janë këtu për të dhënë përgjigje dhe kur nuk ka përgjigje, natyrisht se ka hapësirë të madhe pastaj edhe për të spekuluar, edhe me përqindje, edhe me hamendje, e kështu me radhë.

Pra, nuk po shoh seriozitet të kjo ministri për t'i çuar përpara këto reforma. E kuptojmë mungesën e arsyeshme të kryeministrit, por assesi nuk arsyetohet mungesa e ministrave të tjerë, të cilët siç thash janë drejtpërdrejtë përgjegjës për zbatimin e këtyre masave, sepse çështjet që ne do të duhej t'i diskutonim sot janë edhe ato që kanë dalë nga raporti i vendit për këtë vit. E këtu ngecjet që theksohen në këtë raport kanë të bëjnë me integrimin në BE, i cili thotë se është penguar nga zbatimi i ngadalshëm i MSA-së. Zbatimi i agjendës për reformë evropiane po ashtu ka ngecur, zbatimi i ULTI-MSA-së ka pamundësuar Kosovën që të ketë përfitim dhe qasje të rritur në tregti. Rekomandimet për të zhvilluar më shumë kapacitete dhe ngritur resurse për të mundësuar sundimin e ligjit ende nuk janë adresuar. Asnjë vendim nga kjo Qeveri nuk është marrë, ta zëmë, mbi ndihmën shtetërore e cila do t'u ndihmonte bizneseve të ndryshme për rritjen e kapaciteteve të tyre për konkurrueshmëri në tregun e BE-së.

Edhe nga agjenda për reformë evropiane por edhe nga plani kombëtar për zbatimin e MSA-së deklarohen prioritete, siç thamë, siç është qeverisja e mirë, sundimi i ligjit, depolitizimi i administratës publike, e kështu me radhë. mirëpo, veprimet dhe vendimet e Qeverisë nuk janë në përputhje me këto prioritete. Një nga këto, për shembull, që ka të bëjë edhe një herë me reformën në Administratën Publike, veprimet e Qeverisë kanë qenë të kundërta dhe sidomos emërimi tejet i madh i zëvendësministrave. Me këto 3 milionë euro, të cilat shkojnë në pagat e dhe çështje tjera administrative për këta zëvendësministra, mendoj se do të ishte më e drejtë që të investoheshin, për shembull, në arsim për rritjen e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore, të cilat pastaj do të ndikonin edhe në rritjen e konkurrueshmërisë, kur këto kuadro do të bëheshin pjesë e tregut.

Po ashtu, ministrja Hoxha e theksoi se raporti për zbatimin e planit për zbatim të MSA-së është përdorur si mekanizëm dhe ka për qëllim që ministria të ofrojë llogaridhënie dhe transparencë dhe të njoftojë edhe publikun e gjerë. Ne nuk e kemi këtë raport as sot, por ai nuk mund të gjendet as në ueb-faqen e ministrisë. Ndoshta, ministrja na i shpjegon arsyet se pse ky dokument, ky raport, nuk është i qasshëm për publikun e gjerë.

Dhe për fund, çështja e integritimeve evropiane është ndoshta e vetmja temë që i bën bashkë të gjitha partitë politike. Pra, të gjitha partitë mendojnë se rruga drejt BE-së është ajo që ne duhet të ndjekim. Dhe, kjo Qeveri nuk e ka shfrytëzuar këtë konsensus edhe brenda subjekteve politike, por edhe jashtë, që të ndërmarrë hapat që ata duhet të ndërmarrin, por edhe të shfrytëzojë

ndihmën e partive politike. Të paktën Partia Socialdemokrate është shumë e interesuar që ta ndihmojë vendin drejt këtij procesi, jo vetëm me dhënien e kritikave që ne i kemi për ngecjet që janë bërë, por natyrisht edhe duke ofruar mbështetjen tonë. Por, Qeveria nuk po tregon vullnetin e nevojshëm, vullnetin e mjaftueshëm, që të shfrytëzojë këtë konsensus, këtë qëllim të mirë të partive, në mënyrë që të ecim përpara në këtë proces.

Pra, duhet vullnet më i madh e natyrisht pastaj angazhimi na takon të gjithëve, që ne të bëhemi pjesë e familjes së BE-së. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Isufi e ka fjalën.

**AHMET ISUFI:** Faleminderit, kryesues!

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Që nga viti 2016, kur ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, ne kemi të bëjmë me faza herë të angazhimit të detyrueshëm, por jo në afat gjatë, por kemi edhe ngecje në disa sfera të cilat janë të ndjeshme për Kosovën. Qeveria, e cila ka filluar t'i marrë këto obligime e që janë konkrete, mendoj që këto masa zbatuese i ka orientuar, sidomos nëpërmjet ministrive që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me ndryshimin e gjendjes, sa u përket masave të marra.

Ne dëgjuam edhe raportin e ministres, e cila për tre muajt e fundit deklaroi për avancimet që kanë ndodhur dhe normalisht, që kemi obligim të inkurajojmë edhe më tutje, por jo vetëm ministren, vërtet vërejtja që u dha këtu se ministrinë duhet të bëjnë angazhime permanente, praktike në mënyrë që të arriturat të jenë evidente dhe të dalim me rezultate sa më të mira në mënyrë që përmbushja e obligimeve tona dhe detyrimeve që kemi për zbatimin e Marrëveshjes së MSA-së të arrihet në nivelin e duhur, nëse duam të kemi integritet të avancuara.

Rreth këtyre realizimeve dhe objektivave, ministrja ka qenë e pranishme edhe në komisione parlamentare, në të cila ka raportuar me të dhëna konkrete, por që nuk janë të mjaftueshme vetëm shifrat, sa janë të mjaftueshme zbatimi i ligjeve dhe zbatimi i të gjitha obligimeve që janë marrë. Prandaj, edhe pakoja e ligjeve që ekziston në Parlamentin e Kosovës duhet sa më shpejt të ketë një qasje nga ana e votimit të ligjeve, të cilat detyrimisht i kemi jo vetëm për të përmbushur obligimet ndaj kësaj marrëveshjeje, por edhe ndaj vetvetes, sepse ne duam të avancojmë në integritet në të gjitha sferat. Po ashtu, për ngecjet që u përmendën, ne duhet të jemi shumë më azhur, sidomos në zbatimin e rendit dhe ligjit, luftën kundër korrupsionit, reformën në administratën publike dhe në të gjitha dikasteret, ku duhet të jetë një angazhim shumë-shumë më permanent në këtë periudhë e cila duhet të jetë më dinamike dhe më me përkushtim.

Po ashtu, edhe ne si grup parlamentar jemi të gatshëm të bashkëpunojmë, në mënyrë që çdo iniciativë e cila ofron më shumë Kosovën drejt integritetive të reja të jemi bashkë dhe pavarësisht

prej orientimeve politike të punojmë në mënyrë që edhe të zbatohet marrëveshje, por po ashtu edhe në avancimin e integritimeve në mekanizmat tjerë ndërkombëtarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë të nderuar,

Qytetarë të Republikës,

E dëgjuam ekspozën e ministres rreth angazhimeve, rreth përpjekjeve dhe veprimeve që janë bërë në funksion të realizimit apo të zbatimit të marrëveshjes së MSA-së, për atë që ka qenë e mundur brenda kësaj periudhe, ta quaj ashtu, tetë mujore dhe dëgjuam edhe këndvështrimet e kolegëve të partive opozitare. Mendoj që të gjithë e dimë që marrëveshja e MSA-së është një lloj rrugëtimi përmes të cilit ne vendosim se sa zgjatë ky rrugëtim, e vendosim këtu në Parlament, e vendosim përmes aktiviteteve të Qeverisë, punës së Qeverisë, e vendosim përmes punës që bëjnë komunat e Republikës së Kosovës. Pra, aktiviteti i gjithmbarshëm i institucioneve lokale dhe qendrore është përcaktues për rrugën sa do të jetë e gjatë ajo.

Dhe unë mendoj që këtu në këtë drejtim ka një përparim të dukshëm dhe sepse shihet një vullnet më i gjithanshëm në raport me zbatimin e kësaj marrëveshjeje apo plotësimin e kushteve, të cilat kërkohen nga kjo marrëveshje. I tërë ky rrugëtim është përshtatje, përshtatje, përshtatje... me vendet e Bashkimit Evropian, me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Është i tërë ky rrugëtim reformë pas reforme, si në rrafshin ekonomik, në atë të legjislacionit mbi luftën kundër kimit dhe korrupsionit, sikur në rrafshin e administrimit të përgjithshëm, pra ngritjes së kapaciteteve administrative. Të gjithë e dimë që këto nuk janë punë të lehta, sepse këto lidhen edhe me burimet njerëzore, lidhen edhe me forcimin e kuadrit i cili do të ndikojë në plotësimin e këtyre kritereve. Në raport me reformat që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik janë marrë disa masa të cilat kanë qenë të parapara me marrëveshjen e MSA-së dhe nuk mendoj se ka mungesë vullneti politik në këtë drejtim.

Tani i tërë ky proces kërkon më shumë kompetencë në rrafshin e administrimit më shumë se sa në rrafshin e politikës. Ajo që bëhet si akuzë se mungon vullneti, na thoni në cilin ligj na ka ardhur në Parlament dhe nuk kemi debatuar e nuk e kemi miratuar, na thoni se cilën detyrë Qeveria është dashur ta kryejë e nuk e ka kryer me qëllim të zhegjitjes së procesit të plotësimit të kësaj marrëveshjeje të MSA-së me Bashkimin Evropian.

Mendoj që Marrëveshja e MSA-së është një marrëveshje për të cilën ka punuar edhe Qeveria e kaluar. Është një proces të cilin jemi duke punuar edhe ne, si mazhorancë, si opozitë. Vlen këtu të theksohet edhe deputetët e opozitës, sidomos në komisionet ku jam unë, besoj edhe në të tjerat, vazhdimisht janë shumë konstruktivë në debatimin dhe kalimin e projektligjeve të cilat

lidhen edhe me MSA-në, edhe me liberalizim të vizave dhe në përgjithësi me procesin e integritit të Kosovës drejt Bashkimit Evropian.

Kjo është ajo që të gjithë jemi njëzëri, nuk kemi alternativë tjetër, ajo që ne duhet të bëjmë tani e tutje, është që të punojmë më shumë, të punojmë me një dinamikë më të shtuar në mënyrë që rrugën drejt integritimeve evropiane ta shkurtujmë, sepse kjo është vetëm në dorën tonë dhe në dorën e askujt tjetër.

Unë nuk kam më shumë çka i shtoj. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Sherifi! Lista serbe s'ka të paraqitur. 6+-i nuk ka të paraqitur. Po vazhdojmë me deputetët. Zonja Bunjaku e ka fjalën.

VALENTINA REXHEPI-BUNJAKU: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuara ministre,

Të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në raportin e fundit për shkallën e zbatueshmërisë në pjesën pasqyrë e përgjithshme e zbatimit tregohet shkalla e dobët e zbatimit të MSA-së. Programi përmban gjithsej 531 masa, nga të cilat 27,11% apo 144 prej tyre janë masa legjislative, ndërsa 72,89% ose 387 prej tyre janë masa zbatuese.

Sa i përket shkallës së zbatimit të programit deri në fund të tremujorit të parë të gjeturat tregojnë se 8,29% e masave 44 masa janë zbatuar plotësisht, 66,67% e masave, 354 masa janë duke u zbatuar sipas planit. 12,24% e masave, 65 masa përballen me vonesa. 3,77% e masave apo 20 masa përballen me vonesa serioze. 9,04% e masave apo 48 masa kanë mbetur për t'u realizuar në tremujorët në vazhdim.

Pse 65 masa përballen me vonesa? Kush është përgjegjës për këtë? Çfarë është ndërmarrë për të evituar këto vonesa? Pse 20 masa me vonesa serioze e 48 masa kanë mbetur për t'u realizuar në tremujorët në vazhdim?

Edhe në kapitullin e arsimit dhe kulturës, edhe pse mungojnë të dy ministrat këtu, edhe i arsimit, edhe i kulturës, paraqiten gjithsej pesë masa, nga të cilat 40% apo 2 masa janë legjislative, ndërsa 60% apo tri masa janë masa zbatuese. Nga të gjitha këto masa asnjë nuk është planifikuar të zbatohet plotësisht deri në fund të këtij tremujori. Deri në fund të tremujorit të parë të gjeturat tregojnë në sektorin e arsimit dhe kulturës, asnjë masë nuk është zbatuar plotësisht. 20% e masave apo 1 masë zbatuese ka filluar së zbatuari dhe janë duke u realizuar me vonesa. 60% e masave 3 masa, 3 masa legjislative dhe 1 ekzekutive janë në realizim e sipër me vonesa serioze.

Ndërtimin e 8 institucioneve parashkollore publike, 20% e masave, 1 masë zbatuese përballen me vonesa serioze.

Asnjë masë nuk ka mbetur të realizohet në tremujorët në vazhdim. Domethënë, 8,29% në tremujorin e parë në këtë trend mundet vetëm 34% e asaj që është planifikuar nga vet Qeveria të zbatohet. Si arsyetohet kjo vonesë, apo kjo ngecje?

Në raportin e tremujorit të vitit 2018 niveli i përgjithshëm i zbatimit të kapitullit për arsim dhe kulturë deri në fund të tremujorit të parë është 0%, pasi që asnjëra nga 5 masat e planifikuara nuk është zbatuar.

Kjo Qeveri është duke dështuar në drejtimin e vendit dhe në shkallën e ulët të zbatimit të ulët kombëtar të zbatimit të marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Raporti i zbatimit të MSA-së nuk është shpresëdhënës dhe në për të gjitha fushat, ndërsa për arsimin dhe kulturën, po ashtu është shumë keq. Shumë masa nuk janë zbatuar dhe nuk kanë në plan të zbatohen, përkundër fjalëve të mëdha nga kjo Qeveri ka punë shumë e ka nga fjalët e mëdha nga kjo Qeveri punët janë shumë të vogla. Qytetarët tanë meritojnë më shumë. Meritojnë angazhim dhe realizime konkrete për zbatimin e MSA-së, si rrugë e vetme drejt integritit në BE. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonjë! Fjalën e ka zoti Çoçaj. S'është këtu. Atëherë, zoti Hoti e ka fjalën.

ANDIN HOTI: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Para se të flas për qëndrimin tim rreth zbatimit të MSA-së dua t'ua rikujtoj se ky Kuvend e ka miratuar marrëveshjen e parë kontraktuale ndërmjet dy palëve.

Marrëveshja e Stabilizim Asocimit vendos kornizën e marrëdhënieve të Kosovës me shtetet anëtare dhe institucionet e Bashkimit Evropian për jetësimin e procesit të Stabilizim Asocimit deri në anëtarësimin e plotë në Bashkimin Evropian. Sa i përket fushëveprimit, përveç çështjeve politike e detyrimeve juridike, duke përfshirë edhe ato që prekin rendin e brendshëm juridik, MSA mbulon të gjitha sferat e qeverisjes. Ajo përmban 10 kapituj kryesorë si dhe 7 shtojca, 5 protokolle dhe një deklaratë të përbashkët. Secili organ i Administratës Shtetërore do të jetë përgjegjës për zbatimin e programit dhe monitorimit të zbatimit të tij, në kuadër të fushëveprimit të kompetencave të tij.

Si mekanizëm qendror i Qeverisë dhe në vend për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga MSA përgjegjësia për monitorimin dhe zbatimin e tij bie mbi Qeverinë e Kosovës, secilin anëtar të



Kabinetit dhe secilin organ të administratës shtetërore që e drejtojnë ata, si dhe mbi të gjitha institucionet tjera të përfshira në përgatitjen e programit. Përveç Qeverisë, Kuvendi do të jetë një nga shtyllat kryesore institucionale në zbatimin e këtij programi, në veçanti miratimin e legjislacionit. Rol kyç në kuadër të tij do të ketë Komisioni për Integritet Evropian, si në aspektin e shtyrjes përpara të agjendës legjislative, ashtu edhe atë të koordinuesit për monitorimin e përmbushjes së detyrimeve të marra përsipër nga Kuvendi. Kuvendi do të ndikojë edhe në strukturat e Stabilizim Asocimit në kuadër të Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit. Ngjashëm me Kuvendin, rol kyç të drejtpërdrejtë në zbatimin e këtij dokumenti dhe monitorimin në vlerësimin e zbatimit të tij do të kenë të gjitha institucionet e pavarura dhe komunat.

Rol të rëndësishëm në përmbushjen e detyrimeve të MSA-së dhe rrjedhimisht në zbatimin e PKZ MSA-së do të luajë edhe Zyra e BE-së në Kosovë.

Të gjitha këto fjalë janë marrë fjalë për fjalë nga hyrja e programit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit e miratuar në mars të vitit 2016. Dua të përgëzoj ministren e Integritetit, Dhurata Hoxha, për dinamizmin e procesit si dhe përkushtimin e fuqishëm për çdo fazë të procesit ku e trashëgoi. Konsideroj po aq sa është përgjegjëse ministrja Hoxha, janë përgjegjës të gjitha institucionet, administrata e çdo niveli, sikundër edhe të gjitha partitë politike. Është kërkuar disa herë konsensus për çështjen e procesit të integruar, e kam kërkuar edhe unë disa herë këtu në këtë foltore. Në këtë kuvend tashmë këtë konsensus është duke e dëshmuar secila parti politike. Konsideroj se kemi edhe shumë punë për të bërë, por angazhimi i sinqertë dhe brenda afateve dhe rekomandimeve të Brukselit mund të kemi sukses.

Sigurisht, se sukcesi është i të gjithë neve, sepse vlerat integruese janë pjesë e mendësisë dhe kujtesës sonë të fuqishme historike, gjeografike, etno-psikologjike dhe kulturore me Evropën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hoti! Fjalën e ka zoti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Sot realisht po flasim për njërën ndër çështjet kryesore që në të gjitha diskutimet, qofshin politike, po në të vërtetë qofshin edhe private, e prekin këtë temë, sepse thënë shkurt e shqip është përpjekja e Kosovës për t'u afruar në Bashkimin Evropian. Ky është thelbi i krejt kësaj çështjeje edhe pse e kemi këtu me një emër, programi kombëtar për zbatimin e masave, e ku di çka...

Nga ajo që u diskutua deri më tani, edhe nga ekspozetja e ministres, edhe nga ekspozetja e të gjithë kolegëve dhe kolegeve nga të gjitha partitë politike mund të themi, se u konstatua që

ekziston një konsensus edhe synimesh, edhe qëllimesh, opozitë-pozitë, përafrim në Bashkimin Evropian, ani pse ky bashkim domethënë ose futja e Kosovës e ka një perspektivë disa dhjetëra vjet, por sidoqoftë edhe si synim edhe si qëllim politik po edhe njerëzor është kjo.

Në ekspozenë e ministres po ashtu, u dëgjua një çështje, një fjali, që mua më bëri përshtypje dhe ajo do të thotë kërkesa, ftesa për një konsensus nacional dhe për angazhim të të gjithëve, duke përfshirë edhe opozitën në zbatimin e këtij programi kombëtar, domethënë të të gjitha masave. Unë mendoj që derisa u konstatua nga të gjithë, se nuk ka ndonjë pengesë të theksuar shprehimisht nga opozita edhe diçka e ngjashme nuk u konstatua, unë natyrisht që dua të fokusohem më shumë te puna e Kuvendit, sepse edhe roli i opozitës në këtë rast më shumë reduktohet në punën në Kuvend, sepse nuk është pjesë e ekzekutivit dhe pjesë e Qeverisë, për të marrë përgjegjësi për zbatimin e këtyre masave.

Ftesa e ministres për konsensus politik për angazhim ishte sikur një trokitje në derë të hapur dhe kjo ishte ana pozitive, mirëpo dera është e hapur, nuk trokitet në derë të hapur. Por, ajo që mua më bëri përshtypje ishte në të vërtetë edhe si një përpjekje për ndarjen e fajit, se “ja të gjithë kemi faj në këtë drejtim, që nuk po zbatohen këto masa”. Edhe këtë do ta konsideroja si të mirëqenë, nëse edhe ministrja si pjesë e rolit koordinues të ministrive do të tregonte ose do të operacionalizonte në mënyrë konkrete, vërtetë cilat janë ato, nëse mund të themi, fajë, ngecje apo probleme që mund t’i paraqesë opozita në zbatimin e këtyre masave. Nuk kishte diçka të tillë, nuk kishte një operacionalizim, përveç një ftese që kishte edhe një tërheqje moralizuese në fund, pa ndonjë konkretizim të kërkesave se si duhet të veprohet.

Vërtetë ky ishte ai problemi se ne këtu e kemi vetëm ministren, hiç persona brenda Qeverisë që kanë arsye objektive të mos jenë sot këtu, nuk e kemi asnjë ministër, e mbi 99% për masat për zbatimin e masave përgjegjëse është Qeveria, asnjë nuk është këtu jo të marrë përgjegjësi, po së paku të ofrojë ndonjë përgjigje apo sqarim për moszbatimin e masave.

Ky është një problem që ne nuk po mund ta tejkalojmë, e kanë dërguar një ministre, të cilës mund t’i drejtohem dhe, në rastin më të mirë, për shumë ministri do të mund të thotë se nuk jam përgjegjëse, nuk e di sepse unë nuk merrem me zbatimin e këtyre masave. Sidomos unë u gëzova kur e pashë ministrin e Drejtësisë, po ai paska hyrë për një punë edhe paska dalë menjëherë, sidomos ministri i Drejtësisë, prania e tij, ministri i Administratës Publike, që kanë të bëjnë me krejt administratën publike, me gjyqësorin, me dy pushtetet kryesore që nuk janë këtu, unë ua zë shumë për të madhe, sepse në të vërtetë problemin më të madh me zbatimin e masave e kemi te Ministria e Drejtësisë dhe te Ministria e Administratës Publike.

Ne e kemi një administratë publike që është si është, janë venat e një shteti, që janë mbyllur dhe gjithkund ka nevojë për stenta. Ai nuk është këtu për t’u përgjigjur. Ne dëgjojmë për reformën në administratën publike, por nuk kemi asgjë konkrete.

Sigurisht unë do të kisha pyetje për ministrin e Administratës Publike për shumë çështje në administratën publike, edhe për ministrin e Drejtësisë, po nuk janë këtu, kjo me të vërtetë tregon, prandaj po ia tërheq vërejtjen ministres që ftesa që i bëhet edhe opozitës për konsensus nuk është e sinqertë, po është më tepër përpjekje për ndarjen e fajit. Sepse nëse ka probleme ku pjesë të fajit ka opozita, e ai është Kuvendi, duhet të na thuhet konkretisht se këtu janë pengesat që dalin dhe këto duhet t'i eliminojmë. Mirëpo, në të vërtetë nuk është Kabineti qeveritar dhe personat përgjegjës për çështjet që ceken në këtë program kombëtar, por edhe në raportet e Unionit Evropian.

Unë e konsideroj krejt të papërgjegjshme qasjen e Qeverisë, e ministrave, po them përjashto ata që kanë arse objektive sot të mungojnë këtu, kur kemi të bëjmë me një program kombëtar, nuk po e quajmë program qeveritar, po kombëtar, për zbatimin e masave të asociimit, do të thotë për të diskutuar për synimet dhe qëllimet e përbashkëta për afrimin e Kosovës me Unionin Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kurteshi! Fjalën e ka zonja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

E nderuar ministre,

Faleminderit për ekspozenë që e bëre për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe për përkushtimin e Qeverisë për arritjen e cakut që Kosova sa më afër t'i ofrohet Bashkimit Evropian dhe integriteteve evropiane, sepse në fakt ky është qëllimi i Kosovës që të jemi pjesë e BE-së.

Unë e di që ka shumë punë dhe ne të gjithë besoj që e konsiderojmë të rëndësishme votimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në vitin 2016 dhe njëkohësisht në atë periudhë janë formuar komisionet e përbashkëta Kosovë-BE, si Komisioni për Stabilizim-Asociim, ku dakordohen dy mbledhje gjatë vitit kalendarik, një mbledhje mbahet në Kosovë, ku debatohen tema të ndryshme dhe tema që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Mirë që kërkuat një konsensus dhe unë mendoj që ky është debati më i qëlluar të shihet se deri ku ka arritur zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe sot të informohemi me sa ku ka ngecje.

Ashtu siç e kanë të gjitha dikasteret e ministrisë qëllimin për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, është detyrë edhe e deputetëve, po detyrë edhe e komisioneve parlamentare të shohin se deri ku ka arritur zbatimi i zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Është detyrë edhe jona si deputetë në lëmenj të caktuar, kur shohim që ka pengesa, t'u drejtohem ministrave përkatës qoftë me pyetje parlamentare apo në deklarime jashtë rendit të ditës, në mënyrë që një farë forme t'i stimulojmë dhe të angazhohen ministrat që të jenë shumë më azhur në arritjen e këtyre synimeve që po kërkojmë.

Gjithashtu edhe komisionet parlamentare, ka qenë praktikë edhe në mandatin e kaluar, sepse kur kemi pasur të bëjmë me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndoshta komisioni ka mbajtur nga dy takime, duke i thirrur ministrat e caktuar dhe konkretisht kemi kërkuar raport se deri kur ka arritur zbatimin e marrëveshjes.

Dhe, nëse mobilizohemi në këtë formë, qoftë si deputetë apo si komisione parlamentare, unë mendoj që është një shtytje për Qeverinë që të punojë më shumë në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Në fund të fundit, të gjithë, është në interesin e përgjithshëm, është në interesin e qytetarëve të Kosovës, është në interesin e Kosovës që të punojnë të gjithë bashkërisht, në mënyrë që sa më parë të zbatohen këto marrëveshje dhe të jemi pjesë e Bashkimit Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Veç e kam një pyetje për ministren drejtpërdrejt.

Në radhë të parë i falënderoj ata që e kanë thirrur këtë interpelancë, se është për mendimin tim shumë e rëndësishme.

Sa janë gjasat që ne kemi zbatuar këtë marrëveshje dhe sa janë gjasat për ecjen e qytetarëve të Kosovës pa viza në fundin e këtij viti.

Ndërsa po kyçem pak te diskutimi i Shqipe Pantinës që tha me shumë të drejtë që shumë përpilues të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të ligjeve nuk janë vendorë, po janë ndërkombëtarë.

Unë mendoj që ky është defekti numër një i të gjitha qeverive të pasluftës, jo i kësaj Qeverie, po i të gjithave. Në këtë duhet pasur shumë kujdes dhe ma ha mendja që në bazë të asaj që na ka ndodhur me "Bechtel&Enka"-në, ku u dhanë 53 milionë dhe asnjë njeri nuk shkoi në burg, dhe asnjë njeri, imagjino, jo në burg, po asnjë njeri nuk u përjashtua prej pune.

Unë sot e kësaj dite, të nderuar deputetë dhe qytetarë, nuk mund ta bind veten si mundet një vend kaq fukara t'i paguajë 53 milionë pa shkuar askush në përgjegjësi? Këtë nuk e kuptoj.

Dhe, e dyta, jemi këtu shënojeni datën 18 sot, që të njëjtën penallti do ta paguajmë për termocentralin “Kosova e Re” .

Kontrata me “Contour Global” do të dështojë, e pastaj nuk do ta themi të vërtetën se kush është fajtor, po do të kërkojmë t’i gjejmë fajtorët pa qenë fare. Do t’i paguajmë atje nja 20 milionë penallti për dështimin e atyre kontratave dhe kemi paguar penallti të mjaftueshme për shumë dështime të tjera.

Kështu që në këtë drejtim kisha pasur dëshirë që Qeveria e Kosovës të ketë shumë kujdes, dhe ju zonja ministre, të flisni me optimizëm real para qytetarëve të Kosovës, pasi që kemi sinjale që qytetarët tonë do të udhëtojnë pa viza këtë vit, të na jepni bile pak shpresë se, ashtu kështu jena në ‘stand by’ diqysh, është ndalur vullneti për gjithçka në Kosovë e të mos na vrasin bile ëndrrat për të shkuar në Evropë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja ministre ka replikë më shumë se sqarim.

**MINISTRJA DHURATA HOXHA:** Vetëm shkurtimisht. Unë mendoj se zbatimi i MSA-së është i kënaqshëm, duke pasur parasysh se në vitin 2016, prapë po e përsëris, kemi pasur një implementim prej 55,46%, ndërsa në vitin 2017 kemi një zbatim prej 62,05%, pra trendi është pozitiv, në rritje e sipër.

Gjithashtu nëse krahasojmë tremujorin e parë të vitit 2018 kemi një trend pozitiv të rritjes së zbatimit prej 53%.

Ndërsa në tremujorin e parë të vitit të kaluar 2017 ky trend ishte 45.79%.

T’i përgjigjem edhe pyetjes shkurtimisht. Rekomandimi presim që të jetë pozitiv tani në fund të qershorit për çështjen e procesit të liberalizimit të vizave, po gjithashtu duhet të jemi të kujdesshëm dhe të theksojmë se zbatimi i MSA-së apo kriteret e tjera, qoftë në procesin ERA, apo qoftë në procese të tjera nuk janë të ndërlidhura me procesin e liberalizimit të vizave, sepse procesi i liberalizimit të vizave ka qenë i ndërlidhur me plotësimin e kriterëve të dala nga udhërrëfyesi, i cili në fitin 2012 zyrtarisht i është dhënë Kosovës dhe i ka pasur 95 kritere, nga të cilat 95 Kosova i ka zbatuar. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Bajrami e ka fjalën.

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit, kryesues!

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të vendit,

Se zbatimi i MSA-së ka ngecje, nuk ka asnjë dyshim, në fakt, këtë e thonë edhe raportet e shkruara dhe kemi të gjitha faktet para vetes.

Mungesa e ministrave të ndryshëm, të cilët janë përgjegjës secili për një numër të caktuar të kapitujve për zbatim të MSA-së, sot lë shumë për të dëshiruar.

Ministria e Integritimit Evropian është vetëm një ministri koordinuese, ministrja Hoxha në një prononcim publik ka përmendur që nuk ka fare mekanizma koordinues dhe nuk ka kënaqshmëri të nivelit të implementimit nga ministrinë respektuese.

Në fakt, sot barra e implementimit të MSA-së assesi nuk mendoj që ju bie juve mbi supë të gjitha, sepse janë ministrinë e ndryshme. Unë e di nga përvoja paraprake që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është përgjegjëse për implementimin e tetë kapitujve të MSA-së.

Sot mosprania e ministrit këtu lë shumë për të dëshiruar, ajo tregon që në fakt ministri nuk e ka fare prioritet zbatimin e planit kombëtar për zbatim të MSA-së.

Nuk e di se si mund të justifikohet mungesa e ministrave, të cilët kanë deri në gjashtë zëvendësministra në ministrinë e tyre, mungesa e tyre në seanca është skandaloze dhe nuk mund të flitet për progres në një gjendje të tillë.

Ajo që u tha dhe u përsërit shumë në përqindje dhe në figura është se në tremujorin e vitit 2018 janë vetëm 8,29% e asaj çka është planifikuar në fillim të vitit.

Ju ministre, e thanë që presim që 60% e MSA-së të implementohet deri në fund të vitit. Në fakt, keni bërë një rishikim të planit kombëtar për zbatim të MSA-së dhe menjëherë pas disa muajve keni ardhur në përfundim që ajo çka keni planifikuar në fillim të vitit nuk mund edhe të zbatohet.

Le shumë për të dëshiruar zbatimi i MSA-së të kriteret politike.

Unë do të ndalem të kriteret ekonomike, janë 53 masa, të cilat nuk janë zbatuar dhe po zbatohen në mungesë të madhe. Në fakt, në shumë fusha ka edhe regres.

Unë po përmend disa prej ministrive, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e kriterëve ekonomike.

Mirëpo te reforma e administratës publike u theksua disa herë, numri i madh i ministrive, numri enorm i zëvendësministrave, punësimet e zyrtarëve të lartë jashtë çdo kriteri, të gjitha këto shënojnë regres në zbatimin e MSA-së dhe në implementimin e rrugës sonë drejt Bashkimit Evropian.

Sepse në mandatin e kaluar, e dinë të gjithë që patëm vendosur një praktikë të mirë, ku zyrtarët e lartë punësoheshin në mbikëqyrjen e një kompanie të kontraktuar nga Ambasada e Britanisë së Madhe.

I kemi parë edhe letrat, i kemi parë ankesat dhe kemi parë shumë raste ku sekretarët permanentë të ministrive janë zgjedhur persona të cilët nuk plotësojnë as kriteret minimale.

Rritja e pagave nga ana e kryeministrit përreth 700 zyrtarë, mungesa e Ligjit të pagave në Kuvend, mungesa e Ligjit të Qeverisë, mungesa e Ligjit për administratë publike ka ndikuar që edhe sot e kësaj dite të mos ketë një mbështetje të premtuar, por të kushtëzuar me këto tri ligje, mbështetje buxhetore mbi 20 milionë euro nga Bashkimi Evropian.

Në fushën e tregtisë, doganave, tatimeve, lëvizjes së lirë të mallrave dhe ngritjes së konkurrencës është bërë shumë pak progres.

Sot në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë i keni mbi 40 zyrtarë, të cilët janë punësuar me kontrata mbi vepër.

Reformimi dhe ngritja e kapaciteteve të agjencisë KIESA ka qenë e paraparë që të ndodhë me rishikim të buxhetit të vitit 2017. Në atë kohë patëm marrë edhe zotimet e Ministrisë së Financave, sot e kësaj dite asnjë përmirësim nuk është bërë në ngritjen e kapaciteteve të Agjencisë për Promovim të Investimeve, e cili agjenci në Maqedoni ka kapacitetet e një ministrie, ndërkohë që është shënuar progres, sepse në krye të saj tanimë është një zyrtar i thjeshtë ushtrues detyre, sepse i është ndërprerë mandati zotit Besian Mustafa, i cili konsideroj që ka pasur performansë jashtëzakonisht të mirë, të vlerësuar, edhe nga vetë ministri. Performansa ka qenë e vlerësuar që të jetë pozitive dhe nga ministrat e tjerë.

Kemi vonesa në pakon e dytë fiskale, nuk është bërë asnjë hap për përmirësimin e ambientit të biznesit.

Para një kohe ka qenë në media dhe publike letra kërcënuese e zonjës Apostolova drejtuar ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, sepse në krye të Agjencisë së Akreditimit ka vendosur një zyrtarë të thjeshtë, e cila nuk ka plotësua as kriteret minimale. Kërcënimi ka qenë se do të ndalohet projekti prej 3,2 milionë për lëvizjen e lirë të mallrave.

Të gjitha këto projekte dhe projekti i Bankës Botërore janë të nënshkruara në mandatin e kaluar, të cilat edhe sot e kësaj dite ende nuk kanë filluar për shkak se nuk ka marrëveshje për vendosjen e personave që do t'i koordinojnë këto pozita.

Ka edhe shumë ngecje të tjera. Për shembull, gjatë këtij mandati, ministre, është mbajtur vetëm një takim i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik.

Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik në mandatin e kaluar ka funksionuar shumë mirë. Ne jemi ulur pothuajse në baza tremujore për të diskutuar me të gjitha asociacionet e biznesit.

Ne sot për secilin ligj që pranojmë në fushën ekonomike në Parlament marrim kritika prej asociacioneve të biznesit, të cilat nuk janë konsultuar gjatë përpilimit të ligjeve nga ministrinë respektive. Duhet të vendosen mekanizmat e koordinimit.

Me një gjë u pajtuam me ju që kjo, në fakt, edhe reforma e agjendës evropiane, edhe plani kombëtar për zbatim të MSA-së nuk është agjendë partiake, është shumë e vërtetë, është agjendë kombëtare, sepse tanimë jemi përcaktuar të gjithë pa dallime partiake për rrugën drejt integritit në BE.

Ajo çfarë është e nevojshme të dihet është që përgjegjësia kryesore i takon Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ne këtu si Kuvend mendoj që kemi dhënë provimin, sepse sa herë që ka qenë puna për nisma të tilla legislative, marrëveshje ndërkombëtare, ne kemi qenë këtu në dispozicion me të gjitha votat. Mirëpo duhet të ketë zotim nga të gjitha ministrinë respektive për zbatimin e kapitujve për të cilët ata janë përgjegjës.

Ne presim që puna të intensifikohet, merreni shembullin e Kroacisë, ku në baza javore Qeveria e Kroacisë ka mbajtur mbledhje të gjithë kabinetin për të raportuar për zbatimin e masave të MSA-së.

Unë mendoj që jemi vonuar dhe duhet faktikisht që të ketë vullnet politik dhe vullnet në punë që të koordinohemi pozitivisht dhe opozitivisht, por normalisht që e thashë edhe një herë, përgjegjësia i takon Qeverisë që të implementojmë MSA-në, sepse është një marrëveshje të cilën ne e kemi pranuar me dëshirë dhe nuk është diçka që është e imponuar. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Shemsi Syla.

**SHEMSI SYLA:** Përshëndetje, zoti drejtues,  
Përshëndetje delegatë,  
Dhe ju kolegë të nderuar,  
Përshëndetje qytetarët e Republikës së Kosovës,



Ekspozeja e sotshme e ministres vërtet për të mos thënë se është e dështuar plotësisht, ka mangësi të cilat janë në shpërputhje me një realitet të pasqyruar në raport pothuajse në të gjitha fushat dhe segmentet që çojnë drejt përbushjes së obligimeve dhe masave.

Duke u bazuar në faktin se sot mungojnë një numër i madh i ministrave, të cilët konkretisht lidhen me këto sfera, posaçërisht meqë fjalën do ta kem rreth sigurisë, mungon ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Punëve të Brendshme, me çka sigurisht ministrja ndoshta është njoftuar dhe ka informacione të mjaftueshme rreth raportit që lidhet me fushën e sigurisë.

Unë po i drejtohem konkretisht, po thirrrem në kapitullin “Mbikëqyrja civile e Forcave të Sigurisë”, që ka të bëjë me mbikëqyrjen e FSK-së konkretisht.

Ky kapitull përmban gjithsej 11 masa afatshkurtra, prej tyre 36.36%, apo 4 masa janë legislative dhe 33.64%, apo 7 masa janë zbatuese.

Sa i përket shkallës së zbatimit të këtij kapitulli gjatë vitit 2017 të gjeturat tregojnë si në vijim:

Dy masa janë zbatuar gjithsej, ndërsa 9 masa kanë mbetur të pazbatuara.

I bëj pyetje ministres: pse nuk janë zbatuar këto masa?

Siç tregojnë të gjeturat e raportit, ky sektor në përgjithësi ka vonesa serioze, veçanërisht nëse merret parasysh aspekti politik që influencon në mënyrë thelbësore këtë sektor, masa të cilat shoqërohen me pengesa apo vonesa në zbatim kanë pasur afat tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit 2017.

Megjithatë vlen të theksohet që për shkak të peshës së madhe të këtij sektori, si një ndër shtyllat thelbësore të shtetndërtimit, realizimi i shumicës dërmuese të masave varet plotësisht nga veprimi që ka të bëjë me transformimin e FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës, gjë që kërkon ndryshime në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Vlen të përmendet se kjo nuk është zbatuar deri në fund të vitit 2017 dhe është bartur për vitin 2018.

Meqë e shikova edhe raportin për vitin 2018, nuk është bartur një masë e tillë. A flet kjo për joseriozitetin që kjo Qeveri nuk e ka futur në prioritet transformimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës për këtë vit.

Njëkohësisht, sipas të dhënave tona, kapacitetet aktuale të deklaruara nuk janë në nivelin e duhur, a ka vlerësim të dokumentuar apo referencë të dokumentuar përpos deklarimeve politike se në çfarë niveli janë të plotësuara kapacitetet aktuale?

Zonja ministre, a mund ta siguron dokumentin apo të bisedoni me ministrin e Mbrojtjes që të argumentojë certifikimin e kapaciteteve të plota operationale nga NATO-ja, apo vetëm është një deklaram politik që argumenton se ato kapacitete nuk janë të plotësuara.

Meqë edhe Raporti i progresit sugjeron që të rritet mbikëqyrja nga Komisioni Parlamentar, përderisa nuk ekziston raporti me shkrim, me shifra të sakta rreth nivelit të përmbushjes së këtyre kapaciteteve.

Shfrytëzoj rastin të bëj thirrje për një nisim për verifikim të saktë të përmbushjes së këtyre kapaciteteve.

Gjithnjë duke iu shmangur deklarimeve politike, por të mbështetemi në fakte konkrete rreth plotësimin të këtyre kapaciteteve. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Topalli.

**FATON TOPALLI:** Faleminderit!

I nderuar kryesues,

E nderuar zonja ministre,

Kolegë e kolege deputete,

Zonja Dhurata Hoxha paraqiti raportin e saj lidhur me zbatimin e MSA-së në fushën e sundimit të ligjit, zhvillimit ekonomik, mirëqenies sociale, stabilitetit politik në Kosovë, e kështu me radhë.

Besoj dhe mendoj, gjë që u pa edhe gjatë diskutimeve, që pavarësisht nga përkatësia politike dhe ideologjike ka një konsensus të përgjithshëm se të gjithë e duan integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian.

Në fakt, ideja e integritit është kuptuar më shumë për të hapur rrugë që me mbështetjen e BE-së të rregullojmë dhe të krijojmë mundësi për zhvillim ekonomik dhe kushte për mirëqenie sociale, sesa krijimin e kushteve dhe mundësive që zhvillimi ekonomik, ta bëjmë duke e rregulluar bazën ligjore dhe duke përcaktuar masat, të cilat krijojnë kushte për zhvillim ekonomik në Kosovë. Pra, ka një pritje që BE t'i hapë dyert e saj për ne dhe me pak përkushtim për t'i kryer punët tona që na takojnë, për t'u bërë pjesë e BE-së në kuptimin e krijimit dhe promovimit të vlerave evropiane dhe normave që na bëjnë për të qenë pjesë e identitetit politik dhe kulturor evropian. Tani ne mund të flasim shumë për suksese, por në fakt, unë më pak e mat progresin vetëm me shifra dhe

ndoshta më shumë me faktin se çfarë është ndryshimi në jetën praktike për qytetarët e Kosovës nga zbatimi i masave për të cilat foli zonja ministre.

Në fushën e zhvillimit ekonomik ne nuk është që kemi arritur ndonjë përparim të madh, kemi një informalitet shumë të lartë në ekonomi, kemi një deficit tregtar, të cilin e dimë të gjithë e i cili nuk i shërben as zhvillimit ekonomik, as krijimit të vendeve të reja të punës. Pra, nuk mjafton as harmonizimi i ligjeve në raport me BE-në, sepse nëse shikojmë në fushën e mirëqenies sociale ne kemi diku 30.2% të qytetarëve të Kosovës të cilët janë të papunë, 27.8% meshkuj dhe 38% vajza e gra dhe në të njëjtën kohë i kemi edhe diku 120 mijë qytetarë, të cilët jetojnë nga ndihma sociale, respektivisht diku rreth 25% e buxhetit të Republikës së Kosovës shkon për rroga e për skema sociale, gjë që është vështirë pastaj për të arritur përparime në fushën e zhvillimit ekonomik.

Sigurisht që Kuvendi i Kosovës mban përgjegjësi për aspektin e ndryshimit të bazës ligjore dhe në këtë pikë mendoj që Qeveria do të duhej të koordinohet dhe të koordinonte më mirë punën e Kuvendit në lidhje me detyrat që i takojnë Kuvendit të Kosovës sa u përket ligjeve, të cilat duhet të rregullohen për të zbatuar Marrëveshjen për MSA-në. Në këtë kuptim pres që përmes rekomandimeve, të cilat janë duke u harmonizuar që Qeveria e Republikës së Kosovës t'i përcaktojë qartë dhe me afate kohore dhe siç e obligon Kuvendi Qeverinë, të përpiqemi të krijojmë një mekanizëm, respektivisht një rregull, i cili do të mundësonte pastaj që së paku kjo pjesë e cila i takon Kuvendit dhe krijimit të bazës ligjore të jetë e planifikuar mirë dhe të realizohet për të qenë më të suksesshëm në këtë fushë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, Faton! Fjalën e ka zoti Muharrem Nitaj.

**MUHARREM NITAJ:** Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Besoj që tema që po e flasim sot është me interes, debati është me interes dhe sigurisht që është mirë që në këtë seancë të ketë njëfarë lloj interesimi më të madh të deputetëve. Dëgjova disa prej kolegëve të mi më herët të flasin për mungesën e ministrave, është mirë që ministrat që janë përgjegjës për dikasteret që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit të ishin përballë nesh, por çfarë flet mungesa e deputetëve në sallën e Kuvendit, unë po ju kujtoj, për shembull, që aktualisht kemi më pak se 1/3 e deputetëve, ndërkohë që një numër jo i vogël i tyre janë mbrapa kësaj salle që pinë kafe dhe cigare.

Kolegu Shemsi Sylja po flet për Ministrinë e Mbrojtjes, për ministrin e Mbrojtjes, por fatkeqësisht ne nuk kemi ministër të Mbrojtjes, ne kemi ministër të FSK-së dhe unë nuk e kuptoj fare, për shembull, se cila do të ishte përgjegjësia e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila nuk e paska planifikuar transformimin e FSK-së në Forca Mbrojtëse të Kosovës, kur e dimë se cila është situata dhe kur e dinë për shembull se cilat janë pengesat paraprake për ta proceduar një nismë të tillë. Ajo që dua të them unë është do të ndërlihem me fjalimin e zotit Topalli,

realisht Kuvendi i Kosovës është mirë që të mos flasë vetëm për obligimet që i ka Qeveria e Republikës së Kosovës në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, mirëpo të flasë edhe për obligimet që i ka vetë Kuvendi i Kosovës në këtë proces, në këtë agjendë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Çoçaj e ka fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në këtë interpelancë kushtuar zbatimit të MSA-së në tremujorin e fundit për 2017, gjegjësisht në tremujorin e parë të vitit 2018, e falënderoj ministren Hoxha për qasjen e saj proaktive dhe qasjen e saj gjithëpërfshirëse, duke raportuar për të arriturat dhe ngecjet e procesit integrues të MSA-së.

Ajo që dua të them patjetër është se ne nuk mund të lavdërohemi as si Qeveri e as si Kuvend për punën tonë, e aq më pak të marrim rolin e përfaqësimit të akuzës për njëri-tjetrin për proceset, të cilat edhe po të kemi unitet të plotë, nuk janë në duar tona. Historia parlamentare e secilit nga ne mund të jetë e ndritur, por assesi e mëshirshme për qëllimet e këqija dhe destruktive në Kuvend. Shpeshherë kemi treguar se çka nuk është parlamentarizmi, për të mos thënë se jemi bërë gaz i botës. Konsideroj se është koha e fundit që të japë secili kontributin e vet për të çuar procesin pavarësisht bindjeve tona politike. Asnjë tendencë për politizim të çështjeve madhore të interesit nacional nuk i shërben procesit tonë. Sot rrugëtimi i kuvendarëve tonë në Strasburg, Paris e gjetiu në krye me kryetarin Veseli rikonfirmoi vullnetin tonë për liberalizimin e vizave pa dallim partie. Kjo vizitë e përbashkët për sensibilizimin e çështjes së liberalizimit të vizave është një hap më afër vlerave integruese, duke punuar në zbatimin e konsensusit politik e nacional, pra për integrimin euroatlantik. Kjo rrugë është e përkufizuar nga realizimi i MSA-së.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kemi mundësi të bëjmë më shumë, ata që janë duke bërë, nuk kanë pse ndalen, përkundrazi duhet bërë më shumë. Vëmendje të veçantë duhet t'i kushtojmë hartimit të ligjeve, punës së komisioneve parlamentare që mbikëqyrin jo vetëm procesin integrues, por edhe arsimin, shëndetësinë, infrastrukturën, mbrojtjen e ambientit dhe sektorë të tjerë që janë të evidentuar një për një. Ministre, në fund dua t'ju përgëzoj sinqerisht, duke qenë i bindur se puna juaj nuk ka mbetur e pavërejtur apo e pavlerësuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arbër Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Përshëndetje, të nderuar qytetarë!

Po e filloj me pasqyrën e përgjithshme të zbatimit të MSA-së për periudhën janar-mars 2018. Programi përmban 531 masa, nga të cilat 27.11, apo 144 prej tyre janë masa legjislative dhe të

tjerat janë zbatuese. Paramendoni, 8.29% e masave, pra 44 masa janë zbatuar, 66.67 e masave janë duke u zbatuar sipas planit, 12.24% e masave, apo 65 prej tyre përballen me vonesa, 3.77 e masave, 20 masa pra, përballen me vonesa serioze, 9.04% e masave, respektivisht 48 masa kanë mbetur për t'u realizuar në tremujorin e ardhshëm.

Po e filloj me arsimin, sa i përket realizimit të masave të vitit 2018. Paramendoni, nga 5 masa sa janë në total, asnjëra prej tyre nuk është planifikuar të zbatohet plotësisht. Raporti për vendin ka theksuar se nuk është bërë asnjë përmirësim sa i përket sektorit të arsimit. Po ashtu, edhe në fushën e edukimit. Pra, si mund të shkojmë drejt integritit kur nuk ka përmirësim në këtë sektor bazik dhe kyç për shtetin e Kosovës dhe kjo Qeveri duhet të na tregojë, pra sa shkolla ka menduar t'i ndërtojë, sa çerdhe publike dhe të ketë një plan e ide se si ta zhvillojë arsimin për t'u integruar më pastaj. Sa u përket drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, vonesa kanë një sërë aktesh nënligjore nga arsye subjektive, po i përmend ato që janë më të rëndësishmet: Rregullorja për integrimin e të huajve, Rregullorja për qëndrimin e tyre. Sa i përket kornizës së politikave, ka vonesa në miratimin e strategjisë kundër korrupsionit, pra kundër krimit të organizuar. Strategjisë kundër terrorizimit dhe Planit të veprimit, strategjisë së re, pra kundër narkotikëve, e tjera, e tjera. Ato që nuk janë zbatuar janë një numër i masave, të cilët ishin parapara në vitin 2017, për shembull, themelimi i divizionit për kompensimin e viktimave të krimit, ndërtimi i stacionit policor për togjet patrulluese kufitare në Vitomiricë dhe, në fund, më së keqi qëndron administrata, sepse ka 25 masa, 20%, apo 5 masa janë realizuar dhe 80%, ose 20 masa nuk janë realizuar dhe kjo dihet për shkak të partizimit të skajshëm të administratës kudo në Kosovë, sigurisht me përjashtime, aty ku qeveris Lëvizje Vetëvendosje. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Rexhep Selimi e ka fjalën.

**REXHEP SELIMI:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Fakt që obligimet që dalin nga MSA-ja dhe po ashtu obligimet që dalin nga analiza që i është bërë parashikimit të strategjisë së sektorit të sigurisë, duket atje që janë paraparë 11 masa, ku shumica prej tyre janë afatshkurtra, pra nuk janë masa që parashohin një afat të gjatë. Nga këto 11 masa, janë zbatuar ose janë trajtuar vetëm 2 dhe çështja është se çka është bërë me 9 masat e tjera, pra të cilat shumica prej tyre kanë qenë afatshkurtra dhe nuk mund të themi që janë në proces.

Dhe, në anën tjetër, nganjëherë në analizë këtu po del, po flasim me përqindje referuar shifrave dhe statistikave numerike, por po t'i referohemi esencës dhe materies, del shumë më shumë ajo çfarë nuk është bërë se sa ajo çfarë është bërë dhe ajo çka paraqitet në statistika. Por, nuk mund të mos i përmend disa çështje që kanë të bëjnë me fushën e sigurisë, e sidomos nga ajo që është tashmë tash e 4 vjet apo më shumë se katër vjet: çështja e amendamentimit të Kushtetutës që ka të bëjë me krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Pra, kemi mbetur në këtë fazë që nga 2014-ta dhe nuk ka se si të jetë ndryshe, përveçse një manipulim krejt politik në këtë çështje

shumë të ndjeshme, pra, në këtë çështje që ka të bëjë me sigurinë jo vetëm të Kosovës, sepse Forcat e Armatosura të Kosovës nuk kanë impakt vetëm në kontributin e tyre për sigurinë e Kosovës, por edhe kontributin e tyre në partneritetet me shtetet e tjera dhe me aleancën e NATO-s.

Pastaj, parashihen, nuk di sa u përmendën, por parashihet edhe Ligji për ndryshimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura të Kosovës, respektivisht me FSK-në e sotme. Pra, janë përmbi 40 ligje që do të duhej të amendamentoheshin dhe të ishin gati dhe unë ju konfirmoj edhe një herë që ato as që janë parë dhe as që janë shikuar deri më tani, ose komisionit, të cilit unë i përkas, nuk ka pasur rastin, pavarësisht gatishmërisë që të merret me këto. Në mesin e këtyre ligjeve, pra masave të tjera është edhe Ligji për komisarin e Forcave të Armatosura të Kosovës. Duhet t'ju them edhe një herë që ky ligj është draftuar tash e pesë vjet dhe Qeveria e Kosovës nuk ka pasur asgjë të bëjë vetëm që ta procedojë në Kuvendin e Kosovës dhe nuk ka ardhur asnjëherë. Kjo neve na bën edhe një herë të jemi, të ndihemi ashtu siç jemi shumë larg përmbushjes së detyrimeve tona si shtet për t'u afruar më shumë BE-së. Është përmendur edhe mbikëqyrja parlamentare ndaj Forcës së Sigurisë së Kosovës, pavarësisht që komisioni parlamentar ka në agjendën e vet dhe në planin e vet të punës ta bëjë këtë, gjithsesi mbikëqyrja parlamentare ndaj një institucioni që nuk po udhëhiqet mirë edhe është e zorshme, por nganjëherë është edhe e pamundshme për shkak se mbikëqyrja parlamentare ka të bëjë me zbatimin ose mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, e ne në fakt, para se të shohim zbatueshmërinë e ligjit, ne duhet ta kemi ligjin, diçka që po mungon, pra ne duhet t'i kemi ligjet që t'i mbikëqyrim pastaj se si po zbatohen ato, e në rastin konkret nuk i kemi ato ligje.

I bie që jemi shumë keq në këtë fushë dhe sidomos në fushën e sigurisë në 11 masa që janë paraparë, janë ndërmarrë vetëm në dy drejtime dhe kjo është shumë pak, madje është aq pak sa që mund të themi që nuk ua kemi filluar atyre më kryesore, qoftë amendamentimin e Kushtetutës për Forcat e Armatosura të Kosovës, qoftë për Ligjin siç e përmenda edhe plotësimin apo ndryshimin e ligjeve që kanë të bëjnë me këto Forca të Armatosura dhe me ligjet konkrete, siç e përmenda Ligjin për komisarin. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur, zonja Mexhide Mjaku s'është këtu. Tani sipas Rregullores radha është e ministres Dhurata Hoxha që ta marrë fjalën, në qoftë se dëshiron që t'u përgjigjet shqetësimeve të deputetëve dhe deputeteve. Zonja Hoxha e keni fjalën!

**MINISTRJA DHURATA HOXHA:** Të nderuar deputetë!

Këtu u diskutuan shumë çështje, shifra dhe për hir të një pasqyre reale dhe transparente, më lejoni edhe një herë të jap shifra të raportit të zbatimit të PKZMSA-së për tremujorin e vitit 2018.

Pra, programi përmban gjithsej 531 masa, prej të cilave 144, ose rreth 27.11% e tyre, janë masa legjislative, ndërsa pjesa tjetër prej 387 masave, ose rreth 72.89 % e tyre, janë masa zbatuese. Sa i përket shkallës së zbatimit të programit deri në fund të tremujorit të parë të gjeturat tregojnë, si

në vijim: 8,29% e masave apo 44 masa janë zbatuar plotësisht. 66,67% e masave, apo 354 masa janë duke u zbatuar sipas planit. 12,24% e masave, apo 65 masa përballen me vonesa të vogla, 3,77 apo 20 masa përballen me vonesa serioze, 9,04% e masave, apo 48 masa kanë mbetur për t'u realizuar në tremujoret në vijim. Prapë po e përsëris, në vitin 2016 kemi pasur një zbatim prej 55,46%, në vitin 2017 kemi një zbatim prej 62,05%, në tremujorin e parë të vitit 2017 kemi një zbatim prej 45,79%, ndërsa në tre mujorin e parë të vitit 2018 një zbatim prej 53,85%.

Pra, krahasuar me vitet 2016 dhe 2017, kemi një zbatim të kënaqshëm për tremujorin e parë, duke pasur 66,67% të masave, të cilat janë duke u zbatuar sipas planit. Duhet ta kemi parasysh se masat e parapara në PKZMSA nuk janë masa, të cilat zbatohen për një ditë apo për një javë, por janë procese. Më lejoni me theks të veçantë të përmend masat legislative dhe të gjithë e dimë procesin legjislativ, andaj këtu kërkohet angazhim i të gjithëve, e them sërish se kemi trend pozitiv të zbatimit me përqindjen aktuale për këtë tre mujor, e cila sigurisht duhet të rritet dhe të reflektojë në raportin e radhës. Nuk ka dyshim se institucionet tona mund të bëjnë më shumë duke përfshirë edhe deputetët që kanë rol kyç në procesin e miratimit të ligjeve. Më lejoni t'ju rikujtoj se aktualisht kemi në Kuvend Projekt-kodin Penal, Projektligjin për mbrojtjen e informatorëve apo sinjalizuesve, Projektligjin për konfiskimin e pasurisë së fituar me veprë penale, Projektligjin për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare, Projektligjin për eficientë e energjisë, të cilat janë kërkesa që dalin nga ERA. Këto projektligje që dalin nga ERA ende presin në Kuvend për të kaluar hapa të nevojshëm dhe për t'u miratuar. Miratimi më i shpejtë i tyre do të përmirësonte dukshëm zbatimin e gjithmbarshëm të ERA-s, por edhe MSA-së.

Këtu është edhe roli i deputetëve, duke përfshirë edhe deputetët e opozitës, nuk mjafton vetëm të themi se nuk ka progres, por duhet të fokusohemi në faktin se kush mund të bëjë më shumë për të arritur progresin e nevojshëm. Do të doja gjithashtu t'ju rikujtoj edhe kolegëve nga LDK se zbatimi i PKZMSA-së gjatë vitit 2016 ka qenë 55.46% në tërësi, kurse tani në vitin 2018 vetëm në tremujorin e parë kemi zbatim 53.85%. Nuk e them këtë sa për të replikuar dhe nuk mendoj se zbatimi i PKZMSA-së duhet të jetë garë mes partive, e them këtë vetëm për të treguar se nuk mund të mohohet progresi dhe progresi është rezultat i punës së të gjithëve, por nuk është në rregull të mohohet progresi që kemi krahasuar me vitin 2016. Nuk jam dakord se kemi bërë vetëm reforma sipërfaqësore, përkundrazi, jemi duke ndërmarrë reforma përmbajtjesore në të gjitha fushat, reforma e Administratës Publike nuk është reformë sipërfaqësore, Projekt-kodi Penal dhe ai i Procedurës Penale nuk është reformë sipërfaqësore, sepse do të mundësojë suspendimin e zyrtarëve të lartë publikë me aktakuzë. Sa i përket politizimit të bordeve e kemi vendimin e Qeverisë për shkarkimin e anëtarëve të bordeve sipas rekomandimit të Agjencisë Kundër Korrupsion. Kur flasim për ndërmarrjet publike duhet përmendur edhe ndërmarrjet publike komunale, ku kemi parë raportime në media për probleme të ndryshme sa i përket emërimit të drejtorëve dhe politizimit të tyre. Edhe këto ndërmarrje publike duhet të zbatojnë ligjin njësoj si ndërmarrjet publike qendrore.

Kolegia nga Lëvizja Vetëvendosje e di më së miri se kush është emëruar drejtor i Ndërmarrjes Publike Banesore, personi që ishte kandidat për deputetë nga radhët e kësaj partie. Pra, pavarësisht a jemi pozitë apo opozitë, nuk guxojmë të lejojmë standarde të dyfishta. Zbatimi i ligjit vlen për të gjithë dhe nuk mund të flasim për zbatim të ligjit vetëm për njerëz e grupe të caktuara. Politizimin e institucioneve publike e dëmtojnë edhe 400 kontrata mbi vepër dhe punësimi i militantëve partiakë, prandaj kur Lëvizja Vetëvendosje flet për aftësinë e tyre për të reformuar institucionet e vendit, unë kam dyshimet e mia sidomos duke pasur parasysh problemet e tyre të brendshme.

Sa i përket rolit të Ministrisë së Integritimit, më lejoni të them që përveç rolit koordinues, kam kërkuar nga kolegët që të jemi më aktivë dhe më dinamikë sa i përket adresimit të sfidave dhe monitorimit të institucioneve për zbatimin e MSA-së. E them edhe një herë, zbatimi i MSA-së nuk është punë dhe angazhim i vetëm një institucioni, por i të gjitha institucioneve, duke përfshirë edhe Kuvendin, edhe opozitën. Deputetët e opozitës e kanë mundësinë të kontribuojnë në arritjen e progresit, të cilin po e kritikojnë, duke i shqyrtuar më shpejt dhe miratuar më shpejt projektligjet që janë në Kuvend dhe unë shfrytëzoj rastin që t'ju lus sërish që t'i trajtoni këto projektligje me prioritet. Ministrat përkatës kanë kryer punën e tyre kur kanë sjellë ligjet në Kuvend, tani mbetet që deputetët të bëjnë pjesën e tyre. Raporti për zbatimin PKZMSA-së ka qenë në proces të përkthimit dhe i njëjti do t'u dërgohet të gjitha institucioneve në tri gjuhët, edhe pse versionin në gjuhën shqipe veç e kemi dërguar në Kuvend, dhe po ashtu edhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen e ministrisë.

Sa u përket masave që përballen me vonesa serioze, kryesisht kemi të bëjmë me procese që kërkojnë më shumë kohë e koordinim dhe janë në përqindje të vogël, vetëm 3.77%. Kurse sa u përket 48 masave që kanë mbetur për t'u realizuar në tremujore në vijim, janë masat për të cilat vetë institucionet i kanë planifikuar që të kryhen në tremujorët e tjerë. Sa i përket rolit të opozitës, mendoj se mund të bëhet më shumë, sidomos me punën në Kuvend, sepse realisht kjo është ajo çka kërkohet, mund të bëhet më shumë nga opozita kur kemi në agjendë projektligje që janë pjesë e ERA-s dhe MSA-së. Prandaj, ftesa ime për konsensus me opozitën është e sinqertë dhe gjithnjë ka qenë. Opozita duhet të luajë rol konstruktiv dhe të mos e mohojë progresin e arritur, të mos vonojë miratimin e ligjeve, por të përshpejtojë miratimin e tyre. E përmendën edhe deputetët Andin Hoti, edhe deputetja Time Kadrijaj mundësinë që deputetët në komisione t'i përshpejtojnë proceset.

Prandaj, për fund mbetem e përkushtuar dhe do të punoj me të gjithë, duke përfshirë edhe opozitën, si dhe mbetem në dispozicion për raportim dhe çka do që mund t'ju duhet në lidhje me këtë proces. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pacolli, a deshe replikë ti, po? Zonja Pacolli ka replikë.



FITORE PACOLLI-DALIPI: Është për ardhur keq se si ministrja dështimin e saj e paraqet duke folur për Lëvizjen Vetëvendosje. Pra, ju nuk arritët të përgjigjeni në asnjë pyetje që jua drejtua sa i përket planit për zbatimin e MSA-së. Pra, nuk treguat se ku keni dështuar dhe cilat janë arsyet pse dështuat në realizimin e masave konkrete.

Reformat, të cilat duhet të ndërmerren, reformat e thella në Administratën Publike nuk keni arritur t'i ndërmerrni as në vitin 2017 dhe nuk do të arrini t'i ndërmerrni as në vitin 2018. Ftesa nga ju është e pasinqertë, përderisa ju vazhdoni të fshihni raporte të cilat vijnë nga ekspertët evropianë, të cilët paraqesin gjendjen reale në këtë vend. Pra, ju keni fshehur raportin dhe nuk keni qenë këtu të pranishëm kur është diskutuar për gjendjen e rëndë, nga e cila është përshkruar fare mirë nga tre ekspertët e pavarur evropianë të angazhuar nga Komisioni Evropian. Prandaj, ju po tentoni t'i ikni përgjegjësisë që keni si ministre. Po ashtu, ministre, është mirë të na sqaroni pse po jep dorëheqje sekretari i përgjithshëm në ministrinë tuaj? Këtu duhet të na sqaroni dhe të na jepni arsye, a ka ndonjë vepër korrupsioni apo ka shantazh mbi personin për të cilin po flasim? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë nuk dëshiron ministrja. Propozuesi i interpelancës e ka fjalën, pesë minuta, zoti Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Më lejoni t'i jap disa vlerësime për debatin që u bë këtu në Kuvend për këtë çështje të iniciuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së.

1. Vlerësoj se diskutimet nxorën në pah se ka vonesë në realizimin e masave të parapara në këtë program kombëtar.
2. Shumica e diskutuesve shprehën vërejtje lidhur me seriozitetin e Qeverisë, që në fakt reflektohet edhe me mungesën e pranisë së tyre këtu në sallë, përveç ministres për Integritet Evropian.
3. Unë vlerësoj që nuk duhet të bëhemi shumë robër të interpretimit të përqindjeve të realizimit të planeve, sepse mund të jenë çështje që janë shumë esenciale, por që nuk janë realizuar.

Prandaj, e ftoj ministren dhe deputetët përkatës nëpër komisione të ndryshme, në veçanti në Komisionin për Integritet Evropian dhe MSA, që t'i identifikojnë reformat kyçe dhe projektligjet kyçe, që duhet të kalojnë në këtë Kuvend.

Tash, në fund, ministrja po shfaq pak tendencë që ta hedhë përgjegjësinë tek opozita. Sigurisht, ne jemi gjithmonë të gatshëm që të luajmë rolin tonë si parti opozitare për t'i çuar përpara çështjet e rëndësishme nacionale dhe më lejoni t'i kujtoj ministrat dhe të gjithë deputetët këtu që

nuk është asnjë ligj që lidhet me MSA-në, me procesin e integritit evropian, me procesin e vizave, që është bllokuar nga opozita, pa përjashtim. Asnjëherë nuk ka ndodhur kjo.

Prandaj, kërkoj prej ministres, që është përgjegjëse për koordinimin e këtij procesi, sepse shumica e detyrave janë nëpër ministritë përkatëse, por kjo është përgjegjëse për t'i koordinuar të gjitha këto aktivitete, që të jetë e kujdesshme në deklaratimet e saj, sepse do t'i duhet mbështetja e opozitës në çdo hap në këtë proces.

Tash, më lejoni ta lexoj rezolutën që është harmonizuar me grupet parlamentare, me PDK-në, me Vetëvendosjen, me PSD-në, me AAK-në dhe me Nismën. Grupi Parlamentar i PDK-së e ka ofruar një propozim. Më lejoni t'i lexoj pikat:

## REZOLUTË

1. Në afat prej dy javësh, Qeveria të sjellë në Kuvend Programin Kombëtar të rishikuar për zbatimin e MSA-së për vitin 2018, i cili plan merr parasysh vonesat e deritashme.
2. Komisioni Parlamentar për MSA dhe Komisioni për Integritime Evropiane ta shqyrtojë në afat prej dy javësh këtë program me zyrtarët përkatës të Qeverisë dhe t'i paraqesin Kuvendit raport me shkrim, duke identifikuar masat prioritare dhe institucionet përgjegjëse.
3. Pas çdo tremujori, Komisioni Parlamentar për MSA t'i paraqesë Kuvendit raport me shkrim lidhur me realizimin e programit kombëtar për zbatimin e MSA-së.
4. Të gjitha komisionet parlamentare obligohen ta përcjellin punën e dikastereve qeveritare dhe institucioneve tjera, të cilat ato i mbulojnë lidhur me detyrat e tyre të parapara në Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së.
5. Në afat prej dy javësh, Kuvendi ta bëjë një plan veprimi për përsheptimin e projektligjeve që lidhen me agjendën e reformave evropiane dhe MSA-në dhe që presin për miratim në Kuvend.

Këto pra janë rekomandimet e harmonizuara me të gjitha grupet parlamentare, të nënshkruara. I janë dorëzuar protokollit të Kuvendit për t'ua shpërndarë të gjithë deputetëve. Unë ftoj që sapo të kemi kuorum në sallë t'i votojmë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Siç po shihet, nuk kemi kuorum për ta votuar. Shpresoj që do të votohen ashtu siç jeni marrë vesh. Por, unë desha, meqenëse po lindin problemet e kuoromit, ta komunikoj një vendim, që kemi për t'i shqyrtuar disa raporte dhe projektligje, qoftë në lexim të parë, qoftë në lexim të dytë. Seanca do të fillojë votimin çështje për çështje në orën 17:30

minuta. Do të ketë veç votime, prandaj i lus kryetarët e grupeve parlamentare që t'i thërrasin deputetët me qëllim që të mos na barten nëpër seancat tjera çështjet që i kemi shqyrtuar sot.

Ndërsa ne po vazhdojmë edhe me pikën e katërt të rendit të ditës pastaj shkojmë në pauzë, për shkak se për pikën e pestë, të gjashtë, të shtatë dhe tetë, më duket ministri i Financave ka kërkuar që të jetë i pranishëm, derisa ta kryejë një takim që e ka me IBRD-në, ai vjen në sallë.

#### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aktet juridike**

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. E ftoj ministrin Abelard Tahiri, i autorizuar nga kryeministri, që ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti ministër Abelard Tahiri, e keni fjalën.

**MINISTRI ABELARD TAHIRI:** Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ashtu siç e paralajmëroi edhe kryesuesi i seancës, pra ky projektligj është i sponsorizuar nga Zyra e Kryeministrit dhe jo nga Ministria e Drejtësisë, pra sot jam i autorizuar ta prezantoj para jush.

Më lejoni që të ju drejtohem në lidhje me Projektligjin për akte juridike. Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji konsiston në përcaktimin e llojeve dhe hierarkisë së akteve juridike, si dhe unifikimin e parimeve dhe standardeve për hartim, nxjerrje, miratim, konsolidim, korrigjim dhe publikim të akteve juridike.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në përgjithësi i përcakton vetëm aspektet e hierarkisë së akteve juridike, ndërsa ky projektligj në detaje do t'i rregullojë këtë materie ligjore të nevojshme për plotësimin e kuadrit ligjor në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, dispozitat e këtij projektligji e rregullojnë edhe ndërlidhjen e akteve juridike, si:

- ndërlidhja ndërmjet akteve juridike të natyrës së përgjithshme dhe atyre akteve juridike të natyrës së veçantë;
- ofrimin e zgjedhjeve në rast të konflikteve ndërmjet dy akteve juridike dhe niveleve të njëjta;
- nxjerrjen e akteve juridike për ndërlidhjen dhe fushëveprimin apo ndërlidhjen e dy e më shumë institucioneve.

Për më shumë, ky projektligj e përkufizon natyrën e secilit akt juridik, të cilin e nxjerrin institucionet e Republikës së Kosovës në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe fushën e rregullimit nga këto akte juridike. Me fjalë të tjera, ky projektligj përcakton se çka

rregullohet me akte nënligjore, si: rregullore; udhëzime administrative; urdhër; urdhëresë. Pastaj, çka rregullohet me akte juridike të institucioneve të pavarura dhe atyre të organeve komunale, si dhe raporti dhe fuqia juridike ndërmjet këtyre akteve juridike.

Ky projektligj për herë të parë në Republikën e Kosovës ofron bazë ligjore për procedurën e konsolidimit dhe korrigjimin e akteve juridike bazuar në standardet që aplikohen edhe në Bashkimin Evropian. Në veçanti, është marrë për bazë praktika e Komisionit Evropian në rastin e korrigjimit të gabimeve teknike dhe gjyqësore, të cilat shfaqen gjatë procesit të hartimit të akteve juridike në gjuhë të ndryshme, të cilat gabime shpesh mbeten si të tilla edhe pas hyrjes në fuqi të këtyre akteve, duke shkaktuar mungesën e harmonizimit ligjor dhe së këndejmi edhe pasiguri juridike për qytetarët.

Duke paraparë zgjidhjen ligjore të konsolidimit të akteve juridike do të lehtësohet edhe procesi i identifikimit të normës juridike në fuqi dhe zbatimi më i lehtë i tyre nëpërmjet konsolidimit të gjithë tekstit ligjor në një tekst unik. Pra, nisur nga kjo, ju rekomandoj që projektligj të aprovohet në parim dhe të procedohet më tutje në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Tani radha është e kryetares të Komisionit Funkcional. Nuk e di... Albulena nuk është këtu. Kush e merr fjalën në emër të komisionit? Zoti Kurteshi!

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Në të vërtetë, unë nuk jam autorizuar të flas në emër të komisionit, por jam anëtar i komisionit dhe këtu me sa po shoh jemi vetëm katër anëtarë të komisionit, këtu nuk janë as kryetarja dhe as zëvendëskryetari i komisionit.

Ligji është shqyrtuar, por unë kisha propozuar që të priten dhe ata ta thonë fjalën për vendimin që ka marrë komisioni në lidhje me këtë çështje. Sa për informim, me sa e di unë, komisioni ka vendosur që ky ligj t'i kthehet prapa, t'i propozohet seancës që ta kthejë mbrapa, sepse nuk është i përpunuar si duhet. Mirëpo, unë propozoj që ta presim kryetaren, ose zëvendëskryetarin e komisionit, që ata të flasin në emër të komisionit lidhur me vendimin e komisionit për ligjin. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Unë s'e di, Albulena ndoshta është e zënë, është dashur ta autorizojë dikë. A ka ndonjë informatë që Albulena do të kthehet këtu, apo si është puna? Ne e kemi edhe sqarimin që komisioni i ka rekomanduar Kuvendit mosmiratimi në të. Problemi është që ne nuk i kemi praktikën e parlamenteve demokratike, ashtu siç nuk i kemi praktikën në komisione që të shqyrtohen me anë të mirë profesionale, sepse normalisht nëse komisioni nuk e miraton, atëherë nuk do të duhej të shqyrtohej në Kuvend. Atëherë, edhe tre minuta po e presim Albulenën, meqenëse është mirë të sqarohet. Nëse dëshironi grupet parlamentare, por po mendoj

se më mirë është ta presim njëherë mendimin e komisionit, pastaj... Po e presim pesë minuta Albulenën dhe kush të dojë mund të pijë ndonjë kafe.

Zoti Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Si zbatues i përkorë i Rregullores, mendova zoti nënkryetar që ju do ta konstatoi këtë çështje, veç është papërgjegjësi edhe e kryetares, edhe e zëvendëskryetarit, që së paku njëri nuk është këtu. E kanë bërë një raport me rekomandime, e kanë kthyer prapa një projektligj, ndërsa asnjëri nuk është këtu për ta arsyetuar këtë çështje. Dhe, unë nuk di tash, nëse ata nuk janë këtu dhe janë të partive të ndryshme, nuk është me rëndësi çfarë partish janë, për vërtet është papërgjegjësi totale. Së paku duhet të merren vesh dikush nga ata të jetë këtu, nëse s'është kryetarja, së paku të jetë zëvendëskryetari, ose e kundërta.

KRYESUESI: Faleminderit! Dakord, pro kjo e ka një fëmijë më duket të vogël, që duhet t'i shërbejë nganjëherë. Zoti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për deputetët,

Nuk shkon faji për kryetaren e komisionit, se kryetarja e komisionit dhe nënkryetari e kanë shpjeguar qëndrimin në seancën e kaluar. Tash, në qoftë se e nxjerrim në debat dhe debatojmë për arsyen për të shkuar ligji tutje apo jo, e vazhdojmë debatin. Në qoftë se seanca është kundër, atëherë..., por sqarimet janë dhënë me kohë në seancën e kaluar kur ka qenë ky projektligj.

KRYESUESI: Unë jam i detyruar ta zbatoj Rregulloren dhe ta arsyetoj sot Albulenën, meqenëse ka kërkuar edhe leje për të shkuar diku.

Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën në emër të komisionit.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni vetëm të ju informoj që ne qëndrimin e komisionit e kemi lexuar edhe në seancën e kaluar, por që nuk është proceduar tutje për shkak të mungesës së Qeverisë, ose sponsorizuesit, që në këtë rast është Zyra e Kryeministrit.

Andaj, në qoftë se është e nevojshme, po e lexoj sërish rekomandimin e Komisionit për Projektligjin për aktet juridike. Ashtu siç e ka përmendur edhe anëtari i komisionit, zoti Sami Kurteshi, rekomandimi është që të mos miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-030 për aktet juridike.

Ne kemi diskutuar shumë gjatë në Komision për Legjislacion lidhur me këtë projektligj dhe ndryshe prej herëve të tjera, para se ta miratojmë në parim ose jo në komision, ne e kemi formuar

një grup punues përbrenda Komisionit për Legjislacion dhe në mbledhjen e mbajtur më 15. 5. 2018 e kemi shqyrtuar projektligjin pastaj edhe në Komisionin për Legjislacion.

Komisioni ka vlerësuar se projektligji është tërësisht i panevojshëm dhe nuk e adreson qëllimin për të cilin është propozuar. Pra, kemi rekomanduar që të mos miratohet. Për më tepër, bie në kundërshtim me Kushtetutën, ose ripërsërit çështje që tashmë janë përcaktuar me Kushtetutë dhe me ligjet tjera dhe ndërhyjnë në fushëveprimin e ligjeve tjera. Miratimi i tij dhe hyrja në fuqi e këtij projektligji e mbirregullon apo mbivendos fushëveprimin e institucioneve në nxjerrjen e akteve juridike. Dispozitat e këtij projektligji paraqesin dispozita konkurruese mbi të njëjtin objekt, i cili është rregulluar tashmë.

Neni 1 i projektligjit thekson: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i llojeve dhe hierarkisë së akteve juridike, si dhe përcaktimi i parimeve dhe standardeve për hartimin, nxjerrjen, miratimin, konsolidimin, korrigjimin dhe publikimin e akteve juridike”. Hierarkinë e akteve juridike në Republikën e Kosovës, siç dihet, e rregullon Kushtetua e Republikës së Kosovës, përkatësisht nenet 16, 17 dhe 19. Po ashtu, hierarkia e akteve juridike është trajtuar edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, siç është rasti nr. KO 95/13, ndërsa çështje tjera, si parimet, standardet, miratimi, konsolidimi, publikimi, janë rregulluar me legjislacion pozitiv dhe zakonisht parimet dhe standardet e hartimit janë rregulla procedurale, të cilat përshkruhen në manuale, doracakë apo udhëzime, direktiva apo rregulla të unifikuara.

Pra, meqë rekomandimi i komisionit është që të mos miratohet, po përpiqem ta paraqes specifikisht, sepse kemi konsideruar kësaj dhe gjithnjë po flas në emër të komisionit, për shkak se ka pasur një unitet në komision që ky projektligj të mos miratohet. Pra, të gjithë anëtarët e Komisionit për Legjislacion, që kanë qenë të pranishëm, pozitivë dhe opozitivë, kanë konsideruar që duhet të mos miratohet.

Memorandumin shpjegues rreth arsyeshmërisë për nxjerrjen e ligjit thuhet në disa shtete nuk ekziston një ligj i tillë dhe shumë nga këto çështje janë të rregulluara me Kushtetutë dhe me legjislacion tjetër, kurse në shumicën e shteteve të tranzicionit nga sistemi socialist ekziston ky ligj, por në fakt nuk jepet asnjë e dhënë se cili shtet e ka një ligj të tillë. Sipas një hulumtimi parlamentar, të realizuar pikërisht për këtë çështje në vitin 2013 nga Drejtoria për Hulumtime e Kuvendit të Kosovës, ka rezultuar se asnjë shtet në Bashkimin Evropian nuk e ka një ligj të tillë. Rreth 22 shtete të cilat u përfshin si raste studimi, qoftë ato me demokraci të konsoliduar, ish-shtete socialiste apo në tranzicion, nuk e kishin apo nuk e kanë një ligj të tillë.

Sipas këtij hulumtimi, shtetet kishin akte që i rregullonin parimet e hartimit dhe nxjerrjes së akteve juridike, sepse hierarkia e akteve juridike rregullohet me Kushtetutë, por edhe me legjislacionin në fuqi.

Pra, edhe neni 2 i këtij projektligji është problematik. Domethënë, nuk rregullon asgjë, është komplet deklarativ. Neni 3 po ashtu përmban tekst që haset në fjalorët e zakonshëm juridikë, por ka edhe gabime konceptuale në këtë nen. Neni 4 gjithashtu është problematik dhe bie ndesh me nenin 16 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Pastaj, komplet nenet 5, 6, 7, 8, 9, 10 janë komplet nene të panevojshme dhe janë shumë problematike. Po ashtu, edhe nenet që kanë të bëjnë me rregulloret e UNMIK-ut, projektligj i cili nuk i shfuqizon ato rregullore. Andaj, duke qenë se edhe një herë e kam lexuar rekomandimin e komisionit, unë po e ndërpres këtu. Në qoftë se ka ndonjë koment ndonjë anëtar apo deputet i Kuvendit, ne jemi të gatshëm t'i sqarojmë më tutje.

Pra, rekomandimi i komisionit është që të mos përkrahet ky projektligj. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Korab Sejdiu, në emër të Grupit Parlamentar LDK.

**KORAB SEJDIU:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Shpresoj që së paku ju jeni të pranishëm, se si duket kolegët deputetë e ministra i ka zënë bakllava. Por, sidoqoftë, lidhur me Projektligjin për aktet juridike 06/L-030 besoj që ka pasur konsensus të plotë në komision, që në fakt edhe në fatkeqësi është në trend të ligjeve që po na vijjnë në komision, që janë në nivel shumë të ulët, edhe në aspektin përmbajtjesor, edhe në atë teknik dhe po e vështirëson shumë punën e komisionit, jo vetëm në çështjen e përkthimeve në gjuhë zyrtare, por veçanërisht në mënyrën sesi hartohen ato ligje dhe shpeshherë grupet tona punuese po shndërrohen në grupe hartuese, vetëm e vetëm që të kemi mundësi që këto ligje t'i kthejmë në diçka që mund të tejkalohet, ose së paku të miratohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ne kemi bërë çdo tentim, sikur edhe me shumë ligje e projektligje të tjera, edhe në këtë rast, që ta pranojmë këtë projektligj dhe ta procedojmë tutje, por e kemi parë që e kemi të pamundur. Prandaj, edhe grupi ynë parlamentar ka qëndrim paralel me atë të komisionit, pra që ky projektligj të mos miratohet dhe të kthehet prapa për rishqyrtim, ose edhe rishkrim nga Qeveria. Pra, qëndrimi i grupit tonë është që ky projektligj të mos miratohet. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Reçica e ka fjalën.

**ELMI REÇICA:** Zoti nënkryetar,

Nuk dua ta diskutoj çështjen, meqë në raste të rralla Komisioni për Legjislacion është unik dhe sigurisht se do ta mbështetim qëndrimin e komisionit. Veç dua të ritheksoj edhe një gjë, ne e kemi marrë një rend dite dhe si pikë e tretë e rendit të ditës së kësaj seance është radhitur ky projektligj dhe domosdo, pavarësisht çfarë ka ndodhur në seancat e kaluara, dikush duhet të jetë që ta prezantojë qëndrimin. Mirë që ishte edhe përfaqësuesi i Qeverisë, zoti Tahiri, në emër të

kryeministrit, por kjo është rregull. Nëse është e radhitur si pikë e rendit të ditës, secilën herë duhet të jetë dikush që ta prezantojë, kryetarja, zëvendëskryetari, ose dikush tjetër.

Ne përndryshe nuk duam ta prishim këtë unitet të arritur në Komisionin për Legjislacion dhe e mbështetim, patjetër. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Shqipe Pantina e ka fjalën.

**SHQIPE PANTINA:** Faleminderit, kryesues!

Në fakt, unë dua ta lexoj një nen të një ligji tjetër, i cili ka ardhur në plotësim-ndryshim.

Ta zëmë, ligjet që i kemi tash për t'i shqyrtuar së shpejti është Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor. Neni 2 i këtij ligji, paragrafi 1.1 thotë kështu: “Teksti i paragrafit zëvendësohet me tekstin ‘personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik për kundërvajtje do të dënohet me gjobë 100 euro’”. Arsyeja pse po e lexoj këtë nen, ministër, pasi ju jeni i vetmi përfaqësues i Qeverisë, e Qeveria është sponsorizuesja kryesore e projektligjeve, është se ligje të tilla, sidomos në plotësim-ndryshim na vijnë shumë shpesh, ku thuhet, për shembull, neni 4 thotë “fshihet neni 7 i ligjit bazik”. Eh, për ta ditur se çfarë po fshihet, deputetët duhet të shkojnë dhe ta gjejnë, qoftë në gazetën zyrtare, apo diku tjetër projektligjin që është në fuqi. Njëjtë është kur të shkohet në ueb-faqe të Kuvendit për ta gjetur, ta zëmë Ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar, është ndoshta ndër ligjet që më së shumti e më së shpeshti ka pësuar ndryshime dhe natyrisht se logjika të dërgon që ti të klikosh te versioni i fundit i ligjit që është në fuqi. Por, kur e hap aty janë vetëm 2 nene, e për ta kuptuar se çfarë kanë ndryshuar këto dy nene, ti duhet të shkosh të kërkosh vite më përpara për ta parë ligjin bazë.

Unë kam besuar se ky projektligj do ta rregullojë edhe këtë çështje, sepse në vazhdimësi, sidomos në punën e komisioneve, kur u kemi bërë vërejtje ministrive sponsoruese kanë thënë se këto çështje do të rregullohen me Ligjin për akte normative. Por, në fakt, projektligji që ju na e keni sjellë nuk e rregullon këtë. Neni 7 flet për konsolidimin dhe korrigjimin e aktit juridik, por flet pasi të miratohen ato. Tash, unë nuk jam shumë e sigurt, pasi ne nuk kemi qenë pjesë e komisionit dhe çka është diskutuar aty, nëse është i nevojshëm apo jo ky projektligj dhe nëse ky është dokumenti i cili duhet ta rregullojë mënyrën e hartimit, formatin e projektligjeve, por ka probleme në këtë fushë.

E para, ka raste kur ligjet nuk janë të njëjta. Vjen një ligj i cili është kopjuar prej ndonjë shteti tjetër dhe unë nuk kam asgjë kundër këtyre, sepse e dimë që ligjet nuk janë poezi për t'u shpikur prej fillimit, ato kopjohen diku, por mënyra, formati i ligjit është krejt ndryshe me formatin e ligjeve tjera, ose standardi i përdorur është tjetër me standardin e ligjeve tjera. Kjo është çështja e parë që besoj se duhet të rregullohet. Dhe, çështja tjetër është kjo, sidomos kur kemi të bëjmë me plotësim-ndryshimin e ligjeve. Duhet të krijohet një praktikë dhe kjo ndoshta më shumë është



logjike të rregullohet me një akt të brendshëm qeveritar, që kur të vijë në Kuvend projektligjet të vijë plotësisht, të sillet edhe ligji bazë mbi të cilin po bëhen plotësim-ndryshimet, sepse unë nuk besoj që ka deputet këtu që do ta votojë një nen i cili thotë “neni 4, fshihet neni 30 i ligjit paraprak...”, se unë dua të di çka po fshijmë, ose shtohet fjala e cila ndodh shumë shpesh në projektligjet që ne i shqyrtojmë.

Kështu që unë jam dakord që ndoshta kjo çështje duhet të rregullohet me akt të brendshëm, e jo me një ligj të caktuar, por Qeveria duhet ta gjejë formën dhe të propozojë këtu në Kuvend, ose ta tërheqë këtë projektligj dhe të zotohet se me një akt të brendshëm do ta rregullojë punën e hartimit të projektligjeve, ose t'i rregullojë edhe këto çështje në projektligjin e propozuar. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Sa për kujtesë, dua të ju them që secili deputet ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e të gjitha komisioneve të Kuvendit dhe ka të drejtë të diskutojë për çështjet që është i interesuar. Jo për ta hedhur poshtë atë, se ke të drejtë në atë që po e kërkon, por është mirë që vërtet grupet parlamentare të autorizojnë deputetët e vet për çështje të caktuara që të marrin pjesë edhe ata që janë anëtarë të komisionit, por edhe ndonjë që është i interesuar edhe personalisht, po edhe i ngarkuar nga grupi parlamentar.

Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

**AHMET ISUFI:** Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne e kemi në rend dite këtë projektligj, është leximi i parë, prandaj nëse ka dilema se si mund të harmonizohet, të plotësohet e të ndryshohet, atëherë mund të bëhet deri në leximin e dytë përmes komisioneve parlamentare.

Prandaj, konsideroj se konfuzion ka sjellë Komisioni Funkcional, i cili e ka pasur për detyrë që të na e sjellë një reagim të saktë përmes raportit në seancë dhe konsideroj që në shqyrtimin e parë mund të kalojë për t'u përmirësuar deri në leximin e dytë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Kishte vërejtje të ndryshme në lidhje me këtë ligj, realisht ne si institucione nuk e njohim këtë dukuri të rregullimit kështu në këtë mënyrë.

Unë po e shoh, edhe kolegët ose koleget deputete flasin në lidhje me këtë çështje, po nuk e njohin materien.

Unë po them se ne e kemi një udhëzim administrativ për standardet e hartimit të akteve normative, i vitit 2013, që në të vërtetë mbulon diku rreth 90% të asaj që është synuar të arrihet me këtë ligj.

Tash dikush e përkrah, jo po e kalojmë në lexim të parë, jo po e kalojmë në lexim të dytë, nuk e kemi çështjen kuantitative a po kalojmë a s'po kalojmë ligje, a po shkojnë a s'po shkojnë dhe a po i tregojmë dikujt se jemi duke bërë, po është çështja e rregullimit dhe harmonizimit e standardizimit të normës juridike në Republikën e Kosovës, e me këtë ligj ajo nuk arrihet ashtu siç është synuar.

Ne e kemi Udhëzimin Administrativ për aktet normative, në të vërtetë për aktet juridike, kjo është çështja.

Edhe po të merren të lexohen, të krahasohen, e shohin si është gjendja.

Unë mund ta marr me mend se dikujt i duket se këta të opozitës s'po donë ta kalojnë, nuk është çështja aty.

Çështja është se kërkesa juaj që edhe deputetët e grupeve të tjera të marrin pjesë në mbledhje të komisioneve, edhe të Komisionit për Legjislacion, është e drejtë, unë e përkrah. Megjithatë, aty diskutohet me mospajtime shumë të mëdha nganjëherë, po diskutohet për përmbajtjen e ligjeve, normës juridike që e rregullojnë krejt legjislacionin në Republikën e Kosovës.

Ju lutem, kolegë dhe kolege deputete,

Merren komisionin, nuk ka ardhur te një vendim i tillë rastësisht, lexoni dokumentet që kanë të bëjnë me këtë çështje, krahasoni mirë dhe mandej merrni një vendim, sepse megjithatë me votën tuaj do të miratoni diçka që unë mendoj që nuk do të duhej të miratohej në këtë fazë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

**FATON TOPALLI:** Po, i dëgjova diskutimet rreth Projektligjit për akte juridike dhe, në fakt, ajo që po më brengos pak është që kemi problem evident që shtron Qeveria, pra që ka probleme sa i përket përpilimit të akteve juridike, mungojnë standardet e tilla.

Unë përkrah vendimin e komisionit edhe si deputet, po edhe si grup parlamentar, por ajo që do të prisja nga komisioni, i cili merret më shumë në këtë fushë, është që të ndihmonte edhe Kuvendin, edhe Qeverinë që për ta tejkaluar problemin e rregullimit, respektivisht të standardeve për aktet juridike. Pra, nuk mjafton të themi që 'jo, se ka probleme', por mendoj që është dashur komisioni të jetë më i përkushtuar, përkundër faktit që ka krijuar një grup punues dhe t'ia

lehtësonte punën edhe Kuvendit që në proces e sipër ta rregullonte këtë çështje, sepse problemi si duket është evident, pra ka edhe kontradikta, ka edhe konfuzione në këtë fushë, po kjo i bie për ta shtyrë problemin, e shtyrja e problemit mendoj që nuk është zgjidhja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Unë jam ithtar dhe ju kisha lutur që të marrim më seriozisht Projektligjin për aktet juridike.

Qeveria e ka parë të arsyeshme dhe sigurisht ka arsye pse e ka sjellë në Kuvend, pavarësisht vendimit dhe qëndrimit të komisionit, pa dashur ta ofendoj askënd, nuk janë të fushës dhe të lëmit për t'i ditur nevojat e mënyrës së menaxhimit të Qeverisë me akte juridike, të cilat donë një harmonizim dhe një konsolidim.

Besoj që në proces më tutje, gjatë leximit të dytë ishin formuar grupet punuese, ku kishim shfrytëzuar edhe mendimin shumë profesional edhe juridik të Zyrës Ligjore të Kuvendit, ku është shumë e përgatitur dhe përgëzoi stafin e Zyrës Ligjore, se me të vërtetë kanë treguar cilësi dhe kanë investuar në kualitet në ligjet të cilat i kemi trajtuar në Komisionin për Mbikëqyrje të Punëve të Brendshme, të Sigurisë dhe Mbikëqyrjes së Forcës së Sigurisë.

Po ashtu kisha kërkuar edhe një ekspertizë edhe konsultim me Zyrën Ligjore të Kryeministrit dhe Zyrën Ligjore të Sekretarit të Qeverisë se sa janë të nevojshme harmonizimi i akteve juridike dhe nuk kisha thënë që aq lehtë të kthejmë një projektligj të tillë, mirëpo kemi mundësi ta përmirësojmë gjatë punës edhe për nga ana kualitative, pra edhe nga ana përmbajtjesore e këtij projektligji, në qoftë se ka nevojë.

Kështu që unë jam për t'ia dhënë vizën për të shkuar tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Po të ishin ligjet aq të perfeksionuara ose projektligjet që na sjellin në Kuvend, atëherë ishte dashur ndoshta të miratohen në Qeveri e të mos silleshin fare te deputetët.

Po tash, duke i respektuar ato procedurat parlamentare, Qeveria e ka obligim t'i sjellë projektligjet në Kuvendin e Kosovës dhe është detyrë e komisioneve parlamentare t'i trajtojnë.

Pavarësisht vendimin që sjell komisioni parlamentar, pozitiv a negativ, ky projektligj ka ardhur në seancë plenare dhe duhet të debatohet. Qeveria mund ta tërheqë projektligjin, në këtë rast Qeveria nuk e ka bërë një kërkesë për tërheqje, andaj ne duhet të procedojmë më tutje. Qoftë ajo

çka u diskutua nga deputetët, se jo një çështje të rregullohet me Udhëzim administrativ apo gjëra të ndryshme, ne gjatë amendamentimit është praktikë parlamentare, por për ligjet e çështje të brendshme përcaktohen nga një nen apo një paragraf që të rregullohen me Udhëzim administrativ, ku përcaktohen edhe afatet kohore kur ministria përkatëse e ka të drejtën që të hyjnë në fuqi dhe sa zgjasin, qoftë gjashtë muaj apo sipas rëndësisë që e parasheh komisioni parlamentar.

Andaj, ky nuk është fundi, Komisioni për Legjislacion le të punojë, ta shohë krejt çka mundet, tash nuk është ajo që vendos Qeveria, qysh do të rregullohet është në dorën e deputetëve dhe komisionit përkatës, le ta rregullojë dhe ta bëjnë një ligj të mirë dhe të implementueshëm. Unë po e shoh të arsyeshme tash të tërhiqet, sepse në fund të fundit komisioni s'ka të drejtë ta tërheqë, po vendos seanca plenare, ndaj edhe unë po mendoj që duhet proceduar tutje.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në fund edhe një herë zonja Albulena Haxhiu.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit, zoti kryesues!

Unë i dëgjova me vëmendje diskutimet e grupeve parlamentare, gjegjësisht deputetëve.

Vetëm po ju njoftoj që ky projektligj sillet nëpër sirtarët e Kuvendit që nga viti 2013 dhe nëse nuk gaboj, në atë kohë ka qenë kryetar i komisionit zoti Arben Gashi, edhe në atë kohë kemi kërkuar hulumtim nga Zyra për Hulumtime e Kuvendit, e kemi marrë hulumtimin, nuk e di në qoftë se zoti Xhelili ishte i pranishëm dhe po ju njoftoj që arsyetimin të cilën e theksova në emër të komisionit apo që e lexova në emër të komisionit nuk është i përgatitur nga unë, është i përgatitur pikërisht nga Zyra Ligjore e Kuvendit të Kosovës, gjegjësisht Departamenti apo stafi i Komisionit për Legjislacion. Pra ata e kanë bërë anën profesionale, unë i përgëzoj për punën dhe analizën që e kanë bërë. Pra, nuk është dokument personal imi apo i dikujt tjetër. Ne vetëm kemi diskutuar në aspektin profesional në komision bazuar në hulumtimin parlamentar, por edhe dokumentin e përgatitur nga juristët që e ndihmojnë punën e komisionit.

Tjetra, Komisioni për Legjislacion nuk e ka obligim ta sjellë qëndrimin se çka mendon komisioni. Ne s'e kemi obligim si komision t'i tregojmë seancës çka të bëjë, përveçse ta miratojë apo jo. Sepse në komision ka ide të ndryshme, dikush thotë që duhet me aktet nënligjore, dikush me udhëzim, dikush thotë që duhet ligj i veçantë, e unë konsideroj që duhet këtë të drejtë ta ketë ndoshta si nismë legjislative Komisioni për Legjislacion, sepse kam parë që në Komisionin për Legjislacion megjithatë do të mund të dilte një draft më i mirë.

Kemi diskutuar mundësinë, siç e përmendi edhe zoti Sejdiu, që ta ndryshojmë këtë draft, pra me amendamente, ka raste të shumta kur komisioni bën shumë amendamente, por ky është i papërmirësueshëm për shkak që nga neni 1 deri në fund fare është problematik.

Prandaj edhe rekomandimi i komisionit ka qenë që të mos përkrahet, jo që ka pasur ndonjë tendencë në komision, mirëpo ky ligj është problematik, nuk rregullon asgjë dhe shumë nene janë në shpërputhje me Kushtetutën e vendit.

Prandaj, edhe një herë këtë projektligj duhet refuzuar nga Kuvendi, nga deputetët e Kuvendit, sepse po kemi raste kur komisionet po i refuzojnë projektligjet, pastaj seanca po i voton. Nuk ka kuptim, për shkak se komisionet janë trupa profesionale të Kuvendit dhe duhet të merret si i mirëqenë rekomandimi i komisionit, prandaj edhe jemi angazhuar, apo jo, prandaj na keni votuar që të jemi në këto komisione.

Prandaj, edhe një herë, në emër të komisionit ne kërkojmë që ky projektligj të mos miratohet. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Korab, a e tërhoqe fjalën. Nuk ka tjerë për të diskutuar. Të drejtën e tërheqjes e ka vetëm propozuesi, sipas Rregullores. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk dëshiron ta marrë fjalën për këtë çështje.

E lëmë procedurën e votimit pastaj, varet se si votohet, kjo është mundësia jonë.

Shkojmë në pauzë deri në orën 14:30.

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

**KRYESUESI:** Atëherë, zonja dhe zotërinj deputetë,

Po vazhdojmë me pikat e rendit të ditës.

## **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale**

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të LDK-së në cilësinë e propozuesit që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Atëherë, sipas marrëveshjes po i shqyrtojmë të tria ligjet bashkë, meqenëse kanë tematikë të përafërt, por votimi do të bëhet një nga një.

#### **6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave**

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

#### **7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-037 për tatimin në vlerën e shtuar**

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Të tria këto projektligje i paraqet tash zoti Hoti dhe pastaj kryetari i komisionit dhe ministri që do ta kenë fjalën e tyre. Faleminderit! Zoti Hoti, e ke fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Anëtarë të Kabinetit,

Ashtu siç e tha kryesuesi i seancës, të tri këto projektligje janë të ndërlidhura mes veti, janë pjesë e pakos së reformave fiskale. Prandaj, do t'i paraqes të tria.

Falë reformave të bëra në Qeverinë Mustafa në vitet 2015 dhe 2016, Kosova është renditur si vendi i dhjetë në botë sa i përket fillimit të biznesit.

Puna që është bërë gjatë mandatit të kaluar i ka dhënë frytet e veta, brenda një periudhe të shkurtër kohorë janë publikuar disa raporte, ku Kosova ka shënuar rezultate shumë pozitive.

Ka qenë raporti i Bankës Botërore i të bërit biznes për 2018, i publikuar më 31 tetor të vitit, të kaluar ku theksohet progresi i Kosovës në rangimin ndërkombëtar sa i përket të bërit biznes nga vendi 60, një vit më parë, në vendin e 40, për rikujtim të deputetëve në vitin 2014 Kosova ka qenë në vendin e 86 në këtë raport.

Një reformë tjetër dhe raport tjetër që është publikuar në mars për periudhën mars 2016 - mars 2017 i korporatave të sfidave të mileniumit thekson progresin që ka bërë Kosova në 12 nga 90 treguesit që matin efikasitetin institucional të vendit dhe si rezultat Kosova tani ka kaluar prej një programi 'threshold' në një program kompakt, që është i nivelit më të lartë të kësaj korporate.

Dhe, gjithashtu treguesit e lirisë ekonomike, të cilët janë përmirësuar, sa i përket shtetit të së drejtës.

Në Qeverinë Mustafa është punuar shumë në reforma ekonomike me qëllim të fuqizimit të sektorit privat, si shtyllë kryesor të zhvillimit ekonomik të vendit. Si rezultat, në shtator të vitit 2015 janë bërë ndryshimet e para në pakon fiskale, duke rritur formalizimin e bizneseve përmes ndryshimit të Udhëzimit administrativ për arka fiskale, me ndryshimin e Ligjit të TVSH-së, duke ulur pragun e TVSH-së, duke liruar nga TVSH në kufij linjat e makineritë që përdoren në procesin e prodhimeve dhe gjithashtu lirim nga tatimi doganor dhe TVSH për pajisje të IT-së kur hyjnë brenda Kosovës.

Me këtë ligj kanë përfituar bizneset, vlerësohet që gjatë vitit 2016 janë 47 milionë euro që kanë përfituar bizneset private në Kosovë.

Bizneset e mëdha janë rritur në Kosovë si rezultat i kësaj pakoje me 12%, pra numri i kompanive të mëdha është rritur nga 221 në 248 dhe gjithashtu punësimi është rritur me rreth 5000 persona në këto ndërmarrje.

Përfitime ka pasur edhe për qytetarë, të cilët kanë përfituar rreth 21 milionë euro nga ulja e TVSH-së nga 16 në 8% për një numër të mallrave dhe shërbimeve.

Pas kësaj, në vitin 2017 në Qeveri është aprovuar pakoja e dytë fiskale në bashkëpunim të ngushtë me gjithë aktorët e interesit, janë përgatitur në këtë pako 22 masa fiskale, të cilat janë paraparë të implementohen përmes ndryshimeve qoftë ligjore ose procedurale.

Në kuadër të këtyre masave përfshihen edhe këto tri amendamente të tri ligjeve bazike: Ligji për të ardhurat personale, për të ardhurat e korporatave dhe Ligji për TVSH-në.

Grupi Parlamentar i LDK-së ka ndërmarrë këto tri nisma ligjore për të zbatuar masat 13 e 14 të Pakos fiskale 2.

Më konkretisht, në Ligjin për të ardhurat e korporatave është paraparë që tatimi i mbajtur në burim për grumbulluesit e produkteve bujqësore të hiqet, i cili ka qenë deri tash 3% dhe mënyra e tatimit të rregullohet, mënyra e tatimit të kompanive të sigurimit të cilat deri më tash kanë paguar 5% të tatimit nga të hyrat bruto, ndërkaq tash me këtë projektligj ato do të kalojnë në tatim të rregullt sikur çdo kompani tjetër në Kosovë.

Në Ligjin e TVSH-së është paraparë që të rregullohet çështja e njohjes së TVSH-së për kompaninë e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve dhe të zbatimi i TVSH-së në tregti me ari brenda vendit, ashtu që TVSH të zbatohet vetëm në vlerën e shtuar të arit të përpunuar.

Ndërkaq te Ligji për të ardhurat personale është propozuar të fshihet neni 40 i këtij ligji, duke hequr obligimin për mbajtje në burim të tatimit, siç janë bujqit, fermerët, grumbulluesit e materialeve ricikluese, frutave të malit, bimëve mjekuese dhe të ngjashme me këto, të cilët nuk do të jenë të obliguar më të paguajnë 3% të të hyrave bruto të tyre.

Të nderuar deputetë,

Këtu pra janë ndryshme në këto tri ligje bazike fiskale, të cilat unë kërkoj t'i përkrahni.

Ne do të angazhohemi që të organizojmë diskutime të hapura publike në komisionet përkatëse parlamentare me palë të interesit që të marrim edhe komentet e tyre.

Ne vlerësojmë se këto ndikime dhe këto ndryshime në pakon fiskale do të kenë efekte pozitive, në veçanti tek mijëra bujq anembanë Kosovës, të cilët nuk do të kenë nevojë të paguajnë më 3% të vlerës së produkteve që shesin te grumbulluesit e produkteve bujqësore, si gruri, drithërat, rrushi, pemët, perimet, produktet malore dhe produkte të tjera.

E dyta, kompanitë e sigurimeve në Kosovë, të cilat kanë një portofolio momentale shumë të ulët, vetëm 3% të portofolios totale në Kosovë, të kenë mundësi të zhvillojnë produkte të reja, duke qenë se tash do të mund të tatimohen sikur çdo kompani tjetër në Kosovë.

Gjithashtu janë plot kompani të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve, me rreth 300 të punësuar që tash do të kenë mundësi që t'u njihen blerjet me TVSH brenda vendit dhe mbi 1 500 prodhues dhe përpunues të arit anembanë Kosovës, të cilët do të përfitojnë nga këto ndryshime ligjore.

Efekti fiskal i këtyre në fund do të jetë pozitiv, sepse efektet multiplikuese pozitive do të jenë shumë më të larta se sa efekti i menjëhershëm në buxhetin e shtetit.

Unë jam në dijeni që Ministria e Financave është në proces të përgatitjes së tri ligjeve bazike, komplet ligje të reja dhe ne jemi të gatshëm që gjatë leximeve, ndërkohë që nëse këto tri ligje vinë në Kuvendin e Kosovës, nisma legjislativë të shkrihen pastaj në ato tri ligje bazë, po në këtë proces që jemi tash, unë kërkoj që ju t'i përkrahni këto ndryshime. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Lumir Abdixhiku, si kryetar i Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, e ka fjalën.

**LUMIR ABDIXHIKU:** Faleminderit, kryesues!

Unë po jam mendimin për të tri projektligjet e propozuara dhe në bazë të vlerësimit të ndikimit buxhetor, projektligji nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës.



Ne si Komision për Buxhet dhe Financa i kemi shqyrtuar në parim të tri projektligjet dhe kemi konstatuar se të njëjtit i plotësojnë kushtet formale juridike të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit dhe i kemi rekomanduar Kuvendit t'i miratojë në lexim të parë të tri projektligjet në fjalë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Zoti ministër, a e dëshiron fjalën? Fjala është e grupeve parlamentare. Po fillojmë me grupin parlamentar të LDK-së, zonja Hykmete Bajrami.

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit nënkryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Të nderuar qytetarë,

Ashtu siç u theksua, në mandatin e kaluar një numër i madh i ministrive, të cilat kishin në kompetencë zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e ambientit të biznesit të koordinuara mirë, e në veçanti Ministria e Tregtisë e Industrisë dhe ajo e Financave, kanë punuar ngushtë me asociacionet e biznesit për të bërë progres të dukshëm në përmirësimin e ambientit të biznesit.

Përmirësime këto të cilat janë mirëpritur nga komuniteti i biznesit dhe kanë shënuar rezultate në disa raporte ndërkombëtare, siç ishte ai i Bankës Botërore, mandej në vitin 2016, Qeveria e Kosovës vlerësohet si qeveria më e mirë në Evropën Juglindore për mbështetje të ndërmarrësi. Rezultatet dhe reforma kanë qenë shumë konkrete në vitin 2016 dhe në vitin 2017, ju e dini të gjithë që rritja ekonomike për herë të parë nga sektori publik kemi pasur një zhvendosje që rritja ekonomike vinte nga sektori privat. Implementimi i pakos së parë fiskale ka dhënë rezultate, por nuk ka qenë i mjaftueshëm, kështu që Ministria e Financave, në organizim me MTI-në, ka organizuar tryeza në të gjitha komunat e Kosovës, konsultime dhe konferenca me të gjitha asociacionet e biznesit, përfshirë këtu klubin e prodhuesve të Kosovës, Odën Ekonomike Amerikane, Odën Ekonomike të Kosovës, me të gjitha shoqatat brenda saj, Aleancën Kosovare të Biznesit, Këshillin e Investitorëve Evropianë dhe Odën Ekonomike Gjermane.

Që të gjithë në fakt kishin kërkesa që pakoja e dytë fiskale të konceptohej në 22 masa, të cilat ne i kishim gati para se të shkojmë në zgjedhje. Pakoja fiskale me 22 masa është lënë e gatshme në Qeveri dhe meqenëse kjo nuk kaloi deri më tani, presioni i komunitetit të bizneseve kaloi edhe te grupi ynë parlamentar.

Ne, konform Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit, e ndërmorëm këtë iniciativë ligjore që t'i ndryshojmë këto masa, të cilat janë obligim për implementimin e pakos së dytë fiskale, e cila edhe ashtu kishte kaluar në Qeverinë e Republikës së Kosovës në vitin 2017 dhe jemi këtu me këto tri iniciativa.

Ne kërkojmë, siç tha edhe zoti Hoti, që deputetët t'i përkrahin këto iniciativa ligjore për shkak se të gjitha kontribuojnë në përmirësimin e mëtutjeshëm të ambientit të biznesit dhe natyrisht Qeveria e ka hapësirën e saj që ta përmirësojë më tutje ambientin e biznesit, qoftë me ligje, qoftë me masa të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hadërgjonaj e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për tatimin në të ardhurat personale të iniciuar nga Grupi Parlamentar...

KRYESUESI: Safete, veç një sekondë, se ju s'ishit këtu! po procedojmë me tri projektligje, ta kesh parasysh.

SAFETE HADËRGJONAJ: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i ka shqyrtuar të tri projektligjet, pra Projektligjin për tatimin e të ardhurave personale, Projektligjin për tatimin në vlerën e shtuar dhe Projektligjin për tatimin në korporata, të iniciuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Me këto projektligje është bërë ndryshimi i vetëm nga një neni në të gjitha këto projektligje, domethënë në secilin projektligj ka ndryshimin e nga një neni, që ka të bëjë me çështje të caktuara, të cilat mund të rregullohen në periudha të ardhshme nëpërmjet Ligjit të cilin do ta procedojë Qeveria siç na është thënë edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Sipas rregullativës ligjore për projektligjet, të cilat iniciohen nga grupet parlamentare, apo nga Kuvendi përgjithësisht, duhet të japë një mendim edhe Qeveria për secilën iniciativë ligjore. Qeveria më 28. 2. 2018 e ka dhënë mendimin për të tri këto projektligje, për të tri këto iniciativa, të cilat kanë ardhur nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike dhe janë iniciuar si projektligje të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa, Ministria e Financave na ka njoftuar se janë në përfundim të reformës tatimore dhe se gjatë muajit qershor do të jenë në shqyrtim të tri projektligjet, që përfshijnë komplet reformën tatimore, e cila është bërë në bashkëpunim edhe me ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë dhe në bashkëpunim me komunitetin e biznesit. Pjesë e këtyre ndryshimeve, të cilat do të bëhen nëpërmjet projektligjeve, të cilat do të vijnë nga Qeveria, siç na është thënë në takimin e Komisionit për Buxhet dhe siç e kemi parë edhe nga shkresa që na ka ardhur nga ministria, do të jenë pjesë e ligjeve, të cilat do të vijnë së shpejti në Kuvend.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah rekomandimin e Qeverisë që të mos miratohen këto projektligje, sepse miratimi i këtyre projektligjeve është një mesazh jo i mirë për bizneset dhe investitorët. Në qoftë se për çdo muaj shkojnë në plotësim-ndryshim të ligjeve, atëherë kjo do të jetë një ngarkesë përgjithësisht për sistemin tatimor, pra për Administratën Tatimore, si dhe do të shkaktonte një pasiguri juridike të investitorët e huaj dhe janë sfiduese edhe për biznesin vendor.

Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike nuk do t'i miratojmë këto projektligje. I rekomandojmë Qeverisë që edhe këto nene, të cilat janë ndryshuar domethënë në secilin projektligj nga një nen i caktuar, të jenë pjesë e projektligjeve të reja, të cilat do të vijnë dhe do të jenë pjesë e reformës, të cilën është duke e bërë Qeveria në sistemin tatimor. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, zoti Albin Kurti e ka fjalën.

**ALBIN KURTI:** Deputetë të Kuvendit,  
Kabinet i Qeverisë,

Ligji për plotësim-ndryshim të Ligjit për tatimin në të ardhurat personale kërkon që në nenin e parë të fshihet në tërësi neni 40. Çështja është që ky ndryshim i kërkuar është i lidhur me heqjen e tatimit në burim të Ligji për tatimin në korporata, por këtu mbetet pyetja përse e vendosën atë në vitin 2015?

Neni 31, i cili kërkohet që të hiqet të Projektligji për plotësim-ndryshim të Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave, thuhet që po ashtu duhet të fshihet, edhe pse të gjithë e kanë ditur që kjo masë, jo vetëm që nuk mund të aplikohet, por është edhe e gabuar, kështu siç është paraqitur. Tash, ish-partia që ka qenë në qeverisje, nga pozita e opozitës, po e korrekton vetveten dhe po e heq këtë kërkesë, e cila në masë të madhe është kërkuar që të hiqet nga ricikluesit, e veçanërisht nga ata të ambalazhit të prodhimeve. Sepse, në fund të procesit rezultonte që tatohej fermeri ose prodhuesi, tatohej ambalazhuesi, tatohej transportuesi dhe në fund çmimi i një prodhimi vendor rritej në mënyrë artificiale. Qysh në fillim është ditur që tatimi në burim, kur bëhet fjalë për prodhimin vendas, nuk mund të vendoset tek secili subjekt që e kryen një pjesë të procesit, sepse në fund i ngarkohet çmimit. Edhe pse prodhimi i ka disa cikle deri sa të dalë në treg, e ne e dimë që këto cikle i kryejnë personat fizikë apo kompanitë e caktuara, ama në fund mbetet i njëjti produkt, produkti nuk rritet rrugës. Si shembull praktik, ta zëmë, perimet ose vezët nuk mund të shiten pa një ambalazh, pa një kuti kartoni. Nëse tatojmë në burim edhe atë që i prodhon, edhe atë që e sjell plehun kimik, edhe ujitjen, edhe në fund atë që shet ambalazhin, perimet ose vezët, ose do të shiten nën kosto, pra pa fitim, ose do të kenë çmim tepër të lartë në krahasim me importin dhe nuk do të jenë konkurrese në treg.

Sa i përket Projektligjit për tatimin në të ardhura e korporatave, propozohet ndryshimi, i cili ua heq tatimin prej 5% kompanive private për sigurime. Me cilin argumentim hiqet ky 5%, ne nuk e dimë. Këto kompani nuk vuajnë nga mungesa e fitimit. Përkundrazi, në një vend si Kosova ku ka mungesë të fondit publik të sigurimeve, qofshin ato të jetës, ose të shëndetit, këta janë fituesit kryesorë në treg.

Ndërkaq, te Ligji për plotësim-ndryshim të Ligjit për tatim mbi vlerën e shtuar, këtu është interesant se nuk kuptohet qartë se cila është vështirësia e kompanive të udhëtimit në përlllogaritjen e TVSH-së së zbritshme, por duket qartë që është kërkesë e atyre kompanive.

Ne si Lëvizje Vetëvendosje angazhohemi për një politikë fiskale tjetërfare, për një sistem tjetërfarë tatimor, prandaj edhe nuk mund t'i mbështetim këto projektligje.

Më lejoni të them që pas shpalljen së pavarësisë së Kosovës, Qeveria asokohe i pati bërë tri gjëra në ekonominë e Kosovës. Së pari, e zvogëloi tatimin në fitim në të ardhura prej 20% në 10% krahasuar me vitin 2007. Ndërkaq, investimet e huaja direkte u përgjysmuan, pavarësisht se u zvogëlua tatimi në korporata dhe në të ardhura. Së dyti, ajo qeveri e pati zgjeruar privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore edhe me privatizimin të ndërmarrjeve publike dhe kjo jo prej ndonjë fare përlllogaritje ekonomike, përkundrazi nga një verbëri ideologjike. Dhe, së treti, buxhetin e shpenzoi në asfalt autostradash, ku çmimi ishte sa trefishi i çmimit të tregut, e me kontrata që nuk u bënë publike asnjëherë. Si pasojë e këtyre tri gjërave, pra përgjysmimit të tatimit, shpenzimit për asfalt dhe zgjerimit të privatizimit edhe në ndërmarrje publike, kishim tri pasoja. Së pari, deficitin tregtar u shtua. Së dyti, u rrit korrupsioni. Dhe, së treti, u shtua edhe numri i azilkërkuesve nga Kosova për në Bashkimin Evropian.

Tatimin në të ardhura të korporatave që ne e kemi sot 10%, e trashëgojmë nga 1 janari 2009. Atëherë, nga 20% pati rënë në 10%. Kjo e shënonte fundin e besimit në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe fillimin e thirrjeve dëshpëruese për investime të huaja të korporatave. Mirëpo, të gjithë e dimë se ajo çka fituam është, në njërin anë Bechtel&Enka, në anën tjetër Limak&Çalik. Në fakt, ne humbëm shumë e ishin ata që fituan dhe po vazhdojnë të fitojnë.

Asnjëra prej këtyre që u trashëguan nga qeveria e parë pas shpalljes së pavarësisë nuk u kontestua nga qeveritë e mëvonshme, nuk u hetua dhe nuk u shqyrtua, por u vazhdua mbindërtimi në bazën e njëjtë. Tash, me orientimin e njëjtë, nuk mund të presim rezultate të tjera, por veçse edhe më shumë gjëra të njëjta. Edhe kjo qeveri aktuale nuk ndodhet te regjistri i zhvillimit ekonomik, por te regjistri i kontabilitetit financiar. T'ia marrësh 2,5 miliardë euro buxhetit të shtetit e t'ia bartësh korporatës Bechtel&Enka dhe ta shënosh si rritje të bruto produktit vendor, si shpenzim kapital, kjo nuk paraqet zhvillim, por kontabilitet. 3 milionë euro matematikisht janë shumë më tepër sesa 30 euro. Por, pa dyshim që shumëfish më tepër i dhemb një biznesi të vogël kur ia merr 30 euro taksë, tatim a gjobë, sesa kur një korporate miliardësh ia

merr 30 milionë euro. Prandaj, ne besojmë që tatimi i përshkallëzuar, jo çfarë e kemi ne sot këtu, është i domosdoshëm.

Tatimi i ulët nuk i rriti investimet ashtu siç besuan qeveritë e ndryshme. Fituesi i çmimit Nobel për ekonomi në vitin 2001, Joseph Stiglitz, me të drejtë thoshte para disa viteve se “Ajo që po i ndalë investimet, si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe në Evropë, është mungesa e kërkesës, jo tatimet e larta”. Në fakt, duke ditur se shumica e investimeve financohen me borxh dhe se pagesat e interesit kanë taksa më të ulëta, ndikimi i tatimit në korporata ka ndikim të vogël në investime. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Dardan Sejdiu, në emër të PSD-së.

**DARDAN SEJDIU:** I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar mysafirë,

Unë do të përpiqem të flas shkurt. Në fakt, për mua u krijua përshtypja nëse s’gaboj para tri jave që ekzistonte një dakordim ndërmjet Grupit Parlamentar të LDK-së dhe Qeverisë që këto tri ligje, domethënë të vijnë pas një të themi shqyrtimi që ua bën FMN-ja këtyre tri ligjeve dhe me sa e kam kuptuar nga Qeveria këto tri ligje janë tashmë shqyrtim, apo në FMN dhe kam pak si me hall në dy drejtime: në drejtimin e parë, e kam problem mënyrën se si i qasemi sistemit fiskal, politikave tona tatimore dhe kjo gjithsesi është ideologjike.

Pra, më shumë se teknikalitet i ndërtimit të sistemit tatimor, më shumë është ideologjike. Në fakt, së bashku me disa deputetë kolegë ishim në një themi tryezë të organizuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në Vjenë dhe atje më rastisi të shoh sisteme tatimore të shteteve të Ballkanit Perëndimor. Dhe, aty e kuptova që në asnjë vend tjetër, përveç në Kosovë, nuk janë kaq të sheshta, e kaq të ulëta tatimet dhe kaq të thjeshta politikat fiskale sikur në Republikën e Kosovës. Por, në anën tjetër, gjithashtu pashë që ndonëse janë më të sheshtat, më të ulëtat dhe më të thjeshtat tatimet në politikat fiskale në Republikën e Kosovës, investimet e huaja direkte, motivi për të cilin e kemi thjeshtësuar sistemin tatimor në republikë ishin më të ulëtat në Republikën e Kosovës.

Në vendin tonë në Veri, në vitin 2017, investimet e huaja direkte ishin 2,6 miliardë euro, në vitin 2016 - 2,1 miliardë euro. Ndërsa, në vitin 2018 vetëm në dy muajt e parë kishin mbërrirë vlerën prej 420 milionë eurosh. Ndonëse, tatimet janë edhe më të larta, ndonëse kontributet janë ekzistuese, pra ka kontribute për skema sociale, ka kontribut për sigurime shëndetësore, për sistem pensional, pra në fakt intervenimet e tilla në sistemin tatimor mendoj që nuk i ndihmojnë zhvillimit apo të themi trajtimit të temës kryesore në këtë vend, e ajo është si mund ta rritim produktivitetin, rrjedhimisht duke e rritur produktivitetin si mund të jemi më interesantë për investitorët e huaj, e duke qenë më interesantë për investitorët e huaj, si mund ta krijojmë një

bazë të mirë të të punësuarve, të cilët me kontributet e tyre, qoftë në taksa, e qoftë në kontribute sociale, e rritin edhe bazën e mbledhjes së parave tona që na duhen për buxhet dhe e zvogëlojnë varësinë në buxhet ndaj skemave të ndryshme sociale.

Rrjedhimisht, për një intervenim të tillë me këto tri ligje që na i keni sjellë përpara në parim ne si Parti Socialdemokrate jemi kundër, sepse nuk e trajtojnë problemin fundamental, që një sistem i sheshtë tatimor nuk është asgjë tjetër vetëm se ikje prej përgjegjësisë për qeverisje të mirë, për një politikë të mirëfilltë të zhvillimit ekonomik, për një qasje të duhur sa i përket thithjes së investimeve të huaja që aq shumë po i proklamojmë. Në anën tjetër, gjithashtu, duke e pasur parasysh që Qeveria tashmë këto tri ligje i ka dërguar në FMN për shqyrtim, dhe duke e pasur parasysh që ka ekzistuar një diskutim që të mos bëjmë këso lloj diskutimesh, Partia Socialdemokrate do të votojë kundër, duke u nisur vetëm prej premisë së thjeshtë që po bëjmë fizkultura të vogla në sistem tatimor pa e trajtuar problemin në thelb.

E problemi në thelb nuk është sistemi fiskal, nuk janë këto ligjet që po i shkruani apo po mundoheni t'i shkruani, problemi në thelb është sistemi të cilin e kemi vendosur në këtë vend tash e 18 vjet. Thjeshtësi tatimore dhe koncentrim maksimal të pasurisë, të disa njerëz, duke e mos folur fare për ngritjen e industrive. E di që në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë ekziston një dokument që i thonë "politikat industriale" dhe atë dokument ende asnjëri prej neve deputetëve nuk e kemi lexuar, e është shkruar diku në vitin 2014-2015, nëse nuk gaboj. Pra, tash tre vjet diku atje në sirtarë është i fshehur një dokument që merret me industrializim dhe industri. Kështu që pa e trajtuar mënyrën e zhvillimit, nuk kemi si t'i trajtojmë politikat fiskale, pa i menduar sektorët e industrisë nuk kemi si të mendojmë për politikat tregtare dhe tek atëherë ka kuptim të flasim për rishkrimin e ligjeve, dhe të flasim për mënyrën dhe natyrën e orientimit të politikave tona fiskale e tregtare, sepse monetare qartësisht nuk kemi.

Besoj dhe shpresoj që kur të vijë pakoja e kompletuar, diskutimi do të jetë edhe më i gjerë, edhe më i mirë, edhe më adekuat sa u përket modeleve ekonomike, të cilat duhet t'i përcjellim, rrjedhimisht edhe politikave tregtare e fiskale që na duhen në këtë republikë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

**AHMET ISUFI:** Faleminderit, kryesues!

Meqë këto tri projektligje janë në agjendën qeveritare, atëherë nuk e di pse ka nevojë për iniciativa, të cilat e dublifikojnë punën tonë. Edhe ashtu kemi mjaft punë tjera në Parlamentin e Kosovës, prandaj konsideroj që duhet të priten që t'i sjellë Qeveria në Kuvend dhe pastaj ne ta bëjmë plotësim ndryshimin e këtyre ligjeve, të cilat do të mund pastaj edhe të zbatohen.

Është interesant se kohëve të fundit kemi tema të cilat vërtet po e mundojnë Parlamentin dhe për atë i kemi komisionet parlamentare në mënyrë që të punojmë në ndryshimin dhe plotësimin e këtyre ligjeve dhe të mos krijojmë huti edhe në Parlament, por përkundrazi konsideroj se duhet të zbatohet agjenda, e cila i është ofruar Parlamentit të Kosovës dhe të shkojmë sipas rregullave institucionale duke komunikuar Qeveri e Parlament. Prandaj, ne e shohim si hap të ngutshëm këtë mënyrë të veprimit dhe normalisht që do të jemi kundër këtyre projektligjeve që janë sjellë me iniciativën e një grupi parlamentar. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Unë pak a shumë fjalën time do ta kem në frymën e asaj që edhe kemi biseduar me kolegët në katër sy, kur na është kërkuar mbështetja dhe dua të jem korrekt. Atë që e kam thënë në tavolinë e them edhe publikisht sesi pjesë e mazhorancës do të qëndrojmë koherentë e konsistentë me atë që besojmë se këto ligje, duke pasur parasysh se shprehin edhe filozofinë qeverisëse të një qeverie, nuk mund të vijnë nga opozita njëanshëm. Natyrisht janë të mirëpritura këshillat, vërejtjet e sugjerimet nga partitë opozitare, por nuk mund të jenë bartës, së paku ky është këndvështrimi im, këndvështrim i Nismës, i nismave të tilla legislative pa Qeverinë. Në bashkëpunim me Qeverinë, përkatësisht me Ministrinë e Financave, Zhvillimit Ekonomik e me ministritë tjera, gjithsesi që jemi të gatshëm të ulemi dhe të bisedojmë, por jo në këtë mënyrë, edhe pse ka gjëra për të cilat mund të pajtohemi dhe ka gjëra për të cilat nuk mund të pajtohemi në esencë, në përmbajtje.

Por, unë nuk do të lëshohem në këtë fazë në përmbajtjen e amendamenteve për faktin se si Nismë nuk jemi në pikën, në të cilën besojmë që do të ishte harmonizimi i këtyre ideve, pikëpamjeve të shprehura nëpërmjet amendamenteve me Qeverinë, pjesë e së cilës jemi.

Si Nismë Socialdemokrate, natyrisht që i kemi vërejtjet tona edhe për mënyrën se si trajton sponsorizuesi, por edhe sesi nesër do të trajtohen këto çështje nga Qeveria. Por, jemi të vetëdijshëm që me fuqinë që e kemi brenda Qeverisë nuk mund t'i imponojmë të gjitha politikat socialdemokrate brenda kësaj qeverie me dy parti të djathta. Dardan Sejdiu e ka lehtë nga pozita e të qenët në opozitë, mund të refuzojë gjithçka për shkak të bindjeve ideologjike, por ne besojmë që do ta shtyjmë aq sa ka hapësirë edhe në kuadër të këtyre ligjeve idenë dhe pikëpamjen socialdemokrate që të reflektojnë në këto ligje, por arsyeja se pse sot nuk mund të bëhemi pjesë e mbështetjes së këtyre ligjeve është për faktin se nuk besojmë që kjo është rruga.

Nesër mund të jem unë në opozitë, të tjerët mund të jemi në pozitë dhe ju të jeni në pushtet dhe nuk besoj që rruga e tillë ku do të duhej të shkruhej programi qeverisës nëpërmjet opozitës, qoftë nëpërmjet amendamenteve në ligje të caktuara, qoftë nëpërmjet rezolutave apo rekomandimeve në debate apo interpelanca, nuk e mbështetim këtë lloj përpjekjeje për të cilën secili ka të drejtë

të bëjë përpjekje, por ne do të vazhdojmë të qëndrojmë koherentë, konsistentë, për atë që jemi pjesë e Qeverisë dhe do të bëjmë përpjekje të kontribuojmë në përmirësimin e ligjeve në fjalë, por nuk di që dikush ka ardhur dhe është ankuar se nuk mund të vijmë të investojmë në Kosovë, për faktin se këto ligje duhet ndryshuar dhe këto ligje na qenkan pengesë. Unë nuk di se ku ka tatim më të ulët se 10% në korporata, nuk di dhe nuk di as çka mund të ndryshohet në këtë drejtim nëse 10% na qenka shumë apo... Thashë, do të rezervohem në debatin përmbajtjesor të këtyre amendamenteve, do të ndalem në atë formal dhe kërkoj nga sponsorizuesit, iniciuesit e këtyre amendamenteve që të marrin kontakt edhe me ministrinë, ministria të jetë më azhure në punën e saj në këto amendamente, në këto ligje, në përmirësimin e tyre, amendamentimin e tyre dhe që së paku të kemi një afat, se kur mund, gjithsesi nëse ka nevojë, dhe çka ka nevojë, kur mund të llogarisim në një aktivitet të përbashkët në mes ministrisë dhe iniciuesit.

Do të kisha pasur dëshirë që ministri këtu të na i thotë disa fjalë, që edhe ne deputetët e mazhorancës të krijojmë qartësi rreth këtyre gjërave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Unë i dëgjova kryetarët e grupeve parlamentare, por jo ende edhe ministrin, së paku jo përpara deputetëve dhe publikisht.

Atë që mund të them duke i dëgjuar grupet parlamentare është që nuk ka argumente substanciale pse këto projektligje, këto amendamente të parapara, janë gabim, janë kundër logjikës së ekonomisë së tregut, ose nuk ndihmojnë, si me thënë, zhvillimin e bizneseve. Argumentet po duket se janë qartazi nuk përkrahen sepse kanë ardhur nga opozita edhe kanë ardhur nga Lidhja Demokratike, në veçanti prej partive tjera opozitare. Unë e thash edhe në fjalën time, edhe në diskutimet e vazhdueshme që kemi pasur me kolegët dhe me ministrin e Financave, që jam në dijeni që ministria është duke i përgatitur tri ligje të reja dhe gjatë dy leximeve ne jemi të gatshëm që këto tri iniciativa ligjore t'i bëjmë bashkë, ose t'i tërheqim në rast se ligjet që do të vijnë nga Qeveria do t'i përfshijnë në masë të madhe këto amendamente.

Po të mos përkrahen në parim, vetëm pse kanë ardhur nga opozita e jo nga Qeveria, unë mendoj se nuk është argument që duhet ta dëgjojnë qytetarët e vendit. Praktikisht, le ta dinë qartë të gjithë që deputetët këtu në sallë nuk po përkrahin amendamente të cilat heqin tatimin në burim për bujqit dhe për grumbulluesit e të gjitha produkteve tjera. Dhe, këto në fakt janë amendamente që janë përkrahur një herë në mandatin e kaluar, edhe nga PDK-ja, si dhe plotë ndryshime ligjore të cilat vazhdimisht në bisedat që kam pasur me ministrin Hamza edhe sa ka qenë guvernator, në veçanti te kompanitë e sigurimeve është parë më se e nevojshme që të ndërhyhet në këtë pjesë.



Tani, nëse ma jepni një argument nga Qeveria, ose nga koalicioni qeverisës, nga deputetët e koalicionit qeverisës, që këto amendamente nuk ndihmojnë qëllimin primar, për të cilin janë nxjerrë, ne do të tërhiqemi, por nëse na thoni se nuk do e përkrahin sepse këto duhet të vijnë prej Qeverisë e jo prej juve, atëherë kjo është fundamentalisht si logjikë e gabueshme e punës në Parlamentin e Kosovës.

Pra, unë kërkoj që ministri të dalë në foltore, të jetë opinioni i tij normalisht me të drejtën e tij të plotë, por të marrë përgjegjësinë që këto amendamente të futen në projektligje që do t'i sjellë në Kuvend dhe unë jap fjalën publike dhe zotohem, që ne si grup parlamentar do t'i tërheqim këto projektligje para leximit të dytë, në rast se këto amendamente futen në projektligjet që do të vijnë nga Qeveria. Faleminderit!

**KRYEUSESI:** Faleminderit! Fjalën e ka ministri i Financave, zoti Hamza.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Faleminderit, zoti nënkryetar Haliti!

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë,

Duke vlerësuar iniciativën dhe duke i falënderuar të gjithë deputetët dhe përfaqësuesit e grupeve politike unë besova apo të paktën, desha të besoj se në një nga mbledhjet e kaluara në këtë Kuvend ne u dakorduam, që këto ligje të tërhiqen dhe të vijnë të njëjtat në Kuvend me procedurë të rregullt, ku do të përfshihen të gjitha amendamentet e propozuara.

Mund të kem dallime konceptuale dikush mendon që tatimi në fitim të korporatave duhet me qenë progresiv, dikush mendon se duhet me qenë i sheshtë, mirëpo kur jemi te politikat fiskale gjithsesi duhet të kemi në konsideratë edhe politikat fiskale të vendeve të regjionit. Politikat fiskale janë veç një segment, të cilët kontribuojnë në ambientet e të bërit biznes dhe të cilët kontribuojnë në tërheqjen e investimeve të huaja direkte. Nuk janë element i parëndësishëm.

Nëse shikojmë normën e tatimit në fitim të korporatave del se të gjitha vendet e regjionit e kanë këtë normë, aktualisht rreth 9 dhe 10%. Nëse ne e ngremë normën e tatimit në fitim dhe shikojmë edhe disavantazhet tjera që i kemi si Kosovë edhe krijojmë edhe një ngarkesë shtesë, atëherë nuk do të kontribuojmë në ambientin për tërheqjen e investimeve të huaja direkte.

Përafërsisht, Kosova ka politika të ngjashme me vendet e regjionit. Nuk do të thotë që ka unike, por ka të ngjashme edhe nëse marrim tatimin në vlerën e shtuar dhe shohim normën e tatimit të vlerës së shtuar edhe tatimit të të ardhurave individuale edhe tatimin në fitim të korporatave me disa dallime, me norma dhe çështje tjera që i bëjnë për t'u dalluar.

Kur po flasim për procedurat, të nderuar deputetë, ekziston një situatë që është goxha interesante. Për të ardhur një ligj në Kuvendin e Kosovës i sponsorizuar përmes Qeverisë duhet të ju

nënshtrohet rregulloreve të brendshme të punës dhe është kohë që sipas kalkulimeve që janë nxjerrë me i kalua të gjitha fazat ka nevojë që të jetë rreth 290 ditë. Duhet të krijohen grupet punuese, grupet e brendshme, grupet e jashtme, diskutimet, diskutimet publike, konsultimet me të gjithë faktorët tjerë dhe pastaj të vijë në Kuvend, duhet ta ketë deklaratën për pajtueshmëri me direktivat e BE-së, duhet ta ketë deklaratën e vlerësimit të ndikimit buxhetor. Ndërsa, nëse të njëjtat ligje sponsorizohen nëpërmjet Kuvendit apo grupit të deputetëve, koha është shumë e shkurtër.

Unë nuk e di çka ndryshoi prej seancës së kaluar në raport me këtë seancë! Te ne nuk ka ndryshuar asgjë, mbetet e njëjtë. Mirëpo, nëse duam të marrim pak poenë politike dhe të themi “po ne i sponsorizuam e disa ishin kundër”, kjo nuk qëndron. Unë nuk pash deputetë brenda Kuvendit të Kosovës që ishte kundër një sistemi të mirë tatimor, ligjeve të mira, ligjeve në përputhje me direktivat e BE-së dhe ligje që shkojnë në favor të biznesit dhe i përshtaten situatës në Kosovë, këtë nuk e pash. Edhe në këtë nuk besoj. Po flasim për dallime procedurale.

Ne si Qeveri, Ministria e Financave i ka kryer draftet, të njëjtat i ka lëshuar në diskutim publik, janë dorëzuar te asociacionet e biznesit që edhe ato të japin komentet e tyre, se unë nuk besoj që është mirë një ligj të aprovohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës pa pasur mundësi ata të cilët i ndikon ligji t’i japin komentet e tyre. Janë dërguar për komente në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe i presim komentet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Lidhur me këtë ne kemi pranuar një letër nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, që lidhet me këto ligje, ku në një pikë po e citoj, thotë: “Ky propozim-ndryshim duket se nuk është plotësisht në përputhje me direktivat e BE-së për TVSH”. Prandaj, ligjet do të diskutohen dhe do të komentohen edhe nga institucionet e BE-së edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, edhe nga grupet e interesit dhe asociacionet e biznesit dhe ju siguroj që shumë shpejt, në momentin e plotësimit të kushteve sipas Rregullores së Punës së Qeverisë, do të jenë në Kuvendin e Republikës së Kosovës për diskutim dhe do të jenë të reflektuara në përputhje me direktivat dhe të gjitha procedurat tjera dhe amendamentet të cilat i kemi diskutuar, siç është Ligji për tatim hetim të korporatave ku ka të bëjë me kompanitë e sigurimeve, Ligji për TVSH-në, Ligji për të ardhura individuale dhe besoj në mirëkuptimin e deputetëve me qëllim që ne mos të kemi dyfishim të punës, mos të kemi në të njëjtën kohë dy drafte në procedurë dhe mos të kemi një situatë, kur ndoshta aprovohet një propozim dhe pastaj brenda një periudhe shumë të shkurtë kohore del që duhet me bë plotësim-ndryshimin.

Nëse po kërkojmë që të pritet derisa të vijnë ligjet e reja dhe po mendohet se ne nuk i qëndrojmë asaj që jemi marrë vesh, unë mendoj se kjo nuk funksionon, nuk është mirë. Jemi dakorduar, jemi pajtuar, arsytet janë këto se nuk procedoj ligje në Kuvendin e Republikës së Kosovës, pa i inkorporuar komentet e institucioneve relevante të kësaj fushe. Prandaj, ju lus deputetë të nderuar, që të priten ligjet e Qeverisë, është mendimi i Qeverisë. Këto ligje, këto drafte apo më mirë me thënë këto amendamente, se nëse i shikojmë të tri ligjet nuk kanë më shumë se nga një amendament a dy, të pritet dhe të vijnë ligjet që janë të draftuara në përputhje me standardet dhe

pastaj, nëse ka diçka mungesë brenda këtyre ligjeve, ne do të jemi shumë të hapur, që propozimet, amendamentet nga ana juaj deputetë, t'i inkorporojmë në ato drafte. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Po vazhdojmë me diskutimet e deputetëve. Zoti Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Tash mund ta pranojmë amendamentin e partive në pushtet dhe opozitare se mund ta refuzojnë iniciativën e LDK-së, por s'mund ta pranoj si argument të ngritur, sidomos nga e majta në Parlament, që po shtohet si duket edhe tutje, se tatimet e ulëta nuk sjellin investime. Ky argument s'qëndron ose s'mund të qëndrojë asnjëherë. Mund të themi që tatimet e ulëta s'janë faktor i vetëm që sjellin investime, por s'mund të themi që tatimet e ulëta nuk kanë sjellë investime e tash hajde t'i rrisim tatimet.

Pra, nuk është ky shkak-pasojë reviziv. Nuk ka një teori të tillë, s'ka pasur asnjëherë. Pra, tatimet e ulëta e bëjnë ambientin biznesor më të favorshëm, sjellin më tepër investime dhe për tatime në korporata Kosova është në nivel të njëjtë me pothuajse secilin vend tjetër në rajon.

Faktorë që nuk vijnë investimet në Kosovë janë të tjerë, është niveli i korrupsionit, është mos funksionalizimi i gjykatave në Kosovë, është fakti që burokracia kosovare ka kërkuar edhe hise bizneseve të huaja kur kanë ardhur në Kosovë e na kanë ikur, kanë shkuar edhe në Maqedoni kanë hapur me mijëra e mijëra vende të punës atje. Këta janë faktorët që largojnë investitorët, jo tatimet e ulëta.

Prandaj, nuk e shoshi politikë të duhur për Kosovën rritjen progresive të tatimeve në korporata, sidomos kur në rajon jemi në nivel të njëjtë, se në fakt s'kemi kujt t'i marrim më para më tepër, nuk mund ta bëjmë Kosovën më të majtë se sa është sot. Shikoni për pak buxhetit të vendit çfarë i bëjmë, si e shpërndajmë, mbajmë kategori sociale gjithandej. Na ka mbetur tash që vetëm edhe bizneset e gjora, që i kemi ato pak biznese, s'janë shumë, mos harroni se nuk po flasim këtu për një ambient biznesor të bollshëm, po flasim për 99% të ndërmarrjeve në Kosovë që mezi mbijetojnë. Dhe tash, këtyre t'u marrim më tepër para për të financuar skema sociale në Kosovë. Nuk di çka është më e majtë se kaq.

Prandaj, ne i qëndrojmë vijës së argumentit të djathtë. Unë kam përshtypjen se edhe një pjesë të argumenteve nuk janë kuptuar, në veçanti nga zoti Kurti që ishte këtu. Por, nuk bëhet fjalë për shkurtimin e 5% të kompanive të sigurimit, është e habitshme. Kompanitë e sigurimeve në Kosovë paguajnë 5% tatim në qarkullim dhe kjo si ide është absurde. Nuk ka të bëjë, as me të majtën, as me të djathtën. Nuk po flasim për norma tatimore, po flasim që tatimi në qarkullim s'bën me u pagua. Firmat, ose s'bëjnë fitim, s'bëjnë fitim. Në qoftë se, bëjnë fitim, paguajnë tatim dhe më pas flasim a paguajnë 10% a 15% apo 20% brenda të majtës dhe të djathtës. Ne po

flasim për një industri e cila paguan 5% tatim në qarkullim. Pagan tatim edhe kur është në humbje. Si e tillë, kjo praktikë duhet të marrë fund dhe kjo është pikërisht iniciativa e LDK-së, që e prezanton.

Pra edhe një herë, ne nuk mund t'i marrim parasysh argumentet procedurale e aq më pak ideologjike në këtë drejtim, por mund të marrim pozicionin e partive në pushtet dhe të opozitës të koordinuar, si duket për të refuzuar nismën e LDK-së. E kemi thënë edhe në Komision për Buxhet dhe Financa, po e themi edhe tani, që në qoftë se Qeveria i sjell brenda leximit të dytë ligjin tjetër, kështu e kemi thënë, ne e tërheqim iniciativën e LDK-së dhe i bëjmë bashkë të dy ligjet, sepse këto ligje na është premtuar se janë në pakon e ligjeve të reja. Pra, në aspektin argumentiv nuk ka risi që gjendet te ligjet e reja. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Hamza e ka kërkuar fjalën për sqarime shtesë.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Dallimi është këtu se Qeveri po do të sjellë në Kuvend diçka substanciale, të qëndrueshme. Nuk jemi për diçka kozmetike, nuk jemi të interesuar për të thënë që e bëmë ne dhe e morëm këtë iniciativë, tek e fundit, kurrkush s'e ka penguar Qeverinë e kaluar, duke i vlerësuar të gjitha veprimet e mira që i ka bërë, duke mos e minimizuar asnjë prej atyre që kanë ndodhur, me i procedua. Por, i ka pasur të njëjtat vështirësi për shkaqe procedurale, që nuk ka mundur t'i sjellë më shpejt.

Prandaj, nuk kemi këtu dallime a duhet të ndryshohet mënyra e tatimit të kompanive të sigurimeve. Jemi në të njëjtën linjë. Nëse, të gjitha kompanitë tjera që janë edhe më profitabile, se sa kompanitë e sigurimeve i nënshtrohen tatimit në të ardhura reale, atëherë pse edhe atyre të mos u ndodhë njëjtë, pse të jenë të përjashtuara? Mirëpo, kërkesa jonë ka të bëjë këtu edhe qëndrimi ynë ka të bëjë këtu. Vijnë drafte të ligjeve të harmonizuara me komente të FMN-së me të institucioneve të BE-së, inkorporimin e komenteve nga komuniteti i biznesit dhe pastaj nëse ka mbetur diçka nga kjo që është propozuar, që s'është përfshirë, ne jemi të gatshëm që ta diskutojmë. Mirëpo, nuk mund ta pranojmë diçka që po, është presioni i opozitës edhe me presion të opozitës u bënë këto ndryshime, ndryshime që janë të rëndësishme, por janë shumë simbolike në raport me ato që pritet të vijnë, sepse ne mendojmë që përmes reformës së re të ndodhin gjëra shumë më shumë se këto, të ndodh reforma më e madhe që ka qenë ndonjëherë në Kosovë, të ndodh kalimi i pagesës së TVSH-së prej kufirit në brendi, e cila ndikon pozitivisht në likuiditetin e bizneseve dhe ulë koston e bizneseve dhe shumë ndryshime tjera e jo të lidhemi me tri-katër amendamente e pastaj të themi e kemi bërë një reformë fiskale dhe të ecim prapë me ligjet tjera, që realisht është një dyfishim i punës edhe për institucionet edhe për Kuvendin.

Do të thotë, nuk kemi dallim që me thënë, po ne këto s'po i përkrahim se s'po na pëlqejnë, por kemi dallim se proceduralisht duhet të ecim ndryshe, duhet të ecim të harmonizuar dhe do të

jemi në përputhje me direktivat e BE-së dhe në përputhje edhe me komentet e FMN-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sejdiu në emër personal e ka kërkuar fjalën tani, parëz e pati në emër të grupit parlamentar.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Më shumë e kisha si diskutim karshi referencës që i bëri zoti Abdixhiku për qasjes ideologjike, pra të djathtës karshi të majtës. Sa për qartësim e sqarim, e djathta në Kosovë ose mendimi i djathtë mbi politikat ekonomike, përkatësisht politikat fiskale e tregtare nuk është ndonjë risi, në fakt implementohet që nga viti 2001 e tutje. duke iu për qasë apo duke dashur të shtyjme përpara këtë idenë që vetëm me sheshtësi, thjeshtësi e ulje të politikave fiskale mund të kemi lëvizje përpara, sa i përket zhvillimit ekonomik, kemi përfunduar në diskutimin që në fakt problemi nuk është sistemi tatimor apo politikat fiskale, por korrupsioni enorm.

Mendoj që njëra-tjetrën nuk e përjashtojnë. Pra, ky sistem ekonomik i implantuar e instaluar tash e 18 vjet në Kosovë, pra një qasje neoliberales komplet, është në fakt ai i cili e sjell këtë idenë mbi të mirën publike, të zhveshur në përfitim personal të, të themi, disa bizneseve të ashtuquajtura. Tash, tutje është tepër me rëndësi që politika fiskale e tregtare të mos trajtohen në situatë higjienike të një mendimi, si të them kështu, komplet identik për secilin sektor e secilën industri. Pra, së pari, sipas meje, bëhet një strategji e mirëfilltë për zhvillim, më pastaj për këtë strategji ndërtohet një strukturë ekonomike. Për këtë strukturë ekonomike janë politikat përkatëse fiskale e tregtare, meqë monetare nuk kemi, dhe rrjedhimisht bëhet diskutimi për llojin e politikave.

Në anën tjetër, sa i përket të majtës në fakt unë një gjë këtu që po e shoh sot, është që pikërisht LDK-ja dhe PDK-ja që nuk po pajtohen për procedurën, ju jeni dakord për sistem tatimor, jeni dakord për mënyrën e organizimit të ekonomisë, jeni dakord për llojin e politikave fiskale që duhet këtu me i ndërmarrë. Pra, nuk keni ju dallime në këtë drejtim. Ju dallimin e keni veç kush do të jetë në pushtet. Pra, kush do t'i zbatojë këto lloj politikash?

Në anën tjetër, unë dhe partia të cilën unë përfaqësoj, besojmë që modeli ekonomik duhet transformuar, duhet ndryshuar. E meqë duhet ndryshuar e transformuar ky model ekonomik, pra duhet një strategji tjetër për zhvillim, atëherë edhe struktura të cilën duhet ta përshtatim për këtë strategji është tjetër dhe kjo nuk reduktohet në këtë diskutimin që duhet me e rritë tatimin në korporata, siç po mundoheni ta reduktoni si diskutim, por është një diskutim pak më i gjerë, mbi të cilat janë politikat fiskale, në çfarë sektori industrie, cilët sektorë industrie kanë influencë të drejtpërdrejtë në, të themi, disbalancin tregtar, në krijimin e vendeve të punës, e tjera, e tjera, e tjera... Dhe, kështu të ndërtojmë ca industri, të cilat më pastaj bëhen industri që përkrasin edhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, sepse ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, historia

ekonomike na tregon që i ndihmojnë industrinë e mëdha dhe nuk rriten ato prej të voglave me u bërë të mëdha, pa ekzistuar një industri në të cilën ato shesin produkt, për të krijuar një vlerë të shtuar në industri.

Pra, ky diskutim ideologjik duhet bërë dhe nuk mendoj që definohet e, si të them, zvogëlohet apo reduktohet në diskutimin mbi tatimin në korporata e aq më pak, në reduktimin e diskutimit se çfarë është e djathta e çka e majta. Ajo që kemi sot, sa i përket skemave që po u referoheni ju si skema sociale, nuk është asgjë më pak se tentativë për të blerë elektorat me intervenime ad hoc pa dashur fare me e trajtua temën në thelb. Një temë që e kemi trajtuar këtu para tri javësh është tema e sistemit pensional. Ishte pikërisht e djathta në këtë kuvend, e cila insiston në rritjen e barrës buxhetore, përderisa e majta në këtë Kuvend flet për një kod të unifikuar pensional.

Dhe, krejt kjo në fakt e shpërfaq edhe një element tepër të rëndësishëm, e ajo është që e majta në këtë Kuvend është edhe konsistente edhe e qartë, sa u përket politikave që duhet ndërmarrë, ndërsa e djathta, sikurse çdo e djathtë, është tyxharllëku i votave dhe asgjë më shumë e asgjë më pak. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Replikë ka zoti Abdixhiku.

**LUMIR ABDIXHIKU:** Faleminderit, kryesues!

Unë në fakt të majtën e Kosovës nuk e shoh si artikulum të mirëfilltë politik, sepse ka të paqartë idenë mbi të cilat i shtron dhe në këto diskutimet e deritanishme, prej një diskutimi të normës tatimore kalohet në diskutim industrial.

Tash, sa për të qenë të qartë, LDK-ja i qëndron prapa dhe do t'i qëndrojë gjithmonë idesë se taksat dhe tatimet në Kosovë duhet të jenë të ulëta. Pikë. Është obligim dhe besim yni i djathtë dhe si të tillë do ta shtrojmë.

E dyta, ligjëratat e të majtës më tepër i konsideroj si, e kam thënë edhe më parë, si ligjërime të mira morale, por në teorinë ekonomike bien. Me thënë në Kosovë që ka tatime të ulëta është nënvlerësim i jashtëzakonshëm i gjendjes së tanishme, sepse në rastin më të mirë është nënvlerësim, në rastin më të keq është mosdije. Ka dallim esencial në mes normës tatimore dhe ngarkesës tatimore. Pra, normat tatimore në Kosovë janë të ulëta, në fakt janë në nivel me rajonin, por ngarkesa tatimore në Kosovë është më e larta. Mënyra se si paguhen tatimet, fakti që bizneset kosovare janë të vetmet që duhet të paguajnë TVSH-në para se të krijojnë vlerë, është ngarkesë e veçantë tatimore, kjo s'ka të bëjë me normën tatimore.

Pra, nuk mund të themi, se ambienti ekonomik në Kosovë është i djathtë. Në fakt asgjë s'është e djathtë, sa i përket operimit të bizneseve në Kosovë. Po, norma tatimore janë të ulëta, mënyra se si mbledhet tatimi është jashtëzakonisht e rëndë, është ngarkesë fiskale enorme për bizneset

kosovare. Mënyra si e ndajmë Buxhetin e Kosovës është krejtësisht e majtë. Pra, nuk ka hapësirë për më tepër majtizëm në Kosovë. Në fakt, ne ve duhet sa më pak të kemi ndikim të shtetit, të burokracisë shtetërore në ambientin ekonomik, në mënyrë që t'u japim bizneseve tona aftësi për zgjerim, për krijim të vendeve të punës, për zgjerim të bazës tatimore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sejdiu, kundër replikë.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, unë e kam të qartë këtë diskursin e zotit Abdixhiku, sa i përket trajtimit që i bëjmë ne shpërndarjes dhe në një drejtim edhe e mirëkuptoj, sepse është stoik në trajtimin ideologjik që i bën shtetit. Ajo që është e qartë këtu, është se mënyra sesi i shpërndajmë ne, nuk ka të bëjë me të majtën, nuk ka të bëjë me idenë e krimit të një lloj barazie në këtë shoqëri. Thjesht ka të bëjë me elektorat, vendimet ad hoc elektorale, të cilat e shpërndajnë buxhetin në bazë të presionit apo nevojës për elektorat. Dhe, këtë e kemi parë me 26 skema pensionale. Këtë e kemi parë me kërkesat dhe pagesat që bëhen për këto kërkesa. Rrjedhimisht, këtu asgjë të majtë nuk ka. Kjo veçse e djathtë dhe elektorale.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryesues!

Megjithëse debati tash kaloi në një lloj përplasjeje ose diskutimi filozofik mbi të djathtën dhe të majtën, ka shumë gjëra që nuk merren vesh në debate dhe në diskutimet që bëhen këtu.

E dëgjova pak më herët zotin Kurtin që fliste sesi ulja e tatimit në paga për 50% dhe ulja e tatimit në fitimin e korporatave për 50% ka ndikuar në atë që ai e quan përgjysmim të investimeve të huaja, ose në rritje të eksodit të qytetarëve.

Unë e admiroj zotin Kurti, por nuk e di dhe në çfarë formule e gjen një përfundim të tillë.

Por, sido qoftë, po dua të lidhem pak te deputeti Avdullah Hoti, unë e vlerësoj qasjen e tij, e cila kryesisht në Kuvendin e Kosovës është korrekte, besoj që e pati një shkarje sot kur tha që deputetët e mazhorancës nuk duan t'i mbështetin tre projektligjet e propozuara nga Lidhja Demokratike e Kosovës pse ato vijnë nga opozita. Zoti Hoti nuk është kështu, unë besoj që e dini edhe ju që nuk është kështu, jo vetëm për shkak se nuk është vetëm mazhoranca nuk e po e mbështet këtë nismën tuaj, por janë edhe dy parti tjera opozitare, kjo e para.

Dhe, e dyta, çështja është më e thjeshtë se sa që mundoheni ju ta paraqisni. Në fakt, ka një gjë që Qeveria e Republikës së Kosovës i ka në procedurë të tria këto projektligje dhe unë besoj për shembull që kontributi juaj do të ishte i jashtëzakonshëm në kohën kur këto projektligje do të vijnë në Kuvendin e Kosovës dhe ju atëherë do të mund ta bëni amendamentimin e këtyre.

Në fakt thuhet që politikanët në momentin që fillojnë të mendojnë për brezat e ardhshëm bëhen liderë dhe jo në momentin që fillojnë të mendojnë për zgjedhjet e ardhshme.

Unë besoj për shembull që gjithë ky debat që po bëhet e ka një pikë dhe përfundimi është që po kalkulohet shumë për zgjedhjet e ardhshme.

Hajde të mendojmë pak për brezat e ardhshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Para se të hyj në temë, dëshiroj t'i them dy gjëra. Shihet një ndikim i jashtëzakonshëm i Partisë Demokratike të Kosovës në bashkëqeverisjen e gjatë, shumë të gjatë në pushtet, me Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Po më duket se ajo Qeveria Nën Hijë, të cilën dikur e ka pas krijuar Partia Demokratike e Kosovës, tani i është dorëzuar indirekt stafeta Lidhjes Demokratike dhe këta po dëshirojnë ta bëjnë tash në prag ndoshta që ta zgjedhin njëfarë qeverie nën hijë dhe ky propozim, pavarësisht se është brilant, mua po ma merr mendja se më shumë i ngjan asaj Qeverisë Nën Hijë të Partisë Demokratike të Kosovës dikur, që e ka pasur vetëm për punë të elektoratit. Kjo është e para.

E dyta, sa u përket partive të majta dhe të djathta në Kosovë, unë po ju them që përcaktimi politik në Kosovë mund të caktohet varësisht me cilën dorë shkruajmë, me të majtën apo me të djathtën, sepse nuk mund të kemi parti të djathta në një vend ku gjithë kemi dalë nga komunizmi dhe akoma e kemi trurin e komunizmit.

Kjo është identike sikur kur shkoj në Shqipëri dhe disa njerëz atje, një natë më thanë disa miq të mi, “ne jemi aristokratë”. U thashë ju jeni aq aristokrat sa Enver Hoxha s’ju ka lënë as pulë as edh në torishtë të mbani, e merre me mend çfarë aristokratësh janë njerëzit në Shqipëri dhe çfarë djathtistësh e çfarë majtistësh jemi ne këtu në Parlamentin e Kosovës.

Sot jemi duke folur për një diçka shumë, shumë të rëndësishme, që në esencë ka vlerë të jashtëzakonshme, sikur gjërat e tilla të bëhen bashkërisht me pozitën dhe opozitën.

Ajo që e ka shkatërruar totalisht biznesin në Kosovë dhe sidomos ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që duhet të jenë bazë e fundament i ndërtimit ekonomik të shtetit të Kosovës është TVSH-ja në kufij. Por, jo vetëm TVSH-ja që e ka shkatërruar ekonominë, por tani është një shkatërrim, një kancer numër dy, rimbursimi i TVSH-së.



I dashur ministër,

ATK-ja e shtetit të Kosovës është pistë e krimit, është pistë e plaçkitjes së ndërmarrjeve të vogla, të mesme e të mëdha, e të gjitha bizneseve që janë në Kosovë, sepse unë kam informacione, jo prej një, jo prej dy, por prej dhjetëra biznesmenëve, të cilët nuk e kanë guximin ta thonë publikisht plaçkitjen që ua bënë ATK-ja me rastin e rimbursimit.

Në qoftë se supozojmë se duhet të rimburohet një ndërmarrje e mesme me një milion euro nga TVSH-ja, ata plaçkitësit në ATK ua kërkojnë deri në 20%. Kjo është një diçka shumë e vërtetë.

Dhe, kjo i ka bërë investimet e huaja jo që të përgjysmohen, por ka ndikua në ikjen e investitorëve të huaj.

Kosova u merr tatim në burim tatim në burim investitorëve të huaj, të cilët u dërgojnë edhe familjarëve të vet para në vendet perëndimore, që bëjnë pagesa, që lëshojnë pagesa, ose tatim në burim u merr për çfarëdo transferi bankar. Imagjino, para një jave një investitor i huaj është ballafaquar në Zyrën e Prokurorisë Speciale me këtë pyetje. I thotë, “ju zotëri, keni transferuar në një bankë të huajën, dy herë nga 50 mijë euro”. Ky i thotë “po”. “E keni lajmëruar si shpenzim”. Thotë, “natyrisht se shpenzim e kam”. Po i thotë, “Ne kemi marrë informacion se x dhe y në vendin e vet nuk kanë paguar tatim”. Atëherë, lind pyetja, në qoftë se një gjerman, një anglez, një suedez i paguan dikujt të ardhura në Kosovë, a i intereson shteti suedez ose gjerman nëse unë kam paguar apo nuk kam paguar tatim te shteti i Kosovës? Kjo është thjesht për ta plaçkitur një kompani, kjo është thjesht për ta bankrotuar një kompani dhe këtu është esenca. Dhe, kjo është arsyeja pse unë e mora fjalën kështu pa tjerre filozofike, se ekonomia nuk ka nevojë kështu që ne si deputetë të tjerim shumë në aspektin filozofik, por tjerja është shumë e trashë, sepse plaçkitja është shumë e madhe, duke filluar nga Dogana që të plaçkitë, sepse ne e dimë që çdo shtet që buxhetin e vet e krijon mbi të ardhurat doganore ai shtet është diktatorial, se kur ne nesër të hyjmë në Bashkimin Evropian doganat do të zhduken. Atëherë, lind pyetja si do të qëndrojë ekonomia e këtij vendi.

Po e përfundoj fjalën time me një diçka që dua ta them për herë të parë në Parlament, por e kam thënë disa herë në debate televizive.

Në qoftë se shteti i Kosovës do t'i lejonte vetëm mërgimtarët, vetëm Diasporën e Kosovës, që ta futin kapitalin e tyre në Kosovë pa kurrfarë taksash, pa kurrfarë burokracish, pa kurrfarë plaçkitjesh, unë ju garantoj që Kosova do ta zhvillonte ekonominë e vet, duke qenë hapësirë vetëm 10 000 kilometra katrorë, me dy milionë banorë, barazi me Dubain. Kjo është bindja ime absolute.

Prandaj, ajo që ne duhet të bëjmë si deputetë në bashkëveprim me Qeverinë e Kosovës dhe me ministrin e Ekonomisë dhe Financave, të cilin unë e përgëzoj për atë hezitimin e tij, për atë

frenimin e tij që e ka pasur edhe në rritjen e rrogave, sepse për mendimin tim është një veprim jo vetëm antikushtetues, por është një veprim antiligjor i Qeverisë së Kosovës që t'ia rritësh vetes rrogën, sikur që edhe kam dëgjuar, nuk di a është e vërtetë, ka pasur edhe në Kryesinë e Kuvendit që ua kanë rritur vetes rrogat.

Unë po them, më së paku është vepër antiligjore, sepse Buxheti kalon nëpër Parlamentin e Kosovës dhe ti mund ta devijosh një autostradë, në vend që për Podujevë, autostradën mund ta dërgosh në Gjilan, por brenda linjave buxhetore, por nuk mund t'i rritësh rrogat e ministrave, zëvendësministrave, e gjykatësve, e të prokurorëve dhe kjo t'i kushtojë Buxhetit të Kosovës 15 milionë euro, pa kaluar ajo procedurë nëpër Parlament, sikur që ne nuk mund të heshtim kështu pa shkuar në burg ose Lutfi Zharku për 53 milionëshin e Bechtel&Enkës, ose Pal Lekaj. Thjesht, hajde gjejeni kush është vëlla përgjegjës për 53 milionë që ne ia falëm Bechtel&Enkas.

Duhet të dalë e të na sqarojë edhe ministri i Ekonomisë dhe i Financave, a ka pasur qare Qeveria pa i paguar. Në qoftë se s'ka pasur qare pa i paguar, kush është shkaktari i këtij penalizmi kaq të madh prej 53 milionë eurove?

Luta do të më dhimbej të shkonte në burg, Pali aspak, por megjithatë më fal Lutë, por besoj që dakordohesh me mua, ose duhet të shkosh ti në Dubravë, ose Pal Lekaj. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Milaim, sa për informim, mos dëgjo fort fjalë sokaku, ndërsa Kryesia e Kuvendit nuk ia ka rritur vetes rrogat. Kryesia i ka caktuar rrogat mendoj në mandatin e tretë, edhe për deputetët, edhe për Kryesinë, por pas mandatit të tretë Kryesisë nuk i është bërë asnjë rritje, përjashtoj rrogën e kryetarit që është rritur gjatë mandatit të katërt besoj. Dhe, rroga nuk është rritur nga Kryesia, por është rritur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Të gjithë deputetëve u është rritur rroga nga Komisioni, por anëtarëve të Kryesisë jo. Dhe, dua të them që anëtarëve të Kryesisë, jo që s'u është rritur rroga, por për asnjë mbledhje të Kryesisë nuk marrin asnjë mëditje, as asgjë hiç. Kështu që ju që jeni nëpër komisione, e dini këtë punë, e dini sa merrni. Nuk ke çka ti...

Fjalën e ka ministri, zoti Hamza.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar deputet Zeka,

Përveç që ky vend ka nevojë për ligje të mira, infrastrukturë të mirë ligjore, ka nevojë që të ngrihen edhe kapacitetet e institucioneve të cilat merren me administrimin e këtyre ligjeve.

Mund të ketë individ brenda institucioneve që punën e vet nuk e kryen në përputhje me obligimet e veta kontraktuale, por megjithatë si institucione besoj që edhe në të kaluarën, edhe tash janë duke e bërë një punë të mirë, e nëse e shkojmë trendin e tyre për Buxhetin e Kosovës,

vazhdimisht ka qenë një trend në rritje, por ka edhe vlerësime të institucioneve tjera sa i përket si institucion, duke i përjashtuar individët edhe për Dogana, edhe për Administratën Tatimore të Kosovës.

Zoti Zeka, të kisha lutur që pak guxim tëndin intelektual politik t'ua japësh edhe gjithë atyre njerëzve që kanë punë me Administratën Tatimore të Kosovës dhe për rastet, për të cilat unë nuk jam këtu të them kanë ndodhur a nuk kanë ndodhur, por raste të cila kanë ndodhur t'u ndihmohet organeve të rendit dhe të denoncohen në organet e rendit, ndryshe nëse mungon guximi intelektual njerëzor për ta denoncuar të keqen mbi bazën e fakteve dhe argumenteve, realisht ata nuk dallojnë shumë prej atyre që i marrin. Edhe ata i japin, edhe ata që i marrin.

Prandaj, besoj që ne kemi nevojë për ligje të mira dhe ne kemi nevojë për administrim të mirë të ligjeve.

Sa i përket pagesës së tatimeve, tatimi i Doganës në totalin e Buxhetit është i vogël, por është çështja e pagesës së TVSH-së. Në momentin kur pagesa e TVSH-së kalon në brendi, atëherë të hyrat të cilat i grumbullon Dogana do të jenë krejt në nivel tjetër, sepse vetëm TVSH-ja si tatim indirekt është mbi 800 milionë euro, që sot një pjesë të madhe e mbledh Dogana dhe besoj që reformat dhe ligjet e ardhshme do ta adresojnë këtë çështje.

Mirëpo, pa pasur edhe një bashkëpunim të mirë të personave fizikë dhe juridikë, si te rimbursimi, si te çështja e trajtimit të borxheve, si te çështja e vendosjes së barrës tatimore, si të gjitha elementet tjera, edhe organet e rendit e kanë të pamundur, në mungesë të fakteve dhe në mungesë të përkrahjes, që ta bëjnë aktivitetin e vet dhe unë besoj që me qëllim të përkrahjes, funksionimit të shtetit ligjor, në të ardhmen do të ngrihet edhe vetëdija e të gjithë tatimpaguesve që të drejtat e tyre t'i realizojnë në përputhje me ato që ua ka dhënë ligji dhe për të drejtën e vet të mos kërkojë mbështetje prej askujt dhe të mos kërkojë kanale për t'i kryer punët e veta, por le të kërkojë vetëm rrugë ligjore dhe le t'i denoncojë të gjithë keqpërdoruesit dhe ata të cilët nuk i respektojnë ligjet.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ramiz Kelmendi.

**RAMIZ KELMENDI:** Faleminderit, kryesues!

Kërkesa për lirimi nga tatimet është e duhur, por jo e mjaftueshme. Ka shumë e më shumë ndryshime fiskale që i nevojiten në veçanti ekonomisë prodhuese.

Ne e kemi gojën plot për çdo ditë në emisionet televizive dhe në çdo vend për ekonominë prodhuese, por faktikisht çdo herë punojmë kundër ekonomisë prodhuese.

Por, politikat fiskale sot i kemi më diskriminuese se sa në tërë rajonin.

Produktet tona që prodhohen në Kosovë, një pjesë e madhe e tyre, dalin më shtrenjtë në raftet e dyqaneve prej 5 deri 12% në raport me prodhuesit e shteteve të regjionit.

Dhe, kjo kërkesë për lirim të tatimeve duhet plotësuar edhe më shumë, se të gjitha doganat në të gjitha repromateriale duhet të hiqen në tërësi.

Unë mendoj që duhet të hiqet dogana në të gjitha llojet e repromaterialeve që ekzistojnë. Duhet zvogëluar TVSH-në në produktet bujqësore për ta luftuar informalitetin.

Të nderuar deputetë,

Qytetarë,

Ne sot e kemi një bujqësi që praktikisht është diku në shumicën e vlerës informale. E kemi një konkurrencë joreale nga të gjithë importuesit dhe gjithmonë po dëmtohen prodhuesit vendorë.

Unë kam propozuar edhe më herët, edhe tash kisha propozuar që TVSH-ja në prodhimet bujqësore të zvogëlohet edhe më shumë, jo të jetë 16, por 8. Sa më e vogël që është TVSH-ja, aq më i vogël është informaliteti.

Ne e kemi rastin për shembull kur makinat e transportit kanë doganë, ndërsa para një kohe e kemi hequr doganën për kompjuterë, edhe në pajisjet e kompjuterëve, që është jashtëzakonisht e dobishme, mirëpo edhe makinat transportuese që punësojnë dhe bëjnë ekonomi të vogël individuale kanë nevojë t'u hiqet dogana. Pra, ne kemi ende doganë në makinat transportuese.

Politika tatimore gjithnjë po rregullohen për problemet ekzistuese. Ne zakonisht po rregullojmë tatime dhe dogana për kërkesat e shumta që i kemi nga miqtë dhe afaristët të afërt, që bisedojnë me ta.

Ne fare pak po mendojmë për ata afaristë të cilët gjithmonë propagandojnë “afaristët e rinj”. Ne nuk mund të sjellim dogana dhe tatime për ekonomitë që janë inekzistente. Duhet përdorur teorinë e zgjuar të shteteve të regjionit dhe shteteve të zhvilluara, në mënyrë që ekonomitë e reja të lulëzojnë.

Prandaj, një politikë e tillë fiskale që ekziston në Kosovë nuk lejon lulëzimin e ekonomive të reja, që është dëmi më i madh që i sillt kësaj shoqërie.

Nëse ne e shohim që kërkesat e artarëve, që janë diku 1 500 sa dëgjova, ka qenë që tregtimi me ar të trajtohet si tregti me valutë. Ne e kemi tatimuar arin me 18%, mirëpo nëse e shohim në Doganat e Kosovës ne nuk kemi fare ar të importuar, që do të thotë që njerëzit është dashur ta zgjedhin rrugën e informalitetit, në mënyrë që me e mbrojt qarkullimin e arit në Kosovë, e jo të shkojnë blerësit e arit në shtetet e regjionit për të blerë ar.

Prandaj, lirimi nga TVSH-ja, apo vetëm aplikimi i TVSH-së në vlerën e shtuar për argjendarët do të legalizojë 50 milionë euro, që do ta shtojnë bruto-produktin vendor dhe do t'i legalizoj edhe punëtorë, që janë në këtë ekonomi.

Prandaj, te ndarja politike, unë po shoh sot dhe e dëgjova edhe ministrin që për ndryshim-plotësimin e një ligji po u nevojitkan 290 ditë, ndërsa për ta futur në Parlament në këtë formë në këtë formë, që ka mundur të vijë bashkërisht, së bashku me Grupin Parlamentar të PDK-së, që të shkojë bashkërisht si propozim në Kuvend, në mënyrë që të shkurtohen ato ditë dhe të sillen rezultate më të shpejta për ekonominë.

Ne e kemi lehtë për arsye se ne marrim nga Buxheti i Republikës së Kosovës, ne deputetët i kemi të ardhurat e mira, por duhet të mendojmë për ata afaristë që janë të papunë dhe kanë nevojë për punë.

Prandaj, bashkëpunimi për të ardhur deri te një rezultat qenka më i mirë të vijë drejtpërdrejt.

Nëse ne i shohim edhe disa propozime të reja që vijnë, që afaristët dhe qytetarët e Kosovës duhen pritur ndryshime politike që janë të gabuara nga pavarësimi i vendit, gabim është. Ne nuk kemi mundësi ta ndryshojmë sistemin politik për arsye se ky sistem politik është i duhuri. Ai për të cilën shumica po paramendojnë ka qenë i tejkaluar dhe nuk ka pasur fare rezultate.

Unë po mendoj që ndarja juaj politike, më shumë po e dëmton komunitetin e biznesit dhe investitorët e rinj. Ndoshta qytetarët përfitojnë më vonë, por sa më herët është aq më mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar deputet Kelmendi,

Tri vendimet e fundit apo vendimet e fundit që i kemi marrë si Qeveri e Republikës së Kosovës, janë të dedikuara kryesisht në ndërmarrjet prodhuese.

Besoj që je në informacion që ka të bëjë me lirimin prej tatimit të Doganës për të gjitha lëndët e para që hyjnë në procesin e prodhimit.

Vendimi tjetër ka të bëjë me lirimin prej tatimit të akcizës për të gjitha lëndët e para djegëse që përdoren për procesin e prodhimit.

Dhe, vendimi tjetër ka të bëjë me lirimin e të gjitha linjave për prodhim, duke përfshirë edhe pjesët rezervë, dhe vendimi tjetër ka të bëjë me lirimin prej tatimit të Doganës për pajisjet e IT-së.

Sa i përket kohëzgjatjes së procedurave për sjelljen e një ligji në Kuvend, besoj që këtë informacion e keni nga pozita juaj paraprake si zëvendëskryeministër i Republikës së Kosovës, kur kjo Rregullore ka qenë edhe atëherë në fuqi. Nuk është rregullore që është bërë tash, por është rregullore që ka qenë në fuqi edhe atëherë.

Dhe, nuk është e barabartë, se është rregullore e cila kërkohet prej BE-së, ju e dini, dhe është harmonizuar me ta, se nuk mund një ligj të vijë në Kuvend pa i kaluar fazat e caktuara edhe të diskutimeve publike. Dhe, është mirë, është mirë që ne t'i bëjmë planifikimet me kohë, t'i futim në strategjinë legjislative me kohë dhe t'i procedojmë në përputhje me Rregulloren.

Prandaj, të gjitha veprimet e viteve të fundit kanë shkuar në favor të biznesit. A ka nevojë për më shumë, sigurisht që po, por unë besoj që me ligjet e reja, defektet të cilat janë identifikuar gjer më tani në sistem do të korrigjohen dhe do të ndryshohen.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Kelmendi e ka fjalën për replikë.

**RAMIZ KELMENDI:** Nuk kisha dashur të jetë si një replikë, meqenëse me ministrin kemi edhe biseda nga e kaluara dhe ministri ka qenë pjesë e ekonomisë dhe e njeh ekonominë, e di që edhe unë e njoh ekonominë, se propozimet e mia nuk janë në interes të ekonomisë sime, por janë në interes të ekonomive prodhuese që janë në Kosovë, e që ndoshta janë në kundërshtim me atë që jam importues.

Nuk është hequr dogana në të gjitha repromaterialet. Ne e kemi obligim kushtetues që të gjithë aktorët ekonomikë në Republikën e Kosovës të jenë të barabartë. Para një kohe, ju e dini që e kemi shuar një industri dhe po duhet paguar doganë në repromaterial. Nuk po ankojem për industrinë time, por po ankojem në raport me konkurrencën, e cila ndodh në bazë të shteteve të rajonit.

Ju e dini që edhe industria e tekstilit dhe industritë tjera kanë doganë dhe sa për informim të qytetarëve, se s'po dua të polemizoj, dogana mu si element që përdoret në produktet e gatshme shërben si vlerë e shtuar për pagesën e ekonomisë fillestare, në mënyrë që të jetë konkurrenente me ekonomitë që vijnë nga jashtë. Prandaj, heqja e doganës në repromaterial është në njëfarë forme fuqizim dhe ndihmesë i ekonomisë prodhuese. Nuk bën një komision që ndoshta nuk ka prekur punë me dorë të vlerësojë cili është prodhim, e cili nuk është prodhim, prandaj është propozimi që të hiqen doganat në të gjitha repromaterialet, në mënyrë që të mos ketë komisioni aftësi apo mundësi...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Adem Mikullovc i ka fjalën.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë desha të them, kur aplikohen ligjet, kur merren ligjet për tatim duhet të mendojmë edhe në mirëqenien sociale të çdo qytetarit. E kam fjalën së pari për segmentin a lëmin e kulturës dhe krijimtarisë në përgjithësi.

Unë mendoj që tatimi në krijimtari është shumë i lartë dhe duhet të ulet pak. Ja, për shembull, një shkrimtar e shkruan një roman për 1 ose 2 vjet, i merr 1 500 deri në 2 000 euro honorar. Sa ia rrëzojnë 20% tatimin, vërtet jetë pak. Ose një aktor luan në një seri ose në film, merr 200-300 euro honorar, i rrëzohet 18-20% tatimit, është fukarallëk i tmerrshëm. Unë propozoj, të mos e zgjas shumë, që duhet ta stimulojmë krijimtarinë edhe të mendojmë në mirëqenie sociale të krijuesve në përgjithësi, o kompozitorë, skenografë, aktorë, regjisorë a dramaturgë dhe këtu të kemi tatimin sa më të ulët, minimal, se të ardhurat janë minimale. Posaçërisht kisha apeluar që të lirohen nga tatimi të ardhurat variable, sikur që janë honorarët e ndryshme, shpërblimet e ndryshme, shitja e të drejtës së autorit, e këto pak që janë më të rralla, por aty bile t'i kursejmë njerëzit.

Zoti Bedri Hamza nuk pajtohesh me mua, por po flas për fukarenj, jo për kompani e për firma të mëdha që kanë alamet tatimi, për ta s'marr vesh e as s'dua të flas, bile. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Është vështirë të flitet për këto tema, sepse ne kemi një realitet, do të thosha të hidhur. Ne po flasim të gjithë këtu dhe kemi brenda në sallë ekonomistët më të mirë ndoshta që i ka Kosova. Do ta bëja një pyetje për veten time: përjashto atyre që kanë investuar në privatizim dhe i kanë marrë falas fabrikën e çimentos, "Ferronikelin" dhe ndonjë tjetër, të mos i përmend, çfarë investimesh të jashtme kemi në Kosovë dhe cilat janë arsyet pse s'kemi investime të jashtme? Cilët gjigandë të ekonomisë kanë ardhur për të prodhuar në Kosovë, kur mundësitë qysh i kanë vendet fqinje, të mos i përmend me emra, edhe të tjerët, edhe ne i kemi për të krijuar ligje.

Unë mendoj që garantimi i qëndrueshëm ligjërish i investimeve dhe i pronarëve të tokës, për të cilët po them edhe unë kam pasur rast me ndonjë investitor ose me një njeri që i di problemet dhe i njuh problemet në Kosovë sa i përket fushës së investimeve, nuk kanë besim që pronari i tokës, qoftë shteti, qoftë privat, që pas investimit nuk i thotë: "Unë dua kaq për qind dhe aq për qind vitin tjetër, sepse po fiton ti shumë". Pamundësimi me ligj i titullarëve të dikastereve kompetentë për të kërkuar mito dhe përçindje në investime duhet të rregullohet me ligj dhe duhet të ashpërsohet ligji për këtë. Ne të gjithë e dimë që kemi raste të tilla kur kompanitë e fuqishme edhe politikisht, do të thosha, në Bashkimin Evropian edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

nuk iu është dhënë mundësia pikërisht sepse me ligj e kanë të ndaluar që të japin mito dhe të fusin aksionarë me paratë e tyre që do të investonin.

Prandaj, duke mos u larguar nga biznesi, do ta quaja patriotik, kisha thënë, që bizneset tona të bashkëpunojnë me politikën shtetërore, me qëllim që të largohen nga preferenca e bizneseve, të cilët nuk i bëjnë mirë politikës së Kosovës. Faleminderit!

Diskutues të tjerë nuk ka, po presim kohën e votimit dhe i nxjerrim në votim të tri çështjet. Pikën e tetë e rendit të ditës po ia bashkëngjisim edhe këtyre tri çështjeve, sepse është votim dhe po vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

### **9. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017**

Por, para se të hyjmë në këtë pikë, unë ia kam dhënë fjalën zonjës Bogujevci që ta ngrejë një çështje që ka të bëjë me një ditë të veçantë të sotme, të cilën do ta thotë ajo vetë. E keni fjalën, zonja Bogujevci!

**SARANDA BOGUJEVCI:** Faleminderit, kryesues!

E di që është jashtë rendit të ditës, por është një çështje shumë me rëndësi. Sot është Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në konflikt dhe me rastin e shënimit të kësaj date, Qendra e Kosovës për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, së bashku me “Medica Gjakova”, kanë lansuar kampanjën “Bëhu zëri im”, që ka të bëjë me përkrahjen e grave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë. Të gjithë ju i keni disa zarfe që i kam shpërndarë më herët, ku janë tregimet e grave të dhunuara gjatë luftës. Ne kemi marrë pjesë sot me Bordin e grupit të grave së bashku me kryetaren e Grupit të Grave, Mexhide Topallin, edhe me deputetë të tjerë kemi marrë pjesë në marshin që është organizuar për lansimin e kësaj kampanje, për ta përkrahur kampanjën edhe për t’i përkrahur këto gra.

Ky është një njoftim për të gjithë deputetët, por edhe për qytetarët, për punën që është duke u bërë në këtë drejtim. Tjetra, me propozimin e deputetes Ganimete që pajtohem me këtë, kisha dashur që të gjitha këto tregime të vendosen në këtë pjesë të murit që të mos i harrojmë, domethënë tregimet e këtyre grave dhe t’i kemi këtu pjesë tonat në Kuvend. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, Sarandë! Atëherë po vazhdojmë me pikën e nëntë, Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Ftoj ministrin e Financave, zotin Hamza, që të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Zoti Hamza e keni fjalën!



MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, i nderuar zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Bazuar në nenin 46 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë ju paraqesim raportin vjetor financiar për vitin 2017, i miratuar me Vendim nr. 13/38 i mbledhjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës më 29.03.2018.

Ky raport prezanton ekzekutimin e buxhetit nga institucionet e Republikës së Kosovës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2017, sipas ndarjeve vjetore të Ligjit për buxhetin. Me Ligjin nr. 05/L-125 për ndarjet buxhetore të vitit 2017, të aprovuar në dhjetor 2016, plani vjetor i pranimeve ishte 2 miliardë e 109 milionë euro, kurse i pagesave 2 miliardë e 86 milionë euro, ndërsa me rishikimin e buxhetit që ka ndodhur në tetor të vitit 2017, përmes Ligjit nr. 06/L-002 plani vjetor i pranimeve ishte 1 miliard e 968 milionë, kurse plani i pagesave ishte 1 miliard e 941 milionë euro, duke përfshirë të hyrat vetjake të bartura, grantet e përcaktuara të donatorëve dhe fondet në mirëbesim sipas Ligjit të menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësitë.

Gjithsej pranimet e realizuara gjatë vitit 2017, duke përfshirë edhe fondet në mirëbesim dhe donacionet ishin në shumë 1 miliard e 923 milionë euro që paraqesin 98% të pranimeve të përgjithshme vjetore të planifikuara, ndërsa krahasim me vitin paraprak kemi një rritje prej 8%. Gjithsej pagesat e realizuara gjatë vitit 2017, duke përfshirë fondet në mirëbesim dhe donacionet ishin 1 miliard e 837 milionë euro dhe paraqesin 95% të pagesave të përgjithshme vjetore të planifikuara, ndërsa krahasim me vitin paraprak kemi një rritje prej 4%. Bilanci i fondeve më 31 dhjetor 2017 ishte 357 milionë euro, kurse saldo fillestare e fondit në buxhetin e Republikës së Kosovës më 1 janar 2017 ishte 271 milionë e 200 mijë euro, duke shënuar një rritje të bilanceve të ruajtura për 86 milionë e 600 mijë euro. Sipas rregullës fiskale, bilanci buxhetor i përgjithshëm ishte në deficit prej 0.8% të bruto produktit vendor, kurse me planin vjetor deficitin ishte parashikuar që të jetë 1,5%. Në vazhdim më lejoni të paraqes të dhënat e detajuara të raportit të pasqyruar në formë analitike si vijon:

Pranimet: Pranimet e prezantuara më lart në vlerë prej 1 miliard e 923 milionë euro sipas strukturës buxhetore ishin si vijon: të hyrat direkte ishin në shumë 238 milionë euro, të hyrat indirekte në shumë prej 1 miliard e 315 milionë euro, të hyrat jotatimore ishin 186 milionë euro, huamarrja shtetërore nën huazim 212 milionë euro, grantet e përcaktuara të donatorëve 8 milionë euro dhe pranimet e tjera në shumë prej 21,5 milionë euro.

Përderisa kthimet tatimore ishin 57 milionë e 600 mijë euro, që kanë reflektuar në totalin neto të prezantuara më lart, prej të cilave kthimet tatimore nga doganat 9,1 milionë euro, ATK-ja në vlerë prej 48.5 milionë euro. Të hyrat e mbledhura në nivel të agjencive në kuadër të Ministrisë së Financave ishin 1 miliard e 535 milionë euro, si vijon: doganat kanë mbledhur një shumë prej 1 miliard e 121 milionë euro dhe marrin pjesë me 58% të të hyrave të përgjithshme, duke arritur

planin vjetor dhe me një rritje prej 7% krahasuar me vitin paraprak. ATK-ja ka mbledhur shumën prej 414 milionë euro, duke përfshirë të hyrat e njëhershme nga arkëtimi i borxhit tatimor 11 milionë euro dhe merr pjesë me 22% në totalin e përgjithshëm, më 98% të planit vjetor dhe me një rritje 7% në krahasim me vitin paraprak. Të hyrat jotatimore ishin 186 milionë euro, me një pjesëmarrje 10% në totalin e përgjithshëm dhe 92% të planit vjetor të kategorisë. Të hyrat vetjake të komunave 66 milionë euro, duke përfshirë edhe tatimin në pronë në total paraqesin një nivel të njëjtë krahasuar me vitin paraprak, kurse tatimi në pronë shënoi një rënie prej 11%. Në vitin 2017 tatimi në pronë ishte 22,4 milionë euro, krahasuar me vitin 2016, prej 25,1 milionë euro. Të hyrat nga taksat koncesionare 8.5 milionë euro, të hyrat nga renta minerare 30,6 milionë euro, të hyra nga dividenda nuk ka pasur në vitin 2017, kthimet e kredive nga ndërmarrjet publike 9,35 milionë euro, të hyrat e dedikuara prej 9,4 milionë euro, të hyrat nga huazimet e institucioneve financiare ndërkombëtare 108,25 milionë euro, duke mos përfshirë pranimet nga nënhuazimet që ishin në shumë prej 8,38 milionë euro. Pranimet nga letrat me vlerë prej 95,3 milionë euro.

Pagesat: Nga pagesat e prezantuara më lart në vlerë prej 1 miliard e 837 milionë eurosh, pagesat e strukturës së buxhetit ishin si vijon: pagat dhe rrogat ishin në total 551 milionë euro, marrin pjesë me 30% në totalin e përgjithshëm të shpenzimeve, me një realizim prej 99% të buxhetit vjetor për kategorinë dhe një rritje 1% krahasuar me vitin paraprak. Mallrat dhe shërbimet ishin në total prej 204 milionë euro, marrin pjesë me 11% në totalin e përgjithshëm të shpenzimeve, me një realizim prej 88% të buxhetit vjetor në kategori dhe rritje 11% krahasuar me vitin paraprak. Shpenzimet komunale 24 milionë euro, marrin pjesë me 1% në shpenzimet e përgjithshme, me realizim prej 89% të buxhetit vjetor për këtë kategori, me një rritje 3% krahasuar me vitin paraprak. Subvencionet dhe transferet ishin 508 milionë euro, marrin pjesë me 28% në totalin e përgjithshëm të shpenzimeve, me një realizim prej 99% të buxhetit vjetor për kategorinë, rritje prej 7% krahasim me vitin paraprak.

Shpenzimet kapitale: 471 milionë euro, marrin pjesë me 26% në totalin e përgjithshëm të shpenzimeve, me një realizim 90% të buxhetit vjetor për kategorinë, rritje 5% krahasuar me vitin paraprak. Shpenzimet për servisimin e borxhit, përfshijnë interesin prej 69 milionë euro, duke mos përfshirë pagesat për nënhuazimet prej 8.5 milionë euro. Marrin pjesë 4% e totalit të përgjithshëm të shpenzimeve, me një zvogëlim prej 11% krahasuar me vitin paraprak.

Gjendja e parasë së gatshme më 31. 12. 2017: Bilanci bankar më 31 dhjetor 2017 ishte në shumë prej 357 milionë e 800 mijë euro, sipas strukturës së llogarive si vijon: në llogarinë rrjedhëse në Bankën Qendrore ishin 340 milionë euro, paraaja në transit 10,2 milionë euro, fondi zhvillimor i mirëbesimit 5 milionë euro, paratë në llogaritë e misionëve diplomatike 1 milion euro, paratë e imëta, kesh, në organizatat buxhetore 1,6 milion euro. Në kuadër të fondeve të prezantuara më lart bëjnë pjesë edhe bilancet e fondeve të pashpenzuara në vlerë prej 65,6 milionë euro, të ndara për qëllime specifike. Fondet e përcaktuara të donatorëve 6,8 milionë euro, të hyrat vetjake të

bartura 33 milionë euro, fondi zhvillimor i mirëbesimit 10,3 milionë euro, të hyrat e dedikuara 800 mijë euro dhe fondi në mirëbesim 14,7 milionë euro. Si rezultat, bilancet e fondeve të shpërndara më 31 dhjetor 2017 ishin në vlerë prej 292 milionë e 200 mijë euro.

Të nderuar, detaje të tjera më të hollësishme lidhur me pranimet, pagesat dhe bilancet e fondeve të shpalosura janë në raportin, i cili është para juve. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Radha është e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotit Abdixhiku, të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin.

**LUMIR ABDIXHIKU:** Faleminderit, nënkryetar!

Raporti vjetor financiar i buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017 është dorëzuar në Kuvend nga Qeveria në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik, të bazuar në para të gatshme.

Ne në komision e kemi trajtuar raportin në fjalë në mbledhjen e mbajtur më 6. 6. 2018, dhe kemi konsideruar se i njëjti përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe të njëjtin ia kemi rekomanduar Kuvendit për miratim.

Meqenëse e kam fjalën do të doja të jepja edhe disa observime në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës për raportin në fjalë. Ne kemi thënë edhe në mbledhjen e komisionit se raporti në aspektin përmbajtësor ka mungesë të të dhënave narrative, pra ka mungesë të shpjegimit të numrave që prezantohen aty dhe një vërejtje e tillë është thënë edhe në vitet paraprake. Janë disa çështje që ndoshta meritojnë vëmendjen tonë në përgjithësi, e para më e rëndësishme ka të bëjë me inkasimin e të hyrave. Sipas raportit në fjalë, detyrimet ose të hyrat indirekte nga dogana kanë pasur rënie për 4 milionë krahasuar me një vit më parë dhe kjo rënie vjen si rezultat i dy vendimeve të njëpasnjëshme. E para, me marrëveshjen ndërkombëtare të MSA-s dhe ndikime të tilla do të priten të vazhdojnë edhe në buxhetin e vitit të tanishëm dhe në vitet e ardhshme. Pra, MSA-ja po ka ndikim në të hyra më të pakta doganore në Kosovë dhe neve do të na duhej të gjenim një rrugë alternative për të kompensuar këto të hyra, sidomos këtë vit këto të hyra janë pakuar më shumë.

E dyta vërejtje ka të bëjë me huamarrjen e jashtme në rritje, nga 44 milionë e 108 mijë, jo se s' duhet të marrë hua, por se një numër i madh i projekteve përkundër ratifikimit që iu bëhet në Kuvend, nuk po realizohen në praktikë. Shqetësimi kryesor me raportin në fjalë ka të bëjë me listën e të punësuarve. Në faqen 83, aneksi 14, janë paraqitur të punësuar në nivel qendror dhe lokal, vërehet se jashtë listës së pagesave në vitin 2017 në nivelin qendror janë shtuar edhe 369 individë, ndërkaq në nivelin lokal jashtë listës së pagesave janë shtuar edhe 586 të punësuar të tjerë. Pra, bëhet fjalë përreth 900 të shtuar të tjerë të punësuar jashtë listës së pagave, kryesisht në

kontrata mbi vepër dhe kishte qenë e udhës që Qeveria të konsiderojë reduktimin drastik të kontratave të tilla mbi vepër që po ndodh nëpër institucione të Kosovës.

Shqetësimi tjetër po aq i rëndësishëm ka të bëjë edhe me vendime gjyqësore, aneksi 17, faqe 88, rreth 11,5 milionë euro janë paguar për vendime gjyqësore të përmbauesve ndaj institucioneve të Kosovës. Është shumë e madhe që vazhdon të përsëritet, të njëjtat do të duhej të reduktohen. Gjithashtu, shqetësuese mbetet edhe rritja e vazhdueshme e shpenzimeve në mallra dhe shërbime, vetëm vitin e kaluar këto kategori janë rritur për 21 milionë dhe kjo vë në pah idenë që Kosovës i duhet një program kursimi. Vetëm udhëtimet jashtë vendit janë rritur për 1,1 milion krahasuar me vitin paraprak. Jo që s'janë të larta, por janë edhe në rritje të vazhdueshme. Pikë e përbashkët që e kemi vërejtur ka të bëjë edhe me qiranë që e paguajmë. Buxheti i Kosovës për institucionet e veta në vit i paguan 8,2 milionë euro për qira. Në fakt, një shumë e tillë do të mjaftonte të paguanim një kësht të kredisë dhe të ndërtonim objektet tona. Shumë më lirë do të na binte sikur të paguanim një kredi me 8,2 milionë euro kësht, se sa të paguajmë qira vjetore 8,2 milionë euro.

Dhe, e fundit, jo më pak e rëndësishme është kategoria e subvencioneve dhe transferove, e cila ka pasur rritje prej 33 milionë euro vitin a kaluar dhe si LDK kemi ngritur në vazhdimësi dhe vazhdojmë ta ngremë zërin për domosdoshmërinë e kategorizimit të listave të veteranëve, sepse moskategorizimi i listave në fjalë vazhdon të mbajë të hapur xhepin e kategorisë së subvencioneve dhe transfereve dhe rrezikon seriozisht stabilitetin financiar të Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zonja Hadërgjonaj.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministria e Financave nga viti në vit ka bërë ndryshime pozitive në raportimin e financave publike, ka bërë ndryshime që rrisin saktësinë e të dhënave, lehtësojnë të kuptuarit e tyre dhe, çka është më e rëndësishme, ofrojnë të dhëna me kohë sipas raporteve periodike.

E kam thënë disa herë gjatë diskutimeve se për një menaxhim më të mirë të financave publike dhe llogaridhënies është shumë e rëndësishme të përmirësohet klasifikimi buxhetor në fazën e planifikimit, në mënyrë që të ketë përmirësime në ekzekutimin e buxhetit. Nëse analizojmë raportin financiar me kujdes, shohim se janë bërë hapa pozitivë në këtë drejtim, por duhet bërë edhe më shumë në planifikimin më të mirë buxhetor, në mënyrë që të ketë një ekzekutiv më të mirë të buxhetit dhe të mos ketë nevojë për të bërë ndërhyrje gjatë vitit, të barten mjetet nga një program në një program tjetër buxhetor, të ndahen mjetet nga programe të caktuara përmes rezervës buxhetore apo të mbesin mjete të parealizuara në programe të caktuara.

Nëse e analizojmë me kujdes raportin vjetor financiar të vitit 2017, shohim se Ministria e Financave ka pasqyruar më shumë të dhëna për mënyrën e realizimit të të hyrave dhe ekzekutimin e buxhetit, gjë që të hyrat dhe shpenzimet buxhetore i bën shumë më transparente. Në raport mund të shohim të dhëna për çdo organizatë buxhetore, sipas kategorive ekonomike, të dhëna të detajuara për shpenzimet për paga, për mallra dhe shërbime, për investime kapitale. Janë pasqyruar edhe të dhëna për obligimet e papaguara të organizatave buxhetore, janë pasqyruar shpenzimet sipas vendimeve gjyqësore, pagesa nga Thesari sipas nenit 39.2 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi, për obligimet e vonuara, të dhënat për borxhin publik, të dhënat për të punësuarit e rregullt, ata jashtë listës së pagave dhe atyre që kanë të bëjnë me kontrata në shërbime të veçanta.

Të nderuar deputetë,

Fillimisht dua t'i theksoj tri gjëra që janë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe qëndrueshmërinë e financave publike.

Së pari, viti 2017 ka qenë vit elektoral, janë mbajtur zgjedhjet lokale dhe qendrore, është bërë ndërrimi i Qeverisë dhe i kryetarëve të komunave, e zakonisht në vitet elektorale prishet rregulli i financave. E ndjej të nevojshme të theksoj se është ruajtur stabiliteti financiar dhe është për t'u vlerësuar rritja ekonomike prej 4.4%, sipas të dhënave të Bankës Botërore.

Së dyti, nga të dhënat e raportit financiar shohim se deficitin buxhetor është nën 2% të bruto produktit vendor, ashtu siç është paraparë me Ligjin për menaxhimin e financave publike, e në anën tjetër, është ruajtur trendi i investimeve kapitale.

Së treti, raporti përmban edhe të dhënat për rezervën shtetërore, ku vërehet se bilanci bankar i Qeverisë ka qenë më i lartë se vitin paraprak për 86 556 000 euro, pra gjithsej 357 760 000 euro.

Të nderuar deputetë,

Nga tabela në faqen 6 të raportit, ku janë pasqyruar pranimet dhe pagesat në para të gatshme shohim se ka pasur 1 923 360 000 euro pranime në vitin 2017, që janë për 145 452 000 euro apo 8,2% më shumë se në vitin 2016. Pjesa më e madhe e të hyrave ende vazhdon të jetë nga Doganat, 68,38% e pranimeve të përgjithshme janë realizuar nga të hyrat indirekte, kurse vetëm 12,37% nga të hyrat direkte kurse 9,66 janë realizuar nga të hyrat jo tatimore.

Pagesat në vitin 2017 kanë qenë për 1 836 000 000 euro, 73 563 000 euro apo 4,1% më shumë se në vitin e kaluar. 42,4% janë pagesa për shpenzime rrjedhëse, 27,6% pagesa për subvencione dhe transfere, kurse 26% pagesa të bëra për investime kapitale. 371 089 000 euro janë shpenzuar për investime kapitale apo 4,8% më shumë se në vitin 2016.

Në vitin 2017 është ruajtur trendi i investimeve kapitale, ku përfitojnë më së shumti qytetarët e Kosovës, si në arsim, në shëndetësi, në infrastrukturë, në përmirësimin e sistemit të ujitjes, në sport, në trashëgimi kulturore, e të tjera.

Qeveria duhet të përkujdeset për një shpenzim më efektiv të parasë publike për mallra dhe shërbime, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal, si dhe të analizojë më me kujdes skemën sociale që ka ardhur duke u rritur nga viti në vit, pasi që u është dhënë mundësia që të marrin pagë njerëzit që nuk i takojnë kësaj kategorie sociale. Në këtë mënyrë, jo vetëm që po dëmtohet buxheti por është krijuar shtresë e njerëzve që nuk duan të punojnë, presin pagë nga buxheti, kanë shlyer firmat e tyre në biznese familjare, kanë ndërprerë punën vetëm e vetëm që të marrin pagën e cila u është mundësuar nëpërmjet kategorisë sociale.

Të nderuar deputetë, Qeveria po ashtu duhet të jetë më e kujdesshme që obligimet e papaguara të mos barten nga viti në vit, sepse ato janë ngarkesë për institucionet përkatëse. Shumë kryetarë komunash që e kanë marrë udhëheqjen e komunave me borxhe të mëdha, kanë problem në pagesë, në realizimin e objektivave të tyre, në anën tjetër detyrimet e prapambetura u sjellin bizneseve vështirësi dhe i sjellin ato pranë falimentimit, sepse në këtë mënyrë bëhet edhe rritja e kredive të këqija, pasi që ata nuk kanë mundësi t'i marrin mjetet për punët të cilat i kanë përfunduar.

Obligimet e papaguara sipas organizatave buxhetore vërehet se kanë një rënie të lehtë prapëseprapë mbeten të larta, 199 410 000 euro. Te organizatat e nivelit qendror ka një rënie të obligimeve të papaguara për 23 538 000 euro, kurse në organizatat e nivelit lokal ka rritje të obligimeve të papaguara për 12 650 000 euro. Sipas nenit 39.2 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisive nga Thesari janë paguar operatorët ekonomikë në mënyrë të drejtpërdrejtë, për shkak se faturat e tyre nuk janë paguar për punët e kryera në vlerë prej 8 604 163 euro, kurse me vendime gjyqësore përmbartimore janë paguar 11 544 000 euro. këto mjete u janë hequr organizatave buxhetore nga projektet që ato i kanë planifikuar për t'i realizuar gjatë vitit 2017. Për këto mjete ata janë të dëmtuar në realizimin e objektivave të tyre e çka është më e keqja për këto mjete dëmtohen operatorët ekonomikë, dëmtohet biznesi për shkak se nuk i marrin me kohë mjetet dhe janë të detyruar që të realizojnë të drejtën e tyre përmes ankesave.

Tri komunat që prijnë me pagesa të tilla të drejtpërdrejta nga Thesari janë Prishtina, Prizreni dhe Deçani, që secila ka mbi 1 milion euro pagesa të tilla. Për shembull: në një komunë të vogël, siç është Deçani, janë paguar nga Thesari 1 055 870 euro. Për këto mjete janë dëmtuar bizneset, shumë projekte të planifikuara në këtë komunë kanë mbetur të porealizuara, sepse janë hequr mjetet nga projektet që faktikisht janë planifikuar dhe që nuk janë realizuar.

Në aneksin 13 shohim se 18 komuna e kanë shkelur Ligjin për Buxhetin dhe kanë shtuar numrin e të punësuarve krahasuar me numrin e punëtorëve të cilët faktikisht kanë qenë të planifikuar.

Në ligj është i përcaktuar numri i të punësuarve për komuna. Tejkalimi i të punësuarve është shkelje ligjore.

Menaxhimi i përgjegjshëm dhe eficient i financave publike është domosdoshmëri në çdo vend e sidomos në vendin tonë. Secili vend që pretendon të ketë qeverisje të mirë dhe zhvillim ekonomik ka angazhim në drejtim të menaxhimit të përgjegjshëm dhe eficient të financave publike, prandaj ne inkurajojmë Qeverinë që të vazhdojë me rritjen e transparencës buxhetore, të vazhdojë me angazhimin e saj permanent për shpenzim eficient dhe efikas të mjeteve buxhetore dhe të ketë një sistem efektiv të kontrollit të brendshëm si në nivelin qeveritar ashtu edhe në nivelin e komunave. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Ali Lajçi e ka fjalën.

**ALI LAJÇI:** Të nderuar qytetarë,

Ky raport i Buxhetit për 2017 sigurisht se i ka përmbushur kriteret ligjore, të cilat faktikisht janë kërkuar dhe raportimi që është bërë nga ministri dhe nga drejtori i përgjithshëm i Thesarit në përgjithësi janë buxhet faktikisht është i konsoliduar. Unë do të përpiqem të jap një qasje pak më ndryshe, duke qenë dakord me këto pasqyra financiare dhe duke parë metodologjinë e trajtimit të këtij Buxheti për këtë vit, është fjala për 2017, ta shohim në një aspekt tjetër se si buxheti i përgjithshëm i Republikës së Kosovës, ai buxheti grand i saj, se si shpërndahet dhe madje duke analizuar në bazë të programeve të qeverive, të cilat pastaj vijnë dhe administrojnë me vendin.

Ka një rëndësi të veçantë sepse në programet e qeverive parashikohen objektivisht linjat buxhetore dhe rëndësia e zhvillimit të atyre sektorëve, të cilët do të mund t'i jepnin vendit një progres apo jo. Dhe, në këtë mes ne kemi pasur një traditë të menaxhimit të qeverive, si themi të njëjësuar, dhe shpërndarje të buxheteve njëkohësisht kanë shkuar në sektorë të cilët faktikisht nuk ka rrjedhë një rritje ekonomike e zhvillimit e përgjithshme dhe buxhetet njëkohësisht kanë qenë të koncentruara në linja tjetër buxhetore. Prandaj, ne kemi atje konstatime të cilat kanë dhënë nga fusha e ministrit të Buxhetit dhe Financave, rritjet çfarë u thanë dhe duhet të dakordohemi me ato numra dhe ato shifra që janë të pasqyruara atje, por duhet të flasim ndoshta më shumë rreth menaxhimit, shpërndarjes së Buxhetit në kuadër të këtyre sektorëve institucionalë.

Ne shohim se kemi një avari dhe madje kemi edhe skandale buxhetore, jo vetëm në akumulimin e tyre, por sidomos në shpërndarjen buxhetore e që vlen të theksohet njëkohësisht keqpërdorimet, siç bëhen në kohën e fushatave, siç vërehet edhe punësimet me kontratë në vepër në disa nga komunat, ani pse në pasqyrat financiare në fakt shohim rritje dhe shohim aty-këtu rënie në buxhetet komunale, respektivisht shumica prej tyre edhe e kryejnë obligimin në tatime, që i bëjnë qytetarët, por në shpërndarje kemi edhe skandale buxhetore. Kemi po ashtu edhe nivele qeveritare edhe në ministri të veçanta. Shikoni, ne ndajmë buxhetin disa milionësh për

qira, kurse objektet që i paguajmë me fondin e Qeverisë sigurisht se i kemi objekte që janë pronarë vet shteti, Qeveria, dhe si duket ne kemi kërkuar që të shikojmë një analizë të tillë dhe të kemi numrin e atyre objekteve, të cilat janë me qira dhe të merren në administrim nga Qeveria dhe kështu të kemi një buxhet më të mirë dhe të mos e shpërndajmë në mënyrë ndoshta klienteliste, ndoshta edhe në mënyrë keqpërdoruese dhe deri te ana e korrupsionit. Prandaj, këtu nuk kemi qenë, si duket, në nivel dhe ka nevojë një rëndësi e veçantë në këtë fushë.

Kur jemi këtu, edhe mënyra e shfrytëzimit atje në tabelorë në fakt kemi një radhitje kronologjike, e cila faktikisht edhe si metodologji i përmbushë disa nga kriteret e saj, por kur shikojmë nga ana praktike e saj na del bukur një lloj, si të themi, dekori i cili me letra duket se harmonizohet mirë, dhe faktikisht pasqyrat tabelore na dalin bukur mirë, por në praktikë çështja buxhetore është krejt diçka tjetër. Prandaj, këtu duhet të kemi kujdes.

Shih, ne jemi tash në këtë kohë kur do të duhej të bëhej rishikimi buxhetor, kurse ne kemi shpërndarje aq buxhetore, të cilat faktikisht shënojnë rritje dhe deri diku i plotësojnë standardet e shpërndarjes dhe kemi 94, 94 - 97 të shpërndarjes, që është mirë, kurse po të shikojmë si janë shpërndarë ato, këtu është problemi. Dhe tash, të shikojmë a kemi buxhet ne për rishikim. Muaji qershor, a? Gjashtëmujori si duket shpenzimet kanë qenë në atë masë të pakontrolluar, të cilat shtrohet çështja e kemi rishikim buxhetor apo jo, për arsye se s'e kemi pasur një kontroll të nivelit të duhur racional dhe këtu e kemi një çështje bukur telash.

Unë besoj se po që se me këto vërejtje e rekomandime që ka dhënë edhe Komisioni për Buxhet e Financë e që do të duhej të respektoheshin në të ardhmen, bile në mënyrë strikte të mundshme dhe sigurisht edhe me ndryshime e reforma cilësore në Ligjin për menaxhim të financave që do të duhej të ishte, do të mund të konsolidoheshim në një mënyrë dhe do të ecnim me hapa krejt tjerë të praktikës, sidomos të shpërndarjes së buxhetit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Shemi Syla e ka fjalën.

**SHEMSI SYLA:** Përshëndetje, zoti drejtues!

Të nderuar deputetë,

Vërtet kur shfleton këtë raport të Buxhetit është aq voluminoz, aq i krijuar me shifra dhe të dhëna, sa që thua se është gjithçka në rregull dhe kur sheh të metat në shumë sektorë, duhet të rikthehesh dhe ta shikosh vërtet si është miratuar, por edhe çfarë mund të thuash. Meqë, nuk jam specialist i kësaj fushe do të drejtohesha pak tek buxheti që i dedikohet forcës së sigurisë, aty ku Qeveria e Kosovës në të gjitha deklaratimet e saj mbetet që të ketë prioritet këtë sektor, që nga Qeveria Thaçi, Mustafa, tani Haradinaj, përkundër faktit që nuk ka as më të voglin argument që FSK do të bëhet ushtri.



Gjithë ato projekte nga viti 2012, kur ka filluar të flitet për transformim, nuk u realizuan as në vitin 2018. Mungesa e buxhetit por edhe shkurtimi i tij bëri që të mos bëhet kurrë FSK-ja funksionale dhe e pajisur me pajisje adekuate. Falë donacioneve të vendeve mike FSK-ja mbijetoi dhe falë përkushtimit të ushtarëve, të moralit të tyre dhe të oficerëve. Në kundërshtim të dështimit të lidërsipit të FSK-së nuk u tregua profesionalizëm dhe gatishmëri në realizimin e këtyre synimeve. Udhëheqja e dobët me kuadro ishte degraduese. Zgjatja e transformimit ka zbehur moralin tek ushtarët në FSK, gradimi pa kritere, e tjera, e tjera...

Por, mbi të gjitha, një raport që del nga auditimi sheh planifikim dhe menaxhim të dobët të buxhetit. Në raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, i cili ka ekzaminuar pasqyrën financiare vjetore të Ministrisë së FSK-së është identifikuar cilësi e ulët e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës. Cilësia e ulët menaxheriale dhe planifikimi i dobët kryesisht janë identifikuar në menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pajisjes dhe detyrimet.

Për shembull, të gjeturat janë shumë interesante të cilat e mohojnë krejt atë që është thënë në këtë raport, se gjithçka është në rregull dhe kështu, bazuar në tabelën për shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike, në kategorinë e investimeve kapitale është identifikuar parregullsi në planifikimin e Buxhetit fillestar dhe final. Nëse i shohim lëvizjet e buxhetit në këtë kategori në mes të buxhetit fillestar 18 580 000 dhe atij final 4 090 177 shohim se kjo kategori ishte reduktuar për 14 489, për më tepër dinamika e shpenzimit të buxhetit nuk ishte në harmoni të plotë me planin e rrjedhës së parasë, pasi që 50% e buxhetit për investime kapitale ishin shpenzuar në tremujorin e fundit. Dhe kjo, merre me mend, flet për një rrezik eventual që do t'i bëhej performancës së përgjithshme të Ministrisë së FSK-së.

Më tutje, shpenzimi i Buxhetit në fund të vitit ndikon në rrjedhën e vëllimit të punës dhe rrjedhimisht rrit mundësinë që pagesa të caktuara t'u ikin kontrolleve adekuate dhe mund të pasojnë me lëshime apo gabime të mundshme.

E gjithë kjo flet për një periudhë të një raporti, me të cilin paraqitet sikur gjendja është nën kontroll dhe krejt në rregull me shpenzimet e Buxhetit, sidomos në nivel qeveritar. Ndërkohë, ky raport ka brenda dy Qeveri, Mustafa dhe ajo Haradinaj. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Vazhdojmë me pikën e dhjetë, në qoftë se nuk thonë propozuesit, qoftë ministri, qoftë propozuesi... që është:

## **10. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017**

Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017 dhe Kuvendit i rekomandon për miratim.

Edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim.

Zoti Haradinaj nuk është këtu. A e ka autorizuar dikë? Zonja Gaxherri atëherë. Ftoj Zonjën Gaxherri që në emër të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, ta bëjë arsyetimin e raportit të komisionit.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti ministër,

Ashtu siç e thatë ju, zoti kryesues, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar raportin vjetor nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve memorialë të Kosovës për vitin 2017 dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë këtë raport.

Komisioni pas shqyrtimit të raportit në fjalë vlerësoi se i plotëson kushtet e parapara për të miratuar, nga se paraqet gjendjen reale të gjendjes dhe mënyrës së menaxhimit. Ndaj, komisioni rekomandoi miratim, përkundër vështirësive të cilat do të eliminohen me përmirësimin e gjendjes në këtë autoritet. Pra, ne i rekomandojmë Kuvendit të aprovojë raportin, ani pse vërtet gjendja në këtë fushë është shumë e rënduar.

Zoti kryesues, a bën ta marr fjalën edhe në emër të grupit parlamentar apo... OK, faleminderit!

Atëherë, edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017.

Siç e dimë, Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës është themeluar në vitin 2013 dhe në bazë të ligjit Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë është institucion i pavarur që merret me planifikimin, projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e komplekseve memorialë të Kosovës. Agjencia për punën e vet i raporton njëherë në vit Kuvendit për mes komisionit adekuat. Në bazë të ligjit, agjencia mbikëqyrë, përkujdeset, menaxhon aktivitetet e ndryshme lidhur me komplekset memorialë. Agjencia bën mbrojtjen konservimin, restaurimin, ruajtjen dhe promovimin sipas legjislacionit në fuqi.

Këto i thashë për të pasur parasysh se neglizhenca e qeverive, agjencisë dhe konkretisht Ministrisë së Ambientit që nuk janë bartur të gjitha projektet, financat dhe përgjegjësitë agjencisë në fjalë për menaxhimin e komplekseve memorialë, bën që kjo agjenci të jetë në një kaos total.

Në bazë të raportit shohim, se buxheti fillestar për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë për vitin 2017 është 3 911 878 euro. Buxheti me rishikim të vitit 2017 është 2 841 878 euro, ndërsa buxheti final prapë në fund të vitit është 3 232 838 euro. Buxheti total i shpenzuar gjatë vitit 2017 është 3 175 882 euro, ku prej tyre për paga janë 86 600 euro, për mallra dhe shërbime janë 53 351 euro, për shpenzime komunale janë 30 000 euro dhe 3 005 930 euro për shpenzime kapitale.

Ndarja finale e buxhetit ka ndryshuar për shkak të vendimit të Qeverisë, pra që është marrë me datë 11. 12. 2017 për tërheqjen e mjeteve të lira, pra nuk janë ekzekutuar transferimet e mjeteve dhe shtimit të mjeteve, pra buxheti fillestar për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve për vitin 2017 ishte 3 911 878 euro. Buxheti dhe rishikimi buxhetor pra në 2017 ishte në 2 841 878 euro, ndërsa ai final 3 231 838 euro.

Dua të ndalem më shumë tek paraqitja e investimeve kapitale. Paraqitja e projekteve kapitale në këtë raport është krejtësisht i pakuptueshëm. Në po të njëjtin raport thuhet, se për vitin 2017 në investimet kapitale janë shpenzuar 3 593 000 euro, ndërsa në këtë tabelë në total pasqyrohen 7 187 213 euro. Për ta sqaruar këtë moskorrektësi të raportit apo raporti që nuk është i hartuar mirë, kemi edhe të gjeturat e auditorit. Nëse kalojmë tek aktivitetet për periudhën raportuese për vitin 2017, unë për të mos marrë kohë po i lexoj, janë diku afër 40 projekte dhe për çudi të gjitha këto projekte janë të ndara në Prekaz (ritenderim), Podujevë, Vrellë, Kleçkë, Divjakë, Vushtrri, duhet ta keni parasysh ta përcjellim që të gjithë, domethënë do t'i lexoj vendet, ndërsa do t'i shihni komunat që nuk kanë asnjë projekt, Vushtrri, Gjakovë, Prekaz, prapë Skenderaj, Marinë, Skenderaj, Penuhë, Podujevë, Vrellë, Istog, Drenas, Prekaz, Skenderaj, Reçak, Shtime, Kleçkë dhe Divjakë, Malet e Berishës, Koshare, Reçak, Shtime, Meje Gjakovë, Reçicë Podujevë, kemi prapë Reçak Shtime, Likoshan Drenas, Prekaz Skenderaj, dhe prapë Istog Vrellë, si dhe në Penuhë prapë Podujevë.

Kolegë të nderuar

Në bazë të këtij raporti që për mua është krejtësisht i paqartë, domethënë nuk është i kompletuar, ne shohim se në bazë të përshtypjes se për vitin 2017 edhe planifikimit për 2018 asnjë projekt për asnjë memorial në komunën e Pejës, Gjilanit dhe Ferizajt. Njëkohësisht, nuk është bërë asnjë investim për kompleksin memorial të presidentit Rugova.

Investimet në tërë Kosovën nuk janë të pasqyruara mirë dhe qartë. Duhet të theksojmë se janë ndarë shumë mjete vite me radhë për memorialët, por ne ende nuk e kemi asnjë kompleks

memorial që është në gjendje të mirë e mos të flasim për dizajnimin e tyre apo ekzekutimin e punëve, që shpesh janë fyerje për të rënit. Mirëmbajtja e tyre është si më keq.

Për të dokumentuar këtë nuk po thellohem më shumë, por disa të gjetura të auditorit e konfirmojnë se kjo agjenci nuk ka klasifikim korrekt të shpenzimeve në buxhet, në mënyrë që shpenzimet të realizohen dhe të regjistrohen në kategoritë buxhetore adekuate.

Po ashtu duhet siguruar që shpenzimet e mirëmbajtjes të mos regjistrohen në regjistrin e pasurive, pasi që ato nuk mund të trajtohen si pasuri.

Edhe këtu nuk po hyj tash t'i analizoj, por ne e shohim që edhe Auditori ia ka tërhequr vëmendjen kësaj agjencie që vërtet financat t'i pasqyrojë më mirë dhe të jenë më korrekt.

Unë konsideroj se është koha urgjente që Qeveria dhe Ministria e Ambientit duhet t'i bartë sa më shpejt të gjitha kompetencat agjencisë dhe pastaj ne të kemi më lehtë që të kërkojmë përgjegjësi te kjo agjenci sa u përket memorialëve dhe komplekseve memorialë në Republikën e Kosovës.

Ne jemi të gjithë dëshmitarë se vërtet në këtë fushë ka shumë për të bërë dhe natyrisht unë konsideroj se ndoshta është koha që ne si Komision për Bujqësi dhe Zhvillim Rural ose ne ta formojmë një komision që të dalim në terren të shohim, ose ndoshta është koha që edhe në Kuvend të ngremë një komision hetimor rreth shpenzimeve për komplekset memorialë në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputete! Tani e ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku, për arsyetimin e raportit me rekomandime në lidhje me raportin vjetor financiar. Urdhëroni, deputet!

**LUMIR ABDIXHIKU:** Faleminderit, kryesuese!

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 6.6.2018, pasi që e shqyrtoi raportin vjetor financiar të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017 dhe vlerësoi se i njëjti i përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe të njëjtin i rekomandoi Kuvendit për miratim. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit! Fjalën e ka Ganimete Musliu, nga Partia Demokratike e Kosovës. Urdhëro, Ganimete!

**GANIMETE MUSLIU:** Faleminderit, e nderuar nënkryetare!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Sot kur po shqyrtoj raportin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës, më lejoni që fillimisht të përshëndes fillimin e aksionit për rivarrosjen e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga Kodra e Polacit në Kompleksin Memorial të UÇK-së në Marinë të Skenderajt.

E di që ky proces është i dhimbshëm për familjet dhe më të dashurit e tyre, por është e domosdoshme që përfundimisht dëshmorët të kenë një varr të dinjitetshëm me përkujdesje shtetërore, ku familjet e tyre do ta kenë vetëm dhimbjen dhe mallin për ta, e jo të dëshpërohen e të zhgënjehen sa herë që i vizitojnë dhe i përkujtojnë.

Është e dhimbshme, po njëkohësisht edhe shumë e turpshme që kemi pritur kaq gjatë për këtë proces. Po një fjalë e urtë thotë: "Më mirë vonë se kurrë", prandaj uroj që ky proces të përfundojë me sukses dhe dinjitet.

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Siç kam thënë edhe në mandatin e kaluar, raportet e agjencive të pavarura që shqyrtohen dhe votohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës për mua vazhdojnë të jenë dokumentet më të pakuptimta që ne i shqyrtojmë dhe i miratojmë në këtë Kuvend.

Për të vërtetuar pakuptimësinë e këtyre raporteve dua ta bëj një pyetje: çka ndodh nëse një raport i cilësdo agjenci nuk miratohet në këtë Kuvend? Thjesht, përgjigjja është se nuk ndodh asgjë.

Agjencia në fjalë vazhdon punën dhe ndaj menaxhmentit nuk merret asnjë masë, përkundrazi rritet arroganca dhe keqmenaxhimi.

Tani ne po shqyrtojmë një raport të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017, i cili gjithsej i ka 29 faqe.

Nga faqja e parë deri në faqen 20 të këtij raporti flitet për misionin, vizionin, asetet që ka kjo agjenci, organo-gramin e agjencisë, dizajnin e web faqes, e gjëra të tilla, që më së paku do të duhej të zinin vend në raportet e punës për periudhën për të cilën raportohet.

Në faqen 20 të këtij raporti mund të shohim disa aktivitete që flasin për periudhën raportuese, pra për vitin 2017 dhe pastaj menjëherë në faqen tjetër paraqiten aktivitetet që janë paraparë për periudhën e vitit 2018, çka nënkupton se gjysma e aktiviteteve të vitit 2017 janë bartur si të papërfunduara në vitin 2018 dhe prej këtyre tash kur jemi në gjysmën e vitit 2018, ka aktivitete të planifikuara, të cilat ende as që kanë filluar, e lere më të gjejnë zbatim.

Ajo që bie në sy në këtë raport është në faqen e fundit të këtij raporti, ku thuhet: "Mungesa e mbështetjes së nevojshme financiare dhe mostrajtimi me kompetencë nga Qeveria e Republikës

së Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës është dhe mbetet pengesa kryesore në arritjen e objektivave të parashikuara të agjencisë”.

Si deputete në tri legjislatura, nuk e di që ndonjëherë kjo agjenci i ka drejtuar një kërkesë Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe nuk është përfillur apo nuk ka gjetur mbështetje. Përkundrazi, çdo kërkesë eventuale ose propozim që ka ardhur nga kjo agjenci u trajtua me prioritet dhe seriozitet të lartë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, pa dallim pozitë e opozitë.

Duke pasur parasysh që tash kur po diskutojmë rreth raportit të vitit 2017 drejtori i atëhershëm e ka përfunduar mandatin dhe është zgjedhur një drejtor i ri, nuk po e shoh të arsyeshme të zgjatem më shumë për diskutim. Vetëm se i propozoj drejtorit të ri që në raportin tjetër, pra në vitin 2018, të mos humbë kohë të na njoftojë përsëri për misionin, vizionin, organo-gramin e gjëra të kota, por të fokusohet në punë konkrete dhe në rezultate konkrete, sepse gjendja e memorialëve në Republikën e Kosovës është në gjendje jo të mirë dhe thjesht e pakënaqshme.

Ndërsa sa i përket votimit ose jo të këtij raporti, e potencave edhe më lart, as nuk ndryshon asgjë, si e votuam, si nuk e votuam. Prandaj, le të mbetet në vullnetin e deputetëve se si do të marrin vendim rreth këtij raporti. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputete! Fjalën e ka Shemsi Sylja. Urdhëro!

**SHEMSI SYLA:** Përshëndetje, zonja drejtuese,

Deputetë të nderuar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Një raport që kishim në duar rreth memorialëve vërtet është voluminoz, ka shumë të dhëna, të cilat unë mendoj se nuk i përkasin fushës për të cilën edhe është kjo agjenci.

Pajtohem me delegatën parafolëse, e cila dha vërejtje se vërtet shumë shifra, shumë fakte janë dhënë jashtë fushës me të cilën është dashur të merrej kjo agjenci.

Dhe, duke u bazuar nga këto që nuk ka pasur në fokus esencën për të cilën është dashur të raportohet, unë kam bërë një fjalim, me të cilën kam vënë në spikamë të metat e mëdha që janë rreth ruajtjes së asaj më të shenjtës, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Pas përfundimit të luftës çlirimtare në Kosovë u paraqitën një serë paradoksesh. Shumica prej tyre dukej qartë se janë pjesë e projekteve të përpunuara më herët. Plot prej përgjegjësve institucionalë u bënë pjesë të tyre ose u nënshtruan, edhe pse ishin të vetëdijshëm për pasojat.

Duke u nisur nga administrata e UNMIK-ut dhe jo vetëm, çdo ditë kishte përpjekje që lufta e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës të zhbëhej deri në mospërfillje.

Prej një lufte çlirimtare gjithë protokollit shtetëror, bashkë me të gjitha shënimet zyrtare kudo u kthyen vetëm në një 'konflikt të armatosur'.

Mjerisht udhëheqësit tanë nuk u treguan të kujdesshëm dhe të vendosur që atë UÇK-në që gjatë luftës e pranoi dhe e çmoi gjithë bota demokratike, në rrethana shumë më të lehta, në kohë paqe, vlera dhe kontributi i saj u relativizua si një 'konflikt i momentit'.

Kështu duke qenë fitimtarë pranuan demobilizimin dhe çarmatosjen e UÇK-së, që ishte edhe fillimi i një përbuzjeje, të cilën fatkeqësisht nuk e parandaluan, edhe pse ishim guerilja më e suksesshme në luftë.

Paradoksi vazhdonte me tendencën e distancimit sikur UÇK-ja ishte kundër Kosovës dhe lirisë së saj.

Shpeshherë në faza të ndryshme u shkua edhe më lart, sa që kur krijoheshin institucionet, si ishte TMK, Policia e Kosovës dhe FSK, nuk ishte e preferuar që brenda tyre të kishte UÇK, madje as shenjat e saj. Përpjekja ka qenë qartë shlyerja e gjurmëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si institucion i rezistencës së armatosur dhe trashëgimia e saj institucionale.

Kjo shpjegon edhe pse sot nuk e kemi muzeun e luftës dhe pse nuk kemi askund uniformën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, flamurin që ka mbajtur, stemën në uniformë, pra nuk i kemi askund të ekspozuara në institucionet e Kosovës.

Edhe ato përmendore, shtatore e varreza që janë ngritur nga populli, e pak nga institucionet, nga moskujdesi janë degraduar në masë të përbuzjes, ato duken sikur të jenë ngritur para një shekulli dhe sikur këto troje të ishin nën robëri, e jo në liri.

Nga aspekti i trajtimit institucional të pasluftës gjurmët e një pjese që kanë lënë të rënë në luftën e fundit në Kosovë me armë dhe me ekspozate të tjera, edhe pse ruhen në një sektor të themeluar në Muzeun e Kosovës, në asnjë mënyrë nuk i plotësojnë as minimumin e asaj që do të duhej të ishte.

Mungesa e një muzeu të luftës së UÇK-së që do të trajtonte këtë periudhë historike të krenarisë, lavdisë dhe sakrificës, fatkeqësisht është një dëshmi e mospërfilljes dhe anashkalimit institucional që i bëhet historisë më të lavdishme të popullit tonë.

Nuk ka asgjë më zhgënjyese kur edhe sot pas 19 vjetëve të mbarimit të luftës asnjë qeveri deri më tani lëre që nuk bëri një gjë të tillë, por si duket as që ka në plan të bëjë.

Që nga viti 2010 nisma për muzeun e luftës të UÇK-së në FSK ka ngecur, armët dhe eksponatet e tjera nuk dihet se ku mbahen, janë apo ndoshta janë tretur, nuk di askush. Kështu po kryhet misioni, në FSK nuk duhet të ketë gjurmë të trashëgimisë, fatkeqësisht kështu duhet bërë shlyerja e memories historike të një lufte çlirimtare.

Ky shtet e kjo shoqëri po bën një padrejtësi të madhe në këtë indiferencë ndaj këtij fenomeni të mosinteresimit deri në mohim të luftës së vërtetë.

Nuk e di nëse ka ndonjë rast në botë ku lejohet çdo ditë të fshihen faktet dhe argumentet materiale të vërtetësisë të një lufte të tmerrshme e gjenocidit fashist të ushtruar ndaj popullit të paarmatosur.

Për të treguar se në një vend ka ndodhur kjo e keqe, dihet se ai vend duhet ruajtur dhe konservuar gjithçka nga ajo që ka ndodhur në hapësira të burgut, për shembull, siç është Burgu i Dubravës.

Në vend që të shpallim muze dhe të konservoheshin të gjitha ato gjurmë të vrasjes dhe ekzekutimeve klasike ndaj pengjeve shqiptare, aty u veprua në drejtim të kundërt.

U zhdukën të gjitha gjurmët sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

Tani nëse vendos ta vizitosh atë vend dhe atë vetëm një herë në vit, me leje të veçantë, nuk mund të shihet asgjë si dëshmi materiale se aty kishte kamp përqendrimi, ku ishin ekzekutuar më shumë se 120 shqiptarë dhe ishin plagosur mbi 200 të tjerë.

Vendimi për të kthyer ai vend në një burg aktiv, duke mbuluar të gjitha gjurmët, lirisht mund të quhet një vrasje e dytë ndaj të gjithë atyre që mbetën aty, atyre që shpëtuan dhe familjeve të tyre, duke kujtuar kujtesën historike.

Tani, nëse faji mbetet gjithmonë jetim, por një gjë është e sigurt: fajin më të madh e kanë ata që kanë mandatin e qeverisjes që ndaj kësaj çështje të sillen më me përgjegjësi dhe jo të flasin dhe të kujtojnë vetëm në fushata elektorale me premtime dhe fraza patriotike për të mbledhur ndonjë votë.

Nëse ajo fazë ku është dashur të jemi më syçelë dhe të ruanim gjurmët e vuajtjeve tona të kaluara, kjo nuk na amnistion që me akte ligjore t'i trajtojmë rastet sot.

Nëse Qeveria e Kosovës dhe Parlamenti do të sponsorizonin një ligj, i cili masakrën e Dubravës do ta trajtonte ashtu siç ishte, pra kamp të përqendrimit dhe të gjithë të mbijetuarit dhe atyre që u masakruan aty do t'u njihej statusi i veçantë si të mbijetuar, kujtesës sonë historike dhe brezave



që do të vinin pas nesh nuk do t'ju hynim në hak, por do t'ua tregonim të vërtetën, e cila kam frikë se kështu si po shkon do të harrohet bashkë me këtë brez që po jetojmë.

Nëse nuk kujdesemi për të shënuar historinë tonë dhe luftën çlirimtare të Kosovës, nga kush e presim që të bëhet kjo detyrë?

Shënimi në mënyrë shkencore i ngjarjeve historike të 20 vjetëve më parë është përgjegjësi tepër e madhe morale, politike e ligjore për t'u bërë.

Jemi vonuar tashmë 19 vjet nga çlirimi dhe 10 vjet nga shpallja e pavarësisë. Tanimë nuk ka më justifikim, as fshehje pas ndërkombëtarit të radhës që kalon këndeje.

Ju që keni qeverisur deri më tash keni dëshmuar me prova gjithë këto vite që nuk dini as nuk doni të vendosni UÇK-në dhe luftën tonë aty ku e ka vendin.

Andaj, memorialët sot kudo nëpër Kosovë e kanë një pamje dhe ajo pamje është e fytyrës suaj, pra të shpërfytyruar. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Para vetes e kemi një raport të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë, i cili është bukur voluminoz.

Në fakt, edhe pse raporti përmbush obligimet ligjore, por kjo është vetëm njëra anë e medaljes, ndërsa ana tjetër është që kjo agjenci prej themelimit e deri në vitin 2017 është përballur vazhdimisht me probleme sa u përket kompetencave që atij ia përcakton Kuvendi dhe pjesërisht kompetencave të cilat i janë marrë nga ministrinë e ndryshme. Pra, një problem i cili deri më tani nuk është zgjidhur dhe shpresoj të zgjidhet gjatë vitit 2018 me drejtuesin e ri të kësaj agjencie.

Themelore mendoj është që po shihet që deri tani nuk ka pasur një trajtim dinjitoz të memorialëve në Kosovë, duke e pasur parasysh që është treguar një përkushtim shumë i vogël për vlerat tona historike, gjë që është detyrë e kësaj agjencie, e me planifikimin e saj, me veprimet që ka ndërmarrë dhe në përgjithësi me planin menaxhues është treguar që pikërisht ky trajtim ka qenë jodinjitoz dhe nuk është në mbështetje të vlerave dhe funksionit për të cilin është krijuar ky kompleks memorial.

Ajo që bie në sy është shpërndarja e mjeteve për të cilat janë vënë në dispozicion nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke përjashtuar këtu jo vetëm Ferizajn, po edhe Pejën, e kështu me radhë. Mendoj që kjo nuk është e drejtë, prandaj në të ardhmen sa i përket planifikimit të agjencisë duhet të ketë parasysh edhe këtë ndarje.

Pra, në kuptimin formal raporti përmbush obligimet ligjore, ndërsa po mendoj që mbetet që secili deputet pastaj, duke pasur parasysh funksionin që ka kjo agjenci të vendosë vetë nëse do ta mbështesë apo do ta kundërshtojë miratimin e tij. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Shkumbin Demaliaj e ka fjalën. Nuk është këtu. Atëherë, zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar Xhavit Haliti!

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht dua të falënderoj kryetarin e Komunës së Skenderajt, zotin Bekim Jashari, i cili prej marrjes së detyrës së tij ka insistuar që varrezat e dëshmorëve në Polac të zhvendosen aty ku ka qenë e planifikuar tani e 19 vjet, në Kompleksin e Dëshmorëve në Marinë të Skenderajt.

Pra, po e filloj me falënderimin për kryetarin dhe insistimin e tij, zotit Bekim Jashari, sepse u deshën që 19 vjet pas luftës në udhëheqje të vijë i biri i heroit Hamzë Jashari dhe ai të insistojë që një çështje që ka qenë kompetencë ligjore dhe detyrim ligjor i dikujt tjetër, të zgjidhet me insistimin e Bekim Jasharit, i cili e ka pasur edhe përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të cilët i falënderoj, por që ka qenë një neglizhencë totale e Agjencisë për Komplekse Memorialë, sepse disa herë, edhe këtu në Kuvend e kam paraqitur si një vërejtje, sepse përveç që sot është e dhimbshme, por edhe krenare, për familjet e dëshmorëve që eshtrat e më të dashurve të tyre, dëshmorëve, të vendosen në Kompleksin Memorial në Morinë, sigurisht që më e dhimbshme ka qenë që ata për 19 vjet të shkojnë në Polac dhe të bëjnë homazhe pranë varrezave, të cilat nuk kanë qenë të trajtuara në mënyrën meritore se si do të duhej të ishte.

Disa herë këtu në Kuvend, në çdo raportim të Agjencisë për Komplekse Memorialë, ka ngritur shqetësimin sepse jo vetëm varrezat në Polac, po anekënd Kosovës komplekset memorialë, përmendoret e dëshmorëve kanë qenë të trajtuara jo mirë dhe jo në mënyrë meritore dhe kemi qenë të pakënaqur, sepse edhe si Parlament, mendoj edhe si Qeveri, kemi qenë të gatshëm që në aspektin buxhetor të përmbushim të gjitha kërkesat dhe detyrimet, të cilat do të duhej t'i bënim që vërtet trajtimi i komplekseve memorialë, përmendoreve dhe objekteve të tjera të veçanta të luftës së fundit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të jenë të trajtuara në mënyrë meritore.

Ju e dini që këtu edhe në mandatin e kaluar, gjithashtu edhe në trajtimin e buxhetit kam kërkuar mjete për ruajtjen dhe konservimin e kompleksit të Jasharajve, sepse shtëpitë muze të Jasharajve rrezikohen të rrënohen dhe u desh një sensibilizim i përgjithshëm edhe i Parlamentit, edhe i

shoqërisë civile që vërtet të fillohet me iniciativën për restaurimin dhe konservimin e shtëpive muze në lagjen Jasharaj.

Dhe as nuk duhet të merren me kritika të raportit, e as me të çka ka ndodhur në të kaluarën, sepse unë mendoj që objektivat tona duhet të jenë përpara, me një vizion të qartë.

Edhe në njërin nga diskutimet e mia të kaluarën e kam propozuar dhe po e përsëris.

Parlamenti i Republikës së Kosovës nga analiza e këtij raporti duhet të nxjerrë disa rekomandime, e unë mendoj që një nga rekomandimet e para është që të themelohet Agjencia për vlerat e luftës, i cili do të kishte disa drejtori.

Duke filluar nga Drejtoria për familjet e dëshmorëve, Drejtoria e invalidëve të luftës, Drejtoria e veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Drejtoria e civilëve të vrarë dhe të plagosur gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Drejtoria e të zhdukurve, Drejtoria e grave të dhunuara dhe Drejtoria e infrastrukturës, e cila pastaj do të merrej me mirëmbajtjen dhe menaxhimin e komplekseve memorialë dhe objekteve të rëndësisë së veçantë nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kështu ne do largonim këta sektorë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila shpeshherë di të jetë pjesë e kalkulimeve të ndryshme politike dhe ne me themelimin e Agjencisë për vlerat e luftës, do të kishim mundësi që si Parlament vërtet të monitoronim dhe t'i japim hapësirë pa ndikime politike trajtimit të kërkesave dhe nevojave të të gjitha kategorive të dala nga lufta.

Mendoj që është një objektivi yni që duhet të arrihen në të ardhmen dhe që kemi pasur raste që shpeshherë ka ndodhur që kjo ministri të udhëhiqet edhe nga minoritetet dhe nuk ka qenë shumë e pranueshme prej këtyre kategorive që vërtet kërkesat e tyre pastaj t'i adresojnë aty ku mendoj që ka mundësi që ne ta rregullojmë në mënyrë shumë më objektive.

Dhe krejt në fund, derisa jemi këtu pranë Kuvendit duke bërë investime në rregullimin e një sheshi, i cili do të duhej të ishte sheshi "Adem Jashari", dhe ajo përmendorja e kohës së komunizmit do të duhej të vendosej me përmendoren e heroit kombëtar Adem Jashari. Është turp, ama bash turp për kryeqytetin e Republikës së Kosovës që 19 vjet pas lufte të mos e ketë një përmendore të Adem Jasharit këtu, e për cilat vlera dhe për cilën agjenci çka mund të trajtojmë ne më shumë, përderisa mungon përmendorja e Adem Jasharit, dhe këtu ka pasur në të kaluarën shtyrje ndërmjet subjekteve politike, ato që e kanë udhëhequr Komunën e Prishtinës dhe Qeverisë, e unë mendoj që këto shtyrje do të duhej të ishin në aspektin pozitiv se cila më përpara do të insistonte ta ketë një projekt më të mirë për përmendoren Adem Jasharit në Prishtinë, e jo për një metër pronësi, apo një metër e gjysmë pronësi, sepse asnjëri nga ne nuk do

të arrinte të jetë në këto ulëse ku jemi sot pa luftën heroike dhe sakrificën e Familjes Jashari dhe dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Gani Dreshaj.

GANI DRESHAJ: Ju përshëndes nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë s'e kam ndërmend në këtë fjalë të shkurtër që dua të flas ta zgjas shumë për ta marrë ndonjë votë edhe këtu, por unë mendoj se këtu më së paku duhet ta rruhdhë dorën Qeveria e Kosovës, ose shteti i Kosovës për memorialë.

Dhe, më vjen keq prej disa deputetëve që bën vaki s'kanë qenë te memoriali hiç, e i akuzojnë njerëzit për keqpërdorim, shumica edhe s'e kanë lexuar materialin. Pas 20 vjetëve, edhe në Istog është dashur të jetë një memorial... I kemi 52 dëshmorë, të cilët e meritojnë. Lus deputetët, normalisht që duhet të përfundojë dhe të mirëmbahet te Jasharët. Është prioritet i Kosovës. Por, edhe në Glllogjan shteti duhet ta shtrijë shteti dorën. Dje kemi qenë në të pame të gjithë, mua nuk më është dukur qysh duhet vendi, ku është mbajtur e pamja për bacën Hilmi. Këtu do ta kisha bërë edhe një kërkesë. Ne e kemi përmendoren e Presidentit Rugova në Istog, nëse familja është e pajtimit, kisha dashur që Istogu, aty e kemi edhe një përmendore tjetër të ushtarëve të UÇK-së, që të hyjë në Agjencinë e Menaxhimit të Komplekseve Memorialë, dhe përmendorja e Presidentit Rugova, le të përfundojë një herë e përgjithmonë. Kaq kisha. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Saranda, a je paraqitur, apo të ka mbetur prej më herët? Atëherë, zonja Bogujevci e ka fjalën.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryesues!

Sa i përket raportit, në fakt unë nuk dua të ndërlihem me të dhënat që janë në raport, por me aspektin e memorialëve. Në raport thuhet që vizioni i Agjencisë është kompletimi dhe funksionimi i Agjencisë, angazhimi në ngritjen dhe funksionalizimin e komplekseve memorialë në mënyrë dhe në funksion të shtimit të numrit të vizitorëve.

Domethënë, në çfarë forme janë duke u bërë memorialët në Kosovë? Çfarë historie tregojnë, qoftë për qytetarët e vendit, por qoftë edhe për vizitorët e huaj. Domethënë, si jemi duke e dokumentuar historinë e vendit nëpërmjet këtyre memorialëve, kjo mendoj që është shumë me rëndësi. Para se të merret vendim se si do të duken memorialët duhet të bëhet diskutim, planifikim, mendim, hulumtim rreth mënyrës se si duhet të realizohen këta memorialë. Tjetra është që duhet të ruhet kujtesa kolektive brenda institucioneve. Dua ta marr një shembull sa u përket viktimave të luftës, po kjo njëjtë lidhet edhe me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, qoftë i referohet në emër të individit, apo në emër të familjes. Domethënë, kur shkon në Podujevë, askush nuk flet si raste të vendit që kanë ndodhur, por flitet si rast i një familje apo tjetrës. Dhe, mendoj që kjo është gabim dhe duhet të punohet që të njihen të gjithë ata që kanë

kontribuar për luftën e fundit, të njihen si kujtesë kolektive brenda institucioneve. Kemi shembuj nga e gjithë bota shembuj për mënyrën sesi janë realizuar komplekset memorialë dhe historinë që e tregojnë. Dhe, mendoj që duhet të punojmë në atë drejtim siç e përmenda edhe më herët, domethënë të diskutohet, të bëhet planifikim, të mendohet mirë dhe të bëhet hulumtim, meqë më ka ndodhur në shumë raste kur unë kam vizituar komplekse memorialë, por nuk kam arrit në fakt ta kuptoj historinë rreth ngjarjes që ka ndodhur.

E kemi shembull Sarajevën, ku është memoriali për fëmijët, ku janë të konservuara pjesë të qytetit ku kanë ndodhur ngjarje të ndryshme, e ku mëson shumë rreth asaj se çfarë ka ndodhur në atë vend. Kështu që unë mendoj që është shumë me rëndësi të mendojmë rreth memorialëve në këtë mënyrë. Tjetra, mendoj që Agjencia është pjesë e komisionit të gabuar, domethënë komisionit parlamentar, e kjo mendoj që hynë në pjesën e trashëgimisë dhe duhet të jetë në komisionin përkatës, u ruhet historia dhe trashëgimia e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arbër Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Përshëndetje,

Të nderuar qytetarë,

Mendoj që memorialët duhet ta shprehin dhe historinë tonë kombëtare dhe atë ta ravijëzuar historikisht nga dita në ditë deri në historinë më të re të Kosovës.

Në Kosovë, në territorin e Republikës së Kosovës, përkatësisht ngado që të shkosh ke memorialë, ke buste dhe ke histori të trasuar në mënyrë individuale. Ajo çka mendoj se do të duhej të mendohej si koncept dhe si ide është edhe kjo historia jonë kolektive e dëshmorëve tanë të kombit, e siç është rasti në Shqipëri edhe të dëshmorit të panjohur. Historia jonë kombëtare mban mend dëshmorë e martirë, komplekse memorialë të dëshmorëve dhe të martirëve, mirëpo kur i shikon ato e sheh që mungojnë edhe koncepti dhe ideja, sepse fundja legjendat mungojnë dhe përbrenda saj pa e pasur idenë e një historie paraprake të ngjarjes çfarë ka ndodhur, një vizitor i cili nuk e ka informacion të duhur rreth një kompleksi memorial, nuk do të dinte ta shpjegonte se çfarë në atë moment edhe po sheh. Prandaj, mendoj që do të duhej të ri konceptohet komplet çështja e ideve të memorialëve dhe për këtë bota ka shumë, e po ashtu është mirë që të shohim edhe në vendin tonë fqinj, pra Shqipërinë, sepse aty ka ca komplekse memorialë, të cilat të japin idenë e një lloj kolektivizmi kombëtar. Sigurisht që kemi dëshmorët, martirët dhe për çdo të rënë, mirëpo luftërat janë bërë në mënyrë kolektive dhe në mënyrë popullore. Populli i Kosovës e ka çliruar vetveten dhe mendoj që kjo ideja e kolektivitetit do të duhej që të vendosej, qoftë në memorialë martirësh, qoftë në memorialë dëshmorësh.

Dhe, se sa më shumë që të kemi memorialë që e përkuqtojnë historinë tonë në etapa të caktuara do të ishte më mirë, paçka që sigurisht edhe dëshmorët individualë e kanë vlerën e tyre, i kanë historitë e tyre, e kanë konceptin mbi të cilën janë angazhuar nëpër kohë me vullnetin e plotë për

liri e demokraci, por do të ishte mirë që tash e tutje, meqenëse janë kryer pothuajse të gjitha veprimet në kohë e hapësirë për luftën e fundit çlirimtare, do të duhej që ne ta rikonceptonim komplet idenë e memorialëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Është mirë që më në fund Kosova, edhe pse vonë e ka një ligj, që është Ligji për përkujdesen ndaj memorialëve dhe secili memorial e ka rëndësinë e veçantë, cilado qoftë lufta që është bërë, sepse faktikisht kjo po përfshin memorialët që kanë të bëjnë me luftën e fundit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ne e dimë se deri sot shumica e memorialëve janë bërë me investime private, ose me investime shoqërore, ose në fakt ka qenë që vetë familjarët kanë investuar për ngritjen e një memoriali për familjarin e tyre dëshmor ose hero, dhe kjo vërtet s'ka qenë e drejtë, sepse Kosova ka pasur borxh ndaj heronjve dhe ndaj dëshmorëve, sepse ata nuk kanë rënë për interesa familjare, por kanë rënë për interesa të kombit dhe të shtetit. Dhe, falë përkushtimit dhe sakrificës së dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ne sot e gëzojmë këtë liri, të cilën sot po e gëzojmë.

Është mirë që u bë një ligj dhe ligji duhet të zbatohet në tërësi. Ne para një apo dy seancave e kemi zgjedhur edhe kryesimin se kush do të kryesojë me këtë dhe besoj që ata do të jenë në nivel të detyrës. Ka shkuar një kohë e gjatë derisa është amendamentuar, derisa është përshtatur, derisa më në fund është votuar në Kuvendin e Kosovës dhe unë mendoj që kjo agjenci duhet të përkujdeset për secilin memorial, në cilëndo pjesë qoftë, qoftë për heronjtë, qoftë për dëshmorët, për viktimat civile, ta mendojmë Masakrën e Mejës, për të cilën është ndarë një buxhet, ndërsa deri sot ende kanë ngelur ashtu veç gurthemet dhe është punuar shumë pak, por shpresojmë që në përvjetorin e tjetër të Masakrës së Mejës dhe për masakrën në Lybeniq, dhe masakrat e tjera anekënd Kosovës, të përfundojnë në afatin sa më të shpejtë, sepse është edhe njëfarë rehabilitimi për familjarët e dëshmorëve dhe të familjarëve të viktimave civile, sepse shihet që dora e shtetit po e respekton sakrificën dhe mundin e gjithë atyre që kanë kontribuar për lirinë e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ali Lajçi e ka fjalën.

ALI LAJÇI: Shkurt, ne e kishim në dëgjim drejtorin e komplekseve memorialë, i cili i paraqiti edhe vetë shqetësimet e tij gjatë punës për mungesën e stafit, për mundësinë e buxhetit gjithnjë e më të favorshëm, e që ai ankohej dhe dukej se ishte ashtu, por një realitet tjetër është shumë i qartë. Sot e kemi pra një hero kombëtar Adem Jasharin, të cilin grupet e klanet tjera shpesh disa e konsiderojnë si të vetin rajonal, regjional, madje të katundit e tjera, dhe nuk e ka një monument.

Shikoni, ne ishim dhe çdo kush në Prekaz e di çka kemi, e di çfarë kushtesh dhe si është bërë memoriali atje, e di edhe çfarë donacionesh kanë hyrë, e dimë edhe në çfarë gjendje është sot objekti i Adem Jasharit si vlerë e rezistencës historike të armatosur, por sot nuk e kemi një monument të tij në qendër të Prishtinës, e që duhet faktikisht ta kemi atë sa më shpejt, sepse ashtu i kompletton edhe gjithnjë synimet e tij, gjithnjë dhe luftën e tij, e cila faktikisht ka qenë në nivel të Kosovës.

Prandaj, sot nuk e kemi as në Prekaz si duhet, por s'e kemi as në qendër të kryeqytetit të Republikës një monument, i cili do të ishte monument i vërtetë, me një qasje të re të një infrastrukture, e cila faktikisht do të shndriste edhe në mënyrë moderne, kurse modelet tjera të cilat ne i po i huazojmë, shpesh dhe ndërtime, teknologjia e tyre duket sa edhe pak demode, por do të duhej të kishte një kujdes të veçantë. Prandaj, propozoj që monumenti i Adem Jasharit të jetë në krye të qendrës së Prishtinës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Po vazhdojmë me pikën e 11 të rendit të ditës, nëse doni kemi edhe dy pika, që do të duhej t'i shqyrtojmë, ose po hyjmë në votim.

## **11. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017**

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar mosmiratimin e tij. Ndërsa, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, zotin Ismajl Kurteshi, për arsyetimin e raportit të Komisionit Funkcional.

**ISMAJL KURTESHI:** Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë deputetët,

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 4 dhe më 8 maj 2018, e shqyrtoi raportin e punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017 dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

### **R e k o m a n d i m**

I rekomandohet Kuvendit të mos e miratojë raportin e Punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017.

## A r s y e t i m

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore është organ i krijuar nga Kuvendi i Kosovës në bazë të Ligjit nr. 02/L-88 për trashëgimi kulturore. Komisioni, në mbledhjet e mbajtura më 4 dhe 8 maj 2018, e shqyrtoi raportin e punës të Këshillit të Kosovës për trashëgimi kulturore për vitin 2017.

Komisioni konstatoi se raporti i punës i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017 nuk e pasqyron punën dhe aktivitetet për vitin raportues, por në masë të madhe është kopje e raportit të punës të vitit paraprak.

Komisioni, pas shqyrtimit të raportit, në mënyrë unanime votoi kundër miratimit të tij dhe i rekomandon Kuvendit mosmiratimin e këtij raporti, si dhe kërkon nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore që në afat sa më të shkurtër të përgatisë dhe procedojë në Kuvend raport të detajuar për punën e Këshillit për vitin 2017. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, nënkryetar!

Ne e kemi shqyrtuar vetëm pjesën financiare dhe buxheti i ndarë për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi ka qenë 152 mijë euro, prandaj ne e kemi konsideruar në mbledhjen e mbajtur më 6. 6. 2018 se i njëjti i përmbush obligimet ligjore për pjesën financiare dhe të njëjtit ia kemi rekomanduar Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Valentina-Rexhepi, a je në emër të grupit?

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë të Republikës,

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, unë do t'i arsyetoj mangësitë e këtij raporti të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgimi.

Lidhja Demokratike e ka analizuar raportin e punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017, i cili nuk i pasqyron aktivitetet dhe nuk raporton për aktivitetet e vitit paraprak, por pothuajse është kopje e aktivitetëve të viteve paraprake. LDK-ja, pas shqyrtimit të raportit, do të votojë kundër miratimit të këtij raporti. Ne kërkojmë nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore në afat sa më të shkurtër të përgatisë dhe të procedojë në Kuvend raport të detajuar të punës së Këshillit për vitin 2017. Në këtë raport ka shumë parregullsi, ku afër katër muaj nuk ka pasur as udhëheqës ekzekutiv dhe kanë mbetur pothuajse të paangazhuar dhe të



papunë në Këshillin e Trashëgimisë së Kosovës. Dhe, në këta katër muaj derisa nuk ka pasur udhëheqës ekzekutiv, ka pasur edhe shfrytëzim të financave jo të drejta karshi kërkesave dhe buxhetit që e kanë poseduar si Këshill.

Në rekomandimin e parë të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturorë bëhet e qartë se kryetari i Këshillit duhet të sigurojë menaxhim efikas të buxhetit, bazuar në shkaqet e realizimit të ulët të buxhetit të marrë vendime përmirësuese, ndërsa performansa buxhetore monitorohet në baza të rregullta dhe të merren veprime, ku është e nevojshme.

Sipas Zyrës, ka pasur dobësi në menaxhimin e dosjeve të personelit, është gjetur kjo parregullsi tjetër në Këshill, ndërsa në vlerësimin e mirëmbajtjes së dosjeve të personelit kemi vërejtur se ka nevoja për disa përmirësime të këtyre dosjeve konform Rregullores 03/2011. Në të gjitha dosjet nuk kishte listë për përkushtimin e detyrave të punës dhe mungonte kopja e dokumentit të identifikimit dhe kartelës së llogarisë bankare. Kurse, në dy raste nuk ishte bërë vlerësimi i stafit për vitin 2017.

Rekomandimi tjetër sipas Zyrës për Këshillin është si në vijim: kryetari i Këshillit duhet të sigurojë që të gjitha dosjet e personelit të jenë të plotësuara në përputhje me legjislacionin dhe të azhurnohen me kohë.

Po ashtu, fokus i veçantë duhet t'i kushtohet vlerësimit të rregullt të stafit dhe përkushtimit të qartë të detyrave dhe përgjegjësi për të gjithë punonjësit e organizatës. Këshilli ka treguar mosefikasitet edhe në mungesën e inventarizimit, apo në regjistrimit të pasurisë.

Rekomandimi i tretë që del nga Zyra, kryetari i Këshillit duhet të sigurojë kontroll efektiv në menaxhimin e pasurive të saj nëpërmjet procesit të inventarizimit. Inventarizimi duhet të kryhet në fund të çdo viti fiskal dhe duhet të shpërbejë si mekanizëm për të konfirmuar gjendjen fizike, saktësinë, plotësinë dhe të krahasojë gjendjen me regjistrat e pasurive që mbahen në Këshill. Këshilli nuk ka marrë parasysh as rekomandimet nga dy vjetët paraprakë, për këtë arsye Zyra kishte dhënë për Këshillin edhe këtë rekomandim: kryetari i Këshillit duhet të sigurojë fillimisht përgatitjen e një plani të veprimit, ku përcaktohen saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Zbatimi duhet të monitorohet në vazhdimësi me qëllim të përmbushjes së rekomandimeve në plotësi.

Zyra ka identifikuar edhe këtë parregullsi të Këshillit - mosplotësimin e pozitave kyçe brenda Këshillit sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit, ku janë identifikuar shumë mangësi.

Në vitin 2017 ishte menaxhuar nga ushtrues detyre i udhëheqësit ekzekutiv me rotacion prej 3 muaj nga tre zyrtarë të brendshëm. Për më tutje, në periudhën gusht - tetor 2017, Këshilli kishte

mbetur pa ushtrues detyre të udhëheqësit ekzekutiv. Të gjitha aktivitetet dhe shpenzimet e planifikuara sipas Planit të punës janë pezulluar në këtë periudhë në mungesë të vendimmarrjes. Vlen të theksohet se në fillim të vitit 2018 ishte emëruar udhëheqësi ekzekutiv nga Bordi Drejtues i Këshillit dhe Këshilli nuk e kishte hartuar regjistrin e rreziqeve konform rregullave të MFK-së. Si pasojë, Këshilli kishte vepruar pa i analizuar dhe identifikuar rreziqet me të cilat mund të ballafaqohet kjo organizatë gjatë vitit.

Pra, me këto parregullsi, shkelje dhe mungesë të zbatimit të rekomandimeve nga vitet paraprake Zyra e Akreditimit, për të cilën Kuvendi i Kosovës duhet të jetë kontrollues dhe kërkues për një transparencë sa më të madhe të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, pasi parregullsitë janë bartur nga viti në vit dhe nga vitet paraprake janë pothuajse të njëjta parregullsi bazuar në raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Kuvendi i Kosovës duhet të kërkojë sqarime, hollësi të tjera të raportit të punës në mënyrë që Këshilli të mos i përsërisë këto shkelje. Nëse ne si deputetë e miratojmë sërish shpejt e shpejt këtë raport të punës për vitin 2017, ndërsa në anën tjetër Zyra raporton për një mori shkeljesh po për këtë vit për këtë Këshill, atëherë ne i amnistojmë apo i falim këto parregullsi, shkelje dhe raport jo të plotë. Ne bëjmë thirrje që Këshilli të detyrohet të ofrojë dokumente, raporte dhe detaje më të gjera për mënyrën e punës dhe rezultatet e Këshillit gjatë vitit 2017. Në të kundërtën, ne vetëm i trimërojmë dhe i bëjmë ata që të shkelin edhe më tepër dhe të mos funksionojë ky Këshill. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Nezir Çoçaj.

**NEZIR ÇOÇAJ:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë raport të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi kulturore dhe si të tillë ka paraqitur vërejtjet e veta që do të vërehen dhe do të paraqiten më poshtë.

Ne si zakonisht e kemi njëfarë sistemi që në komision raportohet nga këto trupa që i raportojnë Kuvendit të Kosovës nëpërmjet komisioneve dhe është një kornizë e paraparë që duhet të plotësohet dhe në këtë farë mënyre ne kemi plotësim të raporteve. E tha edhe kryetari i Komisionit, ne dy herë kemi pasur mbledhje për këtë raport në komision dhe nuk jemi pajtuar me shumë nga ato që i ka pasur apo janë paraqitur në këtë raport të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Ky raport është i shkurtër apo me më pak përshkrime për punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore, këtu përshkruhen ligji dhe kushtet, ndërsa për aktivitetet e këtij Këshilli është shkruar shumë shkurt. E them shkurt pasi që vetë kryetari i këtij Këshilli në raportimet që i

ka bërë në komisionin tonë ka paraqitur aktivitete dhe punë më të shumta gjatë raportimit sesa në vetë raportin e paraqitur me shkrim te ne. Në këtë raport janë paraqitur edhe vështirësitë dhe sfidat e shumta, si stafi i nevojshëm profesional, mospërfillja e këtij Këshilli dhe rastet kur programi i trashëgimisë kulturore që vjen në Kuvend, për të cilin nuk është konsultuar fare ky Këshill, apo kur e kemi rastin e studimit të fizibilitetit për trase, teleferikë, parcela banimi e tjera. Pra, me një farë mënyre janë vënë anash dhe si i tillë ky Këshill e ka pasur të pamundur t'i japë sugjerimet, vërejtjet dhe aspektin profesional lidhur me problematikat në fjalë.

Po ashtu, duhet të përmenden disa aspekte pozitive në këtë raport, sepse janë paraqitur edhe disa aktivitete në fushat, të cilat është paraparë edhe me ligj që ky Këshill të merret, siç janë fusha arkeologjike, arkitekturore, e trashëgimisë së luajtshme, peizazhet e natyrës, trashëgimia shpirtërore e tjerë. Po ashtu, duhet të ceket se gjatë mandatit të fundit të këtij Këshilli janë hartuar edhe rregullore të punës, sidomos ajo Rregullorja financiare që e ka përmirësuar aspektin financiar të këtij këshilli, duke e pasur parasysh se në të kaluarën kjo Rregullore s'ka qenë fare dhe ka pasur parregullsi të mëdha në rrogat dhe mëditjet e anëtarëve të Këshillit dhe të vetë stafit administrativ.

Po ashtu, duhet theksuar se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2017 ka rritje të buxhetit për 30%, që është për inkurajim e shpresoj që do të ketë një rritje edhe të vetë Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Por, ajo që dua ta them në fund është kërkesa e drejtuar vetë Kuvendit të Kosovës që të mbështetet më shumë ky Këshill në plotësimin e vendeve me staf profesional, e sidomos mendoj me ato thirrjet e nevojshme shkencore siç është raportuar me shkrim dhe siç ka qenë edhe raportimi i vetë kryesuesit të këtij këshilli në komisionin tonë.

Pra, qëllimi i gjithë neve duhet të jetë funksionalizimi sa më i mirë i këtij Këshilli, në të njëjtën kohë të kërkojmë edhe llogari edhe më të mëdha nga ky Këshill, pasi është drejtpërdrejt i lidhur me Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Adem Mikullovcit e ka kërkuar fjalën. Po bëj përjashtim, pastaj edhe për juve...

**ADEM MIKULLOVCI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Unë vetëm desha të ju them shkurt, nëse kryetari i Komisionit raporton dhe thotë, lënda, projektligji, nuk ka kaluar në komision, e ka një mori vërejtje dhe do të bëhet raporti i ri, pse humbim kohë rreth një materiali i cili është refuzuar dhe s'do të kalojë. Kjo është humbje kohe kotnasikoti. Ishte i cektë. Unë kam qenë anëtar i Komisionit. ishte i cektë, s'ishte gjithëpërfshirës dhe e kemi hedhur poshtë, ndërsa e kemi analizuar nen pas neni. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit! Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e ka shqyrtuar këtë raport dhe, pa humbur kohë për të mos i përsëritur të metat e raportit, ka ardhur në përfundim se raporti nuk duhet të kalojë dhe se kërkon nga këshilli që ta bëjë një raport vërtet raport pune për vitin 2017. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Po, si Parti Socialdemokrate e kemi shqyrtuar këtë raport dhe po them shumë shkurt që ky raport është një skandal i paparë me përmbajtjen e tillë dhe është në njëfarë mënyre edhe tallje me Kuvendin e Kosovës për mënyrën se si raportohet.

Ne si Parti Socialdemokrate jemi për atë që ky raport të mos miratohet nga Kuvendi dhe të bëhet një raport i mirëfilltë, i cili paraqet punët që ka bërë ky komision, por paraqet edhe një strategji dhe një planifikim për veprimtarinë në kuadër të tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E fundit është zonja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Të nderuar deputetë,

Sot po e diskutojmë raportin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi për vitin 2017.

Ajo që u tha nga Komisioni për Arsim, Kulturë, që dy herë komisioni e ka kthyer raportin, mu sinqerisht po më befasojnë edhe kolegët e mi që kanë qenë anëtarë të komisionit dhe nganjëherë krejt po ia huqin. Do të thotë, e kemi kthyer dy herë këtë raport dhe normalisht kemi rekomanduar të mos votohet. Janë shumë e shumë arsye për të cilat rekomandojmë që të mos votohet, por ajo që është edhe më skandaloze është që raporti i këshillit nuk është votuar, është hera e tretë nëse s'gabo, përderisa unë jam që tri mandate në të njëjtin komision dhe kjo ka ndodhur.

Fatkeqësia më e madhe është që një koordinim dhe një mosbashkëpunim i këshillit me departamentin për trashëgimi në kuadër të Ministrisë së Kulturës, ajo që ka reflektuar vazhdimisht ashtu siç na është thënë nga anëtarët e Këshillit për Trashëgimi. Dhe, në fund të fundit, kur i kemi ballafaquar të dy, do të thotë edhe departamentin edhe këshillin atëherë kanë dalë disa çështje të tjera, siç është mosrespektimi i Ligjit për trashëgimi. Mirëpo, ajo që mua personalisht më shqetëson më së shumti është që vet raporti i këshillit është ashtu siç u tha nga shumica, pos që është përshkrues ka pasur raporte individuale të anëtarëve të këshillit që kanë sjellë, kanë marrë guximin për të sjellë para komisionit dhe kanë pasur më shumë punë, se sa vetë raporti i krejt këshillit.

Jam shumë e vetëdijshme për atë që e them, se disa anëtarë të këshillit kanë punuar me shumë seriozitet, por disa të tjerë absolutisht jo vetëm që nuk e kanë arsyetuar pagën, por kanë qenë në shërbim të askujt. Dhe, sinqerisht, për derisa tri herë ndodh që një raport i një institucioni që është i themeluar nga Kuvendi nuk votohet, atëherë nuk di se çka Kuvendi dhe si do të vazhdojë më tutje, përderisa nuk nxjerr edhe rekomandime për raste të ngjashme, siç po ndodh edhe me Këshillin.

Edhe njëherë, them se normal që nuk po votohet, por nuk është hera e parë, është hera e tretë. Andaj, anëtarët e rinj që do të vijnë, i lus që ta marrin me shumë seriozitet punën në këshill, mos ta marrin si punë dytësore a tretësore, siç ka ndodhur me anëtarët e këtij këshilli dhe absolutisht nuk kanë qenë në funksion të përshkrimit të detyrave për çka ata i kemi çuar. Për herë të parë kam menduar që i kemi dërguar anëtarët më profesionalë, por me shumë seriozitet ju them se ka qenë puna më e paktë që ka ndodhur e shumicës, ka pasur anëtarë të këshillit që kanë punuar, por në plotëni do të thotë si grup nuk ka qenë absolut ajo që është kërkuar prej vetë këshillit.

Andaj, unë mendoj që është një sinjal shumë i keq për vetë Këshillin, por edhe për të gjitha institucionet përderisa nuk ju votohen raportet në Kuvend, në organin i cili edhe i ka themeluar. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Unë mendoj se është koha e fundit që Kuvendi duhet ta miratojë një rregull, sa u përket këtyre raporteve, që data 25 dhjetor me qenë data e fundit kur miratohen dhe ato që s'vijnë deri më 25 dhjetor të mos shqyrtohen më dhe të konsiderohen si komisione, si agjenci të pavarura, të paafta dhe të shkarkohen. Çka ke tash për vitin 2017 në gjysmë të vitit duhet me i miratua raportet e një agjencie, qe tre vjet radhazi nuk u është miratuar raportit. Kjo s'është gjë e mirë.

Pika e njëmbëdhjetë, do të thosha... veç edhe një pikë e kemi me raporte edhe pastaj po hyjmë në votim menjëherë. Nëse doni mos me e zgjatë, se zakonisht këto duhet një me diskutua kundër e një për edhe me shkua në votim, po ne po kemi qejf të diskutojmë të gjithë. Vazhdojmë t'i lexojmë ato që na i kanë shkruar.

## **12. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017**

Komisioni Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu edhe ky komision edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Ftoj kryetarin e Komisionit për Siguri, zotin Haxhi Shala që po më duket s'është këtu. Nuk është. A është dikush i autorizuar që ta lexojë. Jo.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Abdixhiku për arsyetimin e raportit me rekomandimin në lidhje me raportin vjetor financiar, zoti Abdixhiku e keni fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni ynë e ka shqyrtuar raportin në fjalë. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave e ka një buxhet prej 284 000 eurosh. Komisioni ynë ka vlerësuar se raporti i përmbush obligimet ligjore për raportim, që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe i rekomandon Kuvendit ta miratojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Xhelili.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Duke marrë parasysh që deputetët janë lodhur pak me seancën e zgjatur shkurt kisha thënë që ky raport është një prej raporteve më të mira të shkruara, të strukturuar, të hartuara dhe të prezantimit të aktiviteteve që i ka zhvilluar agjencia bazuar në kompetencat ligjore që i ka.

I ka identifikuar problemet, i ka identifikuar objektivat, ka pasur hendikep për shkak të mungesës së mbikëqyrësit kryesor shtetëror për mbikëqyrjen e të dhënave personale dhe gjithashtu ka përcaktuar objektivat që do t'i realizojë bazuar në ligjin e ri që ka ardhur këtë javë në Kuvend dhe shpresojmë që me ligjin e ri dhe me strukturën e re organizative, e cila është propozuar për këtë agjenci, agjencia do të luajë rolin e vet bazuar në kompetencat ligjore që dalin prej Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Andaj, propozoj Kuvendit që ta miratojë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nitaj, urdhëro!

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryesues i seancës!

Ndryshe nga raporti vjetor i Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore që i është refuzuar raporti tre herë, e përmendi zoti Xhelili, besoj që raporti vjetor i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017 është një shembull i mirë, se si përpilohen raportet dhe pa e zgjatur shumë unë ftoj deputetët që ta japin votën pro. Faleminderit!

KRYESUESI: Ishalla na i ruajnë të dhënat mirë! Zoti Sveçla e ka fjalën.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Me zhvillimin kaq të hovshëm teknologjik, me të mirat dhe të këqijat e saj, kjo agjenci dhe veprimtaria e saj fitojnë rëndësi të jashtëzakonshme. Një prej problematikave me të cilat bota e zhvilluar po ballafaqohet është keqpërdorimi i të dhënave personale, qoftë për përfitime ekonomike, financiare e politike, deri edhe tek shfrytëzimi për aktivitete ordinere kriminale.

Edhe tash së voni jemi njoftuar për skandalin e Cambridge Analitica, që duke përdorur të dhënat e shfrytëzuesve të Facebook-ut ka ndikuar në procesin zgjedhor në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Keqpërdorim të të dhënave personale ka edhe në vendin tonë. Për këtë ka shembuj e shembuj. Po ashtu, ka edhe reagime të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, por a janë të mjaftueshme këto reagime? As për afërsisht.

Çka vërehet në raportin e kësaj Agjencie? Te ankesat në raport shkruan se gjatë vitit 2017 janë pranuar vetëm 78 ankesa. Pyetja është, a dihet për këto ankesa se çfarë kategorish janë? Si është trendi mujor e vjetor i tyre? A ka rritje të numrit sipas muajve apo rënie? Nëse ka rënie, ndoshta nuk po inkurajohen qytetarët të raportojnë apo nuk po punohet mjaftueshëm për vetëdijesimin e tyre lidhur me këtë problematikë.

Në raport shkruan se këto 78 ankesa janë parashtruar gojarisht, përmes telefonit, me shkrim dhe përmes mjeteve tjera. A dihet për këto 78 ankesa? Cila është mënyra e raportimit, cila mënyrë prevalon dhe është më e shpeshta? Në këtë mënyrë e kuptojmë se në çfarë mënyre qytetarët nuk po hezitojnë që të paraqesin ankesat.

Po ashtu, nuk e dimë se a ka sistem online, ku formulari plotësohet shpejt on-line dhe nuk ka nevojë për t'u shkarkuar. Nuk dihet nëse agjencia ka sistem online, ku përpos rasteve të ankesave personale qytetarët mund të raportojnë edhe shkeljet tjera të privatësisë dhe të të dhënave personale që ndodhin në Kosovë. Në Kosovë kryesisht kohët e fundit po bëhet abuzim me të dhëna personale nga shitësit në pika të shitjes, si për shembull Vala dhe IPKO, ku numrat e telefonit, vendbanimet dhe ditëlindjet e klientëve po thuhet se po shiten tek kompanitë private, të cilat i promovojnë prodhimet e tyre, sipas target grupeve specifike (mosha, vendbanimi, e tjera...).

Pra hipotetikusht, nëse hapet një dyqan i këpucëve në lagjen tënde, ndodh që të vjen mesazhi nga kompania që hap dyqanin, e cila në fakt e di se ti jeton në atë lagje dhe sipas moshës së caktuar (ditëlindjes) e di që ti je konsumator potencial. Në raportin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave te dokumentet përcjellëse administrative ceket se lista e kontrollit përfshinë: lista e kontrollit për sektorin shëndetësor, lista e kontrollit për sistemin e kadastrit, lista e kontrollit për regjistrin civilë, lista e kontrollit për regjistrin penal, lista e kontrollit për sektorin financiar dhe lista e kontrollit për sigurimet shëndetësore.

Tash, agjencia duhet t'i bëjë disa pyetje. A e keni numrin e memorandumit të mirëkuptimit, që për shembull, regjistri civil e ka nënshkruar me organizatat tjera për qasje direkte në sistemin e tyre, data-bazën personale. A e dini numrin se sa zyrtarë janë jashtë regjistrin civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme, mundën lirisht të kërkojnë në data-bazë të tyre dhe t'i marrin komplet shënimet personale të cilitdo person (emrin, mbiemrin, numrin personal, ditëlindjen, vendlindjen, e tjera...). A jeni në njohuri, se kjo qasje direkte në sistemin e tyre mund të abuzohet pa dijen e zyrtarëve të Regjistrin Civil? A e keni numrin e memorandumeve të mirëkuptimit, që për shembull, sektori financiar, Administrata Tatimore i ka nënshkruar me organizatat tjera për qasje direkte në sistemin e tyre, domethënë data-bazën personale? A e dini numrin se sa zyrtarë jashtë Administratës Tatimore nga institucionet tjera mundën lirshëm të kërkojnë në data-bazë të tyre sipas numrit personal dhe a keni njohuri që bankat në Kosovë i përcjellin të dhënat bankare të ndonjë personi në ndonjë ambasadë të caktuar pa pëlqimin dhe njohurinë e tij apo të saj?

Në raport tek inspektimet dhe kontrolli, për shembull në vitin 2014 janë gjetur shkelje të të dhënave personale nga spitali Bahçexhi. Përflitet që i njëjti spital më vonë bëhet sponsor i një konference private të organizuar nga zyrtari, i cili është shkarkuar nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kësi lloj praktikash nuk duhet lejuar që të përsëriten. Te transferimi i të dhënave personale, a dihet numri dhe kategoria e saktë e të dhënave personale, që janë transferuar nga Kosova në ndonjë shtet tjetër dhe si është proceduar në këto raste, si dhe tek burimet njerëzore.

Në raport shkruan se është bërë kërkesë edhe për nëntë pozita të reja pune me kosto mujore prej 4 468 eurosh. Të jemi të sinqertë, me këtë buxhet kaq të vogël nuk duhet pritur mrekulli, andaj është e domosdoshme që të gjenden forma të tjera financuese për këtë agjenci. Në ligjet e EU-së për mbrojtjen e të dhënave përmbajnë një serë parimesh që organizatat, Qeveria dhe bizneset duhet t'i përmbahen për të mbrojtur të dhënat e dikujt të sakta, të sigurta dhe në mënyrë ligjore. Këto parime duhet të sigurojnë që përdoren vetëm në mënyrë specifike dhe të deklaruar, nuk ruhen më shumë se sa është e nevojshme, domethënë duhet me pas afate të ndryshme për lloje të ndryshme të të dhënave. Përdoren vetëm në mënyrë relevante, do të thotë, i përshtaten temës që po konsiderohet, mbahen në mënyrë të sigurt. E tash neve menjëherë na kujtohet dhoma e sigurisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Përdoren brenda kufijve ligjor, nuk transferohen diku tjetër në mënyrë të paorganizuar dhe ruhen duke pasur parasysh mbrojtjen e të dhënave të njeriut.

Po ashtu, duhet të kemi konsideratë për kamerat apo CCTV-të se ku vendosen ato, a janë paralajmëruar me stiker që po incizohen dhe moslejimi i distribuimit të pamjeve filmike palës së tretë pa autorizim ligjor.

Është shumë me rëndësi që t'i mundësohet agjencisë auditimi i log-fajlave të kërkimeve të caktuara në data-bazë për periudhë të caktuar, pra që mos t'i lejohet lloj-lloj individi që të bëjë



kërkim të të dhënave personale në data-bazat e caktuara pa autorizim adekuat edhe nëse është administrator i data-bazës, ai mund të kërkojë ndonjë të dhënë vetëm sipas urdhrit gjyqësor, policor, e tjerë... por, jo sipas tekeve të tij apo të saj, që të kërkojë të dhëna për dikë që e njeh apo që mund ta shantazhojë më vonë.

Ai, ajo që i kërkon ato të dhëna duhet të jenë të ruajtura në log-file dhe të auditohen më vonë, do të na japë mundësinë të shikojmë se përse ky person po i kërkon të dhënat personale të një qytetari. Normalisht, që ne jemi të interesuar që sa më shumë të mbrohen të dhënat personale të qytetarëve të këtij vendi, por po ashtu duhet pasur konsideratë se duhet të ruhet një balancë në mes privatësisë dhe sigurisë kombëtare, e cila nuk duhet të anashkalohej, apo të nënçmohet për hir të ruajtjes së disa parimeve të privatësisë.

Të gjitha këto rekomandime të EU-së apo norma të EU-së, është mirë që të tentojmë t'i plotësojmë meqenëse kemi gojën plotë integritet drejt EU-së dhe duhet fokus e energji shtesë e institucioneve për përmirësimin e situatës në këtë fushë e nëse kjo nuk bëhet, situata vetëm sa do të rëndohet edhe më shumë dhe atë shumë shpejt.

Prandaj, përkundër një përpilimi sidokudo profesional të këtij raporti, ne mund të konkludojmë se gjendja e sigurisë së të dhënave personale të qytetarëve të Kosovës nuk është duke u mbrojtur sa duhet dhe rrjedhimisht, patjetër që duhet investime shtesë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Sveçla! Fjalën e ka zoti Topalli.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Grupi i PSD-së e ka shqyrtuar raportin dhe mund të them se ky është një prej raporteve të mira që i paraqiten Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kisha ndoshta edhe pak kritika, sa i përket këtij raporti, por arsyeja pse nuk po i them këto kritika është demagogjia e madhe në çështjen e ruajtjes së privatësisë nga diskutuesi i fundit, kështu që unë po tërhiqem nga kritikata e mijja.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajl Kurteshi, je paraqitur?

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit! Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale sipas ligjit është përgjegjëse për mbikëqyrjen e legjitimitetit dhe përpunimin e të dhënave personale. Është përgjegjëse për kryerjen e inspektimit dhe kontrollit të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Po ashtu, kjo agjenci jep pëlqim lidhur me krijimin e sistemit të dosjeve. Detyrë e agjencisë është që t'i këshillojë institucionet e vendit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale e të tjera.

Mirëpo, e vërteta është se agjencia gjatë vitit të kaluar, pra vitit raportues, dhe këtij viti nuk e ka mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, nuk janë kryer inspektime në

këtë fushë, nuk janë marrë vendime për çështje të ndryshme në këtë fushë, nuk janë iniciuar raste në gjykatë kundër abuzuesve me të dhëna personale. Problemi më serioz i kësaj agjencie që është mungesë e organit kolegjal mbikëqyrës, nuk është funksional dhe ky problem përmendet vetëm shkarazi, kurse në këtë raport, si në shumë raporte të agjencive të tjera, shumë hapësirë i kushtohet shpjegimit të bazës ligjore, misionit, vizionit, objektivave, autorizimeve, përgjegjësive e të tjera, kurse pjesa e raportit ku flitet për punën konkrete të kësaj agjencie dhe të agjencive të tjera, është shpesh e shkurtër, e përgjithësuar dhe e paqartë.

Bazuar në raportin në fjalë, agjencia gjatë vitit 2017 kryesisht është marrë me dhënien e këshillave dhe mendimeve, derisa punët më të rëndësishme si inspektimi marrja e vendimeve e të tjera, nuk janë kryer. Kuvendi si themelues i kësaj agjencie nuk duhet ta konsiderojë se e ka kryer obligimin e vet ndaj agjencisë me shqyrtimin e aprovimin e këtij raporti të punës. Detyrë e Kuvendit është që ta bëjë funksionale agjencinë dhe ta përcjellë për së afërmi dhe në mënyrë më proaktive punën e kësaj agjencie dhe agjencive të tjera, që i ka themeluar Kuvendi.

Me raporte vjetore puna e agjencive të krijuara nga Kuvendi po shihet tanimë se nuk po mund të përcillet, prandaj propozoj që agjencitë që i përgjigjen Kuvendit, përveç raporteve vjetore për Kuvendin, duhet t'u raportojnë komisioneve funksionale të Kuvendit në baza mujore, në mënyrë që të përcillet puna e tyre, në mënyrë që me kohë të bëhen vërejtje në punën e tyre dhe në mënyrë që të korrigjohet ajo që është për t'u korrigjuar në punën e agjencive. Përndryshe, agjencitë po mbeten trupa të pakontrolluara dhe të cilat po punojnë bazuar në vullnetin e tyre, që shpesh po u mungon. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti Kurteshi! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Mendoj që as kuorumin e mjaftueshëm nuk e kemi, por si fillim unë desha të ju njoftoj që debati parlamentar në lidhje me Kornizën afatmesme të shpenzimeve 2019-2021 i kërkuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës shtyhet me marrëveshje në mes të Grupit Parlamentar të LDK-së dhe ministrit, për shkak se ministri është në udhëtim zyrtar dhe Kryesia do ta vendosë se kur do të mbahet ky debat, domethënë pas datës 26 qershor.

Çështjet që kanë ngelur pezull, është pika e 13-të, që është propozimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimin e shërbyesve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës dhe propozimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më datën 29 mars 2018.

Kemi në sallë 51 deputetë. Unë mendoj se kemi dy, ose kemi disa variante që mundemi, mund t'ia lë Kryesisë që ta vendosë, ose mund të merremi vesh që ta vazhdojmë nesër pasdreke. Zoti Hoti?

AVDULLAH HOTI: Kryesues!

Unë sugjeroj që Kryesia e Kuvendit të mblidhet për ta caktuar seancën e re dhe në fillim të asaj seance ne të listojmë krejt çështjet që duhet të votohen nga kjo seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Sejdiu?

DARDAN SEJDIU: Pajtohem me propozimin e zotit Hoti.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Reçica.

ELMI REÇICA: Dakordohem plotësisht me zotin Hoti, si zakonisht.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kinolli, edhe ti pajtohesh, besoj.

ALBERT KINOLLI: Kryetar, gjithsesi që edhe ne pajtohemi me këtë propozim, mirëpo është edhe nënçmim edhe ndaj nesh që jemi këtu të pranishëm, por edhe ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët janë duke na përcjellë përmes ekraneve televizive, për shkak se është papërgjegjësi totale që ne të jemi këtu dhe jemi disa që kemi ardhur prej udhëtimit direkt në seancë dhe këta kolegët e nderuar që janë këtu prej mëngjesit, mendoj që është e pahijshme, johumane dhe jonjerëzore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, e lëmë që Kryesia kur të mblidhet e cakton një seancë të radhës dhe pastaj humbim dy ditë me këto çështje. Faleminderit!

Mirupafshim në seancën e radhës, që e cakton Kryesia e Kuvendit!

\* \* \*

*E enjte, më 28 qershor 1 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 14 qershor 2018*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës me procedimin e pikave të papërfunduara nga seanca plenare e mbajtur më 14 dhe 19 qershor 2018.

***- Interpelancë me ministren e Integrimit Evropian, zonjën Dhurata Hoxha, në lidhje me zbatimin e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit për kuartalin e katërt (K4) 2017 dhe kuartalin e parë (K1) 2018***

Diskutimet për pikat e rendit të ditës kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 14 dhe 19 qershor 2018, po në mungesë të kuorumit të mjaftues për vendimmarrje nuk është proceduar në votimin e tyre.

Tani lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, për propozim-rezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe të harmonizuar nga grupet e tjera parlamentare, e cila u është shpërndarë deputetëve më 19 qershor, votojmë tani:

A ta përsëris edhe një herë, a jeni dakord, pikën e tretë.

Edhe një herë po e përsëris votimin e propozim-rezolutës nga interpelanca me ministren e Integrimit Evropian, zonjën Dhurata Hoxha. Besoj e dini për çka është fjala.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Faleminderit!

Kanë votuar 69 deputetë, për kanë votuar 67, një është kundër dhe një ka abstenuar.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi rezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

#### ***4. Votimi në parim i Projektligjit për aktet juridike***

Komisioni FunkSIONAL i ka rekomanduar Kuvendit që të mos e miratojë Projektligjin për aktet juridike. Prandaj, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Nuk duan të votojnë deputetët, jo edhe një herë jo, nuk jam këtu lodër juaja, ose përcillni, qëndroni në mbledhje, edhe unë jam njeri, nuk jam lodër.

Edhe një herë po e nxjerr në votim Projektligjin për aktet juridike. Votojmë tash! Nuk kalon.

***5. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale***

Votojmë projektligjin, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Në sallë janë 70 deputetë, kanë votuar 60, a jeni për? Në rregull.

Kanë votuar me kartelë 60 deputetë.

E përsërisim edhe një herë votimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-28 për tatimin në të ardhurat personale.

Votojmë projektligjin, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Faleminderit! Kanë votuar 65 deputetë, për janë 15 deputetë, kundër 47 deputetë dhe 3 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi nuk e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale.

***6. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave***

Votojmë projektligjin, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Faleminderit! Kanë votuar 67 deputetë, për janë 19 deputetë, kundër kanë votuar 44, kanë abstenuar 4.

Konstatoj që Kuvendi nuk e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-050 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave.

***7. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-037 për tatimin në vlerën e shtuar***

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 66 deputetë, për janë 17, kundër 45 dhe 4 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi nuk e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-051 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-037 për tatimin në vlerën e shtuar.

***9. Votimi i raportit vjetor financiar për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017***

I kam nxjerrë këto që kanë mbetur pa u votuar, pastaj ato amendamente i votojmë pas raporteve.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

S'po doni të votoni. e përsëritim edhe një herë.

E përsëris votimin edhe një herë, në qoftë se dikush ka harruar të votojë. Votojmë tani!

Është e njëjta situatë, e lëmë për seancat e ardhshme derisa të marrë formë të prerë votimi.

#### ***10. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017***

Votojmë raportin, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Edhe këtë e lëmë për një herë tjetër, kur plotësohen kushtet për votim.

#### ***11. Votimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore për vitin 2017***

Komisioni Funkcional ka rekomanduar mosmiratimin e raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore për vitin 2017.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

A doni ta përsërisim? E përsëris edhe një herë votimin, se gati është të plotësohet numri. Paska më shumë sipas komisionit, tani e përsëris edhe një votimin, votojmë tani:

E lëmë kur të plotësohen kushtet.

#### ***12. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017***

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Mbetet për seancën e radhës.

Para se të futemi te çështja e Komisionit Hetimor, na ka mbetur pika e rendit të ditës:

### **8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit miniera dhe minerale**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Sala Berisha-Shala, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

Zonja Shala, e keni fjalën!

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Dhe, ju të pranishëm.

Do të kërkoja mirëkuptim ta them fjalën time edhe në cilësinë e kryetares së komisionit, edhe në emër të komisionit parlamentar, sepse kjo nismë është e komisionit, nuk është nismë që ka ardhur nga Qeveria, pra është nismë e Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik.

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të neneve 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit në disa mbledhje të mbajtura shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-127 për miniera dhe minerale. Vërejtje për administratën, të propozuar nga Kuvendi, jo nga Qeveria, ndërsa në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2018 vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë raport me rekomandime. Para se të hyj në raportin me rekomandime, përfshirë me amendamente, të nderuar kolegë deputetë, më lejoni t'i them disa fjalë.

Ky ligj ose ky draft ligj është tërësisht i spastruar nga mendësia e UNMIK-ut. Ligji për miniera dhe minerale, i cili e rregullon sektorin minerar ka qenë Rregullore e UNMIK-ut e shndërruar në ligj pa pasur mundësi të ndryshohet asnjë pikë dhe asnjë presje. Rrethanat në Kosovë tashmë kanë ndryshuar dhe duhet t'i marrim vetë në dorë frenat e zhvillimit ekonomik, por edhe sektorët e tjerë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për miniera dhe minerale është nismë e Kuvendit, siç e thashë edhe më lartë, përkatësisht e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, të iniciuar nga unë dhe të mbështetur nga anëtarët e komisionit të të gjitha grupeve parlamentare, të cilët shfrytëzoj rastin t'i falënderoj. Gjatë hartimit të projektligjit në grup punues janë përfshirë edhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, shoqëria civile dhe ekspertë. Objektivi që synohet të arrihet përmes këtij projektligji të ri është rregullimi më i mirë ligjor për shfrytëzimin e resurseve minerare në funksion të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm, në pajtim me standardet e pranuar mjedisore dhe maksimalizimin e përfitimit publik, si dhe objektiv tjetër është eliminimi i barrierave të panevojshme administrative dhe teknike për ushtrimin e aktiviteteve minerare, por gjithnjë duke ruajtur interesin publik dhe mjedisin, si dhe sigurimin e konkurrencës së lirë gjatë ushtrimit të aktiviteteve minerare.

Ndër çështjet kryesore që trajtohen me projektligjin e ri janë: aplikimi për licenca dhe leje në një vend "one stop shop", rregullimi i hulumtimit dhe shfrytëzimit të gazit dhe naftës, çka ligji i mëparshëm nuk e ka pasur, garancitë bankare për sigurimin e mbylljes së minierës dhe

rehabilitimin, thjeshtësimit i licencave dhe lejeve, kolizionet e këtij ligji me ligjet e tjera, kufizimet për ushtrim të aktivitetit minerar, përfitimet e komunitetit ku ushtrohet aktiviteti minerar, shfrytëzimi zejtar i resurseve minerare, çështjet mjedisore, përgjegjësinë dhe llogaridhënia e Bordit të KPMM-së dhe përgjegjësia e institucioneve në parandalimin dhe ndalimin e operimeve ilegale.

Më 30 nëntor 2017 komisioni e ka miratuar nismën për Projektligjin për miniera dhe minerale dhe ka proceduar më tutje sipas procedurës për mendim në Qeveri. Qeveria më 15 janar 2018 e ka kthyer mendimin e saj lidhur me këtë nismë ligjore, më pastaj projektligji ka vazhduar në procedurë të rregullt të shqyrtimit sipas procedurave të parapara me Rregulloren e Kuvendit. Gjatë shqyrtimit në mes dy leximeve komisioni ka organizuar edhe dëgjim publik, ku janë marrë edhe opinionet e palëve të interesuara që vlen të përmendet, me theks të veçantë kemi pasur ekspertizë edhe ndërkombëtare, janë përfshirë edhe komentet e komunave, bizneseve ndërkombëtare dhe vendore që operojnë në sektorin minerar. Gjatë afatit dyjavor të propozim-amendamenteve, siç edhe e keni të paraqitur në raport, një grup parlamentar, përkatësisht Lista serbe ka propozuar 24 amendamente, komisioni nuk i ka përkrahur këto amendamente, për shkak se ka konstatuar se disa prej tyre janë të përfshira në ligjet e tjera dhe janë tërësisht të panevojshme.

Ndërsa, komisioni ka pranuar edhe dy amendamente nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, të cilat komisioni i ka përkrahur, mirëpo komisioni nuk është pajtuar me Komisionin e Buxhetit në lidhje me shpërndarjen e tantimës, ku do ta elaboroj më tutje kur të vijmë te amendamenti përkatës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! E dini që të drejtë për të diskutuar lidhur me këtë ligj kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, të Qeverisë dhe deputetët. Zoti Mikullovc i është paraqitur për fjalë. Zoti Mikullovc, e keni fjalën!

**ADEM MIKULLOVCI:** I nderuar deputet!

Më lejoni, dua të tërheq vërejtjen, me keqardhje, po dua ta përkujtoj, kur keni dhënë betimin për deputet keni marrë obligimin të votoni për çdo gjë që vihet në votim, jeni të obliguar të votoni, të mos i prishim mbledhjet. Pra, kundër ose për, po të votoni jeni të obliguar. Kush nuk voton fare, ai faktikisht nuk është në seancë, s'ka kuptim të prishen mbledhjet. Kaq!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka kërkuar fjalën.

**MILAIM ZEKA:** Kryesues, edhe unë desha ta mbështes fjalën e bacit Adem, në qoftë se shkoni në arkiv, i merrni në çdo rezolutë që ka propozuar LDK-ja dhe Vetëvendosja kam votuar për. Arsyeja pse kam votuar për është se rezolutat janë vetëm këshillë për Qeverinë, nuk janë



obligative. Në qoftë se ne tallemi në këtë formë në Parlament me votuesit tonë, marre për neve, bash marre!

Le që s'po i votojmë ligjet, por ne nuk po i votojmë as rezolutat që fare s'kanë të bëjnë me ligje, prandaj e kemi bllokuar Parlamentin, kështu që, zoti kryesues, propozoj të na e sjellësh nga një jastëk këtu dhe një sfungjer dhe t'ia fusim gjumë.

KRYESUESI: Faleminderit! Ne jemi deputetë dhe mund ta bëjmë një amendament në Rregullore, i cili e rregullon këtë çështje dhe përgjegjësitë pastaj për secilin mund ta ndryshojë, këtë gjendje e kemi. Po, ju kisha lutur që është kryer kjo çështje e votimeve dhe është bërë praktikë kjo, po dihet pse.

Jemi në shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës që është Projektligji për miniera dhe minerale, të diskutojmë vetëm për këtë.

Zonja Shala, e keni fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Kërkoj vëmendjen e kolegëve të mi deputetë që t'i mbështesin amendamentet që janë miratuar dhe janë mbështetur nga Komisioni Funkcional, kërkoj vëmendjen, sepse janë bukur shumë amendamente dhe mund të mos e kemi vëmendjen, krejt është normale, jemi pasdite dhe mbas një pune të lodhshme. Kërkoj që të mbështeten amendamentet, të cilat janë me përkrahjen e Komisionit Funkcional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë po fillojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1, propozim i Listës serbe, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Votojmë me elektronikë, votojmë tani!

Të nderuar kolegë, ju e dini që po u bllokuam në këtë variant, mosmiratimi i amendamentit të parë ose mospërfundimi i votimit për amendamentin e parë na bllokoi për të shkuar në amendamentin e dytë, e kështu me radhë. Lus që vërtet të votojmë ose të deklarohe mi si grupe parlamentare që jemi kundër këtij ligji, që s'po e di pse, çka po ndodh?

Edhe një herë e votojmë me elektronikë amendamentin e parë. Votojmë tani!

Unë nuk mund të shkoj më tutje me ligjin në fjalë, e lëmë kur t'i përsëritim seancat e radhës, s'po votoni. E kemi pikën 14:

#### **14. Propozimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq, më 29 mars 2018**

Grupi Parlamentar i LDK-së, mbështetur nga 40 deputetë nënshkrues në bazë të Ligjit për hetim parlamentar i ka propozuar Kuvendit formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq, më 29 mars 2018. Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 31 maj 2018, në bazë të përfundimit numër 06F/056 ka kërkuar nga grupet parlamentare t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar sipas propozimit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Përbërja e komisionit do të jetë në 11 anëtarë. Grupet parlamentare të LDK-së, Lëvizjes Vetëvendosje dhe PSD-së i propozojnë pesë anëtarë dhe Grupet Parlamentare të PDK-së, AAK-së, Lista serbe, Nisma Socialdemokrate dhe 6+ propozojnë gjashtë anëtarë të komisionit. Kryesuesi zgjidhet nga radhët njërit grup parlamentar, i cili nuk është iniciator i Komisionit Hetimor dhe nuk i përket partisë së koalicionit qeverisës, përkatësisht nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, ndërsa zëvendëskryesuesi emërohet nga radhët e grupit iniciues, përkatësisht nga Grupi Parlamentar i LDK-së.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së, zotin Hoti, që në cilësinë e propozuesit ta paraqesë propozimin për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar. Zoti Hoti, e keni fjalën!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Kërkesa jonë për formimin e këtij Komisioni Hetimor Parlamentar bazohet në nenin 77 të Kushtetutës, në nenin 71 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në nenin 4 të Ligjit hetimor për hetim parlamentar. Për të hetuar çështjen e dëbimit joligjor, siç është konsideruar, të gjashtë shtetasve turq më 29 mars 2018.

Çështja për hetim është përcaktuar në pikën 4 të rekomandimeve të miratuara në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës më 4 prill 2018, është Rezoluta nr. 06DO571, në mënyrë specifike çështja për hetim është si në vijim: shqyrtimi i përputhshmërisë me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi të procedurave të ndjekura me rastin e dëbimit të gjashtë shtetasve turq, më datë 29 mars 2018. Kjo është shqyrtuar në Kryesinë e Kuvendit, me sa jam i njoftuar grupet parlamentare i kanë dërguar propozimet. Ne propozojmë që te përbërja e Komisionit Hetimor Parlamentar, pra të jenë 11 anëtarë që përfaqësojnë proporcionalisht grupet parlamentare sikurse në komisionet e tjera parlamentare. Kryetar i Komisionit të jetë anëtari që propozohet në këtë komision nga opozita, gjegjësisht nga Grupi Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje, të cilët nuk janë nënshkrues të kësaj kërkesë. Ndërsa, zëvendëskryesues të jetë anëtari i këtij komisioni nga Grupi Parlamentar i LDK-së, si iniciues i kësaj kërkesë.

Tek afati kohor ne propozojmë që ky komision të ketë një afat prej 4 muajsh për t'i prezantuar Kuvendit të Kosovës raportin e vet. Unë i ftoj të gjitha grupet parlamentare, ashtu si jemi në

seancën kur është diskutuar për këtë çështje dhe kur e kemi dakorduar rezolutën, atëherë të votojmë këtë komision hetimor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dua t'ju them që Grupi Parlamentar i LDK-së ka propozuar Driton Selmanajn zëvendëskryesues, Anton Qunin anëtar. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike nuk i ka sjellë anëtarët...

*(Reagime nga salla)*

Atëherë thuaje. Unë thashë se sot i keni sjellë dy emra, po s'di në cilin komision. Zoti Krasniqi e keni fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në fakt, jo një herë, dy herë i kemi dërguar emrat, edhe kur ka qenë herën e parë në rend të ditës dhe që është tërhequr prej propozuesit, edhe tash kur ka ardhur për herën e dytë. E kanë shkresën zyrtare dhe si herën e parë, edhe herën e dytë dy anëtarët e Partisë Demokratike të Kosovës në këtë komision janë deputetët Hajdar Beqa dhe Ganimete Musliu. Kështu që ftoj sekretarinë që t'i verifikojnë, unë për pesë minuta mund t'jua sjell kopjet me datë, me siguri para një muaji dhe para tre muajsh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Krasniqi, për sqarimin. Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka propozuar deputetin Xhelal Sveçlën kryesues dhe deputetin Sami Kurteshi anëtar. Grupi Parlamentar i PSD-së ka propozuar zotin Dardan Molliqaj për anëtar, Grupi Parlamentar i AAK-së a ka propozim? Zoti Isufi!

AHMET ISUFI: E kemi dorëzuar edhe ne emrin, Muharrem Nitaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Në rregull! Lista serbe s'është këtu. Nisma? Zoti Sherifi!

BILALL SHERIFI: Po, e kemi dorëzuar qysh në seancën e kaluar, e kemi thënë veç po e përsëris, është deputeti Haxhi Shala, i cili është edhe anëtar, përkatësisht kryetar i Komisionit për Siguri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! 6+? Zonja Balje!

DUDA BALJE: Parlamentarna Grupa 6+ predlaže gospodina Bahrina Šabani.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, mendoj që ky komision u kompletua me emrat. Kërkohej deklarimi me votim për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar sipas kërkesës së Grupit

Parlamentar të LDK-së, mbështetur nga 40 deputetë nënshkrues lidhur me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq, më 29 mars 2018.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Në sallë kemi 69 deputetë, votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar 63 deputetë. 58 janë për. 1 kundër dhe 4 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi e formoi Komisionin Hetimor Parlamentar në përbërjen që i lexuan më parë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Kërkohet nga Komisioni Hetimor Parlamentar që të veprojë në përputhje me Ligjin për hetimin parlamentar dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime në afatin sipas kërkesës që e bëri zoti Hoti më herët, domethënë nga dita e formimit sot, katër muaj. Faleminderit!

### **13. Propozimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyesve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës**

Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate, në bazë të Ligjit për hetimin parlamentar i ka propozuar Kuvendit formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me emërimet e shërbyesve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës. Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 31 maj 2018, në bazë të përfundimit nr. 06F057 ka kërkuar nga grupet parlamentare, të cilat nuk i kanë propozuar anëtarët, t'i propozojnë deputetët dhe anëtarët e Komisionit Hetimor Parlamentar sipas propozimit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate.

Përbërja e komisionit do të jetë 11 anëtarë, Grupet Parlamentare të LDK-së, LVV-së, PSD-së i propozojnë pesë anëtarë, në mesin e tyre propozojnë kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin, si dhe grupet parlamentare të PDK-së, AAK-së, Listës serbe, Nisma Socialdemokrate dhe 6+ i propozojnë gjashtë anëtarë të komisionit. Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të PSD-së, zotin Sejdiu, që në cilësinë e propozuesit të paraqesë propozimin për formimin e komisionit. Më duket e kanë dorëzuar këta, qenka këtu. OK! Atëherë, po i lexoj sipas kërkesës ose vendimit të grupeve parlamentare.

Grupi Parlamentar i LDK-së ka propozuar: Mimoza Kusari-Lila, anëtare, Mirjeta Kalludra, anëtare.

Grupi Parlamentar i PDK-së propozon: zotin Bekim Haxhiu dhe zonjën Xhevahire Izmaçu.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka propozuar zotin Liburn Aliu, anëtar dhe zotin Sali Zyba, anëtar.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate ka propozuar zotin Dardan Sejdiu, anëtar dhe zëvendëskryesues.

Grupi Parlamentar i AAK-së, kë e propozoni, zoti Isufi?

AHMET ISUFI: Shkumbin Demaliaj!

KRYESUESI: Faleminderit! Lista serbe nuk është këtu. Grupi Parlamentar Nisma, zoti Sherifi?

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Deputetin Enver Hoti.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar 6+?

BAHRIM ŠABANI: Hvala, predsedavajući!

Parlamentarna grupa 6+ predlaže poslanicu Duda Balje.

KRYESUESI: Faleminderit! Është mirë që të përcaktoheni për kryesuesin e komisionit, zoti Hoti. Zotit Hoti fjalën, ju lutem!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit! Dy anëtarët që kemi propozuar ne, Mimoza Kusari-Lila dhe Mirjeta Kalludra, propozojmë që deputetja Mimoza Kusari-Lila të jetë kryesuese e këtij komisioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani kërkohet deklarimi me votim për formimin e Komisionit Hetimor sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PSD-së, lidhur me emërimet e shërbyesve të lartë civilë të Administratës Shtetërore të Republikës së Kosovës. Votojmë tani!

Nuk kemi kuorum, i kemi 60 veta në sallë.

E përsëritim votimin, meqenëse tani është kuorumi i plotë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani! Faleminderit!

Kanë votuar 61 deputetë. 59 janë për, asnjë kundër, dy abstenime. Konstatohet se Kuvendi e miratoi formimin e Komisionit Parlamentar në përbërjen përkatëse, që u deklarua nga kryetarët e grupeve parlamentare dhe kryesuesin e komisionit.

Kërkohet nga Komisioni Hetimor Parlamentar që të veprojë në përputhje me Ligjin për hetim parlamentar dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandimet në afatin e paracaktuar sipas nenit 6 të Ligjit për hetim parlamentar.

## **15. Debat parlamentar në lidhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, 2019/2021**

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka parashtruar kërkesën për debat parlamentar lidhur me kornizën afatmesme të shpenzimeve 2019/2021.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotin Avdullah Hotin, që në emër të propozuesit ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar. Zoti Hoti, e keni fjalën.

**AVDULLAH HOTI:** Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Me datë 27 prill 2018 Qeveria e Kosovës e ka aprovuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për periudhën 2019/2021 dhe e ka proceduar në Kuvend. Kjo kornizë është dokumenti bazë i planifikimit buxhetor për tre vjetët e ardhshme.

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka iniciuar këtë debat parlamentar për të diskutuar, së pari, sa janë reale projeksionet për tri vitet e ardhshme dhe së dyti, përputhshmërinë e këtyre projeksioneve me nevojat ekonomike, sociale e zhvillimore të Kosovës, me premtimet elektorale të koalicionit qeverisës dhe me programin qeverisës 2017-2021. Ne e kemi analizuar në detaje këtë dokument dhe vlerësojmë se ky dokument shpërfaq mungesën e vizionit të kësaj Qeverie, se kah duhet të shkojë shoqëria dhe ekonomia kosovare. Dokumenti e bën të qartë, se ky koalicion nuk ka njohuri dhe as përkushtim për të ofruar një qeverisje që është për qytetarët e vendit.

Në vijim unë do të flas për mënyrën se si janë reflektuar premtimet elektorale në këtë dokument dhe pastaj për çështjet tjera. E para, premtimi për rritje ekonomike prej 7 - 8%, qartë ka qenë mashtrim, pasi që në kornizë është paraparë rritje ekonomike prej 4 - 5%. Krijimi i mijëra vendeve të reja të punës ka qenë gjithashtu mashtrim. Të vetmit persona që po duket se do të punësohen gjatë këtij mandati janë 522 anëtarë të Kabinetit Qeveritar me 22 ministra, me 220 anëtarë të kabineteve, me 70 zëvendësministra me 210 persona në shërbim të tyre, tash edhe me koordinatore nacionalë.

E treta, zoti Veseli gjatë fushatës ka nënshkruar memorandum me Lidhjen e Pensionistëve për rritjen e pensioneve për 25% dhe pension minimal prej 200 eurosh. Ky qartë ka qenë një mashtrim, pasi në kornizë nuk është reflektuar në projeksione financiare të Qeverisë.

**KRYESUESI:** Ju lus për qetësi!

AVDULLAH HOTI: Në pikën katër, zoti Haradinaj edhe zoti Veseli, kanë premtuar rritje të pagave 30% në kornizë rritja e pagave është rreth 3%, ndërkaq për vete pagat i kanë rritur, jo 30% siç kanë premtuar, por 100%.

Zoti Haradinaj pati premtuar që brenda 90 ditësh minatorëve të Trepçës do t'u njihet stazhi i punës. Nuk ka asnjë veprim tash e nëntë muaj të qeverisjes. Kemi pranuar tash Statutin e Trepçës i cili lë jashtë Trepçës plot asete të rëndësishme, duke hedhur dyshime për motivet e këtij veprimi.

Të nderuar deputetë, kjo kornizë e bën të qartë, sikurse premtimet elektorale edhe Programi Qeverisës 2017-2021 ka qenë dhe është mashtrim. Ja faktet! E para, në Programin Qeverisës në faqe 6 parashihet buxhet më i lartë për bujqësi. Ndërkaq, në kornizë rritja e buxhetit për bujqësi është zero. Por, këtu kemi edhe një skandal tjetër. Për bujqit joserbë Qeveria mbulon 50% të investimit në bujqësi, ndërkaq për bujqit serbë ministri Rikallo mbulon 90% të investimit në bujqësi.

E dyta, sipas Programit Qeverisës investimi do të vijë kryesisht nga sektorë privatë, por në kornizë trendi i rritjes së investimeve është dukshëm më i ulët se sa në tri vitet e fundit.

E treta, sipas Programit Qeverisës rritja e të hyrave jen nga eliminimi i evazionit fiskal, por në kornizë trendi i rritjes së të hyrave buxhetore është përgjysmuar krahasuar me vitin 2016. Tek rritja ekonomike tash janë më pak se sa premtimet, jo 8% por 5 - 7, por në kornizë janë vetëm 4 - 5%.

E pesta, në faqen 39 të Programit Qeverisës thuhet se kthimi i TVSH-së do të jetë shumë më i shpejtë, ndërkaq në kornizë shuma e TVSH-së që do ua kthejnë bizneseve për 2019/2021 është e njëjtë si në tri vitet e fundit dhe këtë mund ta shihni në faqen 27 në tabelën 1. Për të realizuar këtë premtim të Programit Qeverisës shuma e kthimit të TVSH-së do të duhej të rritej.

Nën gjashtë, në program në faqe 39 thuhet se pagesa e TVSH-së do të fillojë të zhvendoset nga kufiri në brendi të vendit. Ky është qartë një mashtrim. Në kornizë në tabelën 1, në faqen 27, inkasimi i TVSH-së rritet me 10% për tre vjetët e ardhshme, si në kufi ashtu edhe brenda vendit. Sikur ky premtim të realizohej, atëherë inkasimi i TVSH-së në kufi do të zvogëlohej e do të rritej inkasimi brenda vendit.

Nën shtatë, në Programin Qeverisës parashihet themelimi i fondit për teknologji informative, i fondit për financim të projekteve, i fondit për ndërmarrësi, ndërkaq në kornizë nuk vërehet se do të ketë diçka të tillë në tri vitet e ardhshme.

Prandaj, të nderuar deputetë, është qartë se kjo kornizë e shpenzimeve nuk siguron përmbushjen, as të premtimeve elektorale dhe as të Programit Qeverisës.

Kjo nënkupton se ato premtime kanë qenë mashtrim dhe Programi i Qeverisë është dokument i pavlerë. Projektionet në këtë kornizë nuk janë reale dhe nuk janë konsistente në parametrat e zhvillimit ekonomik. Si rezultat, kjo kornizë nuk mund të shërbejë as si orientim për përgatitjen e buxhetit për vitin që vjen.

Unë ju falënderoj për vëmendjen dhe ju ftoj, që pas debatit që do të bëjmë bashkë këtu në Kuvend, të ulemi bashkë se çfarë mund të nxjerrim një rezolutë nga ky Kuvend për t'u siguruar që të kemi një dokument orientues për Buxhetin e vitit 2019. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! A dëshironi tani në emër të grupit apo e leni këtë që e tha Avdullahu, pastaj diskutoni me radhë. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka zonja Safete Hadërgjonaj.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuari ministër,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe ka vlerësuar këtë dokument si mjaft të rëndësishëm për realizim të objektivave, të cilat Qeveria ia ka vënë vetes për të arritur brenda mandatit qeverisës.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve përmbledh prioritetet e Qeverisë të materializuara në kosto buxhetore. Për herë të parë ne kemi një dokument ku prioritetet që parashihen në 3 vitet e ardhshme janë të specifikuar dhe të ndërlidhura në strategjinë kombëtare të zhvillimit ekonomik, duke u bazuar edhe në masat e parapara në programin për reformë ekonomike 2018-2020, si dhe në programin kombëtar për zbatimin e mekanizmit për stabilizim-asociim.

Duke analizuar me kujdes Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve konstatojmë se është një plan financiar që balancon burimet financiare të mundshme me nevojat prioritare dhe më të domosdoshme, të cilat i kanë qytetarët. Qëllimi i këtij plani trevjeçar vërehet se është planifikimi real i të ardhurave dhe një shpenzim sa më i afërt me qytetarët për një mirëqenie më të mirë për ta. Duke analizuar shifrat shohim se Korniza Afatmesme e Shpenzimeve bazohet ekskluzivisht tek të ardhurat e brendshme, që është baza themelore që u jep forcë reformave ekonomike të parapara në dokumentet strategjike, që i theksova më lart, pa fryrje artificiale siç na ka ndodhur në të kaluarën.



Të nderuar deputetë,

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve ka brenda vetes objektivin kryesor, që Qeveria ia ka vënë vetes, rritja ekonomike e qëndrueshme me qëllim të krijimit të vendeve të reja të punës dhe rritjen e standardit të jetës së qytetarëve. Vitet e fundit Kosovën e ka përcjellë një rritje mesatare ekonomike prej 4% gjatë këtyre tri viteve, parashihet të ketë lëvizje pozitive në drejtim të rritjes ekonomike që parashihet të jetë mesatarisht mbi 5%.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve ka brenda saj edhe menaxhimin e përgjegjshëm të financave publike, duke respektuar rregullën fiskale për deficitin buxhetor në 2% të bruto produktit vendor, si dhe realizimin e objektivave që i ka Qeveria, në arsim, në shëndetësi, në punësim, në qeverisje të mirë, në sundim të ligjit, në industrinë konkurruese, mjedis e infrastrukturë, në mirëqenien sociale, në integrimi euro-atlantik dhe në zhvillimin sektorial. Në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve është planifikuar vlera më e madhe e investimeve publike të realizuara ndonjëherë. Për periudhën 2019-2021 janë planifikuar 860 milionë euro për projekte që përmirësojnë infrastrukturën rrugore, rrjetin e energjisë elektrike, infrastrukturën, në arsim, në shëndetësi, në rrjetin e ujësjellësit dhe të ujitjes, trajtimin e ujërave të zeza e në projektet tjera të rëndësishme për qytetarin e Republikës së Kosovës.

Shpenzimet kapitale përbëjnë 35,1% të shpenzimeve totale apo 11,1% të bruto-produktit vendor përfshi këtu edhe klauzolën e investimeve për projekte kapitale, që do të jetë në interes të gjerë të publikut, duke pasur parasysh menaxhimin e mirë të borxhit publik, në mënyrë që të mos ngarkohen gjeneratat që vijnë pas nesh.

Kolegë deputetë, ne kemi nevojë të fillojmë të mendojmë me përgjegjshmërinë në raport me zhvillimin ekonomik dhe në raport me qytetarin nëpërmjet menaxhimit të financave publike. Çdo të arritur në këtë drejtim duhet ta vlerësojmë. Ky vend ka nevojë të theksohen përparësitë që vendi ynë i ofron në raport me investimet, ka nevojë të dëshmojë stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e shtetit tonë për t'i hapur mundësi investimeve të huaja, zhvillimit ekonomik dhe uljes së papunësisë. Ka nevojë për më shumë pozitivitet e jo të flitet zi e më zi për vendin tonë, shpeshherë pa kurrfarë baze.

Reformat që Qeveria i ka paraparë në objektivat e saj programore në drejtësi, në ekonomi, në sferën politike dhe institucionale, vërehet se janë materializuar në mbështetje financiare sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve. Vlerësimet makro-ekonomike të cilat janë pasqyruar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve tregojnë se gjatë vitit të kaluar, pra vitit 2017, shifrat janë dukshëm më të larta si rezultat i një trendi të rritjes së eksportit, rritjes së investimeve të huaja direkte dhe rritjes së remitencave. Sipas këtyre treguesve të analizuar me maturi pritet që të ketë ndikim pozitiv në ekonominë e Kosovës kërkesa më e lartë për eksporte të mallrave dhe shërbimeve, rritja e remitencave dhe kostoja më e ulët e kreditimit. Bazuar në këta tregues makro-ekonomikë gjatë vitit 2017, gjatë vitit 2019/2020 është paraparë që të hyrat buxhetore të

jenë 27% të bruto-produktit vendor shpenzimet e përgjithshme 31,6% të bruto-produktit vendor, kurse shpenzimet rrjedhëse 20% të bruto-produktit vendor.

Të hyrat pritet të rriten me 5,9% dhe përkundër tendencës rënëse të parashikimit të mbledhjes së detyrimeve doganore dhe reduktimit të tarifave tjera, si rezultat i zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim Asocim. Edhe përkundër kësaj nga përlllogaritjet e bëra shihet se në periudhën afatmesme do të ketë stabilitet. Parashihet të rritet pjesëmarrja e tatimeve direkte në raport me të hyrat totale, kurse TVSH-ja dhe akciza pritet të jenë kontribuuesit kryesorë në vlerë.

Shpenzimet parashihet të rriten për 6.1% të mesatares gjatë vitit 2019/2021, të cilat janë kryesisht rezultat i rritjes së shpenzimeve kapitale, kurse shpenzimet rrjedhëse parashihet të jenë 20% të bruto-produktit vendor. Rritja e shpenzimeve për paga dhe mëditje është bërë për 5% në harmoni me rritjen ekonomike, që parashikohet për këtë periudhë kohore me një pjesëmarrje prej 8,5% të bruto-produktit vendor. Qeveria duhet të fokusohet më shumë në politikat sociale, sepse këto shpenzime parashihet të kenë rritje më të theksuar, sidomos në vitin 2019. Rritja brenda periudhës parashihet të jetë 11,1% krahasuar me vitin 2018 me një pjesëmarrje prej 7,9% të bruto-produktit vendor.

Qeveria duhet t'i rishikojë politikat fiskale, të mos krijojë njerëz që kanë mundësi të punojnë dhe nuk punojnë, duke pritur benificione të cilat ia jep shteti edhe atëherë kur ata, në fakt, nuk i meritojnë benificionet e tilla, sepse nuk i takojnë një kategori të tillë sociale. Prandaj, nuk guxojmë të rrezikojmë buxhetin për shkak të skemave sociale, të cilat po bëhen gjithnjë e më shumë barrë e shtetit tonë.

Sektori i çështjeve ekonomike është planifikuar të ketë rritje vjetore prej 11,8%, që duhet vlerësuar, po ashtu edhe sektori i mbrojtjes së mjedisit 39,7%, qeverisja e përgjithshme publike ka rritje prej 22,6%, shëndetësia po ashtu edhe arsimit janë planifikuar që të kenë rritje gjatë kësaj periudhe. Në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve janë përcaktuar edhe grandet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2019 dhe janë parashikimet për dy vjetët tjera duke u bazuar në projekte strategjike të cilat ia ka vënë vetes për qëllim Qeveria t'i realizojë, qoftë në nivelin qendror, qoftë në nivelin lokal.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e vlerëson këtë planifikim trevjeçar përmes Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve si një planifikim shumë real të orientuar kah zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, rritja e stabilitetit makro-ekonomik dhe fiskal, tërheqjes së investimeve të huaja dhe mirëqenies së qytetarëve.

Ne si grup parlamentar do t'i japim në vazhdimësi mbështetje Qeverisë në realizimin e objektivave të saj drejt zhvillimit ekonomik, uljes së papunësisë në implementimin e reformave

që i hapin mundësi integrimit evropian, duke kryer detyrat tona, të cilat duhet t'i kryejmë brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)*

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Kush do të flasë? Deputetja Arbërie Nagavci, urdhëro.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministër,

Të nderuar qytetarë,

Dokumenti për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021, që është aprovuar në Qeveri dhe të cilën po e shqyrtojmë sot, në fakt nuk reflekton nevojat reale të Republikës së Kosovës, por as vetë premtimet e koalicionit qeverisës PAN për zhvillimin ekonomik prej 8 - 10%, për rritje të punësimit dhe investime në fushat e ndryshme, si në shëndetësi, arsim, mirëqenie, përmirësim të jetës për kategoritë e ndryshme sociale, e tjera.

Besoj se të gjithëve u kujtohen këto premtime e që fatkeqësisht, sikurse edhe në qeveritë e kaluara, premtimet me të cilat po kërkohet besimi i qytetarëve po injorohen tërësisht duke u kujdesur pas ardhjes në qeverisje vetëm për interesat dhe luksin personal dhe të klientëve partiakë. Për më shumë, me këtë Kornizë Afatmesme të Shpenzimeve Qeveria nuk po synon as për realizimin e programit të vet qeverisës.

Në këtë mandat qeverisës do të targetojmë rritje të qëndrueshme ekonomike me normë mesatare prej 5 - 7%, për të arritur këto norma që tejkalojnë substancialisht mesataren e viteve të fundit thuhet, domethënë vazhdon citimi, në programin e qeverisjes për vitin 2017 - 2021. Pra, përderisa ata kishin paraparë edhe në programin e tyre qeverisës rritjen deri në 7%, në KASH është parashikuar se për periudhën 2018/2021 rritja mesatare reale projektohet të jetë 5%. Por, nëse shohim se si e kanë shpërndarë atë gjatë këtyre tri viteve shohim se rritja në fakt nuk do të jetë as 5%. Në nëntor të vitit të kaluar kryeministri Haradinaj dhe ministri i Financave, zori Hamza, paralajmëruan se do të ketë rritje të pagave në sektorin publik nga janari i vitit 2018. Në një vizitë në Ministrinë e Financave Haradinaj kishte deklaruar se një lajm i mirë për Kosovën është që Buxheti për vitin që vjen është një buxhet që garanton stabilitet financiar në vend dhe është një buxhet që po ashtu, siguron rritjen ekonomike dhe rritjen e pagave, dhe atë nga janari i vitit 2018, kishte deklaruar zoti Haradinaj.

Por, ajo që në fakt ndodhi është e ne pamë një rritje të pagave për shërbyesit civilë vetëm 4%, derisa 1 ndër vendimet e para të Qeverisë Haradinaj ishte vendimi arbitrar për rritjen e pagës 100% për vete dhe gjithë Kabinetin qeveritar, gjë që do të ngarkojë Buxhetin e Kosovës për

secilin vit më shumë se 5 milionë euro. Se KASH-i nuk reflekton asnjë mundësi për përmirësimin e situatës jo të mirë në pothuajse të gjithë sektorët u dëshmuar edhe në vet mbledhjen e Qeverisë, kur u diskutua ky dokument, ku përkundër që u mundësua të tregohet se sektorët buxhetorë që janë prioritet i financimit janë arsimit, shëndetësia dhe punësimi, ishin pikërisht ministrat e këtyre ministrive, pra i punës dhe mirëqenies sociale dhe ai i arsimit, ata që kishin vërejtje duke u shprehur edhe nga ana e tyre se kjo mbështetje po mbetet vetëm teorike, pra pa planifikim të buxhetit për të treguar se vërtet këta sektorë janë prioritet për këtë Qeveri.

Përtej mosreflektimit të përmbushjes së premtimeve nga Qeveria Haradinaj, që fatkeqësisht tash nuk është as e re dhe as e papritur, nëse analizohet në detaje KASH-i pothuajse mund të kontestohet secili paragraf i këtij dokumenti. Që në fillim KASH parasheh te korniza e përgjithshme fiskale, faqe 8, racionalizimin e shpenzimeve publike, pastaj faqe 9, rishikimin e politikave dhe ngritjen e efikasitetit të administrimit tatimor dhe doganor në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat, por më poshtë, tek tabelat mund të shihet që në fakt shumica absolute shkon vetëm për infrastrukturë rrugore e më pak mbetet për prioritetet tjera dhe atë kryesisht të financuar përmes klauzolës së investimeve.

Nga ekstraktet e mësipërme shihet që ky KASH më tepër i përngjanë një punimi mesatar seminarik, ku thjesht përmbledhet çdo prioritet i mundshëm i Qeverisë dhe është një lloj shpalosjeje afirmative e aspiratave të kësaj qeverisjeje dhe asgjë më shumë. Por, duhet pasur parasysh se Korniza Afatmesme e Shpenzimeve në fakt nuk paraqet një lloj ushtrimoreje të Qeverisë për të dëshmuar aftësitë e tre planifikuese, por duhet të përkthejë prioritetet qeveritare në matricë të projekteve, të veprimeve dhe alokimeve precize buxhetore. Ndonëse, Qeveria ka përcaktuar si prioritet përmirësimin e cilësisë dhe qasjes në shërbimet shëndetësore në kuadër të këtij sektori ceket në KASH, synohet ruajtja e shëndetit të popullsisë, promovimi i mënyrave të shëndetshme të jetesës dhe ofrimi i shërbimeve cilësore dhe të sigurta shëndetësore me qasje të lehtë, të barabartë, pa rrezik financimi dhe me kosto efektive.

Pra, shihet kjo më tepër tingëllon si propagandë për fushatë zgjedhore dhe jo si KASH, sepse nuk është përcjellë edhe me ndarjen e mjeteve buxhetore për këtë qëllim. Më tutje, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019/2021 shënon se është ndërtuar mbi një skenar makro-ekonomik që parasheh përshpejtim të rritjes ekonomike në vend dhe që koïncidon me optimizëm më të lartë për rritjen në shumicën e ekonomive me të cilat Kosova është e ndërvarur. Brenda periudhës afatmesme shënohet në KASH rritja reale ekonomike pritet të përshpejtohet nga trendi historik prej 4% në një trajektore të re të rritjes deri në 5%. Rritja ekonomike mbështetet në një kombinim të rritjes së kërkesës së brendshme dhe asaj të jashtme.

Këtë pra e citova nga KASH-i dhe tani pyetja është, se sa është e logjikshme që të bëhen të gjitha ato avancime të mëdha në reforma në përforcim të qeverisjes, rritjes së eficiencës, përmirësim radikal të arsimit e shëndetësisë, luftim të korrupsionit, ngushtim të hendekut tatimor,

përmirësim të infrastrukturës bujqësore krejt ndikimi i saj të jetë ky margaritar kalim nga trajektorja e rritjes prej 4% në atë prej 5%-ve. Dhe, pastaj të thuhet se kjo s'ka të bëjë asgjë me këto politikat tona, por me rritjen e kërkesës së brendshme dhe të jashtme dhe përmes përmirësimit të kushteve kreditore, në bazë të çkafit ne mund të dimë se do të përmirësohen këto kushte kreditore, kur në të njëjtën kohë thuhet se popullata është e zhytur deri në fyt në borxhe, e tash po ashtu thuhet se do të marrim edhe më shumë kredi për inkurajim të konsumit privat dhe jo për zhvillim ekonomik.

Mbi këto parashikime makro-ekonomike korniza financiare parasheh që të hyrat buxhetore do të mbarëvijnë pjesëmarrje prej 27% në bruto-produktin vendor. Pra, edhe kjo është pjesë e marrë nga KASH-i, ku një rënie e lehtë në të hyrat si rezultat i implementimit të vazhdueshëm të marrëveshjes për stabilizim Asocim, stimujve tatimor për prodhim dhe planifikim shumë konservativë të të hyrave jotatimore pritet të kompensohen nga përfitimet fiskale si rezultat i masave për reduktimin e informalitetit ekonomik, përderisa më lart në KASH ishte thënë se do të punohej me ngushtimin e hendekut tatimor. Pra, të mos rritet kuota e shtetit në ekonomi.

Sipas ASK-së, përkundër një inflacioni mesatar gjatë vitit 2017 prej 1,5% përmendet në KASH, me çmime të konsumit dhe 4% me çmime të importit, rënia në kosto të investimit dhe eksportit ka bërë që viti 2017 të përmbillet me deflacion prej 0,2% në nivel të bruto produktit vendor.

Edhe kjo deklaratë është krejtësisht e palogjikshme. Si ka mundësi që kur importohet më shumë se 30% të GDP-së dhe të ketë inflacion prej 4%, në fund të dalë se ka pasur deflacion?

Kjo do të demantohet më vonë në faqen 22, kur tregohet që KASH s'ka asnjë rrjedhë logjike dhe nuk është harmonizuar, pasi shihet se është shkruar nga disa persona.

Nëse e shohim grafikun e tretë, rritja në përqindje e importeve dhe eksporteve shihet se ky grafik nuk korrespondon me shpjegimin në anën e djathtë sa u përket përqindjeve, këtë mund ta vërejtë edhe dikush që nuk është ekspert i ekonomisë.

Te tabela e parë, projeksioni për të hyrat tatimore, të hyrat nga tatimet indirekte parashihen të rriten me një mesatare vjetore prej 6,5% gjatë periudhës afatmesme.

Kontributi kyç për rritjen e të hyrave indirekte parashihet të vijë nga TVSH-ja dhe kjo pritet të nxirret nga një rritje mesatare nominale të importeve prej 6,2%, një rritje mesatare e parashikuar prej 5,8% në konsumin privat dhe një rritje mesatare prej 4,8% në blerjet qeveritare të mallrave dhe shërbimeve.

Kjo e vërteton edhe një herë që Qeveria gjithë shpresat për rritje të të hyrave buxhetore i ka të rritja e importeve, është hipokrizi që pretendosh se synon uljen e debalancit tregtar dhe të njëjtën kohë të lavdërohet se do të rritësh të hyrat buxhetore duke shpresuar në rritjen e importeve.

Plus në këtë shpjegim as nuk përmendet fare synimi për uljen e hendekut tatimor në kufij.

Është e rëndësishme edhe pjesa ku përmendet për pagat dhe mëditjet, ku kategoria e shpenzimeve për paga dhe mëditje planifikohet të rritet gradualisht konform rritjes ekonomike, me dy vjet diferencë në një periudhë kohore.

Rritja në këtë kategori të shpenzimeve është planifikuar të mbajë një mesatare prej rreth 5% gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, përderisa pjesëmarrja e përgjithshme e kësaj kategorie në bruto produktin vendor parashikohet të jetë një mesatare prej 8.5% deri në fund të periudhës raportuese.

Ky shpjegim për lëvizjen e pagave është tërësisht i palogjikshëm, meqenëse me asnjë vendim qeveritar nuk kemi rritje të pagave si përgjigje ndaj lëvizjeve makro-ekonomike apo lëvizjes së produktivitetit dhe ashtu pagat nuk mund të rriten në bazë të rritjes së bruto produktit...

**KRYESUESI:** Faleminderit! Tani sipas radhës i jap fjalën Grupit Parlamentar të Partisë Social Demokrate, nuk është paraqitur askush. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, po ashtu nuk ka të paraqitur. Lista serbe? Grupi Parlamentar Nisma, jo! Grupi Parlamentar 6+, askush. Përfaqësuesi i Qeverisë, nëse dëshiron të marrë fjalën, urdhëro, ministri i Financave e ka fjalën.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar zoti nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të prezantoj para jush Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2019-2021, dokument që e reflekton përkushtimin e Qeverisë në adresimin e sfidave zhvillimore afatmesme të elaboruara në dokumentet tona strategjike, si programi i Qeverisë, programi për reforma ekonomike, programi kombëtar për zbatimin e MSA-së, strategjia kombëtare e zhvillimit ekonomik dhe dokumente të tjera strategjike.

Ne e kemi ruajtur një konsistencë dhe një vijueshmëri të dokumenteve, të cilat i kemi në fuqi, pavarësisht se disa prej këtyre dokumenteve janë aprovuar dhe janë diskutuar në mandatin e kaluar.

Ky dokument nuk është vetëm një kornizë buxhetore, po është një instrument i privatizimit dhe realizimit të objektivave të programit të Qeverisë përmes procesit buxhetor.

Para se të flas në detale për përmbajtjen e kornizës, fillimisht dua t'ju informoj mbi procesin që kemi ndjekur deri në finalizimin e këtij dokumenti.

Procesi i përgatitjes së këtij dokumenti ka filluar në shkurt të këtij viti, ku paralelisht është punuar në këto drejtime.

Duke u bazuar në dokumente strategjike të Qeverisë, Zyra për Planifikim Strategjik pranë Kryeministrit, në konsultim me institucionet e tjera relevante, ka punuar në pjesën e prioriteteve strategjike të Qeverisë, ku tregohet se cilët sektorë buxhetorë do të marrin mbështetjen më të lartë, kjo është pjesa e parë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve.

Njësia makro-ekonomike brenda Ministrisë së Financave ka përgatitur projeksionet ekonomike fiskale, duke na dhënë parashikimet e parasë publike në dispozicion për shpenzim gjatë tre vjetëve të ardhshme, kjo është pjesa e dytë e kornizës.

Departamenti i buxhetit në Ministrinë e Financave, pas marrjes së imputeve nga të gjitha ministritë dhe institucionet e tjera publike ka përgatitur pjesën sektoriale të kornizës si bazë për zhvillimin e procesit buxhetor, që është pjesa e tretë e këtij dokumenti.

Paralelisht Ministria e Financave në koordinim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Arsimit si dhe në Komisionin e granteve ndërqeveritare ka përgatitur pjesën e katër që ka të bëjë me financimin e komunave nga grantet e nivelit qendror.

Pra, hartimit të kësaj kornize i ka paraprirë një proces i gjatë i konsultimeve me të gjitha organizatat buxhetore, ku ndër të tjera është kërkuar që të përcaktojnë objektiva dhe prioritetet e tyre të matshme dhe nevojat e tyre për financim për periudhën 2019-2021.

Tani më lejoni t'ju mbuloj më në detaje pjesët kryesore të kësaj kornize.

Pjesa e parë: pjesa e parë e këtij dokumenti i elaboron në detaje prioritetet strategjike të Qeverisë që rrjedhin nga një numër i dokumenteve tona strategjike.

Për periudhën 2019-2021 fusha prioritare përcaktojnë rangimin brenda 10 sektorëve buxhetorë që janë përgjegjës për implementim.

Sipas deklaratës afatmesme të prioriteteve, këto fusha janë:

Arsimi, punësimi dhe shëndetësia, prandaj edhe sektorët buxhetorë që kanë prioritet financimi janë: arsimi, shëndetësia dhe sektori përcjellës, mbrojtja sociale.

Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit: ky sektor buxhetor bartës janë rendi, ligji dhe siguria publike, ndërsa sektor përcjellës është qeverisja e përgjithshme publike.

Industritë konkurruese, duke dhënë kështu prioritet sektorit buxhetor për çështjet ekonomike.

Infrastruktura dhe ambienti, ku sektor bartës buxhetor është çështja ekonomike, ndërsa sektor përcjellës mbrojtja e mjedisit.

Integrimi evropian, politika e jashtme dhe çështjet e sigurisë me sektorët bartës qeverisja e përgjithshme dhe sektorët përcjellës mbrojtja, rendi, ligji dhe siguria publike.

Pjesa e dytë: Projektionet ekonomike e fiskale janë përgatitur duke marrë për bazë të gjitha politikat, të cilat janë duke u implementuar si dhe supozimet për politika të reja të inkorporuara në kornizën makrofiskale.

Zhvillimet e fundit ekonomike, të shoqëruar me implementimin e politikave të orientuara drejt rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe reforma strukturore japin indikacione për rritje mesatare relativisht të lartë ekonomike.

Duke u bazuar në këto projeksione, rritja ekonomike do të vazhdojë të jetë e nxitur kryesisht nga investimet, eksporti dhe konsumi.

Në veçanti investimet publike dhe private priten të kenë rol më të theksuar në rritjen e ekonomisë.

Për sa i përket rritjes së ekonomike për vitin 2019, rritja reale pritet të jetë rreth 5%, ndërsa dy vjetët vijuese edhe më e lartë se 5%, duke arritur me 5,3% në vitin 2021.

Kjo rritje e projektuar bazohet në atë që ne i referohemi si projektionet e bazuara në skenarin bazë.

Në anën tjetër, nën supozimin e implementimit të një numri të projekteve zhvillimore të përcaktuara me programin e Qeverisë, siç janë: projektet në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhe, zhvillimi i kapaciteteve të reja për prodhimin e energjisë elektrike, përmirësimi i infrastrukturës bujqësore në funksion të agrobiznesit, përfshirë këtu edhe rritja e investimeve në sektorin privat, si rezultat i reformave të reja institucionale dhe fiskale.

Rritja reale ekonomike mund të shkojë mes 6 dhe 7% brenda kësaj periudhe afatmesme, nën supozimin se realizohen investimet e lartcekura.



Mbi bazën e këtyre projeksioneve ekonomike, ne kemi bërë projeksionet fiskale, respektivisht të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

Sa u përket të projeksioneve të hyrave buxhetore, ato pos që bazohen në vlerësimet afatmesme të indikatorëve kyçë makroekonomikë, përfshirë këtu lëvizjen e importit dhe çmimeve, këto vlerësime supozojnë një përmirësim të performansës së institucioneve përgjegjëse, respektivisht Administratës Tatimore dhe Doganës.

Duke u bazuar në këto supozime, të hyrat e përgjithshme buxhetore në vitin 2019 priten të jenë në vlerë një miliard e 923 milionë euro, ndërsa deri në fund të vitit 2021 ato priten të arrijnë në dy miliardë e 160 milionë euro.

Nëse krahasojmë vitin 2021 me vitin 2018, të hyrat e përgjithshme priten të rriten me 18,9%.

Nëse u referohemi vetëm të hyrave tatimore, të cilat përfshijnë të hyrat nga tatimet në kufij dhe të hyrat nga tatimet brenda vendit, deri në fund të vitit 2021 vlerësohet të arrijnë shumën një miliard e 941 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 21% krahasuar me vitin 2018.

Kjo normë e rritjes është mjaft më e lartë se norma e projektuar për rritje ekonomike, një sinjal i asaj se ne presim të rrisim efektshmërinë e Administratës Tatimore të Kosovës dhe të Doganës dhe të ulim informalitetin si një prej prioriteteve tona.

Në anën tjetër, shpenzimet e përgjithshme gjatë periudhës së projektuar 2019-2021 pritet të shënojnë një ngritje të vazhdueshme, duke arritur në vlerë prej 2 miliardë e 483 milionë në vitin 2021. Kjo përfaqëson një rritje të ndjeshme prej rreth 19.3% krahasuar me vlerën e buxhetuar të shpenzimeve për vitin 2018.

Edhe më tutje, gjatë periudhës 2019-2021 shpenzimet kapitale do të prijnë si kategoria më e madhe ekonomike e shpenzimeve, duke shënuar një rritje mbi 25% nëse e krahasojmë vitin 2021 me buxhetin e vitit 2018.

Vlera e shpenzimeve kapitale në vitin 2021 pritet të arrijë në 869 milionë euro.

Në krahasim me total shpenzimet, shpenzimet kapitale përgjatë periudhës afatmesme pritet të përfaqësojnë rreth 35% të shpenzimeve totale, nga 27% në vitin 2017, apo një mesatare rreth 11% të bruto produktit vendor për vitin 2019-2021.

Rrjedhimisht kjo kategori e shpenzimeve gjatë periudhës afatmesme do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritjen e pjesëmarrjes së sektorit privat përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës.

Në kontestin e projekteve individuale, pjesa më e rëndësishme e investimeve kapitale mbeten projektet; autostrada Prishtinë-Shkup, autostrada Prishtinë-Gjilan, projekti i rrugës EM2 për Mitrovicë, EM3 për Pejë dhe rruga për Podujevë.

Përfundimin e ndërtimit të autostradës Skenderaj-Drenas, zgjerimin e rrugës Dollc-Gjakovë dhe Qarku i Gjakovës.

Projekti për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10, projekti për rehabilitimin e kanalit Ibër-Lepenc, projekti për rehabilitimin e rrugëve rajonale, trajtimi i ujërave të zeza do të ketë prioritet, ku gjatë vitit që vjen pritet të fillojë implementimi i projektit për kryeqytetin e Prishtinës, Fushë-Kosovën dhe Obiliqin, projekti për konkurrueshmërinë dhe gatishmëria për eksport dhe investime të tjera për përmirësimin e infrastrukturë lokale sportive, arsimore dhe projekte të tjera, të cilat krahasuar me vitin e kalitur kanë shënuar një rritje të ndjeshme.

Në kuadër të financimit përmes klauzolës së investimeve, ne kemi përfshirë vetëm projektet të cilat kanë parapërgatitjen e duhur dhe ku interesimi për institucionet financiare ndërkombëtare ekziston dhe kemi kontrata të lidhura.

Rritjet e shpenzimeve janë planifikuar edhe te kategoritë e tjera ekonomike.

Kategoria e pagave dhe e mëditjeve në vitin 2021 pritet të arrijnë në 673 milionë, ose një rritje 14% krahasuar me vitin 2018.

Kategoria e mallrave dhe e shërbimeve në vitin 2021 planifikohet të arrijë në 351 milionë euro, ose një rritje prej 32% krahasuar me vitin 2018, këtu duhet të japim një sqarim.

Në të kaluarën, për arsye të ndryshme, një shumë e konsiderueshme e shpenzimeve që sipas standardeve klasifikohen si shpenzime për mallra dhe shërbime, janë klasifikuar si kapitale.

Tani ne kemi bërë korrigjimin, duke rritur kështu transparencën dhe duke siguruar klasifikim të drejtë të shpenzimeve dhe duke marrë për bazë rritjen e ndjeshme të shpenzimeve kapitale, stoku kapital në vend është rritur mjaft shumë dhe ne duhet të sigurohemi në mirëmbajtjen adekuate të këtij kapitali.

Këtu e kanë fjalën për mirëmbajtjen e rrugëve, shkollave, spitaleve, e assesi nuk kemi planifikuar rritje të shpenzimeve administrative.

Në vijim i kemi të shfletuara edhe shpenzimet e tjera nëpër kategori. Mirëpo mund të them se është një projeksion real, i bazuar...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e deputetëve, sipas radhës së paraqitjes, por unë paraprakisht dëshiroj të njoftoj seancën që kolegja, deputetja Emilija Rexhepi ka njoftuar Kryesinë e Kuvendit që nga sot është pjesë e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Fjalën e ka deputeti Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Ne sot diskutojmë këtu për dokumentin më të rëndësishëm financiar të Kosovës dhe rrjedhimisht e di që është bërë klishe, por kishte qenë e udhës që të gjithë ministrat e Qeverisë të ishin sot të pranishëm, sepse flitet për tri buxhetet e ardhshme të dikastereve të tyre. Pra, kot e kanë punën me fotografi e me dokumente e me strategji, kur nuk janë këtu për të kërkuar ose për të debatuar rreth fondeve të tyre financiare për tre vjetët e ardhshme, pra për gjithë periudhën dhe mandatin e tyre qeverisës.

Ne sot diskutojmë jo vetëm për anën financiare të buxhetit, diskutojmë edhe për pjesën makroekonomike, pra të zhvillimit, të rritjes, të punësimit e stabilitetit social në vend.

Dhe, si i tillë, me gjithë elementet në fjalë, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve projekton pasqyrën tonë ekonomike për tre vjet e ardhshme.

KASH-i tregon se ku do të jemi tre vjet më pas dhe me këtë projektim tonin konsideroj se janë disa elemente që duhet shterur.

Pa dyshim elementi më i rëndësishëm i dokumentit në fjalë është ai i projeksionit të rritjes ekonomike. Pra, të faktit për sa rritet dhe zhvillohet ekonomia jonë për këto tre vjet, cila do të jetë shpejtësia jonë ekonomike.

Dhe në faqen 17 të dokumentit të fjalë jepet përgjigjja për këtë.

Aty thuhet se brenda periudhës afatmesme rritja ekonomike pritet të përshpejtohet nga trendi historik prej 4% në një trajektore të re të rritjes prej 5% dhe thuhet se ky parashikim bëhet me një optimizëm të lartë, pra me një optimizëm të lartë rritja ekonomike në Kosovë do të jetë 5%.

Dhe, jo shumë larg nga sot, saktësisht më 28 maj të vitit të kaluar gjatë fushatës zgjedhore koalicioni PAN, dy njerëz kyçë sot të qeverisjes në Kosovë, kryeministri dhe kryetari i Kuvendit, kishin premtuar rritje ekonomike prej 8 deri në 10% në vit.

Në 100 ditët e para të qeverisë tonë, thoshin, do të ulim tatimet në të ardhurat të korporatave, do të dyfishojmë buxhetin për bujqësi, do të trefishojmë eksportet e do të kemi rritje ekonomike 8 deri 10%.

Se dokumenti në fjalë s'ka lidhje jo me premtime zgjedhore, por as me dokumentin qeverisës që është prezantuar në Parlament, krahasoni edhe me rritjen ekonomike.

Pra, në dokumentin qeverisës të Qeverisë së Kosovës për tre vjetët e ardhshme rritja ekonomike do të jetë 7%. Në këtë dokument numri 7 nuk paraqitet askund, rritja ekonomike do të jetë 5%.

Dhe, kalimi prej 10 në 5% nuk është zvogëlim i një numri të thjeshtë, është në fakt përgjysmim i ecjes sonë.

Tash që ta keni të qartë, rritjen ekonomike prej 5% në vit Kosovës do t'i duhen plotë 32 vjet për të arritur Kroacinë, me 5% rritje ekonomike do t'i duhen 70 vjet për ta arritur mesataren evropiane.

Pra, paramendoni me këtë projeksion Kosovës do t'i duhen tri dekada për ta arritur Kroacinë e 7 dekada të tjera për të arritur mesataren evropiane.

E po të kishim rritje ekonomike prej 10%, çfarë është premtuar, kjo periudhë tridekadëshe e Kroacisë do të përgjysmohej në 15 vjet, e mesatarja evropiane në 35 vjet.

Pra, me dokumentin e tanishëm, me kalimin prej këtij 10% të premtuar në 5% të dokumentuar, Qeveria i thotë një gjenerate të tërë se vendi i tyre, shteti i tyre do të mbetet pak a shumë ky që është, më i varfëri në Evropë, më i papuni në Evropë, më i pazhvilluari në Evropë, gjysmë jete larg Kroacisë, një jetë të tërë larg mesatares së Evropës.

Gjeneratës së tanishme me kesi projeksioni i thuhet se jeta e tyre praktikisht në Kosovë është e humbur dhe ata s'kanë çka lypin këtu.

Atëherë pse ndodh ky nënzhvillim? Pse nuk kemi rritje dyshifrore, sa është premtuar e sa na duhet e sa mund të bëhet në Kosovë?

Ndonëse në thelb të nënperformansës sonë ekonomike mund të gjenden shumë faktorë, nga ata historikë e deri te këta të mosdijes e të kapjes, besa. Mënyra e shpërndarjes së parasë publike, mënyra se si e shpërndajnë buxhetin është në thelb të kësaj ngecje. Për ta thënë troç, buxheti i Kosovës ky që kemi sot dhe tre të ardhshëm që do t'i kemi e që na u prezantuan në këtë dokument janë buxhete të paqes sociale, janë buxhete të blerjes së paqes sociale, janë buxhet që

mirëmbajnë, që paguajnë paqen sociale dhe nuk janë buxhete që krijojnë zhvillim e as që ofrojnë shërbim.

Pra, ky buxhet dhe buxhetet e ardhshme do të japin para për skema përfituesish nga më të ndryshmet, jep para për përfitues të punës publike, për një administratë hiper të madhe, jep para për skema të ndryshme përfituese nga ata të paraluftës, të luftës e deri të pasluftës. Buxheti është shndërruar në një thes, ku të gjithë qytetarët nuk marrin pjesë, po një kategori e dhënë varësisht prej kontributit ka të drejtë më tepër.

E tani, merreni me mend, nga 2 miliardë euro sa i ka ky buxhet, do të shpërndahen secilin vit nga 600 milionë euro veç për pagat e administratës publike dhe do të japin 600 milionë të tjera edhe për skema sociale dhe do të japin edhe 300 milionë tjera për mallra dhe shërbime, pra prej 2 miliardë eurove, 1,5 miliard i japin për ta mirëmbajtur një administratë publike që mirëmban shtetin e Kosovës dhe mbesin vetëm 500 milionë euro të tjera për të bërë investime kapitale në Kosovë në vit.

Kjo formulë s'mund të japë rritje ekonomike prej 10%. Ajo na ka dhënë gjithmonë do të na japë për tre vjetët e ardhshme rritje ekonomik 5% dhe Kosovës i duhet një transformim rrënjësor i këtij proporcioni.

Buxheti i Kosovës s'mund të durojë këtë ngarkesë dhe s'mund të durojë shpërndarjen e parave, qindra-miliona euro në skema të tilla.

Buxheti i Kosovës nuk është fond i pagesës, buxheti është mjet i Qeverisë për të bërë zhvillim.

Mos harroni, vendimet populiste për paqe sociale kanë dërguar shumë vende në krizë. Kosovën këto vendime e kanë mbajtur në krizë tash e 20 vjet dhe, ta dimë këtu dhe t'u themi qytetarëve tanë se me buxhete të tilla për këto tri dekada e gjysmë pas Kroacisë, ne do të mbesim edhe pa spitale, edhe pa shkolla, edhe pa gjyqësi. Neve na duhet zgjidhje, një zgjidhje që buxheti në fjalë e transformon.

Tash në secilin matje edhe perceptcion publik qytetarët tanë i kanë tri brenga. E kanë arsimin, e kanë shëndetësinë dhe e kanë gjyqësinë.

Këto janë tri hallet kryesore të qytetarëve tanë: ata duan shkollim më të mirë, duan shërbime më të mira shëndetësore, duan rend dhe ligj. Të tri këto elemente, bashkë me investime kapitale, po të adresohen mirë, do të japin edhe rritjen dhe stabilitetin ekonomik në vend.

Tash për qartësim, sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Hyrat Buxhetore të Kosovës në mesatare secilin vit do të rriten nga 6%, për aq do të rriten edhe shpenzimet e buxhetit. Pra, çdo

rritje e buxhetit në këto kategori për 6% është proporcionale, është e njëjtë me rritjen e të hyrave gjithandej.

Sipas KASH-it, në tre vjetët e ardhshme shpenzimet në arsim do të rriten për 7.8%, pra të hyrat e përgjithshme rriten për 6%, shpenzimet në arsim rriten për 7.8%. Nuk ka ndonjë përzierje proporcionale brenda buxhetit që e transformon këtë fond të shpërndarjes së parasë publike.

Ky transformim nuk ndodh as në shëndetësi, rritja jonë vjetore atje do të jetë 4.1% dhe me gjithë këtë rritje simbolike, përgjatë tre vjetëve të ardhshme Kosova do t'i shpenzoj vetëm 2.9% të GDP-së në shëndetësi, pra të tërësisë së ekonomisë sonë.

Për krahasim, vendet në rajon nga tërësia e ekonomisë që kanë i shpërndajnë, si Bosnja, Kroacia e Sllovenia, nga 7% në shëndetësi, pra e marrin 7% të GDP-së së tyre të ekonomisë, të vlerës që e kanë dhe e dërgojnë në shëndetësi. Ne mbesim për tre vjetët e ardhshme me 2.9%, nuk po flas për shumën të parave, po flas për proporcionin me tërësinë ekonomike që e kanë.

Dhe nuk do të kemi as ndryshim në rend dhe ligj, sepse ne do ta rrisim buxhetin nga 1.7% secilin vit, më pak se i rrisim të hyrat dhe shpenzimet në të gjitha kategorinë e tjera.

Dhe si vendi më i korruptuar në Evropë, si vendi me numrin më të madh të rasteve të pazgjidhura në gjyqësor, si vendi me besimin më të ulët në gjykata e prokurori, ne do të duhej të kishim një imput marramendës financiar në gjyqësi. Pra, na duhen impute të mëdha financiare në arsim, në shëndetësi dhe gjyqësi për të transformuar projeksionin tonë ekonomik.

Saktësisht, neve do të na duhej: e para, ristrukturimi i të gjitha skemave të përfituesve që kanë hise sot në buxhetin e Kosovës.

E dyta, të kemi kufizim në administratën publike dhe të nisim një plan të kursimit financiar, në mënyrë që të financojmë projekte që krijojnë rritje.

E treta, t'i rrisim shpenzimet buxhetore për arsim nga 4% të GDP-së, në 7% të GDP-së.

E katërta, të rrisim shpenzimet buxhetore për shëndetësi nga 2,9, në 8% të GDP-së, pra t'i trefishojmë këto shpenzime në shëndetësi.

E pesta, t'i rrisim shpenzimet buxhetore për rend dhe ligj nga 1,7, në 6% të GDP-së.

Dhe, në qoftë se investimet kapitale i kanalizojmë përtej investimeve në asfalt e projekte të vetme, atëherë do të kishim edhe transformimin në fjalë.

Me politika të reja, të guximshme gjithsesi, ne do të mund të kthejmë rrugën e ecjes sonë mbarë dhe mund të kapërcejmë përfundimisht nga rritja ekonomike 5% në 10% dhe derisa nuk e bëjmë këtë punë, derisa nuk arrimë rritje ekonomike 10%, dyshifrore, ne do të mbesim 35 vjet larg Kroacisë e 70 vjet larg mesatares evropiane. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ali Lajçi.

ALI LAJÇI: Të nderuar qytetarë,

Unë do të provoj të bëj një qasje pak më ndryshe, disa prej kapitujve që trajtojnë këtë kornizë buxhetore 2019-2021, e që unë jam shumë dakord me trajtimet që u bënë atje në fushën e buxhetit, të financës nga kryetari i komisionit, madje edhe nga parafolësit, e që çështjet buxhetore dhe zhvillimet e përgjithshme ekonomike varen shumë prej Qeverisë dhe programeve të tyre që në fillim, çfarë ato janë dhe synimet e atyre programeve, madje edhe destinimet buxhetore me ata sektorë apo fusha dhe lëmi të caktuara të zhvillimit të përgjithshëm, e sidomos kur synohet një rritje ekonomike janë shumë me rëndësi edhe destinimet buxhetore në ato lëmi. U pa këtu sipas shifrave, ne patëm një evidentim të mirë të ecurive të përgjithshme ekonomike dhe të disa parametrave, të cilët faktikisht në një mënyrë janë edhe synueshëm, madje të realizueshëm pjesërisht dhe hope-hope, por edhe me rënie pastaj.

Mirëpo, ç'është me rëndësi se te ne ekskluzivisht mbetet një çështje për t'u parë më vonë se a ka Qeveria një strategji për mbledhjen, akumulimin buxhetor edhe më tej dhe duhet të bëjmë që Kuvendi i Republikës ta iniciojë një zyrë të ekspertëve për analiza dhe strategji buxhetore, të cilën nuk e kemi, e që do të duhej të ishte një qasje shumë më racionale dhe më e qëndrueshme në kuptim të zhvillimeve të përgjithshme, qofshin ato ekonomike, madje edhe të menaxhimeve buxhetore. Ne e kemi edhe një konstatim ekskluziv të akumulimit të buxheteve nga Doganat, që faktikisht ekziston në shtetet çfarë jemi ne të rajonit dhe respektivisht Kosova, por një shpërndarje e funksionimit të sistemit në fushën tjetër administrative dhe në fushat tjera tatimore te ne ka munguar dhe në këtë rast edhe më tej mbeten si buxhet ekskluzivisht për vjeljen dhe deponinë e tij janë Doganat, që unë mendoj gjithnjë sa të zgjasë kjo ne do të jemi prapa një zhvillimi të përgjithshëm të sistemit.

Do të shikohej dhe diku u përmend me të drejtë çështja e borxhit publik, të cilin e kemi dhe si e menaxhojmë me kohë të caktuara. Pastaj, sesi menaxhohen skemat sociale, por edhe në mënyrë të veçantë realizimi dhe menaxhimi i buxhetit në projekte kapitale. U pa se zhvillimet ekonomike janë çfarë janë, dhe u pa që ne buxhetin nuk e çojmë në një destinim të rritjes me çdo kusht të zhvillimeve ekonomike, por buxheti në pjesën dërrmuese të tij shpenzohet për paga dhe mëditje, kurse në projektet kapitale kemi filluar diçka, por faktikisht atje nuk kemi arritje të dëshirueshme. Në shumë çështje tjera mund të shikojmë edhe sesi është shpenzuar buxheti në këtë periudhë paraprake për ta pasur pastaj edhe një model të ecurive apo dinamikave të mëtejshme në këtë periudhë që do të hyjmë, në 19-21. Shikoni, ne tash jemi në një kohë kur do të

duhej të bëhej rishikimi buxhetor, do të thotë qershori, dhe do të duhej të kishim buxhetin sigurisht të mundshëm për rishikim, e faktikisht ne nuk e kemi dhe madje-madje as nuk mund të hyjmë në këtë proces të rishikimit buxhetor për arsye se nuk e kemi menaxhuar mirë buxhetin dhe e kemi ndarë në kapituj të veçantë në mënyrë ad hoc dhe madje për interesa të shumta, të cilët veç janë të identifikuar tash për çfarë.

Prandaj, kur e shtrojmë çështjen eventuale të rishikimit buxhetor, ne tani madje frenohemi ta përmendim për arsye se po të hyjmë në atë proces, ne kemi shumë organizata, kërkesa, madje të gjithanshme në të gjitha fushat, sa edhe po të hyjmë në to, do të mbetemi kot. Prandaj, për gjithë këto, unë mendoj që duhet të kemi kujdes në menaxhimet buxhetore, në planifikimet e tyre, realizimin e tyre, të cilat nuk shkojnë karshi deklarimeve apo objektivave që faktikisht Qeveria niset dhe ne ende lëngojmë për shkak të menaxhimeve të dëmshme dhe të dobëta në shumë fusha të sektorit, siç janë shëndetësia, pastaj arsimi, e shumë fusha të tjera, e që në programe parashikohet përmirësimi dhe rritja e tyre rreth investimeve buxhetore, por faktikisht pastaj edhe ndërrohen destinimet. Ta zëmë, ne i kemi edhe disa prej projekteve kapitale, siç është, po e përmend aty shpejt, ta zëmë rrugën Kijevë - Klinë - Pejë e tjera, një buxhet i cili realisht ka qenë i rezervuar dhe është, por e kemi edhe një hua atje të favorshme, por ende nuk ka filluar, dhe dinamikat e saj pastaj të shpijnë të mendojmë, se a thua edhe destinimet mund të ndërrohen, edhe pse janë të përcaktuara qartë.

Prandaj, e gjithë kjo është një çështje që neve na mbetet me një përkushtim më ndryshe, sepse ne nuk mund të bëjmë rritje ekonomike kur nuk e kemi asnjë synim për ta përmirësuar mirë funksionimin e shtetit ligjor. Në qoftë se ne nuk e kemi funksionimin e shtetit ligjor nuk kemi investime. Nuk u garantohet përfitimi e profiti investuesve, sepse nuk beson në ligjshmërinë tonë dhe në këtë rast të ardhurat e investimeve janë të mangëta dhe ne këtu ngecim dhe në këtë temë sigurisht qeveritë edhe përpara nuk e kanë dashur shumë, për arsye se arbitrariteti në jetën tonë politike është ai i cili ka krijuar kushte të korrupsionit që ato të mos kontrollohen nëpërmjet të sistemit ligjor dhe objektivave që faktikisht do të mund të kishim edhe në drejtime tjera të përmirësimit të kushteve dhe standardeve që ne i tentojmë kah integrimi evropian e tjera. Kurse vullneti ynë shumë i madh është që të kërkohen vizat, që të plotësohen standardet, por gjithnjë nëpërmjet vullnetit, por jo nëpërmjet punëve të mira brenda vendit.

Prandaj, njëra prej çështjeve kyçe është kjo e buxhetit dhe strategjia më tej e menaxhimit të tij të mirë dhe mbulimi i fushave, në të cilat qytetarët e republikës faktikisht ende lëngojnë për menaxhim të dobët. Mbetet për të parë se edhe kjo kornizë sipas këtij trendi menaxhues, sado që diku-diku e kemi të ravijëzuar mirë në kuptim të synimeve, por praktikat menaxhuese mbeten shumë pak dhe mbeten mjaft skeptike në realizim. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Të nderuar kolegë, ju njoftoj që të gjithë kolegët deputetë që e kanë kërkuar fjalën deri më tani janë të Grupit Parlamentar të LDK-së dhe të Lëvizjes Vetëvendosje,



kështu që sipas radhës ia jap fjalën deputetit Haxhi Avdyli. Domethënë që të jetë e qartë që s'po e kapërcej radhën, por s'ka deputetë të grupeve tjera parlamentare të paraqitur për fjalë.

Urdhëro, Haxhi!

HAXHI AVDYLI: Faleminderit, nënkryetar!

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve tregon që është një kornizë, e cila më shumë parasheh paqe sociale e jo zhvillim ekonomik, jo rritje të investimeve, jo një strategji për një Kosovë më të zhvilluar në vitet e ardhshme.

U tha edhe më herët nga parafolësit, por unë sot këtu do të ndalem më shumë në prioritetin e deklaruar të kornizës afatmesme, siç janë arsimit, punësimi dhe shëndetësia, të cilat si duket edhe në këtë kornizë mbeten vetëm prioritete formale, sepse ndarja e buxhetit nuk e reflekton këtë gjë në këtë kornizë. Përderisa buxheti për vitin 2019 është planifikuar të rritet në 8,7%, fondet për arsim janë të planifikuara vetëm në 7,8%. Edhe pse kemi rënie të numrit të nxënësve, unë besoj që këto investime do të shkojnë në rritjen e cilësisë në arsim dhe mendoj që në këtë drejtim do të duhej që në sektorin e arsimit t'i jepet prioritet edhe më i madh buxhetor dhe shpresoj që kjo do të përmirësohet në buxhetet e ardhshme, sepse arsimin dhe përmirësimin e cilësisë ne duhet ta konsiderojmë si aset kombëtar.

Është një lajm i mirë rritja e grantit komunal për shëndetësi, që shkon në forcimin e mjekësisë familjare, por kjo nuk është edhe rritje e shpenzimit të përgjithshëm për shëndetësinë, e cila shkon vetëm në 4,1%. Shpenzimet e Qeverisë në bazë të bruto-prodhimit vendor janë dhe mbeten më të ulëtat në rajon, nën 3%, dhe është ndarja më e ulët pas Shqipërisë për shëndetësi. Shpenzimet 4% për arsim mbeten si një mesatare në rajon, por mendojmë që ne do të duhej ta kishim edhe më të lartë. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve nuk e ka asnjë informacion për skemat e reja të planifikuara, siç janë përfituesit e arsimtarëve të viteve të '90-ta, po ashtu të policëve, por edhe për lehonat. Edhe në këtë kornizë ka shumë fjalë premtuese për sektorin e shëndetësisë se do të punohet, po punohet në rritjen e financimit të qëndrueshëm e gjëra të tjera, përmenden edhe sigurimet shëndetësore, përmendet edhe sistemi i informimit shëndetësor, por zhvillimet e deritashme të reformës në shëndetësi s'janë aspak premtuese.

Ka ngecje të reformës në të gjitha sektorët, duke përfshirë edhe reformën financiare dhe shpresat për instalimin e sigurimeve shëndetësore çdo ditë e më shumë po zbehen. Në tabelën e nëntë, këtu në këtë dokument të paraqitur, ku paraqiten trendët e shpenzimeve dhe vlerësimit të periudhës 2019-2021, shihet që rritja e buxhetit për shëndetësi është e mangët, domethënë nga 146 milionë në 173 milionë, por ajo që më ra në sy është që numri i punëtorëve në këtë sektor do të mbetet 2 386 për të gjitha vitet, duke filluar nga 2017 deri në 2021, që do të thotë se ne nuk do të kemi punëtorë të ri në këtë sektor dhe kjo duhet të kuptohet që ne nuk kemi nevojë as për Fakultet të Mjekësisë, as për Fakultet të Infermierisë, sepse punëtorët, të cilët janë të planifikuar

në shëndetësi deri në 2021, dhe do të shpresohet në të vetmin punësim që do ta kemi ndonjë pensionim të ndonjë punëtori shëndetësor, dhe në këtë drejtim ndoshta Fakulteti ynë i Mjekësisë dhe fakultetet tjera të shëndetësisë vetëm do të prodhojnë kuadro, të cilat do t'i eksportojmë në Evropë, siç edhe po ndodh deri më tani.

Mendoj që me këtë Kornizë Afatmesme të Shpenzimeve edhe një herë po tregojmë që nuk do të kemi një sektor të shëndetësisë më cilësor, nuk do të kemi institucione me shërbime më të mira, si diagnostike, terapeutike, por edhe nuk do të kemi një arsim të mirëfilltë, i cili do të na ndihmonte që Kosovën ta vendosnin në binarë të zhvillimit afatgjatë ekonomik dhe do të krijonim një mirëqenie të mirë si ekonomike, si sociale, si shëndetësore. Mendoj që kjo kornizë afatmesme më shumë është koncentruar në mbajtjen e një status quo-je dhe një rahatje apo një stabiliteti social, e jo një ekonomi apo një Kosovë të zhvilluar, e cila do të ishte një Kosovë e prosperueshme dhe me tendencë të integritit në vendet evropiane. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën ia jap deputetit Shemsi Sylja.

SHEMSI SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër i Financave,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në dokumentin Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021, të aprovuar nga Qeveria e Kosovës në prill të vitit 2018, në kuadër të sektorit të mbrojtjes theksohet se ky sektor është duke i ngritur në vazhdimësi kapacitetet e saj, duke u bazuar në rekomandimet e dala nga procesi i rishikimit të sektorit strategjik të sigurisë. Rrjedhojë logjike e kësaj analize është rekomandimi për transformimin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ministri të Mbrojtjes dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës.

Pra, objektivi kryesor në kuadër të sektorit të mbrojtjes është finalizimi i procesit parapërgatitor për transformimin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Kosovës, sipas rekomandimeve të rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë. Sipas tabelës së paraqitur në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për sektorin e mbrojtjes parashihet një rritje e buxhetit nga 53,6 milionë në vitin 2018 në 66,6 milionë euro në vitin 2021. Nëse e analizojmë rritjen mesatare në përqindje për çdo vit, nga viti 2018 deri në vitin 2021 vërejmë se kemi një rritje të planifikuar vjetore të buxhetit në mesatare 7,5%. Rritje në shifra ka pasur për çdo vit, por këto rritje nuk kanë mbetur stabile deri në fund të vitit fiskal. Prandaj, rritja nga 7,5% është e pamjaftueshme, por edhe do të jetë pikëpyetje shumë e madhe nëse do të shfrytëzohet buxheti i këtij viti, pra i vitit 2018, i caktuar nga Ministria e Financave për FSK-në, apo do të ketë shkurtime buxhetore dhe prapë lind pyetja: A do të ketë shkurtime buxhetore për FSK-në për vitin 2018 nga Ministria e Financave siç ka ndodhur çdo vit?

Nëse vazhdon ky trend i menaxhimit të financave duke u ndarë ministrive buxhet dhe po ky buxhet nga mesi apo fundi i vitit të shkurtohet, atëherë FSK-ja, jo që nuk do të jetë në gjendje të ngrejë kapacitete të reja, por nuk do të jetë në gjendje as t'i mbajë kapacitetet ekzistuese. Duke e vërejtur edhe menaxhimin shumë të dobët të Ministrisë së FSK-së, e sidomos të logjistikës, të financave dhe prokurimit, të cilat nuk arrijnë ta shfrytëzojnë as buxhetin u ndahet, ekziston rreziku që këtij dikasteri t'i ulen kapacitetet e gatishmërisë, e aq më pak të rriten këto kapacitete. Çështja themelore që shtrohet natyrshëm nga ajo që u tha më lart është nëse kjo rritje e buxhetit në vitet në vijim do të jetë e mjaftueshme që të mundësojë një poqes efikas dhe efektiv të transformimit të Forcave të Sigurisë së Kosovës në Ushtri të Kosovës.

Dhe, nëse jo, çfarë hapash do të ndër marrë Qeveria për të ndarë buxhet të mjaftueshëm për këtë qëllim? Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani-Sadriu.

**VJOSA OSMANI SADRIU:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zoti ministër,

Ju para pak muajsh ishit në Uashington D.C. në takimet e Bankës Botërore dhe po supozoj që ndër të tjera e keni dëgjuar edhe drejtorin e kësaj banke Dr. Kim, duke folur para gjitha shteteve pjesëmarrëse, ku ai insistonte në një gjë të vetme që Banka Botërore për dhjetëra dekada ka studiuar shtet pas shteti të zhvilluar apo në zhvillim, apo edhe shtete që kanë dështuar, kanë ardhur në një konkludim të vetëm dhe ai është që në qoftë se një shtet dëshiron të dalë nga varfëria, atëherë duhet të investojë në njerëzit e vet dhe jo në kapital të fortë siç e quante ai, siç janë urat apo rrugët e asfalti.

Kjo nënkupton sipas tij, po besoj që edhe ne pajtohemi, që investimi në njerëz kryesisht nëpërmjet investimit në arsim qysh në fazat e hershme, pra nga kopshtet e deri tek arsimi universitar e pasuniversitar dhe po ashtu investimi në shëndetësi janë ato që e nxjerrin një shtet nga varfëria. Pra, pyetja ime e parë, sepse për këtë temë unë vërtet do të flas shumë shkurt, është kjo: Pse në dokumentet që po sillni vazhdimisht nuk e shohim këtë vizion afatgjatë për Kosovën? Dokumentet që po shohim e tregojnë një vizion afatshkurtër, një vizion që vazhdimisht e injoron këtë këshillë themelore të Bankës Botërore dhe nuk po marrim mësim nga shtetet, të cilat kanë pasur sfida të ngjashme, por kanë marrë një rrugë komplet tjetër dhe duke investuar kryesisht në arsim, por edhe duke mos e lënë shëndetësinë anash, kanë arritur që t'i tejkalojnë sfidat e tyre më të mëdha të zhvillimit, e para.

Pyetja ime e dytë ka të bëjë me fushën e politikës së jashtme. Tani nga disa informata që ne i kemi marrë dhe thjesht po kërkoj sqarim nga ju, nga zyrtarë të ndryshëm të Qeverisë na është thënë që në një mbledhje të Qeverisë me kërkesë të disa dikastereve është marrë një vendim në Qeveri, ku Ministria e Punëve të Jashtme si pjesë e shpenzimeve për lobim do të mund t'i bëjë

dy gjëra: e para, të bëjë shpenzime brenda kategorisë mallra dhe shërbime, por asnjëherë pa e sqaruar se ku po shkojnë këto mallra dhe shërbime, çka saktësisht janë ato. Ku po shkojnë këto të holla nga buxheti i shtetit dhe, e dyta, që të mos figurojnë ato askund në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Pra, një lloj mungese totale e transparencës rreth shpenzimeve që i ka ky dikaster. Tani, mua më intereson ta di nëse ekziston vërtetë një vendim i tillë i Qeverisë, qoftë formal, qoftë joformal në mes jush? Dhe, në qoftë se ekziston, së paku ta ndani atë me Komisionin për Buxhet, por edhe Komisionin për Punë të Jashtme që të kemi informata të sakta se ku po shkojnë ato shpenzime për lobim. Nga dokumenti që ju e keni sjellë, ne e kemi këtu në faqe 17 politikën e jashtme si një ndër prioritetet, prioriteti i pestë në qoftë se po e shoh saktësisht, flet për përmbushjen e obligimeve kryesisht që dalin nga MSA-ja, flet për transformimin e FSK-së në ushtri si prioritet, por siç u tha për të cilin akoma nuk është ndarë buxheti i mjaftueshëm që ky proces të përfundojë. Mirëpo, nuk tregon saktësisht ku po shkojnë shpenzimet për lobim, po flas këtu për njohje, për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe për projekte të tilla të ngjashme dhe çka po projektohet në këtë kontekst për tre vjetët e ardhshme. Ndoshta mund të na jepni një sqarim lidhur me këtë, por mbi të gjitha të përgjigjeni në atë nëse është e vërtetë ajo që edhe vetë kryeministri e pati thënë këtu njëherë në seancë, që në fushën e politikës së jashtme po jepen para në të zezën. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ministri Hamza e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni, zoti ministër!

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Faleminderit të gjithë deputetëve për diskutimet e tyre dhe është praktikë gjithmonë që kur diskutohet për buxhetin, për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, gjithmonë flitet se qysh të rriten shpenzimet dhe qysh të financohen më shumë sektorë, ministri e komuna, dhe gjithmonë anashkalohet ai hapi i parë për ndërtimin e një buxheti të qëndrueshëm, të një kornize afatmesme të qëndrueshme, që është pjesa e të hyrave.

Nuk mund të financosh më shumë sesa ke, të projektosh, veç kthehuni në vitin e kaluar, merreni kornizën e vitit të kaluar që është diskutuar në këtë Kuvend, ka pasur numra, shifra, qejfe sa të duash, qit sa të duash, rrit sa të duash, pa kurrfarë analize profesionale. Dokumenti aktual dhe të hyrat bazohen në rritjen ekonomike edhe për një pjesë, një përqindje të vogël si rezultat i uljes së informalitetit. Është respektuar ligji, është respektuar rregulla prej 2% e totalit të deficitit buxhetor dhe është respektuar pjesa tjetër e klauzolës së investimeve. Sa u përket prioritetëve, edhe unë pajtohem që edhe arsimi, edhe shëndetësia, sektori i sigurisë, i rendit dhe i ligjit, edhe infrastruktura kanë nevojë për më shumë financim, por këto janë mundësitë reale për financim.

Arsimi. Po, zonja Sadriu, me shumë vëmendje e kam dëgjuar diskutimin dhe paraqitjen e Presidentit të Bankës Botërore, zotit Doktor Kim, dhe është mirë që e ka thënë edhe në prani të Fondit Monetar Ndërkombëtar, sepse nganjëherë ka pasur mospajtueshmëri ndërmjet këtyre dy institucioneve, sepse Fondi Monetar Ndërkombëtar gjithmonë ka bërë presion në faturën e

pagave dhe pas sa vjetëve analiza është ardhur në përfundim që vendet, të cilat kanë investuar në ngritjen e kapacitetit dhe kapaciteteve humane e kanë pasur një zhvillim më të shpejtë ekonomik dhe kjo është kështu. Nëse i shohim të gjitha vendet që kanë kapacitete më të ndërtuara humane e kanë një standard më të mirë të jetesës e një zhvillim më të mirë. Kjo është reflektuar në kornizë. Tash, mund të flasim nëse ka pasur nevojë më shumë, pajtohemi menjëherë, mirëpo nëse i shikojmë fondet të cilat aktualisht janë ndarë për sektorin e arsimit dhe cilat planifikohet të ndahen, domethënë në fund të vitit 2021 është planifikuar që totali i investimeve për arsim të mbërrinjë, duke marrë nivelin lokal dhe qendror, 297,4 milionë.

U diskutua edhe për shkurtime që kanë ndodhur apo mund t'i ndodhin organizatave të caktuara buxhetore. Organizata të caktuara buxhetore duhet me i ngritë kapacitetet e tyre shpenzuese. Duhet me i bë planifikimet me kohë dhe duhet me i zhvillua procedurat në kohë në përputhje me ligjin, për të mos ardhur në fund të vitit që të mbesin fondet e pashpenzuara dhe të mbesin disa obligime kontraktuale të pambuluara dhe pastaj të rritet kostoja e atyre obligimeve kontraktuale të pambuluara.

Në këto raste kur Ministria e Financave vëren se një projekt për një arsye a një tjetër, që mund të jetë subjektive, rrallë ndodh objektive, nuk është implementuar, atëherë Ministria e Financave bazuar në Ligjin për Buxhetin kryen ridestinimin e atyre fondeve në obligimet kontraktuale të cilat mund të paraqesin kosto shtesë për vendin.

Sa i përket shpenzimit të mjeteve prej ministrive të linjave Ligji i Buxhetit është ligj, na obligon të gjithëve për ta respektuar, e obligon secilën organizatë buxhetore të nivelit lokal dhe qendror. Ligji nuk mund të ndërrohet me vendime, as me vendime të Qeverisë, as me asnjë vendim tjetër dhe është obligim i secilit prej nesh që mjetet t'i shpenzojmë në përputhje me Ligjin e Buxhetit, i cili është aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Sa i përket raportimit të mjeteve të shpenzuara, raportet janë edhe periodike edhe raporti vjetor, që ne si Ministri e Financave i përpilojmë në përputhje me standardet ndërkombëtare për raportim financiar dhe të njëjtat i publikojmë edhe në ueb-faqen e Ministrisë së Financave dhe i prezantojmë këtu te ju, para jush deputetë të nderuar. Asnjë çështje tjetër jashtë ligjit, jashtë standardeve, Ministria e Financave as nuk e di, as nuk e përkrah. Dhe, kërkojmë nga të gjitha organizatat buxhetore që shpenzimin e parasë publike ta bëjnë në përputhje me Ligjin e Buxhetit. Çdo shpenzim jashtë kësaj, jashtë Ligjit të Buxhetit nënkupton shkelje të ligjit dhe pastaj kushdo që e ka shkelur ligjin janë masat me të cilat mund të sanksionojmë.

Sigurisht se nuk kemi qenë të interesuar që përmes formave të ndryshme t'i fryjmë pjesën e të hyrave dhe përmes rritjes së të hyrave pastaj ne të akomodojmë në Buxhet edhe më shumë fonde për ministrinë e linjës, po edhe për projekte të caktuara. Kemi qenë shumë të kujdesshëm me pjesën e planifikimit të të hyrave, i kemi respektuar legjislacionin në fuqi dhe mbi bazën e kësaj

e kemi bërë shpërndarjen. Me buxhete vjetore, me Ligjin e Buxhetit, sigurisht se brenda ministrive të linjës mund të ketë ndonjë lëvizje, qysh ka pasur edhe në të kaluarën, mund të shkojnë ndoshta pak më shumë fonde për arsim apo për FSK-në apo diçka tjetër, mirëpo ky është një orientim dhe besoj se është një planifikim real.

Sa i përket cilësisë së dokumentit, e them me përgjegjësi dhe jap vlerësimin maksimal për njerëzit që kanë punuar në këtë dokument. Nuk është hera e parë që ata e kalojnë këtë dokument. Janë në Ministrinë e Financave, por janë edhe në ministrinë tjera të linjës, pavarësisht se kush është në Qeveri, ata kanë mbetur aty dhe kanë punuar me profesionalizëm maksimal. Nëse ne si politikë u kemi ndërhyrë në punën e tyre profesionale, ne duhet të jemi të sqartë dhe të themi “jo, këtu aspektin profesional ua kemi dëmtuar ne si politikë, se kemi thënë “kjo pjesë, ne po e qesim këtu...”. Por përndryshe, ata janë njerëz që punojnë dhe kanë marrë pjesë në procese buxhetore minimumi të paktën nga 20 herë secili prej tyre.

E mirëkuptoj dhe vlerësoj të drejtën e secilit deputet për të diskutuar, për të kritikuar, po kur është aspekti profesional dhe kompetenca profesionale duhet të jemi korrektë dhe të vlerësojmë punën e njerëzve që kanë punuar në këtë dokument, sepse është dokument profesionalisht mirë i punuar, sipas standardeve. Tash, mund të flasim a janë prioritetet e drejta apo kush cila parti politike çfarë prioritetesh ka po megjithatë këto janë mundësitë reale të Kosovës për financim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Besoj që do të jem brenda Rregullores, jo që s’kam mundësi të dal atje të bëj një koment të shkurtër.

Ai dokument në fund të fundit është politik, pavarësisht pjesës profesionale. Por, ky debat nuk ka të bëjë vetëm me dokumentin, ka të bëjë me dokumentin në raport me programin e Qeverisë. Dokumenti mund të jetë shumë i mirë, por çështja është shtruar ndryshe. Sa janë në përputhje këto dy dokumente themelore? Domethënë, kjo është e gjithë çështja. Unë ju kërkoj falje nëse... Po, urdhëro!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Nëse kam dalë jashtë Rregullores, unë tërhiqem, kërkoj falje, por jam brenda Rregullores dhe do të jem shumë shkurt.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve ka konsistencë me strategjinë kombëtare të zhvillimit ekonomik dhe me programin e reformave ekonomike. Nëse duam ta lidhim Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve me premtimet e fushatës, atëherë unë kam këtu programet e të gjitha partive politike. Veç një dilemë e kam. Cila parti politike ka bërë përpjekje për të dhënë premtime më të mëdha dhe të përealizueshme? Nuk po dua të hyj në detaje por me vete i kam.

KRYESUESI: Faleminderit! Ju jeni brenda Rregullores. Unë pyeta diçka tjetër, po s'po e përsëris. Kështu që, fjalën e ka deputeti Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Gjatë leximit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve unë jam koncentruar në atë pjesën që e trajton çështjen e arsimit dhe ajo që më ka brengosur është se bazuar në këtë dokument arsimit në Kosovë duket të jetë goxha mirë e që në realitet gjendja në arsim në vendin tonë është e keqe, se cilësia në arsim është e ulët, se shkollave dhe fakultete tona u mungojnë mjetet elementare për punë, se arsimit është i politizuar, e pranojmë të gjithë jashtë këtij dokumenti kur bisedojmë. Mungesa e mjeteve të nevojshme financiare dhe e seriozitetit në kryerjen e obligimeve nga përgjegjësit, si dhe mungesa e mbikëqyrjes dhe vlerësimit real nga kompetentët është sfida në vete, që kërkon zgjidhje.

Duke pasur parasysh gjendjen e rëndë në arsim ky Kuvend më 17 janar të vitit të kaluar e pati miratuar rezolutën të përkrahur nga të gjitha grupet parlamentare, përmes së cilës arsimin e patëm shpallur prioritet kombëtar, ku parashihej rritje e buxhetit dhe ndërmarrje e një varg masash, por fatkeqësisht asnjëra nga këto obligime që i patën ngarkuar Qeverisë përmes asaj rezolute ende nuk janë jetësuar.

Prandaj, organizimi në përgjithësi e sidomos vlerësimi real i punës, si dhe mënyra e të fituarit të aftësive në shkolla dhe universitete, kërkojnë ndryshime të thella në organizim, por natyrisht edhe ndryshimet në organizim kërkojnë buxhet shtesë. Duke pasur parasysh faktin, se vetëm një rini e pajisur me njohuri të cilësisë së lartë aftësohet me i përcjellë trendet e zhvillimit shkencor e teknologjik në Botë, mund ta zhvillojnë ekonominë e Kosovës, Qeveria e Kosovës vërtet duhet ta vendosë arsimin si prioritetin numër një. Kjo do të thotë rritjen e buxhetit për arsim në nivelin e vendeve të zhvilluara, natyrisht duke pasur parasysh përqindjen me qëllim të ngritjes së cilësisë në arsim, sepse nga buxheti varen sigurimi i mësimdhënësve të mirë, varet përgatitje e teksteve të mira shkollore, varet motivimi i nxënësve dhe studentëve, që me përkushtim do t'i ndiqnin mësimet dhe që do të përgatiteshin për tregun e punës, i cili fatkeqësisht sot për shumicën e këtyre nuk ekziston brenda Kosovës.

Në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të përgatitur nga Qeveria thuhet se zhvillimi ekonomik në masë të madhe bazohet në cilësinë e kapitalit njerëzor, prandaj Qeveria e Kosovës e ka përcaktuar zhvillimin e arsimit si një prioritet të lartë. Në kuadër të këtij sektori sipas deklarimeve të Qeverisë synohet krijimi i një shoqërie të bazuar në dije dhe shkathtësi konkurruese e integruar në rrjedhat evropiane me mundësi të barabarta për avancimin e cilësisë individuale, që të përgatiten e të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror-ekonomik dhe politik në vend.

Qeveria deri tani vetëm verbalist është angazhuar për zhvillimin e sistemit funksional për sigurimin e cilësisë në arsim, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Qeveria planifikon ngritjen e cilësisë dhe konkurrencës së arsimit të lartë përmes ngritjes, nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkimeve shkencore. Për arritjen e këtyre objektivave Qeveria premton se do të ndërmarrë hapa konkretë, ashtu siç parashihet me strategjitë sektoriale, si dhe me dokumente të tjera strategjike, duke përfshirë këtu edhe planet e veprimit të tyre.

Mirëpo, defektet që e përcjellin arsimin, që nga arsimi parashkollor e deri në përfundim të shkollimit parauniversitar, ndikojnë shumë edhe në cilësinë e arsimit të lartë. Kur kësaj ia shtojmë edhe investimet e pamjaftueshme në arsim në përgjithësi, e sidomos në arsimin e lartë, atëherë del që ajo që prezantohet në këto dokumente është larg realitetit dhe defektet janë në një lloj të riciklimit.

Sipas këtij dokumenti, Qeveria cilësinë dhe konkurrencën në arsim të lartë synon ta rrisë përmes plotësimin të kornizës ligjore për arsimin e lartë, si dhe akreditimin me një proces të rangimit të programeve dhe institucioneve sipas kornizës multi-dimensionale evropiane. Derisa Ligji për arsimin e lartë ka mbetur peng i pakos së Ahtisarit, i cili tani kushtëzohet nga minoriteti serb dhe nuk mund të procedohet në kuvend, kurse parregullsitë dhe ndërhyrjet politike në fushën e akreditimit kanë bërë që Kosova të përjashtohet nga regjistri evropian i cilësisë.

Qeveria për programet e arsimit të lartë dhe atë të arsimit profesional planifikon të rrisë financimin nëpërmjet rishikimit të formulës aktuale të financimit dhe duke e riorientuar shpenzimet nga fushat me më pak prioritet në ato prioritare. Kjo qasje e Qeverisë për rritjen e Buxhetit nuk duket të jetë serioze dhe sidomos nuk është e mjaftueshme për ta bërë arsimin prioritet kombëtar dhe për ta radhitur në mes të tri prioriteteve, të cilat janë të cekura në këtë dokument.

Sa i përket lidhjes së punës hulumtuese të universiteteve me industrinë dhe investimeve në hulumtime dhe zhvillim, fokus kryesor i Qeverisë do të jetë përmirësimi i kornizës ligjore për transferimin e inovacioneve dhe teknologjisë si dhe financimit të aktiviteteve hulumtuese shkencore. Përkundër faktit, se për hulumtime shkencore në Kosovë investohet pak, fatkeqësisht Qeveria vlerëson se është punuar mjaft në promovimin e punimeve shkencore përmendet, për shembull, organizimi i konferencës vjetore, java e shkencës 2017, po ashtu thuhet se janë përkrahur në buxhet 65 hulumtime nga grande për mobilitet afatshkurtër, 8 institucione hulumtuese nga grandet për projekte të vogla shkencore. Përmendet botimi i tri monografive shkencore, 9 publikimeve shkencore në revista me impakt faktorë. Që të gjitha këto sipas Qeverisë dëshmojnë për investime në hulumtime shkencore e në realitet këto flasin për investime tepër të vogla që u kushtohen hulumtimeve shkencore dhe kjo duhet të kuptohet edhe nga Qeveria, që nuk është as përafërsisht e mjaftueshme si investim në këtë sektor.



Ministria e Arsimit bashkë me njëmbëdhjetë organizata tjera më 11 nëntor të vitit 2017 e pati promovuar fushatën për arsim më të mirë në Kosovë, mirëpo gjendja në arsim nuk do të ndryshojë përmes fushatave, ajo do të ndryshojë me rritje të buxhetit, rritje të përgjegjësive, rritje të mbikëqyrjes dhe vlerësimit real të punës të të gjithë pjesëmarrësve në këtë proces.

Tabelat e shpenzimeve dhe vlerësimit për periudhën 2019/2021 nuk premtojnë ndryshim, që i nevojitet arsimit në Kosovë. Në tabelën e shpenzimeve nuk ka asnjë informatë për shpenzimet që duhet të ndahen për hulumtime shkencore derisa në tabelë janë prezantuar shpenzimet për paga, mëditje, për mallra, dhe shërbime, shpenzimet komunale dhe të tjera, që nuk janë të rëndësishme që do të ishte ajo për investime në hulumtime shkencore.

Arsimi në Kosovë ka nevojë për veprime konkrete dhe jo për...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Dardan Sejdiu.

**DARDAN SEJDIU:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Fatkeqësisht, edhe ministri Hamza nuk qenka këtu, sikurse asnjë ministër e as kryeministri deri tash, besoj që gjatë fjalës sime do të kthehet.

Në fakt, mendoj që Korniza Afatmesme e Shpenzimeve është dokumenti që shpërfaq në mënyrën më të mirë të mundshme inkonsistencën dhe jokoherencën e kësaj Qeverie, sa i përket fjalëve në terme të zotimeve të përkthimit të tyre në dokumente e më pastaj buxhetimit të tyre.

Në një qeverisje normale e para që vjen para deputetëve është një program, një strategji, asaj strategjie më pastaj i bashkëngjitet një dokument si Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e prej saj më pastaj derivon buxheti i vendit. Me këtë qeverisje, po jo vetëm me këtë qeverisje, me të gjitha qeverisjet deri më tani, kemi parë një model të përmbysur të gjërave, sa i përket mendimit ekonomik, financiar dhe buxhetimit të tij.

Në anën tjetër, gjithashtu ajo çfarë shpërfaqet në këtë Kornizë Afatmesme të Shpenzimeve është mungesa e trajtimit të temave që me pompozitet të madh prezantohen nga Qeveria. Një temë e tillë është edhe Termocentrali i ri Kosova e Re, kontratë kjo e nënshkruar me Contour-Global. Në fakt një parakusht për ndërtimin e këtij termocentrali është ndërtimi i një mihjeje të re, e cila do të furnizonte termocentralin e ri. Dhe, këtu në listën e investimeve kapitale janë në klauzolën e investimeve kapitale janë të shpërfaqura në faqe 31, kutia 1, janë të shpërfaqura 13 tema të cilat në vete janë investime që kjo Qeveri i pretendon se janë investime më kapitale dhe që marrin një pjesë të madhe të buxhetit për këto dy vjet. E në fakt, një investim prej afër diku 300 milionë

eurove për këtë mihje nuk është i paraqitur fare, ndonëse kjo Kornizë Afatmesme e Shpenzimeve trajton periudhën kohore 2019/2021, ndërsa kjo mihje duhet të jetë gati për vitin 2023, ashtu siç është e paramenduar që edhe termocentrali të jetë. Pra, asnjë cent nuk është i paramenduar në këtë kornizë, sa i përket kësaj teme e cila neve na prezantohet si deputetë, si një prej temave më me rëndësi e në këtë dokument gjithashtu përmendet që termocentrali Kosova e Re do të ketë ndikim në rritjen e GDP-së apo BPV-së së këtij vendi, por në asnjë moment nuk shpërfaqen shpenzimet që vijnë si pasojë e funksionimit apo të bërit të mundshme që ky termocentral të jetë funksional.

Në anën tjetër, kjo është vetëm një nga, të themi kështu, shkarjet në mes të deklaramit, dokumentit, buxhetimit, kontratave të nënshkruara, zotimeve dhe shpërfaqjeve të cilat i shohim në dokumentin në fjalë. Gjithashtu, në dokumentin në fjalë flitet për statistika e që besoj se janë të rëndësishme, të cilat në anën tjetër nuk shpërfaqen me investim apo me buxhetim në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Për shembull, flitet për eksportin dhe zëvendësimin e tij apo zëvendësimin e importeve dhe stimulimin e eksporteve dhe flitet në terme shumë gjenerikë dhe pa asnjë, si me thënë, konkretizim financiar apo konkretizim të politikës publike, se si do të ndodhë rritja e eksporteve apo si do të ndodh zëvendësimi i importeve, me çfarë lloj politikash?

Dhe, këto terme gjenerikë në një Kornizë Afatmesme të Shpenzimeve, e kuptoj unë ministrin e Financave shumë mirë, kur flet për të hyrat dhe rëndësinë që e kanë të hyrat, por në anën tjetër, nëse flasim për politika publike të cilat mund t'i rrisin këto të hyra e që është zëvendësimi i importeve, stimulimi i eksporteve, pra duke rritur numrin e njerëzve të punësuar, sepse kemi rritur produktivitetin e kësaj ekonomie, atëherë po vijmë te një përfundim, fatkeqësisht, i cili është de-javu, përfundim i njëjtë tash e tetëmbëdhjetë vite. Këto dokumente janë veçse obligime ligjore, që përmbushen në mënyrë që të vijmë në Kuvend dhe të themi se kemi një kornizë afatmesme, kjo kornizë afatmesme na qenka një kërkesë e cila duhet të tregojë se ka një lloj angazhimi për planifikim ekonomik e financiar, por gjithsesi në shkarje apo në dallim të madh në mes fjalëve të folura, buxheteve të shkruara e dokumenteve si ky të prezantuar në Kuvend.

Tutje, i njëjti dokument nuk është në përputhje gjithashtu edhe me dokumente që na kanë ardhur këtu në fillim të mandatit, kur flitej për një program të Qeverisë Haradinaj, se si do të ecet përpara. Pra, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve dhe dokumentet e prezantuar deri më tash për zhvillimin e këtij vendi, nuk janë as për së afërmi të njëjta në përmbajtje, në numra e në logjikë.

Krejt në fund, besoj se është tepër me rëndësi që mos të përfundojmë duke i sjellë Kuvendit letra, të cilat në asnjë mënyrë e në asnjë formë nuk janë koherente me fjalët që i bën një Qeveri, sepse kjo tregon edhe joseriozitet e në anën tjetër e bën edhe debatin këtu paksa të vobektë, për shkak se nuk mund të bëjmë krahasimin në mes politikave të implementuara, buxhetit të prezantuar dhe të mirave që ajo politikë publike i sjell në një ekonomi.

Pra, në këtë drejtim dhe në këtë frymë, mendoj që edhe Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e prezantuar këtu te ne, përsëri shpërfaq një dembeli të së paku përgatitjes së dokumenteve në mënyrë koherente me dokumente që janë prezantuar në fillim të mandatit, me politikat për të cilat flitet në televizion dhe në Kuvend dhe numrave të cilët duhet me i përkrahë këtë lloj mendësie, me të cilën gjithsesi si PSD nuk pajtohem e nuk jemi pajtuar as në të kaluarën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap deputetit Enver Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër Hamza,

Të nderuar dhe të respektuar kolegë deputetë,

Është mirë që po debatojmë për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, por po të mund të kurseheshim nga, siç e theksoi edhe ministri, ato idetë dhe premtimet që i kemi dhënë në fushatë me i dallua me dokumentet që janë zyrtare dhe që janë obligative e që janë ligjore.

Korniza apo KASH-i, siç e quajmë, unë do të vë theksin në dy çështje që janë shumë me rëndësi me u përmend, që Korniza Afatmesme e Shpenzimeve është në përputhje të plotë me strategjinë e Qeverisë, me Programin e Qeverisë nën një, dhe që planifikimet buxhetore janë të vendosura mbi parametra realë. Kjo ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe të theksohet dhe të ruhet, sepse neve na shmangë nga ndonjë planifikim, siç kemi parë në të kaluarën planifikime që kanë sjellë edhe shifra, por që nuk kanë qenë realë brenda mundësive të të hyrave buxhetore të vendit.

Qeveria i ka vendosur prioritetet, sidomos unë i mbështes plotësisht prioritetet që janë theksuar në sektorin e drejtësisë, të sigurisë, të arsimit dhe të shëndetësisë.

Ky është një prioritetizim, i cili neve do të na mundësojë të hapim mundësi të reja, po ashtu Qeveria ka marrë masa që të sigurohen investime të huaja, të cilat do të ndikonin në rritjen e punësimeve dhe në mirëqenien dhe do të hapnin mundësi të reja dhe do të avanconin zhvillimin e vendit.

Mirëpo kjo çështje nuk mund të bëhet shpejt, ashtu siç po kërkohet nga kolegët e opozitës.

Unë dëgjova me vëmendje disa që i ngritën çështjet duke u thirrur në atë se po tentohet të blihet paqja sociale. Është mirë që këtë term ta zbërthejnë kolegët deputetë nga opozita, cila është ajo paqe sociale, ku po përendet? Cila kategori, sipas tyre, duhet të merren parasysh që ndoshta po pajtohem të gjithë se është një buxhet bukur i madh ndoshta në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies dhe kemi probleme me skemën sociale dhe me skemat pensionale.

Po këta duhet ta marrin guximin dhe të ofrojnë alternativa, cilat janë ato kategori të cilat nuk duhet të jenë pjesë e atyre skemave dhe jo të sjellin ndoshta vërejtje të cilat unë deri diku i mbështes, por nuk mund të mbështeten në formë paushall, le ta marrin guximin dhe le të thonë cilat janë ato kategori, të cilat duhet të shmangen nga skema sociale apo nga skemat pensionale, sepse është krejtësisht ndryshe të flasësh këtu karshi dokumentit zyrtar, ndërsa në fushatat elektorale apo nëpër institucione të tjera të bëjnë thirrje të gjithë të përfshihen, kush ka mbetur atje i marginalizuar apo i papërfshirë në skema të tilla sociale.

Diçka që më bëri përshtypje nga njëri prej kolegëve deputet që tha se ministri i Arsimit ka pasur vërejtje kur është trajtuar buxheti në mbledhjen e Qeverisë. Unë mendoj që këtu është edhe ajo që duhet të jetë ndërqeveri, kjo është një diçka që duhet të admirohet dhe të mbështetet, sepse projektet e ministrave, të cilët debatohen në Qeveri, nuk është se ka ndonjë përplasje, ndonjë vërejtje, ndonjë diçka që duhet të merren, po kur e sheh varfërinë e debatit, me keqardhje po them se një pjesë e kolegëve të opozitës debatuan duke u thirrur apo referuar në ide të ndryshme që mund të jenë brenda kabinetit qeveritar, e që janë në interes të zhvillimit të politikave zhvillimore, qoftë për arsim, qoftë për shëndetësi apo fusha të tjera, tregon varfërinë e tyre në qasjen e këtij dokumenti. Nuk patën fakte ose nuk e kanë studiuar a analizuar në thellësinë e tij, por është një thirrje, e cila për mendimin tim ishte boshe, retorike që nuk do të duhej të ishte këtu.

Unë edhe një herë bëj thirrje, ministër, ta ruani qëndrueshmërinë fiskale ashtu siç e keni paraqitur, edhe ajo që ju e deklaruat këtu që nuk keni lëshuar pe, ju ftoj të mos lëshoni pe në asnjë mënyrë në ato organizata buxhetore, të cilat nuk kanë kërkesa të artikuluar apo të strukturuar mirë, mos i mbështetni!

Mbështetni të gjitha ato kërkesa të organizatave buxhetore, të cilat janë të strukturuar në formë të qartë dhe në formë profesionale, me ekspertizë dhe me projekte të përcjella.

Ajo tani ka filluar të përmbyllet, do të shtoj edhe këto faza të infrastrukturës rrugore.

Mendoj që edhe në rishikimin buxhetor kur e kemi paraqitur në vitin 2018, kemi thënë se nga viti 2019 do të fillojë me projekte edhe një zhvillim tjetër i vendit, pasi që ne po besojmë dhe jemi të bindur që do të mbyllet investimi në investimet e infrastrukturës rrugore dhe do të hapen perspektiva të reja.

Ne kemi dëshirë dhe vullnet që gjendja në arsim dhe shëndetësi të jetë ndryshe, por cilat janë mundësitë tona reale investive, a kemi financa?

Të gjithë e dimë se si fillon investimi që nga parashkollorët e deri në nivelin universitar.

Mandej e dëgjuam këtu kur dikush na bërë edhe thirrje se sa vite neve na duhet të mbërrijmë me shtetin kroat apo me Bashkimin Evropian në aspektin e zhvillimit ekonomik.

Ne kishim edhe në mandatin e kaluar udhëheqjen e tyre që me vite të tëra kanë jetuar në ekzil dhe kanë parë se si zhvillohen ekonomitë e vendit, ku janë ato programe që nuk u zhvilluan për një mandat trevjeçar qeverisës që ishin udhëheqës të Qeverisë.

Prandaj, po them të mos vijmë këtu me fontanë dëshirash të trajtimeve të problemeve, por t'i qasim dokumentit në formën siç është dhe në aspektin real, unë mendoj që planifikim është brenda mundësive reale që i ka vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Buxheti gjeneral për vitin 2019 është planifikuar të rritet krahasuar me vitin 2018, po me mënyrën se si po qeveriset vendi, me mënyrën se si po humbim 53 milionë euro për autostradën, me rritjen e buxhetit 100% të pagave të kryeministrit, zëvendësministrave e automatikisht edhe gjyqtarëve, i bie se kjo Qeveri shkakton rreziqe buxhetore, e lëre më të ketë rritje prej 8.7% sikur është planifikuar.

Nëse keni rritje pagash pa planifikim paraprak, nëse keni rritje pagash jo më shumë se 20%, po 100% sikur ka bërë kryeministri pagën e vet, do të ketë krizë buxhetore, krizë planifikimi afatshkurtër, e lëre më planifikim afatmesëm apo afatgjatë.

Me buxhetin gjeneral në vitin 2019 fondi për arsim planifikohet të rritet 7.8%, kjo ndodh edhe për shkak të rënies së numrit të nxënësve dhe kjo do të mundësojë në parim rritjen e buxhetit për cilësinë në arsim.

Sipas një analize, pagat dhe mëditjet për mësuesit dhe personelin mbështetës janë të fiksuara në periudhën afatshkurtër. Prandaj, nuk është e qartë a mund të materializohen fitimet e tilla.

Edhe pse në arsim janë paraparë 19.5 milionë euro, ne konsiderojmë që janë të pamjaftueshme për nevojat e mëdha që i ka arsimi në Kosovë.

Shpenzimet e Qeverisë për arsim janë më shumë të fokusuar në shpenzime për çështje dytësore, se sa për nevojat e nxënësve, shkollave dhe universiteteve publike.

Unë propozoj që Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021 të ndryshojë, duke vënë edhe më shumë në prioritet arsimin.

Nëse arsimin e konsiderojmë çelësin kryesor të zhvillimeve shoqërore, atëherë KASH duhet të favorizojë edhe më shumë në buxhet fushën e arsimit.

Duhet të rritet buxheti në nivelin parauniversitar, duke u dhënë më shumë buxhet shkollave në organizimin e punëve praktike, në zhvillimin e aktiviteteve dhe vizitave studimore, pasi që nxënësit tanë shpesh ngarkohen shumë me teori, pa i parë ato që i mësojnë edhe në praktikë.

Më shumë buxhet duhet t'u shpërndahet shkollave, drejtorive komunale të arsimit, në mënyrë që të organizojnë më shumë dhe më shpesh vizita studimore, eksperimente laboratorike, punë praktike, aktivitete të lira të nxënësve, projekte hulumtuese në terren, e të tjerë.

Shkollat dhe krejt komunat e Kosovës ballafaqohen me buxhet jashtëzakonisht të ulët.

Duhet të rritet buxheti për shkencë dhe shkencëtarë të rinj, ngase shkenca është sot parimi kryesor i organizimit të funksionimit të shoqërisë.

Duhet të rritet buxheti për bursat universitare si dhe bursa për lëmenj që janë sot pa kuadro, duhet të jetë një fond i veçantë vetëm për bursistë, të cilët studiojnë brenda apo jashtë vendit, fusha të cilat kanë mungesë të kuadrove profesionale. Duhet të gjejë mënyra të stimulimit të informimit të kuadrove profesionale në fusha deficitare. Duhet të kemi një fond të veçantë për shkolla profesionale, si prioritet i domosdoshëm për Kosovën, nëse dëshirojmë që të rinjtë tanë t'i përgatisim për tregun e gjerë evropian.

Të nderuar deputetë,

Ky buxhet nuk është i mjaftueshëm sidomos në sektorin e arsimit, arsimit duhet të jetë prioritet i secilës qeveri, fatkeqësisht nga ky dokument korniza për tre vjetët e ardhshme të buxhetit për arsimin, se arsimit është shtyllë kryesore dhe nuk do të kalojë as 3% të GDP-së që për keqardhje sistemin e arsimit të vendit tonë do ta përcjellë gjendja e kolapsit dhe kaosit.

U tha që ky dokument është i përpiluar mirë, po më mirë do të ishte që në vend që të jepen "Bechtel&Enka"-s 53 milionë euro, gjysma e këtij buxheti t'i kushtohet arsimit, sepse kur investojmë në arsim, investojmë veç në shtetin tonë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Radhën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në shikimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimit, ashtu edhe si herëve të tjera, vërehet një profesionalizëm i Ministrisë së Financave, i paraqitur në objektiva të qarta, por që mendoj që këtë KASH-in përveç me ministrin e Financave, do të duhet ta diskutonim sektor për sektor edhe me ministra të tjerë.

Pse të diskutojmë me ministra të tjerë? Sepse mendoj që vërejtjet edhe sugjerimet e deputetëve, të cilat kanë qenë të vazhdueshme gjatë seancave qoftë kur është shqyrtuar buxheti, kërkesa të cilat kanë qenë të parashtruara në kohën e miratimit të buxhetit dhe kur nuk kanë pasur mundësi që ato të akomodohen përbrenda një buxheti, atëherë sigurisht përmes planifikimeve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve në këto t'i adresojmë te ministrat përkatës, pastaj ato t'i adresojmë në Qeveri dhe që të marrin një kah dhe zgjidhje të duhur.

Sigurisht që prioritetet tona janë të përcaktuara edhe si Qeveri, por edhe si Parlament, por që nganjëherë disa prej këtyre prioritetëve po anashkalohej nga bartësit institucionalë.

Duke mbështetur punën e ministrit të Financave, sigurisht që më duhet të them një fakt, i cili rrjedh ose buron edhe nga miratimi i ligjeve në legjislaturën e kaluar, kemi të bëjmë me disa ligje të cilat, për fat të keq, nuk po arrijnë zbatueshmëri, jo për ata se nuk kanë bërë planifikime të duhura, por se nuk po ka gatishmëri nga bartësit institucionalë në zbatimin e atyre ligjeve.

Dua të potencoj së pari Ligjin për sponsorizime, të cilin Parlamenti i Republikës së Kosovës e ka miratuar në dhjetorin e vitit 2016 dhe që ka hyrë në fuqi në janar të viti 2017, por që ende Administrata Tatimore e Republikës së Kosovës nuk e respekton dhe nuk e zbaton.

Drejtori i Administratës Tatimore të Republikës së Kosovës, i nderuar ministër, i jep të drejtë vetes ta interpretojë ligjin, edhe pse nuk është i thirrur për atë punë, por është i thirrur të zbatojë direktivat dhe nen për nen Ligjin për sponsorizime. Në veçanti që ky ligj të jetë i zbatueshëm, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e ka nxjerrë edhe Udhëzimin administrativ për zbatimin e Ligjit për sponsorizime dhe kjo po bën një pengesë të madhe për zhvillimin e aktiviteteve sportive, për forcimin e klubeve sportive dhe federatave, e në veçanti tani ku pothuajse shumica e federatave sportive janë pjesë e federatave ndërkombëtare botërore dhe derisa nuk ka një financim të fuqishëm prej shtetit për këto, atëherë sigurisht që mundësia dhe financimi i klubeve dhe federatave sportive buron nga Ligji për sponsorizime dhe tani vetë Administrata Tatimore e Republikës së Kosovës është bërë pengesë për këtë dhe mendoj që duhet t'ia tërhiqni vërejtjen drejtorit të Administratës Tatimore që të zbatojë këtë ligj dhe të respektojë ligjin.

Përndryshe, ne do të detyrohemi që të thërrasim një debat sa i përket kësaj çështjeje, sepse është një kërkesë e të gjithë komunitetit sportiv dhe kulturor që ky ligj të respektohet, sepse edhe ligji parasheh lirimet tatimore në fushën e sportit.

Gjithsesi më duhet të ndalem edhe te planifikimet, të cilat janë bërë për shëndetësi dhe në tri prioritetet, të cilat i parasheh në vitin 2019 deri 2021 Ministria e Shëndetësisë, që janë: mbrojtja e shëndetit, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore të ofruara dhe sigurimi i financimit të qëndrueshëm shëndetësor dhe riorganizimi i sektorit të shëndetësisë.

Ne në vitin 2012 kemi miratuar Ligjin numër 04/L-125 për shëndetësi, pastaj edhe Ligjin për sigurime shëndetësore në dhjetor të vitit 2014 apo Ligjin numër 04/L-249, ligj i cili mendoj që nuk po gjen zbatim përkundër që ka pasur përpjekje të vazhdueshme për implementimin e këtij ligji për sigurime shëndetësore, por që zbatimi i këtij ligji as në këtë Kornizë Afatmesme të Shpenzimeve duket që as viti 2021 nuk do të na gjejë me sigurime shëndetësore, sepse nuk do të arrihet të implementohet sistemi i informimit shëndetësor dhe derisa nuk ka implementim të sistemit të informimit shëndetësor, sigurisht atëherë vështirë që do të jetë edhe grumbullimi apo krijimi i fondit apo burimet e qëndrueshme për fondin e sigurimeve shëndetësore dhe kjo pastaj do të pamundësojë që të kemi një zbatim të sigurimeve shëndetësore.

Kam thënë edhe të kaluarën dhe po e përsëris se ne kemi problem me funksionimin e sistemit shëndetësor. Në Kosovë nuk është vetëm një sistem shëndetësor që funksionon, janë disa sisteme dhe Ministria e Shëndetësisë nuk e ka fokusin e duhur që të kemi një sistem unik shëndetësor, ashtu si e parasheh Ligji për shëndetësi, por po shkohet në parcelizimin e këtij sektori, dhe kjo pastaj po paraqet vështirësi në krijimin apo ofrimin e shërbimeve më të mira shëndetësore. Vazhdimisht po e rrisim buxhetin për barna, për fat të keq në vazhdimësi po rriten mungesat. Në vend se kur të rritet buxheti për barna, të rritet edhe sasia e barnave në klinika dhe në Qendrën Klinike Universitare dhe në spitalet rajonale, po ndodh e kundërta: edhe po rritet buxheti për barna, edhe po rriten mungesat e barnave dhe sot janë këto mungesa evidente, të cilat pothuajse shumica e kolegëve të Komisionit për Shëndetësi i kanë paraqitur në vazhdimësi, sepse po mungon edhe sistemi i menaxhimit të mirëfilltë brenda këtij sektori dhe kjo ka krijuar vështirësi të mëdha për pacientët tanë. Derisa nuk ka edhe sigurime shëndetësore, nuk ka një menaxhim të duhur brenda këtij sektori, sigurisht që këto vështirësi do të paraqiten edhe në të ardhmen.

Kërkoj që vërtet një pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të jetë planifikimi për implementimin e Ligjit për sigurime shëndetësore dhe unifikimi i sistemit shëndetësor, sepse e dini që brenda Republikës së Kosovës, përveç sistemit tonë shëndetësor, i cili është jofunksional për shkak të mungesës së disa sektorëve apo institucioneve, të cilat do të duhej ta bënin të implementueshëm sistemin tonë shëndetësor, ku pothuajse 40% e popullatës së Republikës së Kosovës nuk kanë mundësi të marrin shërbime shëndetësore në sektorin sekondar, atëherë ata nga sektori primar detyrimisht detyrohen që këto shërbime t'i marrin në sektorin terciar dhe krejt kjo pastaj e bën edhe më të komplikueshme situatën kur do të fillojë implementimi i sigurimeve shëndetësore, nëse nuk është e unifikuar në sistemin tonë shëndetësor edhe pjesa veriore e Republikës së Kosovës dhe kjo do të paraqesë vështirësi të dyfishtë. Duhet t'u sqarohet në debate dhe diskutime që është edhe përgjegjësi e përfaqësuesve të tyre në Parlamentin e Kosovës që ata



të bisedojnë me qytetarët bashkë me Ministrinë e Shëndetësisë, sepse nëse ata nuk integrohen në sistemin tonë shëndetësor, do të mbesin pa sigurime shëndetësore dhe sigurimet shëndetësore të cilat ata i kanë, të Republikës së Serbisë, nuk do të vlejnë për Republikën e Kosovës dhe kjo paraqet pastaj vështirësi edhe që ata të marrin shërbime shëndetësore brenda Republikës së Kosovës. Këto çështje duhet të rregullohen me një shkathtësi edhe një bashkëpunim të gjithë aktorëve të pranishëm në Republikën e Kosovës.

Duke e pasur parasysh që tani jemi edhe në fazën e draftimit të disa ligjeve që e rregullojnë këtë fushë, kërkoj në vazhdimësi që Ministria e Shëndetësisë vërtet të sjellë në Kuvend edhe një herë disa prej këtyre ligjeve të shëndetësisë, sepse është parë se disa prej tyre po kanë vështirësi në zbatim dhe implementim dhe pastaj që ne vërtet të kemi mundësi të jemi në shërbim të qytetarëve dhe planifikimet të cilat i kemi bërë në Kornizë Afatmesme të Shpenzimeve t'i arrijmë edhe t'ia dalim deri në fund bashkërisht.

Duke e falënderuar ministrin e Financave për praninë këtu, për punën e shkëlqyeshme dhe për profesionalizim e tij, kërkoj që vërtet këto çështje, në veçanti ato të cilat i thashë për shëndetësinë dhe sportin, të merren në konsideratë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Tani ia jap fjalën deputetit Adem Mikullovcit.

**ADEM MIKULLOVCI:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë nuk dua të flas për Kornizën e Shpenzimeve Afatmesme, po dua t'ju pyes juve si nënkryetar: sa ka kuptim të mbahet seanca me 30 deputetë dhe vetëm një ministër? Ju duhet ta gjeni një klauzolë që deputetët të jenë në sallë, po shihet që diskutuesit janë përgatitur, i kanë përpunuar materialet, diskutime të shkëlqyeshme, po për kë? Fol me tavan! Vetëm kaq desha të them. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Unë besoj që s'kam të drejtë të komentoj diçka të tillë.

Vazhdojmë sipas radhës, deputeti Milaim Zeka e ka fjalën.

**MILAIM ZEKA:** Faleminderit, kryetar!

Edhe unë flas pak me tavan, pak me ministrin, ka të drejtë baca Adem.

Së pari të dalim gjallë deri në vitin 2021, në qoftë se vazhdon ky ajër kaq i tmerrshëm brenda sallës së Kuvendit, s'di ju a po e ndjeni, po unë po e ndjej shumë keq, as ajrosje, as kurrgjë!

Unë, ministër, do të bëj disa pyetje, por para se të dal te tema për të cilën po diskutojmë, duket se sot e pranoi edhe opozita që ne, kjo Qeveri, do të jemi deri në vitin 2021, përveç debatit që u bë.

Tjetra? Duke i përjashtuar partitë, të cilat s'kanë qenë në të kaluarën në pushtet dhe nuk kanë menaxhuar me Buxhetin e Republikës së Kosovës, më duket si shumë hipokrizi nga ata që kanë

bashkëqeverisur me Partinë Demokratike të Kosovës, të flitet për linjat buxhetore, të kritikohet arsimit, të kritikohet shëndetësia, kur dy partitë në pushtet, qoftë për të mirë, qoftë për të keq, keni qenë bashkë në pushtet, Partia Demokratike së bashku me Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Tmerr i keni bërë këtij vendi, s'keni ditur kurrë kah t'i çoni parët, vetëm në asfalt. Asfalt, asfalt, asfalt...! Pse? Sepse në arsim është shumë vështirë të vidhet, në shëndetësi është shumë vështirë të vidhet. Nuk kam dëgjuar kurrë në foltore të Kuvendit të Republikës së Kosovës duke folur për gjendjen e mjerueshme të teatrove, duke folur për mungesën, çfarë u bë me operën. Jemi i vetmi vend që s'kemi sallë të koncerteve. Ia nisëm atje, biseduam për operë, s'kemi as operë, as sallë të koncerteve, të rinjtë tanë s'kanë as salla për ta kaluar kohën e lirë. Këtu është folur gjithmonë jo për të ardhmen, jo për qëndrueshmërinë e buxhetit, por qysh të mund të flasim diçka që kur të na dëgjojë dikush ta mbledhim ndonjë votë atje dhe në mënyrën më hipokrite të mundohemi t'i themi dikujt se “ja ne po interesohemi për ju”. Po të isha unë kryeministër ndonjëherë, po të isha bërë kryeministër, pavarësisht se nuk marr shumë vesh në çështjet ekonomike qysh janë disa ekspertë këtu, por për ta udhëhequr Kosovën, po të duam të punojmë, duke u shpreh popullorçe, se këtu ne s'jemi në tribunë shkencore që të flasim me shifra, me tabela, po të duam ta udhëheqim Kosovën në mënyrë “rrahmanishi”, qysh thonë prindërit tonë, krejt Kosova është sa një shopping center i Berlinit, Londrës, ose Vjenës.

Sa ka qarkullim një shopping center në cilindo qytet evropian, aq është buxheti total i Republikës së Kosovës. Atëherë, pse ne nuk i ndamë kurrë e të themi 200 milionë do t'i ndajmë për shëndetësinë dhe do ta bëjmë spitalin më modern në rajon që të vijë edhe maqedonasit, edhe shqiptarët e Shqipërisë, edhe malazeztë, edhe serbët për t'u shëruar në spitalet tona, e jo të shkojnë pacientët tanë në Shkup, në Tiranë, e besa edhe në Beograd. Pse nuk është diskutuar asnjëherë, se e kam pyetur ministrin Hamza, për përcaktimin e vijave buxhetore dhe nuk harroj, ma keni dhënë një përgjigje shumë të mirë, ke thënë kjo varet prej kërkesës së kryetarëve të komunave. Domethënë, kur kryetari i Komunës nuk të kërkon ty të ndërtohet çerdhe të fëmijëve, ti si ministër nuk mund t'ia ofrosh atij produktin.

Vetë fakti, të nderuar deputetë, që Kosova me 10 mijë kilometra katrorë i ka 1 500 deponi ilegale të bërllokut, kjo flet në mënyrën më madhështore se çfarë shoqërie jemi, ku jemi dhe ku jemi katandisur.

Te shfrytëzimi i buxhetit, nuk është shfrytëzuar buxheti dhe janë marrë kredi, ministri e di shumë mirë dhe prapë keni qenë në qeveri bashkë, janë marrë kredi dhe ato kredi nuk janë shfrytëzuar në kohën kur janë paguar kamatat. Tani te çështja, ministër së pari të përgëzoj për zvogëlimin e mëditjeve që ua ke bërë prej 1 korrikut, kjo është punë për t'u lavdëruar, sepse veç vraponin të dilnin deri në Shkup e deri në Mal të Zi, e në Shqipëri për punë të mëditjeve, prandaj edhe shumë ligje kanë çaluar këtu, shumë ligje nuk kanë kaluar nëpër komisione, sepse komisionet

parlamentare menjëherë kanë bërë plan qysh të ikin diku të bëjnë punëtori atje, të qëndrojnë nëpër hotele dhe gjoja ne po i studiojmë ligjet.

Ministër, unë mendoj që Kosova ka shumë para, por paratë shpenzohen në mënyrë të gabueshme. Ajo që kisha dashur ta kërkoj prej juve si ministër është raporti më i detajuar i çdo institucioni dhe çdo personi zyrtar për mënyrën sesi i shpenzon paratë. Unë po ta marr një shembull te perëndimorët. Në qoftë se një ministër ose një zëvendësministër, ose një kryetar i Parlamentit, kryetar i grupit parlamentar, e shtron një drekë ose një darkë, në Perëndim është i obliguar t'i shkruajë emrat dhe mbiemrat me kënd ka ngrënë darkë, çka ka ngrënë darkë dhe çka ka pirë.

Ne, i nderuari ministër, në Kosovë, jo vetëm gazetarët, por edhe deputetët, po ta marr një shembull konkret, kur kam kërkuar para një jave t'i marr shpenzimet e harxhimeve të Bordit të Postë-Telekomit të Kosovës dhe të drejtorit të Valës, a e di cilën përgjigje e kam marrë unë, ministër? Më kanë thënë nuk mund t'i marrësh, vetëm shko në Kuvend dhe krijojeni një komision hetimor. T'i thonë një gazetari dhe t'i thonë një deputeti që vetëm nëpërmjet komisionit hetimor mund t'i marrësh shpenzimet e një drejtori që i ka vjedhur paratë publike, jo paratë e firmës së vet, kjo është shumë e tmerrshme. Dikush prej deputetëve foli edhe për ATK-në dhe unë nuk dua ta ripërsëris, por është shumë e saktë që edhe në ATK ka mangësi shumë të mëdha. Unë e kam bërë javën e kaluar kur keni qenë përballë meje një kritikë rreth TVSH-së dhe menjëherë ka reaguar ATK-ja, që është absurditet, nuk ndodh kurrkund në botë që ATK-ja t'i reagojë një deputeti se çfarë flet, por kanë reaguar sepse aty ka shumë hajna dhe ka shumë keqpërdorues. Dhe, do të flas me incizime, me fakte shumë shpejt se çka u kanë bërë firmave dhe çka u bëjnë, dhe sa për qind ua marrin.

Njerëzit, inspektorët brenda ATK-së, i nderuar ministër, u qojnë mësit firmave të ndryshme dhe njerëzve të ndryshëm dhe u kërkojnë shuma marramendëse për t'ua mbyllur hetimet. Së pari ua hapin hetimet, pastaj ua kërkojnë 20 mijë, 30 mijë, 100 mijë euro për t'ua mbyllur hetimet. Këtë ta dëshmoj kur të duash me fakte, me incizime dhe me dëshmitarë.

Prandaj, po e përfundoj fjalimin tim që në qoftë se Qeveria e Kosovës dhe ju si ministër, ashtu qysh e keni marrë hapin e guximshëm për përgjysmimin e mëditjeve, vëreni një kontroll të rreptë për mënyrën se si ne i harxhojmë paratë, duke na përfshirë në radhë të parë ne deputetët e Republikës së Kosovës, anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, zëvendësministrat e ministrat, të cilët udhëtojnë nëpër botë pa kurrfarë ftesash. Atëherë, ke për ta parë që kanë për të na dalë para dhe kanë për të na tepruar.

Unë, zoti ministër, në mandatin e ardhshëm, në qoftë se jemi shëndosh dhe në qoftë se vjen ndonjë buxhet, unë nuk do ta votoj asnjë buxhet të asnjë qeverie në Parlamentin e Kosovës, buxhet i cili nuk fokusohet në shëndetësi, në arsim, në çerdhe të fëmijëve, në azil të pleqve dhe

te pensionistët. Ne i shohim këtu edhe sindikatat, në vend që t'i mbrojnë të drejtat e punëtorëve, ata bëjnë hajgare me punëtorët. Nuk ka në Kosovë sindikatë që e mbron të drejtën e punëtorit, por ata i mbrojnë të drejtat e xhepit të vet. Po ta marr një shembull konkret, janë vetëm 300 minatorë të Trepçës që punojnë në zgafelle, ndërsa mbi zgafelle janë 900 harambashë që marrin rrogën kot dhe çohen atje sindikata, thotë po i mbrojmë të drejtat e punëtorëve. Ne një gjë të tillë nuk duhet ta lejojmë. Të njëjtin fenomen e ke në Postë-Telekomin e Kosovës. Prandaj, të uroj sukses edhe faleminderit që na dhe shpresë kështu që do jemi bashkë deri më 2021.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Tani fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

**NASER RUGOVA:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti ministër,

Po bisedojmë për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, që e konsideroj një nga dokumentet goxha të rëndësishme që një Ekzekutiv i një shteti i bën ato planifikimet e veta konform strategjive sektoriale dhe bën alokime buxhetore të planifikuara, por në radhë të parë ky është një dokument politik.

Jo në cilësinë e një deputeti opozitar, por duke e bërë një analizë krahasuese, se duhet të nisemi nga pikat referente, konsideroj që kjo Kornizë Afatmesme e Shpenzimeve e ka një diskrepancë, një shkarje me Programin qeverisës. Tani unë dua t'i kuptoj edhe nevojat, edhe trendët e ballafaqimet që Ekzekutivi i vendit mund t'i trajtojë në periudha tremujore, gjashtëmujore apo edhe nëntëmujore, por dua të besoj që te qeveritë serioze strategjitë sektoriale, alokimet buxhetore për sektorët e caktuar nuk duhet të kenë vakum të madh me projeksionet buxhetore që janë të shkruara në Programin zyrtar të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Te ndarjet buxhetore, te fushat sektoriale, te prioritet e deklaruara në këtë dokument kaq të rëndësishëm për periudhën kohore 2019-2021, te prioritetet që i shohim në këtë dokument, arsimit dhe shëndetësia janë ranguar si të parat. Tani duke qenë që vij nga të dy këto fusha, kam qenë një nga deputetët të vetëm që në dy debate në këtë Kuvend kam kërkuar buxhet 100 milionë euro për shëndetësinë, jo për ministrin dhe Ministrinë e Shëndetësisë, por për sistemin shëndetësor në vend. Bile e kam marr një shembull konkret. Kam thënë t'i lëmë 5 kilometra drejt Hanit të Elezit dhe 5 kilometra drejt Dheut të Bardhë, sepse çuditërisht autostradat në Kosovë po kushtojnë dukshëm më shtrenjtë se në vendet në rajon dhe në BE.

Dhe, realisht, që nga viti 2002 i kemi duart e lira, që nga koha e UNMIK-ut, që për këta dy sektorë kemi pasur përgjegjësi dhe kompetenca të plota. Çuditërisht, si dy shtyllat kryesore edhe të zhvillimit ekonomik, edhe të dijës, edhe të mirëqenies, por edhe të krijimit të një mjedisi normal dhe të një tregu pune, por edhe të prodhimit të kuadrove konform trendëve modernë, tregut të punës dhe proceseve integruese jo bash të lehta që e presin Kosovën në këto dy shtylla,

qeveri të tëra si duket nuk i kanë prioritet dhe nuk i shikojnë me seriozitet. Rritja e buxhetit për arsim në vitin 2019 është planifikuar 7,8% krahasuar me vitin 2018, por në total kjo Kornizë Afatmesme e Shpenzimeve nga bruto-prodhimi vendor i buxhetit thjesht nuk e rrit vlerën deri në 6%, që do të duhej të ishte një pikë referente me shtetet e rajonit, Maqedonia, Mali i Zi, Shqipëria, Serbia bile e ka edhe më larg, ne diku do të na mbërrij 2,9 deri në 3,1% për sektorin e arsimit.

Zoti ministër, konsideroj që është e pamjaftueshme dhe kur kësaj ia shtojmë edhe mungesën e gatishmërisë për rishikim të buxhetit sivjet, unë kërkoj nga ju si ministër i Financave, jeni njëri i fahut do të thotë, keni edhe gradë akademike, do të duhej që organizatat buxhetore që nuk e kanë shpenzuar buxhetin e alokuar për projekte, për investime, apo për qëllime të tjera, të rishikohen dhe një Qeveri e përgjegjshme dhe një Parlament funksional i alokon në fushat në sektorët, ku vendi dhe interesi i publikut është imediat.

Prandaj, me këtë rritje buxhetore, konsideroj që në tre vjetët e ardhshme arsimit do të ballafaqohet me probleme të njëjta, e kur kësaj ia shtojmë faktin që këto janë kalkuluar, dhe zvogëlimi i numrit të nxënësve që do të duhej të ishte alarm për këtë Kuvend të Republikës.

Ju lutem, alarm në kuptimin, jo vetëm institucional e politik, por thjesht në aspektin e mirëqenies qytetare dhe të zhvillimit të përgjithshëm nacional të një vendi. Kemi shkolla ku janë investuar nga 2 e 3 milionë euro dhe tani mund t'i ketë 3 ose 4 mësimdhënës, apo i ka vetëm 30 apo 40 nxënës. Dhe, ky do të duhej të ishte një problem jashtëzakonisht i madh i planifikimit, i një analize, i një fizibiliteti, i thirrur në statistika zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Konsideroj që Korniza Afatmesme e Shpenzimeve dhe më vjen keq zoti ministër, që s'janë edhe kolegët e tjerë nga tri apo katër fusha. Prandaj, bëj apel që të rishikohen këto shifra, këto projeksione buxhetore dhe të bëhet një ndarje racionale vërtet në ato fusha ku Republika e Kosovës thjesht nuk ka shënuar rezultate të kënaqshme konform trendëve dhe reformave që i kërkon edhe niveli i arsimimit të popullatës, por edhe nevojat e vokacioneve të tregut të punës.

Te shëndetësia është një rritje prej 4,1% te grantet komunale, sepse nganjëherë po merren vetëm me SHSKUK-në dhe me spitale regjionale. Koncepti i mjekësisë familjare, mjek për çdo familje apo një mjek në 2 mijë banorë funksionon në vendet normale. Te ne disi nuk po funksionon. Ka probleme të furnizimit me materiale elementare që nga qendrat e mjekësisë familjare - QKMF-të, spitalet regjionale deri te Shërbimi Spitalor Klinik Universitar dhe fatkeqësisht këtu edhe kolegët e tjerë e theksuan që disi nuk po arrijmë që edhe në këtë sektor që është pika më e dhimbshme e këtij shteti dhe e kësaj shoqërie, kur ia shtojmë kësaj që 80 deri 120 milionë euro pothuajse zyrtare dihet që na shkojnë për trajtim jashtë vendit, jashtë buxhetit që e ndan shteti i Kosovës për trajtim jashtë vendit të pacientëve që nuk kanë mundësi të trajtohen në Republikën e Kosovës.

Prandaj, duhet të jemi të përgjegjshëm dhe të fokusohemi në këto dy fusha që janë jashtëzakonisht të rëndësishme. Një tjetër çështje që unë e kam vërejtur në këtë dokument, zoti ministër, është mungesa e projeksioneve buxhetore për krijimin e Forcave të Armatosura të shtetit të Kosovës. Nëse ne pretendojmë dhe deklaramet politike të zyrtarëve institucional, nuk po flasim për premtime elektorale, po flasim për deklarime publike të tre zyrtarëve më të lartë të shtetit, Presidentit, kryeparlamentarit dhe në veçanti ditëve të fundit kryeministrit, nëse ne duhet të marrim vendime dhe do të duhej konform Kushtetutës së Republikës së Kosovës ta themelojmë armatën e këtij shteti, Forcën e Armatosur në këtë Kornizë Afatmesme të Shpenzimeve, nuk kam parë asnjë vijë buxhetore që do t'i qëndrojë mbrapa një vendimi të tillë.

Prandaj, pa dashur ta zgjas shumë, do të bëj apel edhe një herë zoti ministër, që edhe këtë vit të organizohet rishikimi i Buxhetit të Kosovës. Nuk ka gjë të keqe, përkundrazi e korrigjon, e revidon dhe i orienton paratë e suficitit në projektet për të cilat ka nevojë publiku, ka nevojë vendi, ka nevojë qytetari i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Tani fjalën e ka deputeti Arbër Rexhaj.

**ARBËR REXHAJ:** Faleminderit, kryesues!

Unë i kam lexuar parimet, dokumentin e parë, pastaj alternativën qeverisëse, në fund Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2019-2021. Dhe, në fakt, kur i shikon aty fushat prioritare të parimit të alternativave qeverisëse dhe këto fusha prioritare të cilat janë KASH, me shkurtesë po e përmend, dalin pra pa kohezion, pa konsistencë dhe strukturalisht jo të lidhura mirë njëra me tjetrën, e të mos flasim në aspektin përmbajtjesor e semantik, sepse nuk ka madje-madje as përputhje logjike.

Në KASH si fushë prioritare përcaktohet arsimit, punësimi, shëndetësia, qeverisja e mirë, sundimi i ligjit, industrinë konkurruese, infrastruktura, ambienti, integrimi evropian, politikat e jashtme, çështjet e sigurisë e tjera, e tjera. Dhe, nëse e shihni dokumentin bazë të parimit dhe alternativat qeverisëse, del bujqësia në shtatë sektorë, domethënë kjo qeveri, e të mos flasim për sektorët tjerë ku dalin nga 8 e nga 9, 10, e 12, dhe në këtë aspekt konceptual del që KASH-i dhe dy dokumentet tjera të parimit dhe alternativave nuk kanë përputhshmëri. E tash po kthehem aty. Në fushën e arsimit, KASH-i thotë se me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes në aftësimin parashkollor dhe parafillor gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, politikat e Qeverisë do të fokusohen në përmirësimin e infrastrukturës dhe ndërtuar kopshte të reja publike dhe licencimin e institucioneve private.

Deputetët e PAN-it, nëse ju kujtohet, pra nuk votuan për shtimin e pedagogëve, sociologëve dhe asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta, e cila atëbotë u sponsorizua nga deputetja jonë Arbërie Nagavci. Dhe, paramendon si fushë prioritare merret fusha e arsimit, flitet për menaxhim cilësor dhe efikas të arsimit, të bazuar në transparencë dhe llogaridhënie, zhvillim të

sistemit funksional, ngritje të cilësisë së mësimdhënies, ndërsa PAN voton kundër fëmijëve me nevoja të veçanta, respektivisht kundër përkujdesjes së tyre përmes pedagogëve, psikologëve dhe asistentëve.

Në KASH gjithashtu theksohet për arsimin në veçanti, për aftësim profesional në përputhje me kërkesat e tregut në vend dhe më gjerë. Qeverisa e Kosovës, respektivisht Ministria e Arsimit nuk ka asnjë strategji të vetme të reduktuar në pajtimin e arsimit dhe ekonomisë. Nuk kemi rrjedhë institucionale, ku studentët orientohen në premisa studimore, ku ka nevojë ekonomia vendore. Krejt çka na dalin janë juristë dhe ekonomistë e mos të flasim për orientim, pra për vende të reja të punës. Në fakt kjo shkruan rrallëherë, rrallëherë mirë, por kur shkruan mirë pra siç tha edhe ministri si dokument, ministri i Financave, nuk e ka as idenë më të vogël se çka ka të bëjë me arsimimin dhe aftësimin profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës në vend dhe më gjerë. Nëse po, atëherë ministri i Arsimit do të duhej të ishte i përgjegjshëm, pra të vinte këtu dhe të na tregonte si, s'ka nevojë këtë ta bëjë ministri i Financave se nuk është fushë e tij.

Ky dokument këtu nuk ka të bëjë vetëm me këtë ministër që është në këtë Kuvend, por ka të bëjë me krejt Qeverinë, respektivisht me ministrat në fushat dhe dikasteret përkatëse, prandaj do të duhej të ishin këtu, prandaj kemi pak deputetë të PAN-it këtu, prandaj derisa kemi papërgjegjësi të tillë kjo Qeveri duhet të shkojë në shtëpi.

Në fushën e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit përmendet zbatimi i kornizës strategjike për reformën e Administratës Publike. Publikisht kemi diskutuar këtu me dhjetëra herë dokumente të ndryshme, të cilat kanë ardhur këtu. Dihet se administrata në Kosovë është e partitizuar skajshëm dhe madje ndër sektorët më të dështuar në Kosovë.

Dua të ndalem pak edhe te borxhi i përgjithshëm në fund të vitit 2018, pra parashihet të jetë 1,154 milionë euro. Profiti i borxhit shtetëror të Kosovës përmban tri garanci shtetërore në vlerë prej 44 milionë eurove dhe në vitet 2014-2016 për herë të parë në historikun e profitit të borxhit, në fund të muajit dhjetor 2015 shuma e letrave me vlerë të emërtuar në tregun e brendshëm si përqindje e borxhit total ka tejkaluar huazimet nga borxhi i jashtëm për 0,44%.

Për fund unë i kam edhe dy pyetje drejtuar ministrit e që shpresoj se do të na përgjigjet. Për këtë vit nuk parashihet rishikim i buxhetit. Pse? Është pyetje shumë e thjeshtë. Dhe së dyti, deputeti Milaim Zeka këtu tha që ka dokumente dhe ka incizime për korrupsionin dhe kriminalitetin në ATK. Domethënë, shumë qartë e tha.

Ministër, në çdo pyetje të deputetit dole u përgjigje, mirëpo për shembull në deklarinimin e tij të drejtpërdrejtë nuk the cilat janë ato dokumente. M'i thuaj dhe na trego, pse nuk e bërë këtë? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po, ministri i Financave dëshiron të përgjigjet. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit shumë, i nderuar zoti deputet!

Unë i falënderoj të gjithë deputetët për diskutimet e tyre edhe përmbajtjesore, edhe konstruktive, edhe profesionale, por shumë jam mirëkuptues edhe ndaj atyre diskutimeve kritike. Sa i përket rishikimit nuk është obligim ligjor që të kemi rishikim dhe është mirë, që ne si vend të piqemi dhe të bëjmë buxhet të qëndrueshëm dhe të mos kemi nevojë të bëjmë rishikim. Nëse ka nevojë për të bërë rishikim, atëherë sigurisht se nuk do t'i ikim edhe ne procesit të tillë, mirëpo të hyrat e planifikuara për buxhetin e vitit aktual janë në përputhje me trendët e planifikuar, ekzekutimi i buxhetit ka një përmirësim në raport me periudhat dhe vitin paraprak dhe ne nuk jemi duke parë nevojën që të kemi ndonjë rishikim të buxhetit. Nëse ka nevojë për ridestitim brenda projekteve, në tremujorin e fundit të vitit, Ligji i Buxhetit, nëse s'gabohem neni 16 e jep të drejtën që 5% të totalit të ndarjeve buxhetore të ridestonohen nëpërmjet propozimit nga organizata buxhetore me vendim të Qeverisë.

Sa u përket çështjeve të cilat i ngrenë deputetët në Kuvendin e Republikës së Kosovës, unë e vlerësoj atë, është në autoritetin e tyre, mirëpo kushdo që ngritë një çështje të caktuar sigurisht se i ka edhe të drejtat, por i ka edhe përgjegjësitë që për diçka që e deklaroi realisht me e iniciua dhe me e deponua në institucionet që janë përgjegjëse për t'u marrë me atë çështje.

Prandaj, ministri i Financave nuk mund t'ia ndalojë kurrkujt, por ministri i Financave nuk mund të veprojë mbi bazën e deklaratave që mund t'i bëjë kushdo qoftë, duke përfshirë edhe një deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe mbi bazën e fakteve, atëherë ministri i Financave i merr veprimet e veta në përputhje me përgjegjësitë e veta si ministër i Financave, ndërsa pjesën tjetër që është pjesë e institucioneve dhe organeve tjera e kryejnë institucionet dhe organet tjera.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ilir Deda e ka radhën. Po, Arbër urdhëro, replikë! Ilir, një minutë, Arbri edhe një herë ka kërkuar të replikojë.

ARBËR REXHAJ: Rishikimi i Buxhetit është e vërtetë pra që nuk është obligim ligjor, mirëpo gjithmonë ka qenë kërkesë e komunave gjithandej Republikës së Kosovës. Dhe, nëse ka nevojë për rishikim të Buxhetit është rregullativë, pra është e lejueshme. Sigurisht se kjo vlen kur ka buxhet, por është çështja tash a nuk kemi buhet apo kemi kaluar në harxhimin edhe të rezervave të buxhetit, domethënë të deficitit. Në fakt, po mendoj që kjo praktikë është duke ndodhur së pari herë prej disa viteve, më duket që është së pari herë.

Si rishikim, pra kur komunat nuk kanë të drejtë ta rishikojnë buxhetin e vet dhe kjo përnjëmend do të paraqesë problem për komuna. Është shumë e vërtetë ajo që po thoni, se megjithatë buxheti



duhet të ndahet një herë, e tjera, e tjera, por nëse e shikojmë, po e përmendim veç disa dokumente që unë e di se i kuptoni e këtë aspektin konceptual, unë po e them, ka dallime shumë të mëdha në parimet, alternativën qeverisëse dhe në KASH-in, domethënë tash. Edhe dallime tejet të mëdha edhe tematike edhe konceptuale. Pra, edhe ju bëni ndërhyrje aty, e lëre më komunat.

Mandej, është mirë ministër t'ua tregoni të vërtetën qytetarëve, pse nuk ka rishikim? A është harxhuar buxheti, a keni kaluar në rezerva, a çka është në pyetje?

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ministri dëshiron ta japë edhe një sqarim.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** I nderuar deputet, për informatën tënde, edhe në 2011-ën nuk ka pasur rishikim të buxhetit, se s'ka pasur nevojë, ka pasur një planifikim të mirë e të qëndrueshëm.

Më thuaj konkret, cila komunë ka problem me buxhet? Unë nuk kam marrë informacion prej ndonjë komune që ka aq nevojë imediate, të domosdoshme për ta rishikuar buxhetin. Ndërsa, një pjesë tjetër, kërkoj falje, po sinqerisht nuk e kuptova se pat një ngatërrim, harxhimi i deficitit e çështje të tjera, atë pjesë nuk munda ta kap, mirëpo po e them, trendi i të hyrave në raport me të hyrat e planifikuara është duke ecur mirë dhe pres një përmbushje të mirë të planit të të hyrave të Buxhetit.

Deficiti në fund të vitit pres të jetë më mirë se sa ky i planifikuari dhe pres që të ketë një bilanc buxhetor të pranueshëm edhe në përputhje me legjislacionin. Edhe komunat, cilado komunë qoftë ajo brenda Kosovës, ka të drejtë që në tremujorin e fundit të vitit të vijë me propozim dhe ta kryejë ridestinimin e projekteve të caktuara. Edhe aktualisht komunat përmes kuvendeve të tyre komunale deri në 15% kanë të drejtë t'i drejtohen ministrit të Financave, ministri i Financave ka obligim t'ua njohë ridestinimin. Mbi 15% - 25% është me vendim të Qeverisë. Andaj, Ligji i Buxhetit jep fleksibilitet të mjaftueshëm, që organizatat buxhetore me bë ndërhyrjet e nevojshme me qëllim që ato ta bëjnë rirregullimet e tyre të brendshme.

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti ministër! Arbri kundër-replikë, një minutë!

**ARBËR REXHAJ:** Ministër!

Çdo komunë e Republikës së Kosovës që tashmë është ndërruar subjekti politik, ku ka vepruar më herët, ka konceptin e vet qeverisëse, madje-madje, mendon edhe si me harxhua buxhetin në segmente të ndryshme, prandaj ata mendoj se aty ku është ndërruar buxheti, sigurisht se ka nevojë edhe për rishikim. Tash, çështja është se a është drejtuar dikush a nuk është drejtuar, është çështje e tyre, mirëpo unë këtu e përfaqësoj konceptin mbi të cilin edhe mendoj se duhet me

thënë. Prandaj, edhe ju vetë e dini që ka nevojë për rishikim, por nuk mu përgjigjet në pyetjen pse nuk po ndodh rishikimi.

Ju thatë, që nuk ka nevojë për rishikim. Konceptualisht, gjithmonë ka nevojë për rishikim, sepse jo gjithmonë dokumentet mund të pësojnë ndryshime varësisht edhe të kërkesave të...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Ilir Deda, urdhëro!

ILIR DEDA: Faleminderit!

Ministër, me gjithë respektin për juve, por është shumë për mirëseardhje që Korniza Afatmesme e Shpenzimeve nuk është e obligueshme për qeveritë e ardhshme, sepse kjo që kemi marrë sot e tregon mungesën absolute të idesë zhvillimore dhe të planifikimit zhvillimor të Qeverisë në të cilën ju jeni anëtar.

Po hyj e po i them disa me shifra, për shembull, e para ju nuk e parashihni fare reformën e Administratës Publike, hiq nuk është, qe pika e parë. Ju shihet se doni me e shndërrua krejt Kosovën në rast social. Subvencionet e transferim për çka do të rriten në vitet e ardhshme, për çka? A do të shpiken kategori të reja, që do të subvencionohen prej Qeverisë, që të blihet paqja sociale?

Mallrat dhe shërbimet pse po rritet për 100 milionë? A është kjo pjesë e... a do të punësohen prapë njerëzit me kontratë mbi vepër apo do të rritet numri i dikastereve qeverisëse? Pesëqind e njëzetë e ca njerëz nuk janë të mjaftueshëm si të emëruar politikë, do të rritet edhe më shumë?

Shpenzimet kapitale njëjtë janë të pasqaruara. Në bazë të çkaje do të ketë rritje prej 200 milionë eurove të shpenzimeve kapitale, pasi që do të përfundojë më në fund projekti me Behtel&Enkën, çka tjetër do të ndërtohet, çka është e planifikuar? Dhe, është një falsitet i rritjes së totalit të Buxhetit, sepse ju e llogarisni edhe huamarrjen, edhe deficitin, edhe të hyrat prej AKP-së si rritje të Buxhetit të Kosovës, ndërsa kemi rënie nga grandet prej donatorëve, sepse kjo nuk... ata s'kanë interesim me e ndihmua Kosovën dhe në fund të fundit ky është një vizion pasqyrim i vendnumërimit.

Ne qe 20 vjet nuk po kemi guxim që të orientohemi kah nevojat esenciale të këtij shteti. Cilat janë shtyllat e zhvillimit të vendit tonë? Blerja e paqes sociale, sepse s'po ka zhvillim ekonomik, nuk po ka rritje të sektorit privat, nuk po ka të punësuar, nuk është zhvillimore, nuk është projekt zhvillimor, as nuk është stabile. Ajo vetëm do të shkaktojë krizë.

Dhe për fund, mendoj se është jashtëzakonisht pozitive që mandati i kësaj Qeverie nuk do të jetë deri në fund, sepse praktikat e tilla të qeverisjes me vendin duhet të përfundojnë. 20 vjet ministër, 20 vjet... 20 vjet kjo Kosovë s'po ka para kurrë për arsim dhe s'po ka para kurrë për shëndetësi. E për blerje të paqes sociale paska para! Qysh ashtu? Kush e ka vendosur atë prioritet?

Tash, 60% e buxhetit planifikoni të na shkojë në paga e mëditje, apo çka? 1.3 miliardë euro, nejtse prej 2,4, gati 50%. Po, qe ku është. I keni në tabelë. Po më vjen shumë keq, tash ju çka keni tregua në këtë kohë derisa keni qenë ministër, keni treguar se jeni më i kujdesshëm në zbatimin e disa urdhrave të cilat nuk janë të mira për Buxhetin e shtetit dhe unë këtë po ua jap kompliment, por të njëjtën kohë, ku është, në çka e bazoni rritjen ekonomike në vitet e ardhshme.

Vetëm, kisha dashur kështu në mënyrë specifike sqarim, pse rriten mallrat dhe shërbimet për 100 milionë euro, subvencionet dhe transfere, pse ka rritje? Pse ka rritje të shpenzimeve kapitale? Dhe, çka do të bëni me të hyrat nga AKP-ja, 250 milionë euro, të cilat i keni të planifikuara, për çka? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuari deputet,

Me qëllim që të bëj përpjekje për t'i dhënë disa sqarime të nevojshme, nuk do të thotë që çdo reformë që ndërmerret duhet me pas kosto shtesë dhe kosto të madhe. Reformat mund të ndodhin duke mos pasur fare kosto, ose kosto të arsyeshme, disa thjeshtë të tjera janë që kanë kosto edhe më të mëdha.

Dhe reforma e Administratës Publike, duke përfshirë të gjitha ligjet që përfshijnë këtë reformë, është një nevojë e domosdoshme për vendin, është edhe pjesë e marrëveshjes sonë kontraktuale me BE-në, është duke u diskutua qe një dekadë. Është mirë t'i qitet pika kësaj pune, po është mirë që kjo reformë të mos nënkuptojë domosdoshmërisht ngarkesë të madhe dhe të papërballueshme për Buxhetin e Kosovës.

Unë si ministër i Financave jam në përkrahje të asaj që kjo reformë e këto ligje të shtyhen përpara edhe nën kushtin, që kjo të ketë një kosto të arsyeshme dhe të përballueshme buxhetore dhe nuk e pengon Korniza Afatmesme e Shpenzimeve dhe nuk është pengesë për zhvillimin dhe përfundimin e reformës së administratës publike.

Sa i përket pozicionit mallra dhe shërbime, ka edhe elemente tjera, por dy janë kryesore. E para, kemi të bëjmë me riklasifikim. Ne si shtet kemi marrë edhe rekomandime prej Zyrës Kombëtare të Auditimit që kemi nevojë me e bë një riklasifikim të shpenzimeve, sepse disa shpenzime

historikisht që nga paslufta është ditur që janë shpenzime mallra dhe shërbime, ndërsa ne për një arsye a një arsye tjetër, i kemi kategorizua dhe i kemi klasifikua si shpenzime kapitale dhe gradualisht unë nuk them që ato do të kthehen për një vit, por do të kthehen për disa vite. Ky proces është duke ndodhur viteve të fundit. Do të kategorizohen aty ku e kanë vendin.

Po jap vetëm një rast, matrikulimi i gjedhëve. Matrikulimi i gjedhëve, unë e kam mësuar gjatë proceseve të dëgjimeve buxhetore se çka është ai proces dhe kam parë që është për t'i identifikuar me ata numrat. Ne kemi e kemi trajtuar deri vonë si projekt kapital, faktikisht nuk është projekt kapital dhe duhet të klasifikohet atje ku e ka vendin, për shkak se nëse ne si Ministri e Financave po i ngushtojmë organizatat buxhetore drejt klasifikimit të saktë, atëherë Zyra Kombëtare e Auditimit atyre po ua shkruan si rekomandime, të gjetura. Domethënë arsyeja e parë është riklasifikimi dhe arsyeja e dytë është se nëse rriten projektet kapitale, nënkupton që ne duhet ta rrisim edhe fondin për mirëmbajtjen e tyre. Nuk ka asnjë arsye ekonomike nëse ndërtohet një shkollë, një palestër sportive, një rrugë, një spital dhe ne nuk sigurojmë mjete të mjaftueshme për mirëmbajtjen e atyre projekteve. Sa më shumë të rriten objektet kapitale, aq më shumë rriten edhe shpenzimet për mirëmbajtje.

Ndërsa sa i përket pjesës së mallrave dhe shërbimeve, te shpenzimet administrative dhe te shpenzimet e tjera, sigurisht se do të jemi të kujdesshëm.

Te pjesa e subvencioneve dhe transfereve janë rritur, sepse në Kuvendin e Republikës së Kosovës po aprovohen ligje, po aprovohen ligje që shpeshherë e tejkalojnë dhe nuk e marrin në konsideratë as rekomandimin e Ministrisë së Financave dhe pastaj, kur po bëhet ligj je i detyruar ta buxhetosh. Përndryshe, njerëzit i realizojnë të drejtat e tyre në procese gjyqësore dhe rritet kostoja e tyre, po brenda subvencioneve mund të jenë të rritura edhe subvencionet për bujqësi dhe besoj se duhet pasur në konsideratë edhe atë.

Te shpenzimet kapitale, ne mund të flasim te struktura e shpenzimeve kapitale, por unë besoj që është jashtëzakonisht pozitive që të ruhet niveli dhe lartësia e shpenzimeve kapitale sa më shumë.

Kosova vazhdon të ketë strukturë goxha të arsyeshme, të pranueshme, të buxhetit edhe nëse e krahasojmë me vendet e tjera, ku Kosova aktualisht e ka rreth 26, 27, 30%, ka pasur vit edhe 40% të investimeve kapitale dhe po ta krahasojmë me vende të tjera, del që shumë vendeve të tjera kryesisht buxheti u shkon për shpenzime rrjedhëse.

Unë nuk dëshiroj që Kosova të vijë në një gjendje të tillë.

Sa i përket rritjes së buxhetit për sektorë të caktuar, pajtohem që duhet pasur më shumë buxhet, por ministrat e financave, e në mesin e tyre edhe unë, gjithmonë e kam një pyetje për organizatat buxhetore të nivelit qendror dhe lokal: vlerën për para.

Sa po kthehet paraja të cilën ne po e investojmë? Nëse rritet buxheti për arsim 22%, nëse rritet 10%, nëse rritet për shëndetësi, nëse rritet për nivelin komunal, sa po rritet cilësia edhe kualiteti në atë sektor? Nëse rritet edhe për rrugë, sa po fitojmë me atë investim? A kemi mundur të fitojmë më shumë kilometra, a kemi mundur të fitojmë më shumë kualitet, këto janë të domosdoshme që Ministria e Financave t'i bëjë gjatë dëgjimeve buxhetore edhe në takime me organizata buxhetore.

Prandaj, unë pajtohem që ka nevojë për më shumë investime, po kërkoj që edhe organizatat buxhetore të nivelit qendror dhe lokal të udhëheqin llogari për vlerën për para. Jo vetëm të kërkojnë buxhet shtesë, ndërsa gjendja të mbetet e pandryshuar. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ilir Deda ka replikë.

**ILIR DEDA:** Faleminderit, ministër!

Me dijen time, reforma e Administratës Publike do të thotë që nuk mund t'i parashohim 85 mijë njerëz të punësuar si shërbyes civilë. S'po dëgjoni a?

Me dijen time reforma e administratës publike do të thotë që ne nuk mund të planifikojmë t'i kemi 85 mijë njerëz të punësuar, po duhet të ketë ulje, domethënë kjo është reforma e Administratës Publike dhe një riklasifikim në shërbim civil.

E dyta, a i keni paraparë shpenzimet me “Contour Global”, mihja, shpronësimi e këto të tjerat, sepse unë nuk i pashë këtu, ajo kushton gjysmë miliardi euro.

Dhe e treta, “Welly for Money”, a për kualitet të arsimit e të shëndetësisë nuk mund të matet ashtu qysh po e thoni ju prej prizmit puro financiar. Jo, duhet investuar shumë më shumë në cilësi, edhe të ulen këto shpenzime të kota, gjysmën e mallrave dhe shërbimeve, për shembull, çka po na duhen tërë ato para, në çka po shkojnë? Edhe në logjikën e blerjes së paqes sociale, ministër, blerja e faqes sociale është skandaloze. Asnjë vend tjetër nuk e bën në rajon, as në Evropë e as në botë, bile, po Koreja e Veriut ndoshta, të vetmit kanë mbetur ata.

Po në vitin 2018 të blesh paqe sociale, e kontratën me MSA-në që e ka kjo Kosovë, e ka krejt të kundërtën prej kësaj, atëherë kemi shpërputhjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe MSA-së, në rend të parë.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Urdhëroni, ministër.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Sa i përket reformës së Administratës Publike, ne kemi edhe rregullën e pagave. Dhe, rregulla e pagave është ligj, kërkon që rritja e pagave të jetë në përputhje me rritjen ekonomike. Derisa është ky ligj në fuqi, ne duhet respektuar. Nëse dikush mendon që duhet të jetë më shumë se kaq, e para duhet të ndërrohet ky ligj dhe reforma e Administratës Publike ose duhet ndarë nëpër vite ngarkesa, ose duhet pasur në konsideratë që Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë e ka edhe këtë nen.

Sa i përket çështjes së vlerës për para, unë nuk them që kthimi ndoshta duhet të ndodhë në sektorë të caktuar brenda vitit, do të ndodhë ndoshta në të ardhmen, do të ndodhë në perioda më afatgjate, investimi ndoshta ndodh sivjet e kthimi ndodh ndoshta pas 10 vjetësh, këtu jemi në rregull.

Sa u përket projekteve kapitale, qëndrimi ynë është që me një fond të caktuar a ka mundësi të fitosh më shumë sasi dhe kualitet? Për shembull, te rrugët, te shkollat, te spitalet, është pyetja po shohim sa kemi investuar në Qendrën Klinike Universitare mjete për investime kapitale prej pasluftë e deri sot dhe po shikojmë se sa ka ndërruar gjendja në këtë sektor, apo kudo qoftë tjetër.

Te çështjet sociale si Ministri e Financave jemi shumë të interesuar që shpenzimet rrjedhëse t'i mbajmë nën kontroll dhe të mos vijë te rrezikimi i stabilitetit makro-fiskal, sepse shpenzimet rrjedhëse nuk kanë kosto veç njëvjeçare, nuk e rrezikojnë stabilitetin makro-fiskal njëjtë sikur shpenzimet kapitale si shpenzimet rrjedhëse.

Një projekt kapital, sado që të jetë i kushtueshëm, e ka një fond, dy vjet, tre vjet dhe hiqet si presion prej buxhetit. Ndërsa shpenzimet rrjedhëse kanë presion permanent në buxhetin e Republikës së Kosovës e duhet të jemi shumë të kujdesshëm me faturën e shpenzimeve rrjedhëse.

Ndërsa sa u përket prioriteteve brenda organizatave buxhetore, Ministria e Financave jep kufij, thotë këto janë mjetet në dispozicion për shpenzim, i jep të ndara nëpër kategori, ndërsa organizatat buxhetore çka vendosin brenda prioriteteve të tyre, është përgjegjësi dhe obligim i organizatave buxhetore, i ministrave të linjave cilat prioritete i kanë.

Ne e dimë edhe në të kaluarën, ministrat i vendosin disa prioritete dhe i lënë disa top prioritete të pavendosura brenda kufijve buxhetorë, thotë jo unë i kam vendosur këto, e kam zënë hapësirën, po unë i kam edhe këto. Ne jemi të detyruar pastaj, se Ministria e Financave nuk ka buxhet rezervë, e ka këtë që e ka në dispozicion. Këto janë mjetet në dispozicion, ti vendosi prioritetet qysh i vlerëson, ne si Ministri e Financave nuk mund të japim buxhet shtesë, se ne e kemi shpërndarë buxhetin nëpër organizata buxhetore. Prandaj, nëse flasim për rritjen e një sektori, automatikisht duhet pasur në konsideratë që mund ta dëmtojmë sektorin tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ilir Deda, kundër-replikë, një minutë!

ILIR DEDA: Faleminderit!

Atëherë kjo do të thotë që projektimi i këtij dokumenti është bërë me logjikën e status quo-s, edhe ato organizata buxhetore s'kanë ide, e hajt tash, kishe po planifikojnë diçka dhe po kërkojmë pak rritje. Fatkeqësi është që mbetet peng i vendimeve ad-hoc të shpenzimeve financiare, domethënë ad-hoc nuk ka planifikim të mirëfilltë, ju e keni nxjerrë kornizën, por janë ad-hoc vendimet që merren, në qoftë se është kjo Qeveri, e që nuk do të jetë.

E për fund, sa i përket QKUK-së e të gjitha atyre investimeve, nuk është investuar në njerëz, është investuar në objekte, e pse s'ka barna sot, është për shkak të rrjetit korruptiv të importit të barnave, të cilin ky shtet nuk është duke dashur ta luftojë, e për këtë ka përgjegjësi ekzekutivi i vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Drita Millaku.

DRITA MILLAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar qytetarë,

Qeveria pati përcaktuar si prioritet përmirësimin e cilësisë dhe qasjes në shërbimet shëndetësore, për të cilën edhe unë me kujdesin më të madh e kam shqyrtuar dhe e kam lexuar këtë Kornizë Afatmesme buxhetore.

Por nuk na ka dhënë asnjëherë sqarim adekuat se si dhe për sa kohë do të realizojë këtë?

Thuhet se synohet ruajtja e shëndetit të popullsisë dhe ofrimi i shërbimeve cilësore. Po si duket, s'e kanë të qartë se jo vetën në QKUK, por në masë të madhe QKUK-ja dhe spitalet rajonale për çdo vit përballen me situata sikur të ishin spitale të luftës.

Pacientët e shtruar nuk arrijnë t'i kenë as shërbimet bazike, ashtu siç thuhet, pra, falas, nga mantili i doktorit, te dorëzat e te barnat para dhe pas ndërhyrjeve kirurgjikale. Nuk kanë as shiringa, fasha e të mos flasim për antibiotikë.

Duke mos i përfshirë këtu diabetikët fare, sepse ata edhe nëse e marrin insulinën, ministria në tenderët që është furnizuar deri tani i ka paguar 2-3 fish më shtrenjtë se sa që janë në shitje.

Ndërsa pacientët që janë të sëmurë, me sëmundje malinje, po përballen me luftë për ekzistencë çdo ditë të jetës së tyre. Barnat që duhet t'i marrin brenda QKUK-së i gjejnë me çmim 1.5 euro në barnatore përballë QKUK-së.

Në Kornizën Afatmesme që e keni përgatitur, e që është temë e debatit të sotëm parlamentar, keni paraqitur fraza të tipit ‘cilësi të shërbimeve shëndetësore’, pra përmirësim të shërbimeve shëndetësore nëpërmjet ofrimit të shërbimeve shëndetësore në shtëpi.

Seriozisht po habitem për të mirë, në fakt, shumë ide e mirë, por tepër groteske, sepse e kemi parasysh gjendje katastrofale në spitale.

Në këto kushte çfarë keni shkruar në këtë dokument nuk mund të gjejmë tjetër përveç retorikë. Shtoja kësaj qeverisje që përpos retorikës boshe, nuk ka asnjë element, asnjë mënyrë apo plan se si bëhen të realizueshme.

Në këtë material flitet për funksionalizimin e Fondit të sigurimeve shëndetësore si dhe vazhdimin e përpjekjeve për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor, SISH, por të gjithë ne e dimë që ju e keni ndalur realizimin e SISH-it dhe se doni në mënyrë plotësisht joprofesionale të vijoni me sigurimet shëndetësore në kundërshtim me vendimet e Kuvendit të propozuara nga Lëvizja Vetëvendosje, e të miratuara për dy legjislatura rresht nga deputetët e Kuvendit.

Te Korniza Afatmesme Buxhetore 2019-21 flitet për ngritjen e kapaciteteve spitalore në sistemin shëndetësor në ndërtim të objekteve.

Po mbërrijmë në vitin 2021 dhe në projektet tuaja nuk flitet për kërkim shkencor, cilësi të kirurgjisë, avancim teknologjik të pajisjeve diagnostikuese, por për tenderë që ndërtojnë vetëm ndërtesa.

Implementimin e reformave substanciale për të arritur objektivat i keni paraqitur:

Nën një: mbrojtja e shëndetit për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara shëndetësore.

Nën dy, sigurimin e financimit të qëndrueshëm shëndetësor.

Nën tre, riorganizimi i sektorit të shëndetësisë.

Në fakt, organizatat buxhetore, të cilat e përbëjnë këtë sektor janë: Ministria e Shëndetësisë dhe shërbimi spitalor, Klinika Universitare e Kosovës. Po, në të vërtetë këto janë mekanizma të drejtpërdrejt që duhet të punojnë për t’i realizuar ato.

Por ajo që më habit më së shumti është forma tabelore, në të cilën e keni paraqitur prej vitit 2017 deri në vitin 2021.



Në vitin 2017 shpenzimet janë paraqitur në 132 mijë e 345 mijë e 294 euro, pastaj për çdo vit, deri në vitin 2021 ato kanë lëvizur vetëm nga 10 mijë euro.

Janë paraqitur shpenzimet, këto që tregojnë se i keni paraqitur vetëm sa për të thënë kinse po punohet apo kinse po bëjmë diçka.

Pastaj, mallrat dhe shpenzimet nga 43 milionë e 904 969 euro, prej vitit 2017, në vitin 2018 kjo ka arritur në 46 milionë, në vitin 2019 ka arritur në 48 milionë, në vitin 2020 në 60 milionë dhe në vitin 2021 në 74 milionë. Por, ju lutem, si mund t'i realizoni të gjitha këto objektiva që i paraqitët më lart? Paraprakisht po e njëjta qeveri po e mohon vetë nëpërmjet këtij planifikimi, domethënë po e mohon vetë këtë Kornizë Afatmesme. Pra, kjo tabelë tregon se nuk ka pritshmëri, por vetëm fjalë retorike, premtime, të cilat jeni të specializuar t'i bëni dhe jo vetëm, por këto i keni bërë me vite radhazi. Pyetjet, të cilat do të kisha adresuar ish-in drejtpërdrejt për ministrin e Shëndetësisë, mirëpo meqenëse ai nuk është i pranishëm, atëherë pyetjet po i lë t'i dëgjojnë vetëm qytetarët. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu ka replikë, dy minuta.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, kryesues!

Po dua vetëm t'ua rikujtoj disa prej kolegëve të pranishëm në sallë që kur në vitin 2016 kemi votuar buxhetin e Republikës së Kosovës, është transferuar buxheti për barna me ligj nga SHSKUK-ja te Ministria e Shëndetësisë. Ka insistuar Lidhja Demokratike me ministrin e atëhershëm të transferohet ky buxhet nga QKUK-ja në Ministrinë e Shëndetësisë dhe prej një furnizimi përafërsisht 70-80% të barnave nga lista esenciale, prej atij momenti vetëm është rritur kostoja e blerjes së barnave, por barnat në vazhdimësi kanë munguar. Dhe, po jua rikujtoj edhe një fakt tjetër, projektin e modernizimit të kardiologjisë, i blerë me kredi nga Banka Austriake, e aparatura nuk është në Kosovë. Pra, ne kemi pasur në të kaluarën mungesë apo paaftësi menaxheriale e shpresojmë që të përmirësohet në të ardhmen. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Tani fjalën e ka deputeti Sami Kurteshi.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Ne i dëgjuam të gjitha, profesionalisht nuk e di a ka më çka të them, por megjithatë mendoj se duhet pak ta përkthejmë në gjuhën popullore krejt këtë fjalorin edhe intelektual, ndoshta edhe profesional, se njerëzit Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021 ndoshta nuk e kuptojnë drejt. Ajo është paratë që i marrim ne në Kosovë dhe qysh i shpenzojmë. Këtu na i kanë nxjerrë këto para dhe kanë treguar sa marrim brenda një viti, 2019, 2020, 2021, edhe qysh do t'i shpërndajmë.

Ka shumë vrima, sikur çdo shtëpi e madhe, edhe Kosova, se ne bashkë me Kinën i bëjmë një 1 miliard e gjysmë njerëz, mirëpo po fokusohem në këtë buxhetin e Kosovës që e kemi. Po i lë anash të gjitha të tjerat, po koncentrohemi, fokusohemi vetëm me një çështje, të reforma e Administratës Shtetërore. Së pari ky buxhet këtu që e kemi është buxhet klientelist, ky nuk është buxhet zhvillimor. Nëse bëhemi fer, edhe ministri bëhet fer dhe çdokush, do të kishte treguar që me investimet që janë paraparë në shëndetësi, në shkollim, arsim po dua të them, në drejtësi, çka do të përfitojë qytetari i Kosovës, po e zëmë në vitin 2021, në qoftë se kjo qeveri vazhdon? Do të thotë, a do të ketë shkolla më të mira, a do të ketë arsim më cilësor? Dikush thotë qysh e matim, për tre vjet s'mund ta matim. Jo, jo, neve na mat ai testi i PISA-s për çdo vit. Në shëndetësi a do të ketë qytetari i Kosovës sigurim shëndetësor me këtë kornizë? Edhe, sa para kanë për t'u investuar në të? A do të zvogëlohet numri i lëndëve në gjyqësor? A do të presin qytetarët e Kosovës 8.5 vjet mesatarisht për zgjidhjen e një rasti në gjyqësorin e Kosovës? A janë llogaritur investime në këto dikastere, në këto fusha?

Ky është problemi, ne kemi qeverinë politike më të madhen në botë, sa u përket funksioneve politike, bëjeni një hulumtim të të gjitha qeverive në botë, sa u përket funksioneve politike kemi Qeverinë më të madhe në botë me 101 njerëz që janë të zgjedhur politikisht. Nuk ka qeveri të tillë në botë. Vetëm një ministër e kemi këtu, natyrisht nuk jemi për të na aplauduar edhe si Kuvend, po shihet sa është numri i deputetëve në sallë, por si Qeveri e kemi më të madhen në botë, ky është problemi. Edhe duke filluar nga Qeveria, nga numri i njerëzve politikisht të zgjedhur në Qeveri, ne duhet ta shohim edhe rritjen e numrit të të punësuarve në Administratën Shtetërore dhe kur them në Administratën Shtetërore, mendoj në të gjithë njerëzit që paguhen nga ky buxhet që e kemi këtu përpara. Ky buxhet që e kemi ne përpara ka një planifikim të tillë: thotë më 2021 do të jenë 85 mijë e 106 njerëz që paguhen nga buxheti shtetëror, prej tyre do të jenë 44 mijë në nivel komunal dhe 41 mijë e 048 në nivel qendror. Rritja është përafërsisht 680 njerëz, 500 në nivelin qendror dhe 180 në nivelin komunal.

Ky është buxhet klientelist. Ne kemi administratën më të fryrë dhe më joefikase në botë. Po e përmend edhe një herë, mesatarja, përjashto njerëzit që vërtet angazhohen, mesatarja e orarit të punës nga 8 orëve që paguhen, nuk arrijnë 1 orë e gjysmë dhe vëreni diçka, rritja bëhet në nivelin qendror, nuk bëhet në nivelin lokal, kur i llogarisim, domethënë kemi një rritje në nivel lokal për katër vjet 180 persona, në nivel qendror i kemi 500.

Me mallra dhe shërbime, paga dhe mëditje, në vitin 2021 mbërrin rrafsh 1 miliard. Nga ato 1 miliard, kjo rritje domethënë 17 milionë janë në nivel komunal dhe 152 milionë janë në nivel qendror. Domethënë, qeveritë llogarisin të rrisin numrin e të punësuarve, sepse ajo është klientela, aty nuk mund t'i kontrollojë askush sa punësojnë, qysh i punësojnë, a e dinë ata njerëz vendin e tyre të punës, a s'e dinë, a ka zyrë a s'ka, nuk është me rëndësi.

Ministri e bëri një përpjekje që të na tregojë ose që ta operacionalizojë termin “mallra dhe shërbime”, megjithatë unë po e pyes: në këto mallra dhe shërbime a hyjnë veturat, telefonat që paguhen, përfshirë këtu edhe deputetët? A hyjnë karburantet, a hyjnë rregullimi i kabineteve, çdo ministër, apo president apo kryeministër i ndryshon apo s’i ndryshon? A hyjnë të gjitha këto, hiç shpenzimet komunale. Këto nuk janë investime kapitale, kur e shohim rritjen pas 4 vjetëve, më 2021, pas 3 vjetëve, si të doni thoni, për investimet kapitale rritja do të jetë domethënë do të jenë 175 milionë euro, kurse për paga dhe mëditje bashkë me mallra dhe shërbime do të jenë 170 milionë euro. Nuk ka mundësi të rritjes ekonomike kur rritja e pagave dhe mëditjeve, mallrave dhe shërbimeve që janë shpenzime, thjesht konsum, të jetë në masën e njëjtë sa shpenzimet kapitale, është e pamundur.

Ne mund të bëjmë gjithçka, mirëpo ne duhet, edhe një herë po e them, nga ky buxhet këtu, edhe nga të gjitha buxhetet, sepse partitë që kanë qenë në pushtet tani e 20 vjet e kanë bërë klientelën e tyre dhe tani i kemi 85 mijë njerëz që paguhen nga buxheti shtetëror. Nga ky buxhet dhe nga buxhetet e Kosovës së deritanishme me kursimet e arsyeshme që mund të bëhen, mund të kursehen rreth 200 milionë euro në vit, që mund të shkojnë në arsim, në sigurim shëndetësor, në drejtësi, në këto tri sfera, për të cilat Kosova është në vendin e fundit në botë, ky është problemi. Reforma e Administratës Publike është lojë në veti pa u mat performansa, pa u mat efikasiteti edhe eficientia e njerëzve që punojnë. Qysh e di ministri, qysh e dimë ne të gjithë, sot kemi njerëz që paguhen nga buxheti i këtij shteti në nivel qendror, por edhe lokal, ndoshta më pak, sepse ata ballafaqohen drejtpërdrejt me qytetarët, që nuk e dinë ku e kanë vendin e punës. Mesatarja e rrogës në nivel qendror me mallra dhe shërbime është diku rreth 600-650 euro. Edhe po të shndërrohet në shtet social, Kosova krejt këta njerëz që janë tepër po i qiti me pensione 300 euro në muaj, Kosova do t’i kishte kursye rreth 150-200 milionë euro në vjet.

Domethënë, 150 deri 200 milionë euro paguhen për çdo vit për klientelën e partive politike që e kanë zaptuar Administratën Shtetërore. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Dhe, e fundit është kolegja Fatmire Kollçaku.

**FATMIRE KOLLÇAKU:** Faleminderit!

Është bërë dukuri që temat kaq të rëndësishme si kjo që po e diskutojmë tani të diskutohet në orët e vona, pa kuorum, pa praninë e Kabinetit qeveritar, me përjashtim të ministrit të Financave që i dedikohet sot kryesisht kjo temë, edhe pse kjo temë nuk i përket veç këtij ministri, por duke filluar prej kryeministrit dhe ministrave të tjerë, sepse bëhet fjalë faktikisht për një mandat qeverisës dhe ne nuk e dimë se a do ta përfundojë kjo Qeveri këtë mandat, mirëpo në fakt qytetarët e Republikës së Kosovës duhet ta dinë çfarë perspektive i pret, sepse pak a shumë këtu u “prehen teshat”, të them ashtu në gjuhë popullore.

Që në fillim u tha që nuk ka nevojë të jetë në përputhje kjo kornizë, sepse kishte vërejtje se nuk është në përputhje me programin qeveritar dhe programi qeveritar u krahasua me fushatë parazgjedhore, ku, në fakt, po i dërgojmë një porosi qytetarëve të mos u besojnë politikanëve për krejt ato çfarë u thonë në fushatë, se janë një grup i gënjeshtreve dhe pastaj kur të vijë realiteti do të ballafaqoheni me ato çfarë i pret, prandaj kjo është një porosi e mirë për qytetarët që tash e tutje të bazohen në veprat e një qeverie, por jo në premtimet e partive politike, sepse në fytyrë po u themi që këto tashmë qenkan një grup i gënjeshtreve.

Edhe pse desha të fokusohem në shëndetësi, aq shumë u fol për shëndetësinë dhe arsimin, por jo pa arsye, sepse kjo Qeveri i deklaroi si prioritete shëndetësinë dhe arsimin kryesisht dhe nëse bazohemi në ato që tashmë u diskutuan dhe po diskutohet me vite vetëm për Ligjin për sigurime shëndetësore, pra për skemën e sigurimeve shëndetësore, që nuk po reflektohet në këtë kornizë, së paku jo qartë. Prandaj, unë e ftoj ministrin që në fund kur të deklarohet të na tregojë qartë lidhur me implementimin e Ligjit për sigurimet shëndetësore, a ka gjasa, sepse ne nuk po shohim as sistemin informativ shëndetësor, sepse me një fjali të shkurtër thuhet se do të bëhen përpjekje për implementimin e SISH-it, që është parakusht sado që qeveria apo ministri thotë që nuk është parakusht, ne e konsiderojmë parakusht për zbatimin e Ligjit për sigurim shëndetësor.

Prandaj, nëse vetëm këto dy segmente i kemi parasysh dhe si është situata aktuale në shëndetësi, besoj që, siç u tha edhe sa ndahet për shëndetësinë, krahasuar edhe me regjionin, me të vërtetë nuk është fare shpresëdhënëse dhe nuk radhitet si prioritet shëndetësia. Do ta pyesja ministrin po ashtu, sepse shihet se parashikimi nuk është fare, nuk po parashikohen implikimet e Ligjit për pagat, i cili tashmë pritet të miratohet këtu, ku pritet që vetëm ai të ketë diku 40 milionë euro ndikim, nëse parashihet edhe kostoja për vitet e përvojës së punës plus 3 milionë euro, ndërsa e gjithë rritja e paraparë është diku 20 milionë euro.

Dhe, duke e ditur këtë rritje që i bëri Qeveria vetvetes, me gjithë këta ministra, zëvendësministra, këshilltarë, koordinatorë e tjerë dhe pakënaqësinë që u krijua në shoqërinë kosovare, paramendojini tash pritjet e punëtorëve shëndetësorë, të cilët po e presin rritjen e koeficientit, rritjen e pagave. Ndërsa, në këtë kornizë as në tre vjet nuk parashihet as për së afërmi rritja e pagave që presin punëtorët shëndetësorë dhe punëtorët tjerë në Administratën Publike e tjera, që nuk do të ndodhë. Prandaj, nga kjo foltore kërkoj nga ministri të na tregojë më për së afërmi implikimet që do t'i ketë apo ndoshta në Ligjin për pagat, sikur që ka ndodhur më herët, do të shkruajë në përfundim "ligji do të hyjë në zbatim tre vjet nga sot", siç ka ndodhur që një Qeveri dëshiron ta marrë një meritë për një ligj, por zbatimin e ligjit e parashih shumë vite më vonë. Kjo për qeveritë e hershme nuk ka qenë e rrallë si dukuri, prandaj nuk e di a do të ndodhë këtë herë.

Sa u përket subvencioneve dhe transfereve si pjesëmarrës i dytë më i lartë në kategorinë e shpenzimeve, rrjedh se kjo komponentë planifikohet të shfaqë një rritje më të theksuar në vitin e

parë të periudhës afatmesme, kurse në dy vitet e fundit të periudhës raportuese të ketë nivel më të ulët të rritjes me periudhat paraprake. Rrjedhimisht, shpenzimet për këtë kategori planifikohet të arrijnë diku në 584,1 milionë euro në fund të vitit 2021, shifër kjo që përfaqëson një rritje prej rreth 11,1% nëse krahasohet me vitin 2018 me një pjesëmarrje prej 7,6% të bruto-produktit vendor në mesatare.

Duhet theksuar se kjo përkrahje për ndërmarrjet publike planifikohet të bjerë gradualisht gjatë periudhës planifikuese. Ky shpjegim konsiderohet se është qëllimisht shumë i paqartë, meqë synohet të iket nga pranimi se do të implementohet apo jo Projektligji për pagat e mësimdhënësve nga periudha e viteve të '90-ta. E njëjta vlen edhe për koston e Projektligjit për veteranët e luftës. Po ashtu, te kutia 1, klauzola investive, janë paraqitur 7 projekte, por për asnjërin prej këtyre projekteve nuk ka një studim të mirëfilltë të koston dhe përfitimit, që do të ishte pikënisje për çfarëdo huazim, plus që pika e 7-të, projekti për transport publik në komunën e Prishtinës nuk do të duhej të figuronte fare, meqë financimi ka përfunduar moti.

Pika e gjashtë, që ka të bëjë me ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Prishtinë është shumë problematike, meqë kontrata e nënshkruar me francezë, ku parashihet që edhe kredia të vijë nga ata edhe pajisjet të blihen, edhe ndërtimi dhe operimi të kryhet nga francezët, kontratë kjo që konsiderohet edhe e fryrë, por është edhe në kundërshtim me MSA-në dhe si e tillë mund të na fusë edhe në konflikt me vendet tjera të BE-së, para së gjithash me Gjermaninë. Po ashtu, kjo kontratë mund të sjellë edhe dëme në segmentet tjera, si për shembull te ai i ndërtimit të kolektorëve, meqë investitori gjerman dhe zviceran ka shumë mundësi të tërhiqen, si pasojë e pakënaqësive me mënyrën se si është nënshkruar kjo kontratë.

Ka shumë gjasa që kjo kontratë të jetë favor për disa zyrtarë vendorë bashkë me investitorët. Është mirë të kërkohet qëndrimi edhe i Komunës së Prishtinës, meqë parashihet një koncesionim i kompanisë, që nënkupton me shumë gjasë rritje të faturave për të gjithë qytetarët e Prishtinës në një të ardhme të afërt.

Po ashtu, shihet se në grafikun e 10, stoku i borxhit të përgjithshëm si përqindje e bruto-produktit të vendit shihet se vetëm për pesë vjet Qeveria ka arritur të trefishojë borxhin publik nga pak më shumë se 400 milionë në vitin 2013 në afërsisht 1,2 miliard për vitin 2018. Kjo është rritje rekorde në përqindje, që s'e ka asnjë shtet i Bashkimit Evropian, madje rritja është dukshëm më e shpejt edhe se ajo e Greqisë.

Po ashtu, te potencialet zhvillimore, zhvillimi i kapaciteteve të reja për prodhimin e energjisë elektrike pas nënshkrimit të marrëveshjes komerciale nga Qeveria e Republikës së Kosovës me operatorin privat, Kompaninë Amerikane Contour Global për ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re, priten investime të konsiderueshme në periudhën afatmesme. Derisa të gjithë ekspertët e fushës e shohin si shumë të dëmshme këtë marrëveshje dhe vlerësojnë se e njëjta do të ndikojë

në pamundësinë e zhvillimit ekonomik, së paku në 20 vjetët e ardhshme, duke e quajtur madje edhe si kontratë që do ta falimentojë shtetin.

Shihet qartë, se të gjitha shkresat dhe potencialet zhvillimore janë varur te një projekt i vetëm, i cili jo vetëm që nuk ka të ardhme të sigurt, por edhe nuk mund të ketë ndikim buxhetor pozitiv në periudhën së cilës i referohet KASH-i.

Po ashtu, te aneks tabela 1, tabelat me indikatorë makroekonomikë, kjo tabelë tregon rritjen substanciale të pranisë së shtetit në ekonomi, që vjen çuditërisht nga një qeveri djathtiste, e cila gjithë rritjen e ka nga pagat dhe subvencionet. A mund një vend në zhvillim si Kosova ta përballojë një shtet kaq të madh me një konsum të së ardhmes, që gjenerohet, kaq të vogël, në mbështetje të ekonomisë?

Kam disa pyetje konkrete për të mos e zgjatë më tepër, meqenëse siç e thash, fatkeqësisht po flasim në orët e vona, kur edhe interesimi i deputetëve është shumë i vogël për një temë kaq të rëndësishme.

Pyetja, a ka Qeveria strategji të mbledhjes së të hyrave? Çfarë do të ndodhë me nivelin e të hyrave, kur shpenzohen mjetet e parapara nga likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore? Si do të realizohet menaxhimi i borxhit publik? Pse kemi realizim të dobët të projekteve të parapara me klauzolën e investimeve? Pse hyhet në marrëveshje financimi pa përgatitje të duhur të projekteve e në anën tjetër fillohet pagesa e kamatave ende pa filluar realizimi i projekteve?

Po ashtu, siç e ceka në fushën e sigurimit shëndetësor, a janë parë konkretisht projeksionet buxhetore 2019-2021, mjetet buxhetore për sigurimin...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ministri e ka kërkuar fjalën.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Edhe një herë i falënderoj të gjithë deputetët për diskutimet e tyre dhe po i referohem diskutimit të fundit dhe pyetjeve.

Sa i përket inkasimit apo administrimit të tatimeve nga institucionet përgjegjëse, përveç që është e planifikuar rritja e të hyrave të ndodhë në përputhje me rritjen ekonomike, një pjesë është si rezultat i zvogëlimit të informalitetit, ku janë edhe masat adekuate që do të ndërmerren. Sa i përket çështjes së borxhit publik është obligim që strategjia e borxhit publik çdo vit të miratohet.

Kosova, kur flisni me shifra duhet me i pas shifrat e sakta, të krahasueshme, zyrtare, me vend, e tjera... e ka borxhin publik 18% dhe nëse merr, në daç të vendeve të regjionit, që disa prej tyre

kalojnë 80% të bruto-produktit vendor, ka brenda vendeve të BE-së që kalojnë edhe 100% të bruto-produktit vendor, nuk ka nivel të lartë të borxhit publik, mirëpo është shumë e nevojshme të kihet kujdes me rritjen e borxhit publik dhe të huazohet vetëm për projekte të cilat kanë kthim të lartë.

Sa u përket sigurimeve shëndetësore edhe çështjeve tjera sociale, deputete e nderuar, kur po vijjnë ligjet këtu, ligjet që kanë kosto, po bëni gara, që unë e vlerësoj edhe atë, edhe pse drejt, është në autoritetin e deputetëve, por po bëni gara se kush po merr merita dhe po flet më shumë për një kategori të caktuar, kush po e përkrah këtë më shumë dhe kush po i thotë këtij më shumë për të të dhënë para. Dhe pastaj, kur po vini e po thoni, “jo janë të mëdha mjetet e ndara për transfere sociale”. Po, nëse aprovohet ligj në Kuvendin e Kosovës i cili ka kosto, është normal që ka me u rritë edhe pjesa për transfere sociale. Rrallë po ndodh...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bilall Sherifi. Shpresoj të jetë i fundit.

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, kryesues!

Unë do të përpiqem vërtet të prek vetëm një çështje. Rreth akuzës së vazhdueshme që është bërë për blerjen e paqes sociale.

Kam përshtypjen se veç ia kemi dëgjuar zërin paqes sociale, se paqja sociale s’është duke u paguar me buxhet, paqen sociale është duke e paguar diaspora me miliarda të cilat i sjellë në Kosovë çdo muaj, çdo verë, çdo ditë, çdo javë, çdo muaj. Me 100, 150 milionë a 200, sa ndahen nga ky 2 miliardësh për kategoritë sociale të besosh që me ato para je duke e paguar paqen sociale i bie të bësh propagandë, një.

Dy, kushdo që beson se duhet një debat për premtimet elektorale që i kemi dhënë secila parti, le ta bëjmë një debat të veçantë, se vërtet aty kemi secili për secilin çfarë të themi. Ndërsa, për ta përfunduar fjalën time do të thosha në vend, kush nuk është i gatshëm të paguajë paqen sociale, duhet të bëhet për luftë sociale pastaj. Prandaj, mendoj që më e pakta që kjo shoqëri e ka për detyrë të bëjë, sidomos ajo kategori që ka mirëqenie në kurriz të atyre që s’kanë, duhet të jetë e gatshme të ndajë diçka, në mënyrë që ta paguajë paqen sociale, që të mos i vijë lufta sociale.

Dhe, kjo është ajo që e kemi bërë ndër vite, në vend se ta bëjmë Kosovën atraktive për investitorë, ne i kemi shitur gjithçka që ka pasur ky vend. Shit tokat bujqësore, shit fabrika, shit atë, shit këtë... pra, tash nuk mund edhe t’i flakësh njerëzit në rrugë edhe t’ua shesësh krejt çka kanë krijuar për dekada të tëra edhe t’u thuash “tash nuk ke as bukë të hash ti”, “Ti, nuk mund të hash as bukë”. Pra, ky është çmimi i politikave totalisht neoliberalë, se prodhon armatë të njerëzve të cilët kanë nevojë së paku me u ndihmuar bukën me ua dhënë.

KRYESUESI: Fatmire, një minutë!

FATMIRE KOLLÇAKU: Vetëm një gjë, askush nuk është që shteti të mos i mbrojë grupet e cenueshme, se është obligim i çdo shteti edhe i Kosovës, sado me buxhet të varfër. Por, që të revidohen listat e përfituesve të skemave, të gjitha skemave, të fryra është obligim i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie. Është obligim i shtetit që vërtetë të përfitojë nga skemat ai që e meriton, nën një. E sa i përket Ligjit për sigurim është obligim i Qeverisë në 2014 u tha është miratuar një projektligj, i cili ende nuk po zbatohet, ndërsa operojnë kompanitë private të cilat jo rrallë abuzojnë me klientët e tyre, ndërsa po krijohet bindja që dikush qëllimisht po e pengon zbatimin e Ligjit publik, për të përfituar kompanitë private. Kjo përfundimisht duhet të sqarohet këtu.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap propozuesit të çështjes si përfundim i debatit. S'keni të drejtë, jo s'keni të drejtë. Urdhëro, Avdullah Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH: Faleminderit, kryesues i seancës!

U mundova t'i përcjellë shumicën e diskutimeve dhe ndërhyrjet e vazhdueshme të ministrit për të dhënë sqarime e përgjigje dhe vlerësimet e tij dhe të Qeverisë për debatin e sotëm.

Kërkesa jonë initiale për këtë debat ka qenë thjeshtë për të konkluduar se sa Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, që është dokument zyrtar i Qeverisë së Kosovës që vjen në Kuvend, në bazë të të cilit ne bëjmë projeksionet buxhetore për vitin 2019, i reflekton premtimet që këta i kanë dhënë gjatë fushatës. Ju e keni formuar Qeverinë dhe qytetarët presin që ato premtime që janë dhënë në fushatë të reflektohen në projeksionin buxhetor për 3 vjetët e ardhshme edhe në Programin qeverisës që tash është dokument zyrtar, është diskutuar edhe këtu në Kuvend në shtatorin e vitit 2017.

Edhe prej të gjitha diskutimeve, u bë e qartë që ky dokument është një dokument teknik, që ka ardhur në Kuvendin e Kosovës për informim të deputetëve, por që aspak nuk ka ndërlidhje jo me premtimet elektorale, sepse ato duket se i ka marrë era, por në veçanti me Programin qeverisës 2017-2021. Unë besoj se do të diskutojmë shumë më gjatë për këtë çështje.

Tash, kishte deklarime prej më të ndryshmeve edhe prej frikës që paqja sociale apo lufta sociale, po mundohen me e ble paqen sociale për ta evituar luftën sociale, të disa deputetëve që po i ngrenë këto dilema. I kemi kaluar ato faza ne. Tash, me këto skema sociale, ministër, të kemi kujdes, edhe të gjithë deputetët, të mos mundohemi, sepse ka pasur dhe ka tendenca të vazhdueshme për të krijuar sistem klientelist politik për avantazhe të caktuara politike me këto skema të ndryshme dhe e dyta, duhet hequr mentalitetin që ne t'i "keshiratim" të gjitha përpjekjet e qytetarëve të Kosovës për pavarësinë që e kemi mbërri sot.



Të gjithë pajtohemi në këtë pikë, por pak njerëz kanë guxim ta thonë këtë drejtë edhe me u thënë stop disa gjërave.

Unë e kuptoj vullnetin e juaj të mirë edhe këtu në seancë, edhe në foltore që vazhdimisht e shprehin, por besoni me gjithë respektin, nuk është e mjaftueshme. Nuk është e mjaftueshme, sepse si ministër i Financave ju këto gjëra duhet t'i ndalini në Qeveri dhe nuk mund të prisni nga deputetët e opozitës që t'i ndalin disa iniciativa jo të përshtatshme, që nisin, që burojnë nga Qeveria. Po mundohem të kuptoj pozitën e juaj në këtë drejtim dhe vullnetin e mirë, për t'i ndalë këto.

Tani, ne kemi propozuar një rezolutë me tri pika, të cilat u janë shpërndarë grupeve parlamentare. Ende nuk kam marrë komente, por unë besoj se edhe ashtu sot nuk ka kuorum për të votuar këtë rezolutë. Deri në seancën e ardhshme, nëse kanë grupet parlamentare komente ne mund t'i pranojmë.

Nëse më lejoni, kryesues, unë mund ta lexoj:

Kuvendi i Kosovës në mbështetje të nenit 65 të Kushtetutës dhe të Rregullores së Punës së Kuvendit, në debatin parlamentar të zhvilluar sot, të propozuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së propozon këtë:

## REZOLUTË

1. Qeveria e Kosovës të bëjë rishikimin e KASH-it 2019/2021 me qëllim të reflektimit të premtimeve elektorale, Programit qeverisës të prezantuar në shtator 2017 në Kuvendin e Kosovës dhe dokumenteve të tjera strategjike, në veçanti Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.
2. Rishikimi i KASH-it sipas pikës 1 të bëhet dhe të dorëzohet në Kuvend të Kosovës para prezantimit të Buxhetit për vitin 2019.
3. Pjesë e KASH-it duhet të jetë një plan afatgjatë i kursimeve, në veçanti në skemat pensionale-sociale, si dhe reforma në Administratën Publike.

Ne jemi të gatshëm të marrim komente edhe nga grupet tjera parlamentare. Unë besoj se është në interesin më të mirë të ruajtjes së stabilitetit fiskal të Kosovës, që është krijuar në këto vitet e fundit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, të nderuar kolegë, ju lutem për vëmendje, meqë jemi në fund të debatit.

Sipas Rregullores propozuesi duhet të protokollojë këtë mocion, do të thotë këtë projekt-rezolutë, meqë s'e ka dorëzuar në momentin kur ka parashtruar çështjen. Do të thotë, duhet të protokollohet dhe kjo pastaj do të trajtohet, ose më saktësisht Kuvendi do të deklarohet me votim bashkë me pikat tjera të rendit të ditës, të cilat për shkak të kuorumit s'kemi arritur t'i përmbyllim sot.

Unë ju falënderoj shumë për durimin dhe me këtë i mbyll punimet e kësaj seance.

\* \* \*

*E enjte, 12 korrik*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 14 qershor 2018*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli*

#### ***4. Votimi në parim i Projektligjit për aktet juridike***

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar mosmiratimin e këtij projektligji.

Votojmë në parim projektligjin, votojmë tash:

55 deputetë kanë votuar, 25 për, 20 kundër dhe 10 abstenime. Prapë nuk ka kuorum të mjaftueshëm për votim.

Edhe një herë e vendosim në votim. Votojmë tash!

56 deputetë kanë votuar, 26 për, 22 kundër dhe 8 abstenime. Edhe ky projektligj nuk ka kuorum të mjaftueshëm.

\* \* \*

#### ***4. Votimi në parim i Projektligjit për aktet juridike***

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar mosmiratimin e këtij projektligji, votojmë në parim, votojmë tash:

68 deputetë kanë votuar, 31 për, 27 kundër dhe 10 abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin numër 06/L-030 për aktet juridike.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

#### **8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale**

Largohet për momentin nga rendi i ditës sot, deri të marrim një përgjigje nga Agjencia Kundër Korrupsion.

*(Ndërhyrje nga salla)*

Cilin ta përsëris, kur ka dëshirë opozita, e përsëris çdo herë, veç edhe ju mos reagoni nganjëherë kur i nxjerr, vendimi është juaji, transparent dhe publik, në votim i nxjerr ndoshta shpesh, po vendimmarrja është juaja.

#### ***4. Votimi në parim i Projektligjit për aktet juridike***

Ka reagim të tre kolegëve deputetë se nuk kanë mundur të votojnë, edhe një herë do ta hedh në votim, duhet respektuar, edhe një herë, Rasim, e prek prapë sustën.

Komisioni Funkcional ka rekomanduar mosmiratimin e këtij projektligji, votojmë në parim projektligjin. Votoni ju lutem. Votojmë tash!

76 deputetë kanë votuar, 19 janë për, 44 kundër dhe 13 abstenime.

A më lejoni vetëm një moment, për arsye se po të ishte e kundërta, se e kemi aprovuar një herë, po të ishte e kundërta, opozita kishte bërë protesta në rrugë. Tash vetëm ta pyeti administratën, është precedent ta keni parasysh, është precedent, se e kanë votuar 61 herën e parë, kanë votuar, unë e kam rikthyer për hir të respektit për ju.

Do të kemi një interpretim të shpejtë, të keni parasysh. I kemi dy votime, do të kemi një interpretim të shpejtë.

Vazhdojmë me pika të tjera, pastaj edhe një herë mund t'i kthehemi të njëjtës çështje, me rëndësi është vendimmarrja të jetë e lirë, nuk ka rëndësi cila është vendimmarrja e Kuvendit, por të jetë e lirë.

Me 2/3 edhe ky projektligj mbetet edhe një herë, e diskutojmë bashkë.

#### ***9. Votimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017***

Komisioni Funkcional ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Diskutimet kanë përfunduar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Kanë votuar 44 deputetë. 35 janë për, 9 kanë abstenuar. Nuk kalon, për shkak të kuorumit dhe rregullave që i kemi lidhur me këtë çështje.

#### ***10. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017***

Komisioni Funkcional ka rekomanduar miratimin e këtij raporti, votojmë raportin. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Kanë votuar 45 deputetë, 43 janë për. Kundër asnjë. 2 kanë abstenuar. Të tjerët nuk kanë votuar, prandaj edhe kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për seancat e radhës, në qoftë se u mbushet mendja deputetëve që të votojnë.

#### ***11. Votimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin 2017***

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar mosmiratimin e këtij raporti. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Faleminderit!

Kanë votuar 45 deputetë. 24 për, 15 kundër, 6 abstenime. Kuorumi për votim elektronik nuk ekziston, kuorumi fizik është, në sallë janë 74 deputetë.

#### ***12. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017***

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Votojmë raportin, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

E njëjta situatë është, kuorumi fizik është, kuorumi me elektronikë nuk prezantohet në ekranin tim, prandaj shtyhet për mbledhjen e radhës, sepse kanë votuar 48 deputetë, 44 janë për, asnjë kundër, 4 abstenime.

\* \* \*

#### ***15. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021***

Votojmë, pra Propozim-rezolutën të sponsorizuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së, e cila u është shpërndarë deputetëve më 2 korrik 2018. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani.

Kanë votuar 57 deputetë. 19 vota janë për, 37 kundër, 1 abstenim. E njëjta situatë është, në sallë janë 79 deputetë. Kanë votuar 57, por nuk ka pasur kuorum. Edhe një herë e përsëris, nëse ka kërkesë, jo.

\* \* \*

*E hënë, 23 korrik 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 14 qershor 2018*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

***9. Votimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017***

Komisioni Funkcional e ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Votojmë raportin në tërësinë e tij. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

67 deputetë kanë votuar. 60 për, 7 kundër.

Miratohet raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

***10. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017***

Komisioni Funkcional ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Votojmë raportin tash!

59 deputetë kanë votuar. 53 për, 4 kundër. 2 abstenime.

Votojmë edhe një herë raportin vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017, Komisioni Funkcional ka rekomanduar miratimin e tij. Votojmë tash!  
Nuk ka kuorum të mjaftueshëm.

***11. Votimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017***

Komisioni Funkcional ka rekomanduar mosmiratimin e këtij raporti. Votojmë tash!

Me 67 deputetë që kanë votuar, 12 për, 38 kundër, 17 abstenime, Kuvendi nuk e miratoi raportin vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për vitin 2017.

***12. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017***

Komisioni Funkcional ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Votojmë tash!

67 deputetë kanë votuar. 55 për, 13 kanë abstenuar.

Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017.

\* \* \*

***15. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, 2019-2021***

E votojmë Propozim-rezolutën e propozuar nga Grupi Parlamentar, e cila u është shpërndarë deputetëve më 2 korrik 2018. Votojmë tash!

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka propozuar një Propozim-rezolutë, e keni të gjithë, kthehemi edhe një herë në votim, ju lutem, kërkoj falje. Deputetë, përgatituni për votim. 99 deputetë janë në sallë. Votojmë tash!

87 deputetë. Numër rekord i votave sot. 29 për, 47 kundër, 11 abstenime. Nuk miratohet rezoluta e propozuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

\* \* \*

***10. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017***

Komisioni Funkcional ka rekomanduar miratimin e tij. Votojmë tash!

Regjia, ndërpritet votimi. Edhe një herë provojmë, s'prish punë.

***10. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017***

A jemi gati? Votojmë tash!

E shihni edhe vetë rezultatin e votimit. Nuk ka kuorum të mjaftueshëm.

\* \* \*

***10. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017***

Komisioni Funkcional ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Votojmë raportin në tërësi tash!

Regjia edhe një herë, të lutem koncentrim. Raporti vjetor i Agjencisë, jemi kthyer në pikën e pestë të rendit të ditës, votimi i raportit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017. Pastaj pas këtij do të votojmë edhe atë me 2/3-at, po ta keni parasysh, pika e pestë është.

Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017. Votojmë tash!

A shkojmë me dorë, pasi që s'po punon. Shkojmë me dorë, vetëm ta konstatojmë sa deputetë janë në sallë. Kemi problem me elektronikë. Ju lutem, shkojmë me dorë, prisni pak.

Bilall Sherifi, urdhëroni ndërkohë derisa të përgatitemi. Fjala për ju.

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Unë derisa të përgatitet tash, qoftë votimi me dorë, qoftë elektronik, desha të lus deputetët që nuk po marrin pjesë te pika e parë e rendit të ditës që për shkak të rëndësisë që ka, jo për ne si deputetë, po për shumë biznese të vogla dhe të mesme, që presin miratimin e këtij ligji, në mënyrë që të mund të përfitojnë nga këto fonde, le të marrin pjesë në votim, le ta votojnë me 2/3-at këtë ligj dhe t'u japim mundësi që të konkurrojnë, si të gjithë bizneset e vogla dhe të mesme të vendeve të rajonit në këto fonde. Ky ishte një apel, një lutje, deputetëve që deri tani nuk deshën të marrin pjesë për çfarëdo arsye.

Pra, le të marrin pjesë në votimin e këtij ligji, sepse mazhorancat nuk bëhen për të votuar ligje të 2/3-ve, ligjet e 2/3-ve asnjëherë nuk mund të votohen pa mbështetjen e deputetëve të opozitës. Pra, edhe një herë, kryetar, po shfrytëzoj rastin derisa të rregullohet çështja e votimit për ligjin për noterinë, t'i lus le ta kalojmë këtë ligj për hir të shumë bizneseve të vogla dhe të mesme, të cilët janë duke pritur që t'u krijohet mundësia për të marrë pjesë, për të fituar të drejtën që të konkurrojnë në këto fonde. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Nënkryetari Kujtim Shala e ka fjalën.

**KUJTIM SHALA:** Faleminderit, zoti kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar kërkoj që pikën e parë, do të thotë projektligjin që nënkupton ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian ta veni edhe një herë në votim.

**KRYETARI:** Ka reflektim, Bilall. Atëherë, shkojmë e votojmë pikën e parë të rendit të ditës njëherë, pastaj gradualisht. Ku ishe, o Bilall, të flisje para dy muajsh.

Atëherë, jemi te votimi i projektligjit... Deputetët të kthehen në sallë, do të votojmë me dorë, për arsye se kemi problem me elektronikë, do të votojmë me dorë.

Sa deputetë i kemi në sallë? 93.

\* \* \*



***10. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017***

Përgatitemi për votim, përkrahja është e Komisionit FunkSIONAL, qëndrimi është juaji. Pastaj, e kemi edhe një projektligj në votimin e dytë. Votojmë tash!

Tash në mënyrë të drejtpërdrejtë. 54 deputetë janë. Ky raport nuk po kalon, po na mbetet në agjendë prapë, ky është problemi. Bile, ta votonim kundër.

Shkojmë edhe një herë te noteria. Zonja Flora Brovina e ka kërkuar fjalën.

FLORA BROVINA: Unë vetëm desha të konstatoj ndryshe nga ju prezencën e deputetëve. Prezenca e deputetëve numërohet me prezencën në sallë. Domethënë, kaq deputetë janë në sallë dhe ata në qoftë se nuk votojnë, abstenojnë. Kështu kujtoj, sekretari do ta interpretojë.

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Po, kështu unë e kuptoj shqetësimin tuaj, por e kemi...

FLORA BROVINA: Nuk është në rregull, domethënë revolta ime është se prezenca e tyre është e plotë, ishin 105 deputetë, pastaj 93-94, dhe brenda në objekt janë, por nuk po duan për çështje të caktuara partiake të votojnë dhe këtë le ta di opinionin. Ata janë këtu.

KRYETARI: Faleminderit për korrektësi! Deputetët e kanë qëndrimin e vet politik, disa mund të votojnë, disa të mos votojnë, edhe si grupime politike pastaj. Ai është aktvendim i Gjykatës Kushtetuese, atë s'mund ta ndërrojë askush. Pavarësisht mund të jenë 120 deputetë, në qoftë se nuk votojnë konstatohet që nuk kanë pjesëmarrje as në seancë. Kjo është, kuptimi në seancë ata janë, por nuk mund të konstatohen pjesë e votimit, kështu që do t'i përmbahem këtij rregulli deri me Rregulloren e re, në qoftë se ndryshojmë diçka, edhe që nuk del në divergjencë me aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese.

\* \* \*

***10. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017***

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar miratimin e këtij raporti, e votojmë raportin. Votoni tash:

Gjendja në votim ishte ajo të cilën e patë. Aktualisht kemi një pjesëmarrje shumë solide të deputetëve në Kuvend, janë 81 deputetë, por nuk ka kuorum të mjaftueshëm për votimin e raportit.

\* \* \*

*E enjte, 26 korrik 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 14 qershor 2018*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

***1. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017***

Komisioni Funkcional ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Votojmë tash!

Faleminderit! Ky është votimi. Vazhdojmë.

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*